
M. Fethullah Gylen



1

NEN HIJEN E BESIMIT

PËRMBAJTJA

PREZANTIM

INTRODUKTE

PJESA E PARE: ARGUMENTET E MONOTEIZMIT DHE QELLIMET FINALE TE KRIJIMIT

I. DISA ARGUMENTE THELBESORE MBI EKZISTENCEN E ALLAHUT

1. Argumenti i mundësisë.

2. Argumenti i akcidencës.

3. Argumenti i jetës.

4. Argumenti i rregullsisë.

5. Argumenti i artit.

6. Argumenti i kuptimshmërisë dhe qëllimit final.

7. Argumenti i dhembshurisë, mëshirës dhe ushqyerjes.

8. Argumenti i ndihmës reciproke.

9. Argumenti i pastërtisë.

10. Argumenti i fytyrave.

11. Argumenti i shtytjes hyjnore.

12. Argumenti i shpirtit dhe ndërgjegjes.

13. Argumenti i krijimit dhe historisë.

14. Argumenti i ndjenjave.

15.Argumenti i marrëveshjes

16.Argumenti i Kuranit

17. Argumenti i profetësisë.

II. SHKAQET, NATYRA DHE VETEKZISTENCA

1. Shkaqet dhe rastësitë nuk munden ta bëjnë gjithësinë.

2. Gjithësia nuk mund të bëhet vetvetiu.

3. As natyra dhe ligjet e natyrës nuk mund të jenë krijues.

4. Në unitet ka përputhshmëri.

III. PSE JANE KRIJUAR NATYRA, LIGJET E NATYRES DHE SHKAQET?

1. Ligjet dhe shkaqet janë mjete dhe pengesa ndarëse; urdhrat dhe porositë e ardhura nga lart arrijnë në pikat e takimit (të marrëdhënieve të ndërsjella) që ndodhen pas këtyre mjeteve.

2. Ligjet e natyrës dhe shkaqet janë krijuar për t'u bërë objekti i parë i ankesave të padrejta.

3. Ligjet e natyrës dhe shkaqet janë krijuar për t'ia ekspozuar shikimit artin hyjnor.

4. Gradualiteti në ligjet e natyrës dhe shkaqet.

5. Ligjet e natyrës dhe shkaqet janë rrjedhojë e domosdoshme dhe përfundim i ndodhjes sonë në vendin e urtësisë.

6. Ligjet e natyrës dhe shkaqet janë krijuar për sekretin e propozimit dhe provimin.

7. Ligjet e natyrës dhe shkaqet janë krijuar për zhvillimin e ideve, për formimin e diturive, shkencave dhe qytetërimeve.

8. Ligjet e natyrës dhe shkaqet, duke prodhuar një ambientim, afërsi dhe shprehi të caktuar, e bëjnë jetën të dashur.

IV. NATYRA, LIGJET E NATYRES DHE SHKAQET NUK MUND TE JENE KRIJUESI DHE ADMINISTRUESI I VERTETE

1. Ligjet dhe shkaqet ekzistojnë me materien.

2. Ligjet dhe shkaqet janë nga gjërat e mundshme.

3. Ligjet dhe shkaqet janë të krijuara pas, pra, akcidenciale. Për rrjedhojë, gjëja që s'është e pafundme, s'mund të jetë as e pafillimtë.

4. Ekzistenca e ligjeve dhe shkaqeve është nevojtare ndaj shkaqeve të tjera.

5. Ligjet dhe shkaqet janë gjëra konvencionale; ato s'kanë trup të vërtetë dhe individual.

6. Ligjet dhe shkaqet japin rezultate duke u mbështetur në ligje dhe shkaqe të tjera për të cilat kanë nevojë.

7. Mes ligjeve dhe shkaqeve, nga njëra anë, dhe rezultateve, nga ana tjetër, nuk ka përputhje.

8. Ligjet dhe shkaqet nuk mund të jenë krijues sepse janë nevojtarë për të kundërtat e tyre.

9. Disa herë, edhe pse bashkohen të gjitha shkaqet, rezultat nuk ka; disa herë, rezultati del në shesh edhe pa u formuar shkaqet e duhura.

10. Ndërsa nevojat e njeriut si shkaku më i lartë dhe i aftë, zgjaten gjer në pafundësi, mundësia e tij është e barabartë me zero.

V. PSE ALLAHU NUK I KRIJOI NJEREZIT TE NJEJTE DHE TE BARABARTE? PSE NJE PJESE NJEREZISH JANE TE PASUR, KURSE NJE PJESE TJETER, TE VARFER? NDERSA NJE PJESE NJEREZISH NUK KANE ASNJE PROBLEM FIZIOLOGJIK, PSE NJE PJESE TJETER JANE TE VERBER, TE ÇALE OSE ME GJYMTIME TE TJERA? NGA ANA TJETER, SHIHET SE, NDERSA DISA NJEREZ VUAJNE NGA FATKEQESI OSE KOKEÇARJE TE NDRYSHME, DISA TE TJERE ÇOJNE NJE JETE TE QETE E NE MIREQENIE. Ç'KUPTIM MUND TE KENE TE GJITHA KETO, CILAT MUND TE JENE URTESITE DHE SHKAQET E KETYRE?

1. Njeriu e do atë që njeh me aq sa e njeh.

2. Gjithë qenia, përfshi edhe njeriun, gjithë krijimi është pasuri e Zotit.

3. Allahu ka emra të pafund.

4. Në gjithësi sundojnë të kundërtat.

5. Krahas shumëllojshmërisë së formës dhe përmbajtjes së pyetjeve testuese dhe provimeve të zhvilluara për çdo profesion në rrugën për të arritur në përfundimin e dëshiruar, do të jenë të shumëllojshme e të ndryshme edhe numri, vështirësitë dhe lehtësitë e tyre.

6. Bota është shpenzim, jeta e pasme, fitim.

7. Shqetësimet dhe fatkeqësitë janë përjashtime dhe zënë një kohë shumë të shkurtër në raport me jetëgjatësinë mesatare të një njeriu.

8. Drejtësia shpreh kuptimin e një ekuilibri.

9. Jo vetëm që s'është e mundur t'i bëjmë njerëzit të zotërojnë mundësi në të njëjtin nivel, por një gjë e tillë s'është as e dobishme!

10. Botëkuptimi i barazisë ose barazitizmi.

11. Le të përpiqemi ta plotësojmë çështjen në aspektin që ka të bëjë me kokëçarjet dhe fatkeqësitë duke u shtuar një përmbledhje gjërave që thamë më lart.

PJESA E DYTE: SHPIRTI, ENGJELLI, XHINDI DHE DJALLI

I. EKZISTENCA E SHPIRTRAVE, ENGJEJVE, DJAJVE DHE XHINDEVE

1. Ekzistenca e këtyre krijesave është e fiksuar me pohimet e Kuranit dhe të Profetit (s.a.s.).

2. Fakti që nuk i shohim këto qenie, nuk argumenton mosekzistencën e tyre.

3. Këto qenie nuk janë të dimensioneve tona të shikimit, vëzhgimit, perceptimit dhe njohjes.

4. Shpirti te njeriu që është mikrokozmos, është si engjëlli në makrokozmos.

5. Gjithësia është përgatitur për qenie me jetë dhe vetëdije.

6. Jeta nuk varet nga lënda prej së cilës përbëhet.

7. Dukuritë që ndodhin në gjithësi nuk mund t'ua dedikojmë ligjeve imagjinare.

8. Janë një turrë dukurish dhe ngjarjesh që u japin shpjegim çështjeve mbi engjëjt, xhindet dhe shpirtrat.

9. Në botën tonë ka jetë; edhe ekzistenca e jetës së llojeve të ndryshme në planetet e tjerë është gjithmonë e mundshme.

10. Si bilbilat e kopshtit botë, janë edhe bilbilat që këndojnë bukuritë e gjithësisë.

11. Profetët dhe të urtët kanë njoftuar ekzistencën e engjëjve, xhindeve dhe shpirtrave, kurse filozofët dhe dijetarët i kanë vërtetuar.

12. Janë dy pole që përfaqësojnë forcat e të mirës dhe të keqes në natyrën e njeriut: engjëlli dhe djalli.

II. SHPIRTI: EKZISTENCA, NATYRA DHE ARGUMENTET SPECIFIKE

1. Shpirti është një qenie e vetëdijshme që vjen nga bota e urdhrit.

2. Shpirti jo vetëm nuk mund të përshkruhet, por as të kuptohet me anë të informacionit njerëzor.

3. Tek ne, elementi që flet kur hesht lënda jonë, është shpirti ynë.

4. Shpirti ka një formë dhe trup precedencial të posaçëm.

5. Thuhet se janë bërë fotografi të trupit precedencial me anë të metodës cirliane.

6. A mundet trupi precedencial të ndahet nga trupi fizik për të udhëtuar dhe a mund të duket duke u shëmbëllyer në të njëjtën kohë në disa vende?

III. A MUND TA SHOHE SHPIRTI TE ARDHMEN? INFORMACIONI I TE URTIT MBI TE ARDHMEN. THIRRJA E SHPIRTRAVE, PARANDJENJA, TELEPATIA, SPIRITIZMI DHE JOGA

1. Parashikimet për ngjarjet e së ardhmes janë bërë sipas njoftimit të Allahut.

2. Kapërcimi i kohës dhe hapësirës mund të bëhet vetëm duke hyrë në nivelin jetësor të shpirtit.

3. Profetët dhe të urtët kanë dhënë njoftime për të ardhmen duke ia ngarkuar Allahut dijen e tyre.

4. Parandjenja dhe telepatia.

5. Për njeriun që e bën të afërt, Zoti bëhet syri, veshi dhe dora e tij.

6. Spiritizmi dhe joga janë përvoja shpirtërore metafizike.

7. Seancat e thirrjes së shpirtrave janë operacione të hyrjes në lidhje me fuqi metafizike të padukshme e të panjohura.

IV. ENDRRAT

1. E vërteta dhe llojet e ëndrrës. Shpirti në ëndërr sheh të ardhmen.

2. Ëndrrat e vërteta ose besnike

3. Disa shembuj lidhur me ëndrrat besnike.

V. KOMANDUESI I TRURIT DHE TRUPIT ESHTE SHPIRTI

1. Shpirti është ose sunduesi i trupit, ose i burgosuri në trup.

2. Funksionet e trurit kryhen me anë të reaksioneve në qelizat nervore.

3. Po qe se njeriu do të ishte identitet vetëm i materies, do t'i humbte prindërit.

4. Po qe se njeriu do të ishte vetëm një qenie materiale, atëherë morali, karakteri dhe aftësitë e tij do të ndryshonin bashkë me ndërrimin e qelizave.

5. Në kundërshtim me ngjashmëritë e rregullta mes njerëzve në qelizat dhe funksionet trunore, dallimet e mëdha mes tyre në mendje, arsye, vullnet, vetëdije, mendime dhe ide tregojnë se nuk janë funksionet apo ndryshimet qelizore dhe fiziologjike ato që përcaktojnë identitetin e njeriut.

6. Përparimi i njeriut me anë të ndjenjave, ndijimeve dhe njohjes drejt të vërtetave të gjera, përsosja e tij me anë të meditimit objektiv dhe subjektiv si dhe përpjekja e tij për t'i thurur hojet e besimit me anë të përpjekjeve për t'i njohur emrat (atributet) hyjnore e me anë të mundësive të tij kulturore e shpjeguese, nuk mund të arsyetohen me anë të strukturës së tij lëndore.

7. Kush lodhet, shpirti apo kurmi (kufoma)?

8. Ndërsa qelizat na ndërrohen pandërprerë, fytyra dhe pamja na mbeten të pandryshuara, gjë që tregon se secili ka një shpirt të posaçëm për vete.

9. Fytyra është pasqyra e pandryshueshme e shpirtit.

10. Krijimi i lidhjeve të shpirtit të ardhur nga bota e urdhrit, me botën materiale, është i mundur me anë të mjeteve të tilla si dora, krahu, gjuha dhe syri që zgjaten në botën e dëshmisë.

VI. ÇESHTJE TE NDRYSHME

1. Ndërgjegjja dhe krijimi kurrë nuk gënjejnë. Ndërgjegjja e një njeriu që nuk i është prishur natyra e krijimit, e gjen dhe e njeh Zotin e vet.

2. Një nga pikat ku njeriu veçohet nga kafshët është edhe konceptimi i kohës nga shpirti.

3. Ndjenja e përjetësisë dhe dëshira për të qenë i përjetshëm i përkasin shpirtit i cili është kandidat i përjetshmërisë.

4. Ndërprerja e funksioneve jetësore dhe vdekja shkaktohen nga largimi i shpirtit prej trupit.

5. Shpëtim nga vdekja s'ka!

6. Kujdesi që tregohet për të vdekurin, nuk është për kufomën që do të kalbet e tretet.

7. Pse shpirti është bërë i panjohur e i padukshëm?

8. Me argumentet që e vërtetojnë, shpirti argumenton Krijuesin e vet dhe lajmëron me zë të lartë se Ai ekziston!

9. Etapat që do të kalojë shpirti pas vdekjes.

10. Si merren shpirtrat?

11. Si duket engjëlli në çastin e vdekjes?

12. Si hiqet shpirti prej trupit dhe si merret?

13. Ç'ndjejnë kafshët duke ngordhur?

14. Ç'ndodh me shpirtin pas vdekjes së njeriut?

15. Ç'bën shpirti në botën e pritjes?

16. A mund të mbeten gjallë disa organe ose gjymtyrë pas vdekjes së njeriut dhe ndarjes të shpirtit nga trupi?

17. A do të ringjallet edhe kufoma së bashku me shpirtin?

18. Kush e vuan ndëshkimin e xhehenemit, shpirti apo trupi?

19. Cilat janë dhuratat më të mëdha që mund t'u dërgojmë shpirtrave pas vdekjes?

VII. VEÇORITE E ENGJEJVE, XHINDEVE DHE DJAJVE

1. Veçoritë e engjëjve.

2. Kur mbron engjëlli dhe kur shfaqet?

3. Dobitë e besimit te engjëjt

4. Xhindet janë krijuar nga zjarri pa tym e pa prush.

5. Si njerëzit, edhe xhindet janë të ngarkuar me besim dhe adhurim.

6. Lëvizjet dhe veprimet e engjëjve dhe xhindeve nuk janë të kushtëzuara dhe të kufizuara nga koha dhe hapësira.

7. Në krahasim me njerëzit, engjëjt dhe xhindet mund të bëjnë punë më të mëdha e më të rënda.

8. Sa është numri i engjëjve dhe xhindeve?

9. Shëmbëllimi i engjëjve dhe xhindeve, dukja e tyre duke marrë formë dhe entitet të caktuar

10. A mund të hyhet në lidhje me xhindet? Në ç'kushte xhindet mund t'u shkaktojnë dëme njerëzve?

11. A është e vërtetë magjia dhe a mund të bëhet magji?

12. A mund të vihen në punë xhindet në të ardhmen?

13. A mund të bëhen xhindet shkak për sëmundje?

14. Ç'duhet bërë e ç'duhet kënduar për t'u mbrojtur nga e keqja e xhindeve?

VIII. DJALLI DHE DYSHIMI

1. Djalli dhe funksioni i tij.

2. Cila është urtësia e krijimit të djallit dhe e lejimit të tij për t'i prapësuar njerëzit?

3. Ç'është dyshimi?

4. Ç'është shenja e djallit?

5. Cilët njerëz dyshojnë më shumë?

6. Cili është qëllimi i djallit për të shkaktuar dyshim?

7. Ç'do të thotë që djalli i afrohet njeriut nga e djathta, nga e majta e nga drejtime të tjera për ta goditur?

8. A ka dyshimi anë të dobishme?

9. Masat parandaluese për të shpëtuar nga dyshimi.

PJESA E TRETE: MENDIME MBI KADANE, KADERIN DHE FALJEN

INTRODUKTE

ENDRRAT DHE KADERI

Pyetje: Pse kanë hyrë kaderi dhe vullneti mes gjashtë parimeve besimore?

Pyetje: A mund të lexohet kaderi i njeriut nga vijat e duarve ose të fytyrës?

I. NIVELET E KADASE DHE KADERIT

A) Kadaja dhe kaderi nga këndvështrimi i dijes hyjnore

B) Kadaja dhe kaderi nga këndvështrimi i dokumentimit

C) Kadaja dhe kaderi nga pikëpamja e dëshirës hyjnore

D) Kadaja dhe kaderi nga pikëpamja e krijimit.

II. DITURIA HYJNORE DHE MARREDHENIA E SAJ ME KADERIN

III. SUBJEKTI I VULLNETIT TE PJESSHEM

A) Argumentet mbi ekzistencën e vullnetit të pjesshëm

B) Kuptimi dhe përmbajtja e vullnetit të pjesshëm

IV. RRUGA E MESME NE MARREDHENIEN KADER-VULLNET

a) Allahu e ka shkruar kaderin duke e ditur që më parë se si do ta përdorim vullnetin tonë

b) Nuk mund të bëhet fjalë për një kader të njëanshëm ku s'llogaritet vullneti

c) Kaderi përfaqëson tërësinë unike të shkaqeve dhe shkaktarëve; edhe mjetet në dorë të vullnetit janë të shënuara në Librin e Kaderit

d) Si përfundim, kaderi e mbështet vullnetin dhe që të dy shkojnë paralelisht. As kaderi s'e mohon vullnetin, as vullneti s'e mohon kaderin.

V. KADERI, KADAJA DHE LIGJET E FALJES

VI. ÇËSHTJE TE VEÇANTA LIDHUR ME KADERIN DHE VULLNETIN

M. FETHULLAH GYLEN:
NËN HIJEN E BESIMIT - 1
Përkthyes: Dr. MITHAT HOXHA

Titulli i origjinalit turqisht:
M. FETHULLAH GÜLEN:
İNANCIN GÖLGESİNDE - 1
İzmir - 2001

E përktheu nga origjinali: Dr. Mithat Hoxha
Korrektore: Flora Hoxha
Tiranë, maj-korrik 2004

Kjo vepër
është një përmbledhje bisedash të zhvilluara nga autori
në kohë dhe auditorë të ndryshëm

PREZANTIM

Është një e vërtetë dhe realitet në nivelin e çështjeve mbi besimin dhe Islamin se, në parashtrimin e tyre, ndodhemi në një periudhë kur kërkohet të bëhet më shumë shpjegimi i *pse*-ve dhe *përse*-ve, sesa i *si*-ve. Ndërkaq, asnjë mendje e shëndoshë dhe ndërgjegje e kulluar që është e denjë jo vetëm për t'i klasifikuar dukuritë, por edhe për të bërë sintezat e duhura, nuk mund ta mohojë këtë të vërtetë. Sepse në ditët tona, shkencat e natyrës dhe filozofia, duke marrë forcë edhe nga zhvillimet marramendëse të zhvillimeve teknike, po jetojnë ditët më të pamëshirshme të veprimtarive për ta tharë nga rrënjët pemën e besimit e cila duhet t'i ketë rrënjët në mendjen e njeriut, kurse degët dhe frutat, në zemrën e tij!

Siç është e pamundur për të marrë fruta nga një pemë me rrënjët të thara, ashtu është e pamundur për të mbledhur fryte cilësore të llojit *si* nga një *besim* i tharë prej *pse*-ve dhe *përse*-ve.

Hapësira e shkatërruar në fillim duhet meremetuar, pastaj, rregulluar e forcuar dhe, më pas, po të duhet, duhet stolisur. Stolisja para meremetimit dhe përforcimit është pa dobi, përforcimi para meremetimit është i panevojshëm, kurse meremetimi që nuk ndiqet nga rregullimi dhe përforcimi, është, shpesh, që t'i vret sytë. Prandaj, si në çdo çështje, edhe këtu, çlirimi prej qëndrimit të paqëlluar të skajshëm majtas apo djathtas për të ndjekur rrugën e mesme, do të ishte parimi i pashmangshëm i gjetjes së të drejtës.

T'i bësh qëllim në vetvete argumentet racionale për të rënë në idenë fikse të dialektikës dhe demagogjisë, është po aq një deviacion ideor sa ç'është shterpëzim në ide t'i nënvleftësosh ato duke i kundërshtuar plotësisht. Në fakt, që të dyja këto ide fikse janë dy fytyrat e të njëjtës së vërtetë. Gabimi në diagnostikim qëndron te pranimi i këtyre dy fytyrave të të njëjtës së vërtetë si dy të vërteta më vete. Sidomos, duke parë vetëm pasqyrën fikse të të vërtetave të veta, këto dy mënyra të ndryshme mendimi kanë krijuar dhe krijojnë humnera shumë të vështira për t'i mbyllur. Mirëpo pak mendim larg sentimentalizmit dhe arsyetim i gjithanshëm mund t'i bashkojë këto dy skaje për t'i bërë të pashkëputshme. Dihet se burrat e mëdhenj të Islamit si imam Gazaliu dhe poeti Xhelaledin Rumi, i mbiquajtur Mevlana, në shumë vende të veprave të tyre, duke përdorur edhe ndikimin e diagnozës mbi sugjerimin, kanë vërtetuar se preokupimi me argumente racionale për të arritur te e vërteta është humbje kohe dhe se njeriu që i shpenzon përpjekjet vetëm për të mbledhur argumente racionale, për rrjedhojë, nuk do të ketë më fuqi për të arritur te e vërteta. Njeriun që përpiqet ta arrijë të vërtetën me argumente racionale, Gazaliu e përngjason me njeriun që, megjithëse ka vënë si qëllim të shkojë në haxh (pelegrinazh), mbetet pa u nisur ngaqë merret me përgatitjen e kalit! Sipas tij, ky preokupim nuk e çon njeriun te e vërteta, por e privon prej saj. Kurse Mevlana e

përngjason njeriun që përpiqet ta gjejë të vërtetën me argumente, me të mjerin që, *megjithëse ndodhet para Qabes, kërkon kiblen*!

Shqyrtimi i specifikave që i kanë detyruar Gazaliun dhe Mevlanën për t'u sjellë ftohtë ndaj argumenteve racionale, është një çështje më vete. Çdo fjalë e thënë pa analizuar etimologjinë e koncepteve dhe shprehjeve që i përkasin asaj periudhe, nuk mund të shpëtojë nga sipërfaqësia. Ndërkaq, një analizë e tillë etimologjike është e mundur duke rishqyrtuar çështjet e apologjetikës islame të formuar gjer në atë periudhë, lidhur me çështjen në fjalë, dhe duke u bërë atyre një shqyrtim të ri. Duke ua lënë këtë aspekt të çështjes penave kompetente të asaj fushe, ne të përpiqemi ta paraqesim çështjen me nja dy analiza të vogla.

1) Preokupimi me argumente racionale në periudhën kur patën jetuar njerëzit e mëdhenj të Islamit që i përmendëm më sipër, ka qenë jo më shumë nevojë sesa fantazi paradoksale, sepse besimi ka qenë i shëndoshë e i fortë dhe nuk kishte nevojë për meremetim dhe përforcim me argumente. Në të njëjtën kohë, meremetimi që do të kërkohej të bëhej pa qenë e domosdoshme e pa patur nevojë, nuk do të kishte ndryshim nga rrënimi. Prandaj u qenë kundërvënë ata argumenteve racionale që bartnin mundësinë për t'u bërë shkak për një rrënim të tillë.

2) Preokupimi me argumente racionale në një periudhë të pushtuar nga filozofia greke me anë të përkthimeve të bëra prej saj, qe shndërruar në një pasion të sëmurë, të tillë që diskutimi në këtë atmosferë i vlerave të argumenteve racionale ishte aq i pakuptimtë, sa ç'mund të ishte e pakuptimtë nxitja për ta dashuruar Mexhnunin! Në të njëjtën kohë, duhet të ishte dikush që t'u kërkonte një parullë mendimeve filozofike të pranuara pa u bërë asnjë kritikë, dhe ata këtë bënin.

3) Ndërsa argumentet racionale duhet të ishin vetëm pretekste dhe mjete në rrugën që shkonte për tek e vërteta, ato ishin shndërruar në qëllim dhe synim. Ja pra, edhe Gazaliu me Xhelaledin Rumiun, edhe të gjithë autoritetet që mendonin si ta, kërkonin t'i jepnin orientim këtij devijimi.

4) Këtë qëndrim e bënte të domosdoshëm etika e gjendjes dhe pozitës ku ndodheshin ata. Gjithashtu, mjekimi i sëmundjeve moralo-shpirtërore të shfaqura në periudhat e tyre kërkonte metodën mjekuese të përdorur prej tyre.

5) Njerëzit e mëdhenj i ngjajnë ujit të pastër e të kthjellët. Ata formësohen sipas përmasave dhe konfiguracionit të periudhës kur jetojnë. Dhe ky zhvillim merr formë plotësisht në vartësi të kushteve përkatëse. Veprat e shkruara në atë periudhë janë shembulli më domethënës i kësaj.

Njeriu i ditëve të sotme ka nevojë më shumë se kurrë më parë për përforcimin e mundshëm me argumente racionale të të gjitha çështjeve të parashtruara atij me anë të informacionit të përcjellë. Por kjo duhet mbajtur në nivelin e veprimit të thyerjes së guaskës për të zbritur në bazë. E thënë ndryshe, thyerja e guaskës është kusht për ta shijuar origjinën, por jo kushti i vetëm. Kurse përsëritja e këtij veprimi nga të mëdhenjtë është që atë që e kanë shijuar vetë, t'ua mundësojnë për ta shijuar edhe atyre që e kanë një kapacitet të tillë.

Me shikimet dhe vështrimet e tyre të hedhura mbi faktet e jetuara, ata ishin të çliruar nga nevoja për çdo lloj argumenti dhe prove. Këta të lumtur që shëtisnin me njërën këmbë në pozita tejet të larta, këmbën tjetër nuk e shkëputnin nga toka në mënyrë që të kapnin nga dora edhe shumë të tjerë për t'i ngjitur atje. Kishte nevojë për ta që t'i ngjisnin në nivelin e jetës së shpirtit dhe zemrës të mjerët që kishin ngecur të shtrënguar në pengesën e lëndësores. Por duhet pranuar se kthimi i tyre, për këtë qëllim, te argumenti dhe prova, ishte vetëm një sakrificë.

Sepse këtë moral ata e patën mësuar kështu nga Zotëria i Dy Botëve (s.a.s.) që kishte vënë këmbën në pikat ku s'kishte arritur askush tjetër, ku s'kishte mundur të arrinte as dhe vështrimi i Xhebrailit! Kthimi pas i tij nga miraxhi është mësimi filozofik më i madh. Qëllimi, të gjendej mjalti i mjalteve, të aftësoheshin edhe të tjerët për ta gjetur!

"Nën hijen e besimit" u përgatit për t'i shërbyer një qëllimi të tillë. Dhe po me këtë qëllim po ju ofrohet edhe juve, lexues të dashur duke shpresuar se do të mbeteni të kënaqur e të lumtur!

Shtëpia Botuese "Prizmi"

INTRODUKTE

Besimi është identitet i pranimit të Islamit me gojë dhe i vërtetimit të tij me zemër. Besimi është burim i pafund fuqie dhe force. Vetëm se për të marrë frytin e kërkuar dhe rezultatin e dëshiruar, është kusht që besimi të mbështetet me veprimin.

Ndërkaq, kryerja e veprimit nga njeriu sikur ta kishte para Allahun dhe ta shihte, quhet *ihsan* mirësi.

Besimi dhe mirësia janë si drita në sy dhe shpirti në kurm. Kurse plotësimi i adhurimeve të detyrueshme (farz) dhe suplementare (nafile) është si një shpalosje dykrahëshe dritësore në qiejt e amshueshmërisë.

Po, më e sigurta, më e shkurtra dhe më e pranueshmja e rrugëve që e afron njeriun te Zoti, është kryerja e detyrimeve. Kurse të qenët adhurues i vërtetë i Zotit dhe i afërt i Tij arrihet në atmosferën besnike, të gjerë e të pafund të adhurimeve suplementare të pakufizuara e të pakushtëzuara.

Udhëtari për tek e Vërteta e gjen veten çdo çast, nën krahët e një adhurimi suplementar të veçantë, në një korridor të ri që zgjatet drejt pafundësisë, e ndjen se ka arritur një meritim të ri dhe bëhet më kërkues për të kryer adhurime të detyrueshme dhe më dëshirues ndaj adhurimeve suplementare. Çdo shpirt që ka arritur këtë pikë dhe këtë kuptim, e ndjen edhe se Allahu e do dhe, siç shprehet në një hadith të shenjtë, tashmë ai nis të dëgjojë, të shohë, të prekë, të ecë drejtpërdrejt në kushtet e posaçmërisë së afërsisë hyjnore. Nga një aspekt, kjo është edhe intuita e njohjes së Zotit. Ky është niveli ku njohja bëhet një me njohësin dhe kthehet në natyrë të tij dhe ku çdo gjendje e njohësit bëhet interpret i gjësë së njohur. Ka pasur njerëz që e kanë përkufizuar "marifetin" (intuitën e njohjes së Zotit) si zbulim dhe zhvillim të informacionit ndërgjegjësor, i cili, në të njëjtën kohë, konsiderohet edhe si zbulim dhe zhvillim i njeriut me vlera që janë të posaçme për të. Kjo duhet të jetë edhe një formë e shprehjes "kush njeh vetveten, njeh Zotin"!

Shkalla e parë e intuitës së njohjes së Zotit është vështrimi dhe ndjerja e emrave ose atributeve hyjnore që na rrethojnë nga të katër anët dhe udhëtimi në atmosferën mahnitëse të atributeve hyjnore pas portës së të fshehtave të hapur me këto shfaqje. Gjatë këtij udhëtimi, fjalës së udhëtarit të së Vërtetës i pikojnë vazhdimisht dritë nga syri dhe veshi, zemra fillon t'ia urdhërojë sjelljet, sjelljet i kthehen në gjuhë që vërtetojnë dhe njoftojnë Zotin dhe kjo gjuhë bëhet pothuaj si një disketë fjalësh të ëmbla dhe, ndërkaq, në ekranin e ndërgjegjes së tij fillojnë të reflektohen drita veç e veç nga e vërteta plot dritë "te Ai ngjiten vetëm falët e bukura të cilat i ngjisin aktet e mira"[1]. Tashmë një shpirt i tillë mbyllet ndaj të gjitha ndjenjave dhe

[1] Kuran, Fatir, 10.

pasioneve të këqija dhe një zemër e tillë kapet pas frymëzimeve që vijnë prej përtej. Kapet dhe, nga një e çarë enigmatike e hapur për shpirtin e tij, hapen – siç shprehet në pohimin metaforik që kërkohet të sqarohet për atë që dihet fshehtësisht në zemra me anë të idesë së vargjeve të Ibrahim Hakiut, *"nuk më nxënë, tha Zoti, tokë e qiej / në minierën e ndjesive i fshehur u zbulua"* - korridore drite dhe njeriu arrin kënaqësinë e një soditjeje, nga e cila nuk mendon të ndahet e të kthehet pas.

Kjo pikë ku udhëtari i së Vërtetës mbyllet krejtësisht ndaj të tjerëve, të huajve, ku kalon krejtësisht në tendosje kundër frymësores dhe egoizmit dhe ia lëshon veten vajtje-ardhjeve të prehjes dhe kënaqësisë, është pika e intuitës metafizike. Atij që sillet rreth kësaj pike, i thuhet "irfan",udhëtim në kulturën shpirtërore, kurse atij, kryet e të cilit ka arritur në këtë pikë, i thuhet arif, njohës i kulturës shpirtërore.

Ashtu si në kopshtet e xhenetit, parajsës, jeta në klimën e intuitës metafizike është krejt e kthjellët dhe krejt e qetë, e çliruar prej çdo lloj preokupimi dhe shqetësimi, shpirti është gjithë krahëhapur me ndjenjën e arritjes te pafundësia, zemra, e hareshme si një fëmijë, me ëndjen e arritjes së ngopjes dhe kënaqësisë, por, po aq e matur dhe e kujdesshme...

Njohësit e kulturës shpirtërore gdhihen e ngrysen në klimën e shprehjes "ata nuk dinë të kundërshtojnë në gjërat e urdhëruara nga Allahu, përkundrazi, i çojnë në vend ato"[2] dhe vijnë një më një me engjëjt. Këta shpirtra me ndjenjat të hapura si burbuqe ndaj njohjes së Zotit, disa herë në ditë hapen fletë-fletë sikur të udhëtonin në majat e së premteve të xhenetit, parajsës, dhe çdo çast vijnë në një dimension tjetër sy më sy me mikun dhe arrijnë ëndjen e konfidencës me të. Për sa t'i kenë sytë në të hapurën e portës së Zotit, çdo ditë, ndoshta dhe disa herë në ditë, dehen nga konfidenca hyjnore dhe çdo çast ngrihen peshë me një shfaqje hyjnore të veçantë.

Le të merren me dijen e tyre dijetarët që merren me dije, le t'i rrëmojnë idetë filozofike ata që merren me filozofi! Njohësi i kulturës shpirtërore brenda një prizmi drite gjithë përcjell qetësi e kënaqësi, mërmërit qetësi e kënaqësi. Edhe në çastet kur tronditet nga mahnitja dhe frika, madje, ai ndjen një ëndje të amshuar dhe zemra i qesh edhe kur sytë pothuaj i derdhin lot!

Krahas këtyre veçorive të përbashkëta, mes njohësve të kulturës shpirtërore bien në sy dallime natyrore dhe disa dasi. Ndërsa disa, me heshtjen dhe thellësinë e tyre, të kujtojnë vorbullat, disa të tjerë janë të zhurmshëm si përrenjtë e rrëmbyer. Disa një jetë të tërë qajnë për mirësitë dhe mëkatet e veta por pa u ngopur as me rënkime e as me madhërimin e Zotit të tyre dhe të pangopur mërgojnë e ikin nga kjo botë. Kurse disa të tjerë udhëtojnë vazhdimisht në atmosferën e mahnitjes-turpit-familjarizimit pa menduar kurrë për të dalë nga ky det në breg. Disa janë krejt si toka; kushdo që kalon aty pari, shkel mbi ta. Disa të tjerë janë si reja; marrin nën vete këdo duke i spërkatur me pika mëshire. Kurse disa të tjerë janë si ajri; fryjnë gjithmonë mbi ndjenjat tona me frymëra aromatizuese.

Të merituarit e njohjes intuitive të Zotit kanë shenjat e veta. Njohësi i kulturës shpirtërore nuk pret interesim dhe konsideratë prej dikujt tjetër veç Zotit, nuk veçohet kokë më kokë me tjetërkënd veç Tij, nuk ia hap kapakët e syve dhe portat e zemrës tjetërkujt veç Tij. Për njohësin e vërtetë të kulturës shpirtërore, interesimi ndaj një tjetri, dëshira për t'u veçuar kokë më kokë (*halvet*) me dikë tjetër dhe përfytyrimi i një tjetri janë ndëshkimi më i madh dhe vuajtja më e madhe. Ai nuk e dallon dot gjysmë të huajin që nuk e arrin dot intuitën e vërtetë të njohjes së Zotit. Ai nuk mund ta dijë ç'është vuajtja e ndarjes nga Zoti...

Nga një aspekt, "fakti" vjen pas intuitës. Në çdo minutë, në çdo sekondë në çdo gjysmë, në çdo të dhjetë të sekondës së jetës së njeriut, ai ka kuptimin e hapjes ndaj një horizonti të ri, e hapjes së velave në një det të ri. Njohja faktike është një kërkim. Kërkimi i të pakufishmes nga njeriu i kufizuar. Jeta e një njeriu të tillë është e ndriçuar me të tëra. Në ndërgjegje i pikon ekzistencë pa pushim. Dhe ai e jeton jetën vazhdimisht

[2] Tahrim, 6.

mes ndriçimesh. Për respekt të tij ngrihen e shtrohen njëra pas tjetrës sofra qiellore. Është sikur Profeti të mos ketë vdekur, zbulesa hyjnore të mos jetë ndërprerë dhe këmba e Xhebrailit të mos jetë shkëputur prej toke. Ai u përgjigjet me entuziazmin e zemrës frymëzimeve që vijnë prej përtej.

Fakti (*jakin*) është i tillë që të bën t'i besosh çështjet që duhen besuar pa i dhënë mundësinë më të vogël të kundërtës. Në matematikë, dy herë dy bëjnë katër. Por, për sa i përket planit cilësor, numrat mund të mos jenë në të gjitha kushtet të të njëjtës vlerë dhe nivel, për rrjedhojë, ky përfundim mund të kritikohet, pra, jo gjithmonë dy herë dy mund të bëjnë katër! Ja, nga ky këndvështrim, koncepti *"jakin"*, në tërë gjerësinë e tij semantike, është një bindje dhe besim që, për karakterin e vet cilësor dhe kategorik, qëndron mbi të gjitha llojet e kritereve dhe masave matematike. Fundja, vetëm me një bindje dhe besim të tillë mund të vëzhgohen, në bukuritë që shfaqen pothuaj çdo çast dhe në çdo aspekt të qenies, përvijimet e shfaqjeve të bukurisë dhe përsosmërisë së Zotit, i cili është i Bukur dhe Absolutisht i Përsosur, dhe të arrihet në pikën e quajtur "ëndje shpirtërore"! Njeriu që arrin bindjen dhe besimin faktik, e ndjen veten vazhdimisht në majat parajsore të tij. Ndjesitë i mbushen e i zbrazen çdo çast me pasuri të reja ndjesore. Ai e ndjen veten çdo çast tjetër njeri dhe e rinjeh Zotin përsëri. Ja kjo është të bësh tufa lulesh nga lulishtet dhe të mbledhësh fruta nga kopshtet e Arshit!

Si fillim, fakt do të thotë nisje për dobi, kurse si përfundim, do të thotë arritje në bindje dhe siguri, si dhe ngopje. Po të ngopet njeriu me çdo gjë tjetër veç Zotit, nuk i mbetet oreks për Të dhe, po të ngopet me Të, nuk i mbetet oreks për gjëra të tjera. Ata që e ndjekin këtë botë me ambicie, janë njerëz që nuk kanë mundur ta marrin pjesën që u përket prej Tij. Njeriu i tendosur në bindjen ndaj Zotit është i mbyllur ndaj çdokujt dhe çdo gjëje tjetër. Zemra e tij, krejt si një busull që tregon kiblen, orientimin e faljes, shënon vazhdimisht kënaqësinë e Zotit dhe shigjeta e ndërgjegjes së tij nuk bën as shmangien më të vogël. Kjo është një shkallë e lartë fakti, e tillë që, çdo shpirt që ngjitet në të dhe udhëton në atë nivel, ndjen në çdo konak një frymëmarrje të re të premtimit: "Për miqtë e Zotit nuk do të ketë frikë dhe ata nuk do të shqetësohen!"[3] Pastaj dëgjon sihariqin: "Mbi ta zbresin engjëjt dhe thonë: "Mos kini frikë, mos u shqetësoni, por gëzohuni për xhenetet që ju janë premtuar!"[4] Dhe e përjeton me të gjithë qenien kënaqësinë e pohimit: "Dijeni se zemrat vetëm me përmendjen e Allahut gjejnë qetësi!"[5]

Siguria (*itminan*) është cilësia e qenies së njeriut mbi shkaqet dhe përtej mjeteve të ndërmjetme. Në këtë shkallë e përfundon mendja udhëtimin e saj mbinatyror. Shpirti shpëton nga dyshimet e kësaj bote kur arrin në këtë pikë. Në këtë konak enigmatik i gjejnë ndjesitë të gjitha gjërat që kërkojnë dhe, nga pikë, bëhen det!

Ka rrugë më vete që e çojnë njeriun në këtë pikë. Në krye të rrugëve në fjalë vijnë dituria dhe meditimi.

Dituria përbëhet prej ndjerjes, perceptimit dhe konceptimit të gjërave që na tregojnë materia dhe dukuritë, që na i derdhin dhe vënë para urdhrat e krijimit, si dhe prej kuptimit të synimeve të larta të Krijuesit. Njeriu i krijuar në pozitën për të sunduar mbi materien, do të shohë, do të lexojë, do të ndjejë dhe do të mësojë. Dhe, pasi të ketë mësuar, do të kërkojë rrugën për t'u imponuar dukurive fjalën e vet e për t'i shtënë në dorë ato. Ja, kjo është pika ku, me urdhër të Krijuesit të Lartë, materia është e nënshtruara dhe e burgosura e njeriut, kurse njeriu, i nënshtruari dhe i burgosuri i Krijuesit të vet!

Me fizikën, astronominë, kiminë dhe shumë degë të tjera të saj, dituria është në shërbim të njeriut dhe i jep çdo ditë dhurata të reja.

---

[3] Bekare, 38.

[4] Fussilet, 30.

[5] Rad, 28.

Po, dituria, shkencat e natyrës që janë pjesë e saj, teknika dhe teknologjia janë në shërbim të njeriut dhe nuk ka asnjë shkak serioz për t'u trembur prej tyre. Rreziku nuk qëndron te shkenca dhe ngritja e një bote sipas saj, por te padituria, injoranca, pavetëdijshmëria dhe shmangia prej marrjes së përgjegjësisë.

Krahas kësaj, kurrsesi nuk duhet nënvleftësuar fakti se, nëse shkenca mbetet vetëm, e thënë ndryshe, veçohet prej treshes mendim-përvojë-ndërgjegje, bëhet pretekst për devijime.

Sigurisht, atje ku mendjet lihen të privuara nga mendimi mbi amshueshmërinë, ku shpirti kthehet në skllav të teknologjisë, ku jeta ndjesore lihet mënjanë krejtësisht, nuk mund të flitet për diturinë, shkencat dhe dobishmërinë e tyre. Përkundrazi, në një klimë të tillë, shkenca do të ndihmojë që egërsitë të ridimensionohen, që përfytjet të vazhdojnë dhëmb për dhëmb, që mashtrimet dhe shpërdorimet të shndërrohen në fatkeqësi gjigante dhe, duke u radhitur sup më sup me "forcën", do të marrë anën e saj kundër "të drejtës".

E drejta është se, po qe që dituria dhe shkencat janë të dobishme në atë masë sa ç'përpiqen t'i zgjidhin problemet trupore-shpirtërore të njeriut duke vënë si synim lumturinë e tij materiale-shpirtërore dhe sa ç'mund ta bëjnë njeriun të arrijë njësimin zemër-mendje, kur të mos i bëjnë apo të mos mund t'i bëjnë këto, do të jenë të padobishme, madje, në një farë mase, të dëmshme, dhe, atëherë, do të jetë e kotë të presësh prej tyre ndonjë gjë në dobi të njeriut!

Sot, njeriu i materializuar krejtësisht tregon interesim për shkencën dhe teknikën vetëm për kënaqësi vetjake, për mirëqenie dhe komoditet material. Dhe ky botëkuptim e çon atë çdo ditë e ca më shumë drejt rënies morale, turbullimit shpirtëror dhe shterpësisë ideore. Është pikërisht ky tip njeriu që, në shumicën e tij të madhe nuk priret për ta kërkuar të vërtetën dhe për të medituar mbi të, madje, gjëra të tilla nuk i pëlqejnë. Pa dyshim që këtu ka ndikuar shumë sundimi në shoqëri i kulturës së vulgut, mendimi i njerëzve të shkencës për përfitim pasiv dhe pakica e shpirtit të sakrificës. Ndërkaq, më i madh se kaq është ndikimi i pamundësisë për përgatitjen e njerëzve të shpirtit, frymëzimit dhe ndjenjës. Në një kohë kur çdo gjë e kanë rrethuar njerëzit e rregullave të thata me mendjen te sytë që e kërkojnë çdo gjë te lëndësorja, është e pamundur të flitet për shkencën e të vërtetës, për thellimin dhe dimensionimin në shkencë. Përkundrazi, në një atmosferë të tillë, gjykimi dhe meditimi do të shterpëzohen çdo ditë e ca më shumë, njerëzit do të bëhen ca më të trashë dhe të katër anët e botës do të mbushen e derdhen me njerëz që bëjnë punë nën komandën e makinerive dhe aparateve!

Prandaj, ata që planifikojnë t'i rindërtojnë të nesërmet, janë të detyruar së pari ta përcaktojnë shumë mirë se ç'janë dituria dhe shkenca, se ç'mund të pritet prej tyre, se cilat duhet të jenë synimet dhe qëllimet e tyre. Ndryshe, mangësitë do të vazhdojnë të shtohen, kurse dituritë dhe shkencat e natyrës kurrsesi nuk do të mund ta japin atë që pritet prej tyre!

Meditim do të thotë ta rrëmosh fije për pe librin e gjithësisë me metodën e argumentimit. Meditimi është emri i arritjes në majat e parajsës duke kaluar përmes vështirësish të shumta sikur të kaloje nëpër vrimat e zeza, sikur të kaloje nëpër tunel. Me këtë metodë, çdo majë e diturisë dhe shkencave bëhet si një pikë nga ku vështrohet ndriçimi.

Në burimin e materies dhe dukurive është Allahu, Zoti i gjithësisë, dhe e gjithë qenia mbështetet te Ai!

Njeriu ecën me argumente dhe argumentime gjer në një vend të caktuar. Ato e kapin njeriun për dore dhe e çojnë gjer te porta e pallatit. Ato janë si shoqëruese nderi për njeriun. Por vetëm gjer te porta e pallatit, sepse brenda nuk i pranojnë. Sepse, tashmë është zbuluar enigma e mirësisë. I Panjohuri i kërkuar është gjetur dhe njeriu po e dëgjon zërin që vjen prej Tij. Kur njeriu bisedon me vetë të Argumentuarin, ç'punë ka aty argumenti? A po pyet njeriu se ia vodhën mjaltin e kosheres kur ka gjetur Mjaltin e mjaltrave? Allahu, Zoti i gjithësisë, s'ka të bëjë me elementin dhe simptomën, pra, nuk është i përbërë prej lënde dhe simptomash, mirëpo njeriut i duket se, po të hedhë edhe një hap më tej, do ta gjejë veten në prehrin e Tij!

Mirë, po a s'është Zoti më afër njeriut se damari i qafës që i rreh? Atje ku del sheshit kjo enigmë, a mund të flitet më për argument dhe argumentim?

Ç'i duhet rruga apo gjurma atij që e gjen pretekstin, thesarin, origjinën? Mjafton që kjo rrugë të mbarojë në majën e besimit dhe në pikën e fundit të përkryerjes...

PJESA E PARË

ARGUMENTET E MONOTEIZMIT DHE QËLLIMET FINALE TË KRIJIMIT

I. DISA ARGUMENTE THELBËSORE MBI EKZISTENCËN E ALLAHUT

Argumentimi i të qenës është gjithmonë më i lehtë se argumentimi i të paqenës. Ekzistencën e një varieteti molle mbi tokë mund ta vërtetojmë duke treguar edhe vetëm një kokërr prej atij varieteti. Kurse personi që pretendon se varieteti në fjalë nuk ekziston, mund ta vërtetojë pretendimin e tij vetëm pasi të

ketë shëtitur të gjithë tokën. Dhe kjo do të thotë vështirësi gjer në përmasat e të pamundurës. Prandaj mund të themi se e paqena kurrë nuk mund të vërtetohet.

Dy vërtetues parapëlqehen ndaj mijëra kundërshtuesve dhe mohuesve. Po qe se dy vetë kanë rënë në marrëveshje mbi të njëjtën të vërtetë, mohimi i asaj të vërtete nga mijëra vetë me anë të vështrimeve të veta nga dritaret e tyre të ngushta, nuk ka asnjë vlerë.

Po qe se nga një mijë dyert e një pallati, 999 janë të hapura e njëra, e mbyllur, askush nuk mund të pretendojë se në atë pallat nuk mund të hyhet. Ja, pra, se ç'bën mohuesi: duke u treguar shikimeve vetëm atë derë, kërkon ta përqendrojë vëmendjen vetëm te ajo. Në të vërtetë, edhe ajo derë është e mbyllur vetëm për botën shpirtërore të atyre që, si ai, u kanë zënë sytë perde. Për besimtarin nuk ka derë të mbyllur, mjafton që të mos i mbyllë sytë! Fundja, 999 dyer janë të hapura për të gjithë, madje me të dyja kanatet!

Ja, pra, ajo derë dhe disa prej atyre argumenteve.

1. Argumenti i mundësisë

Gjithësia është nga lloji i qenieve të mundshme. Pra, ekzistenca dhe mosekzistenca e saj janë në raport të barabartë ndaj njëra-tjetrës: gjithësia mund të ekzistojë po aq sa mund të mos ekzistojë ose, e kundërta, mund të mos ekzistojë po aq sa mund të ekzistojë. Ndërkaq, çdo qenieje e mundshme varet nga një shkak jashtë saj, pra, që të ekzistojë, duhet të jetë një shkak i jashtëm që mundëson së pari ekzistencën e saj, pastaj edhe format dhe cilësitë e ekzistencës së saj. E thënë ndryshe, duhet të jetë një shkak i jashtëm që të zgjedhë ekzistencën e qenies së mundshme ndaj mosekzistencës së saj. Dhe ky shkak është Allahu, Zoti i gjithësisë.

2. Argumenti i akcidencës

Gjithësia është në ndryshim të vazhdueshëm e të pandërprerë. Çdo gjë që ndryshon, është e pasqenë, akcidenciale. Nga ky aspekt, materia nuk mund të jetë e paraqenë. Dukuri si rrëshqitja e vazhdueshme e materies, sipas ligjeve të termodinamikës, drejt mosqenies, zgjerimi i pandërprerë i gjithësisë dhe ecja e shpejtë e diellit drejt konsumimit tregojnë se ekzistenca e ka një fillim. Çdo qenie akcidenciale, pra, e qenë ose e krijuar pas, e ka një krijues; nuk mund të ketë efekt pa motiv, rezultat pa shkak dhe art pa artist. Ndërkaq, shkaqet nuk mund të zgjaten në kahje të kundërt në formë zinxhiri të pafund. Atëherë themi se kjo gjithësi materiale që është në ndryshim të pandërprerë, që s'është e paraqenë por e krijuar pas, domethënë akcidenciale, e pasqenë, për pasojë, nevojtare për një shkak të parë, e ka një krijues i cili është Allahu, Zoti i gjithësisë.

3. Argumenti i jetës

Jeta, një mister transparent! Po, jeta është aq e çuditshme sa të mos mund të shpjegohet me shkaqe të jashtme dhe transparente për sa i përket argumentimit të Fuqisë Krijuese. Jeta e tregon dhe e shpall Krijuesin e vet drejtpërsëdrejti. Jeta është një dukuri e magjishme që i magjeps shkencëtarët me përbërjen e saj misterioze, kurse njerëzit e thjeshtë, me transparencën e saj! Dhe, me gjuhën e gjendjes cilësore të saj, jeta duket sikur thotë: "Mua më ka krijuar Allahu, Zoti i gjithësisë!"

4. Argumenti i rregullsisë

Ashtu si çdo objekt përbën një tërësi pjesësh harmonike, ashtu dhe gjithësia është një tërësi pjesësh harmonike. Dhe ky është një argument i pagabueshëm që tregon se në gjithësi ka rregull dhe harmoni dhe argumenton ekzistencën e një Rregulluesi dhe Harmonizuesi që është Allahu, Zoti i gjithësisë.

5. Argumenti i artit

Nga atomi te njeriu, nga qeliza te galaktikat, në tërë gjithësinë bie në sy një art i hollë dhe marramendës. Sigurisht, në tërë gjithësinë, çdo vepër (objekt)

ka një vlerë shumë të madhe artistike,

është shumë e çmuar,

bëhet shumë lehtë dhe brenda një kohe shumë të shkurtër,

bëhet në një numër të madh,

është e ndërlikuar dhe e shumëllojshme,

është e vazhdueshme.

Mirëpo, në punët e bëra në dukje në një kohë të shkurtër, në një numër të madh, lehtë dhe të komplikuara, nuk duhet të ketë vlerë artistike. Vetëm se, nëse bërësi është Allahu, Zoti i gjithësisë, çdo gjë ndryshon dhe të kundërtat bëhen bashkë!

6. Argumenti i kuptimshmërisë dhe qëllimit final

Në çdo objekt bie në sy një qëllim final, një synim, një dobi, të posaçme këto për atë objekt, si dhe fakti që në atë objekt ndiqet një rezultat; në të njëjtën kohë, qoftë edhe në një molekulë, madje, nuk vërehet kotësi, mungesë qëllimi dhe kuptimi si dhe ndonjë situatë që do të konsiderohej shpenzim ose shpërdorim material apo energjitik. Mirëpo as në botën lëndore, as në botët bimore e shtazore, si dhe as në materien dhe dukuritë nuk ka vetëdije dhe perceptim e njohje që në ekzistencën e tyre të ketë kuptimshmëri dhe të ndiqet një varg i tillë qëllimesh. Atëherë, po t'ia atribuojmë këtë funksionim të vetëdijshëm në gjithësi, këtë kuptimshmëri dhe këtë varg qëllimesh finale Allahut, Zotit të gjithësisë, themi se mund të kemi zënë një rrugë të arsyeshme!

7. Argumenti i dhembshurisë, mëshirës dhe ushqyerjes

Nevojat e të gjitha krijesave, veçanërisht të njeriut, janë të pafundme, kurse mundësia për të zgjedhur, e barabartë me zero. Ndërsa është kështu, nevojat e të gjithë nevojtarëve plotësohen nga një vend i pashpresuar dhe në një mënyrë të pashpresuar, në sasinë dhe cilësinë e kërkuar. Dërgimi i ndihmës e vërteton hapur faktin se ndihma e dërguar i përgjigjet plotësisht nevojës dhe, kështu, është një dorë dhembshurie ndaj çdo krijese më e afërt se vetvetja, që u përgjigjet nevojave. Kjo dhembshuri, mëshirë dhe ushqyerje sistematike që vepron në tërë gjithësinë dhe që ka për të vepruar gjer në pafundësi, tregojnë për një Individualitet të Shenjtë me atribute që i japin mundësi për t'i kryer të gjitha këto punë, si dhe të pastër prej atributeve që shprehin mangësi dhe relativitet, dhe e vërtetojnë Atë.

8. Argumenti i ndihmës reciproke

Nga më të largëtit nga njëri-tjetri gjer te më të afërtit, të gjitha krijesat vrapojnë në ndihmë të njëra-tjetrës. Në një ndihmë të tillë, dy qenie të gjinive dhe llojeve të ndryshme që s'kanë asnjë lidhje me njëra-tjetrën, bëhen pothuajse si pjesë të një të tëre duke e plotësuar njëra-tjetrën. Mendoni se si bakteret, krimbat dhe dheu bashkohen me të njëjtin qëllim në ndihmë të bimëve, gjë që përsëritet pa pushim. Kjo veprimtari e këtyre qenieve pa mendje dhe vetëdije që e lë pa mend mendjen dhe të mahnitur vetëdijen, na shpalosin para syve të vërtetën se në planin e pasëm të saj është veprimtaria plot urtësi e një Individualiteti që është Qenie e Domosdoshme. E shprehur ndryshe, me gjuhën e kësaj ndihme reciproke, tërë gjithësia thotë "Allah"!

9. Argumenti i pastërtisë

Pastrimi dhe pastërtia që vërehen nga njeriu në qiell e gjer në thellësitë e kozmosit, si një argument më vete, na tregojnë për një Individualitet të quajtur Kuddus, i Shenjtë.

Bakteret, insektet, milingonat dhe sa e sa kafshë grabitqare që e pastrojnë tokën, era, shiu dhe bora, ajsbergët dhe peshqit në dete, atmosfera dhe vrimat e zeza në kozmos, oksigjeni që na e pastron gjakun dhe frymëzimet shpirtërore që na e shpëtojnë shpirtin prej shqetësimeve, na informojnë paprerë mbi emrin i Shenjtë, i Pastër dhe, pas këtij emri na tregojnë Individualitetin e Shenjtë!

10. Argumenti i fytyrave

Ndërsa çështjen, në fakt, mund ta përgjithësojmë në të gjitha krijesat, për ta ngushtuar dhe konkretizuar më mirë, le ta trajtojmë atë duke u përqendruar vetëm te njeriu dhe vetëm te fytyra e tij që është karakteristika më e qartë dalluese që e bën të veçantë çdo individ njerëzor nga tjetri.

Fytyra e një njeriu, kushdoqoftë ai, gjer në hollësitë më të vogla, nuk i përngjet absolutisht askujt prej miliarda njerëzve para tij. Ky rregull vlen edhe për njerëzit që kanë për të ardhur në botë pas tij. Të vizatosh në një sipërfaqe krejt të vogël miliarda portrete të njëjta në një aspekt, por të ndryshme nga njëri-tjetri në një aspekt tjetër dhe pastaj ta veçosh njërin ndër miliarda portrete të mundshme për t'i ngjarë njëri-tjetrit dhe çdo gjë ta vësh në një rrugë dhe formë ndër rrugë dhe forma pafundësisht të ndryshme, e gjitha kjo është, sigurisht, një shpallje e Zotit që e njeh gjer në imtësi çdo qenie që e krijon dhe që zotëron dijen dhe mundësinë për t'i dhënë asaj qenieje formën që dëshiron, një shpallje aq e fuqishme sa ta dëgjojnë edhe shurdhët! Po, krijimi i organeve të një fytyre, të ndryshme nga organet e fytyrave të tjera dhe pajisja e çdo syri me një veçori dalluese absolutisht nga të gjithë sytë e tjerë, i tregon dhe ia bën të njohur çdo njeriu me ndërgjegje, qoftë ai edhe pa dritë në sy, Individualitetin që i krijon të gjitha këto dhe i pajis me urtësi të pafundme!

11. Argumenti i shtytjes hyjnore

Sapo del nga veza, biba mundet të notojë. Milingonat që dalin nga fshikëza, fillojnë menjëherë të rrëmojnë korridor. Bleta mund t'i thurë brenda një kohe shumë të shkurtër hojet që janë një mrekulli arti, po kështu, merimanga mund ta thurë rrjetën e saj aq të hollë. Nga të gjitha këto kuptojmë se këto dhe të tjera kafshë të ngjashme i kryejnë këto veprime me anë të informacioneve që u jepen në një botë tjetër dhe të aftësive të bashkëlindura. Mirëpo nuk ndodh aspak kështu me njeriun, i cili është i detyruar ta mësojë gjithçka në këtë botë, megjithëse është krijesa më e përsosur për sa u përket aftësive dhe mundësive! Kjo do të thotë se krijesat e tjera nuk i kanë ato aftësi dhe mundësi nga vetja, por ua ka dhuruar Individualiteti që e bën çdo gjë me kuptim dhe urtësi!

Të vegjlit e ngjalave që i lëshojnë vezët disa kilometra larg dhe kthehen, sapo dalin nga veza, vihen në rrugë dhe e gjejnë nënën sikur ta kishin vënë aty me duart e veta! Me ç'mund të shpjegohet kjo veçse me shtytjen hyjnore? Po qe se kjo mrekulli që e shohim te kafshët shpjegohet vetëm e vetëm si një e dhënë e Allahut, Zotit të gjithësisë, atëherë ky shpjegim mund të shihet si racional dhe logjik, ndryshe, çdo interpretim tjetër mbetet thjesht një përçartje!

12. Argumenti i shpirtit dhe ndërgjegjes

Edhe cilësia e shpirtit tonë që nuk ia njohim natyrën, por për ekzistencën e të cilit askush nuk ka dyshim, dhe e veprimit të funksioneve të tij mbi kurmin tonë, është një ndër argumentet që njoftojnë për Zotin. Elementi që e përfaqëson në botën tonë Botën e Urdhrit, është shpirti dhe shpirti ka ardhur në këtë botë vetëm për zhvillim dhe përsosje. Meqë ndikimi i urtësisë së kësaj mbi përfundimin është jashtë temës sonë,

po mjaftohemi këtu vetëm duke e prekur pikën që e argumenton ajo. Fakti që shpirti që, si natyrë, nuk ka të bëjë aspak me botën tonë materiale, dërgohet këtu nga një botë e posaçme për të dhe që vihet në një proces maturimi sipas një programi të caktuar, është, pa dyshim, një prej argumenteve më të rëndësishëm që njoftojnë për Zotin.

Nga ana tjetër, parandjenjat te njeriu dhe kthimet te Zoti pa pasur asnjë shkak të jashtëm, orientimet kah Ai dhe përsëritja në miliona herë e këtyre dukurive janë një argument i hapur i faktit që ndërgjegjja e cila ndodhet te njeriu në mënyrë të bashkëlindur dhe është njëri prej pretekseve më të rëndësishëm për gjetjen e Zotit, është e dhënë gjer në adhurim pas Krijuesit të vet dhe është e lidhur me Të me të gjithë qenien e vet. Fundja, a s'është ndërgjegjja njëri prej dëshmitarëve të pagabueshëm të marrëveshjes mes Zotit dhe shpirtit të njeriut? Ja, pra, me shtytjen e domosdoshmërisë dhe detyrimit të respektimit të kësaj dëshmie, ndërgjegjja thotë: "Allah"!

13. Argumenti i krijimit dhe historisë

Ekzistenca tek çdo njeri e një ndjenje dashurie ndaj të mirës dhe të bukurës si dhe, në të kundërt, e një ndjenje urrejtjeje ndaj të keqes dhe të shëmtuarës, është një realitet aq i hapur e i qartë, sa askujt nuk do t'i shkonte mendja për të kundërtën. Kjo do të thotë se, me ndërtimin e tyre siguron prirjen nga moraliteti dhe e mira dhe largimin me neveri dhe urrejtje nga imoraliteti dhe e keqja, këto ndjenja argumentojnë se i zoti i sistemit që e urdhëron njeriun për të vepruar mirë e bukur dhe e pengon nga sjelljet e këqija e të shëmtuara, është po ai Individualitet që ia ka dhënë njeriut këto ndjenja. Dhe, pa asnjë dyshim, ky Individualitet është Allahu, Zoti i gjithësisë!

Historia e feve është dëshmitare se njerëzimi nuk e ka kaluar asnjë prej periudhave të tij pa besim. Në çdo periudhë, njeriu ka pasur një besim qoftë edhe të shtrembër apo bestyt, qoftë edhe qesharak, dhe ka ndjekur një sistem moralo-shpirtëror të caktuar. Në mënyrë të veçantë, besimi është një nevojë sepse ekziston në krijim. Individualiteti që e ka shtresuar këtë nevojë në krijimin e njeriut dhe Individualiteti që na urdhëron ne të besojmë, është i njëjti Individualitet. Ai është Allahu, Zoti i gjithësisë!

14. Argumenti i ndjenjave

Njeriu është pajisur me mijëra ndjenja. Çdo ndjenjë bart një natyrë mesazhi nga një botë jashtëlëndore. Ndërkaq, te çdo njeri është një ndjenjë që ia bën të njohur atij Zotin drejtpërdrejt. Kjo është ndjenja e pavdekshmërisë. Për shkak të kësaj ndjenje njeriu përpiqet pa pra për pavdekësinë dhe amshueshmërinë. Asgjë e fundme, e konsumueshme dhe e vdekshme nuk mundet ta kënaqë atë vërtetësisht. Dhe kjo ndjenjë nuk është e mundur t'i jetë lënë njeriut nën ndikimin e ndonjë gjëje të fundme. Asnjë prej shkaqeve që janë të fundmë nuk mund ta ofrojë këtë pasion për pavdekshmërinë. Mirëpo ekzistenca e kësaj ndjenje është një fakt, një realitet, pra është e pamundur të mohohet. Atëherë themi se këtë ndjenjë na e ka dhënë neve ai që na ka krijuar, Zoti. Dhe është Ai që ka për të na e dhënë edhe jetën e pafundme!

15. Argumenti i marrëveshjes

Po qe se dhjetë gënjeshtarë të njohur na vijnë njëri pas tjetrit e na thonë se na është djegur shtëpia, themi "ka mundësi" edhe pse i njohim ata dhe e dimë se qoftë edhe një herë s'kanë thënë të vërtetën! Ndodh kështu sepse në mes është një marrëveshje, qoftë edhe mes disa gënjeshtarësh! Mirëpo marrëveshja (se Zoti ekziston) për të cilën po bëjmë fjalë këtu, është marrëveshje mes mijëra profetësh, qindramijëra shenjtorësh dhe miliona njerëzish. Pika kryesore e marrëveshjes së arritur nga këta njerëz që kanë jetuar në kohë dhe vende të ndryshme, është e vërteta "Allahu ekziston". Kur i jepet rëndësi edhe marrëveshjes së dhjetë gënjeshtarëve mbi një gënjeshtër, ç'njeri mund të jetë ai njeri që nuk i beson marrëveshjes së miliona

profetëve dhe njerëzve të shquar që s'është dëgjuar të gënjejnë kurrë? Dhe si mund të quhet i mençur një njeri i tillë?

16. Argumenti i Kuranit

Të gjitha argumentet që vërtetojnë se Kurani është fjalë e Allahut, janë, në të njëjtën kohë, edhe prova të ekzistencës së Allahut, Zotit të gjithësisë. Janë qindra argumente mbi Kuranin si fjalë e Zotit që janë të parashtruara me imtësi në burimet bibliografike e teorike të Islamit lidhur me çështjen përkatëse. Ne po mjaftohemi duke ua lënë atyre aspektin vërtetues të çështjes. Të gjitha këto argumente, me gjuhën e tyre të posaçme, thonë: "Allahu ekziston"!

17. Argumenti i profetësisë

Edhe të gjitha argumentet që vërtetojnë profetësinë e profetëve, veçanërisht të profetit Muhamed (s.a.s), duhet t'u shtohen provave që flasin për Zotin. Sepse qëllimi final i ekzistencës së profetëve është shpallja e unitetit të Zotit, besimi monoteist mbi Allahun, Zotin e vetëm të gjithësisë. Prandaj, të gjitha argumentet e çdo profeti që vërtetojnë profetësinë e tij, janë, në të njëjtën kohë, në tërësi, argumente të ekzistencës së Zotit. Ndërkaq, ne s'do të qëndrojmë mbi ta një për një sepse kjo është jashtë tematikës sonë, por do të themi vetëm kaq, që, të gjitha argumentet që pohojnë se një profet është i vërtetë, pohojnë me të njëjtën forcë, madje më me forcë se *Allahu ekziston dhe është një!*

II. SHKAQET, NATYRA DHE VETËKZISTENCA

1. Shkaqet dhe rastësitë nuk munden ta bëjnë gjithësinë

Rastësia është e kundërta e rregullsisë (rregullit, ligjit), është përjashtim. Ndërsa ligji shpreh një marrëdhënie të caktuar dhe të vazhdueshme që mbështetet dhe zhvillohet mbi një plan, program, rregull dhe harmoni, rastësia është krejt e kundërta e kësaj, është një marrëdhënie e pacaktuar, e pavazhdueshme, pra, spontane, e pambështetur mbi një plan ose program, pra, e parregullt. Dituritë, në përgjithësi, dhe shkencat e natyrës, në veçanti, merren vazhdimisht me ligjet. Ato nuk interesohen për rastësitë dhe nuk i

fusin ato në fushën e studimit të tyre. Është një gabim i madh t'i trajtosh dhe studiosh së bashku, në një plan, rastësitë me shkencat dhe ligjet shkencore.

Le ta ilustrojmë këtë vështrim të shkurtër mbi çështjen me një shembull.

Te njeriu ka gjashtëdhjetë trilion qeliza dhe, në një qelizë, afro një milion proteina. Kështu, mundësia e krijimit të rastësishëm të një proteine është një në gjashtëdhjetë trilion herë një milion. Domethënë se formimi në mënyrë të rastësishme i një proteine është po kaq i pamundur dhe absurd.

2. Gjithësia nuk mund të bëhet vetvetiu

Në qoftë se themi se një qenie duhet të ekzistojë, duam të themi se mosekzistenca e saj është e pamundur. Qenia që duhet të ekzistojë e ka, pra, ekzistencën të domosdoshme. Ndërkaq, çdo qenie që s'e ka ekzistencën të domosdoshme, e ka të mundshme, pra, mund të ekzistojë dhe mund të mos ekzistojë; mund të ekzistojë po aq sa mund të mos ekzistojë dhe mund të mos ekzistojë po aq sa mund të ekzistojë. Mundësia shpreh barazinë mes ekzistencës dhe mosekzistencës.

Domosdoshmëria e ekzistencës kërkon, në të njëjtën kohë, pafundësinë, sepse ajo e përjashton mosekzistencën. Mirëpo, në gjithësi vërehet se çdo qenie shkon me shpejtësi drejt një fundi. Atëherë, themi se ekzistenca e asnjë qenieje të shfaqur pas në fushën e ekzistencës në gjithësi nuk është e domosdoshme. Mosdomosdoshmëria e ekzistencës është e njëvlershme me mundësinë e saj. Kurse mundësia ka nevojë për një krijues. Ndërkaq, identifikimi i krijuesit të nevojshëm me materien nevojtare është vetëm një përçartje. *Atëherë, themi se krijuesi i një gjëje që ka nevojë për krijues, kurrë nuk mund të jetë lëndë ose një formë lëndore*. Krijuesi i gjësë që ka nevojë për krijues mund të jetë një Individualitet me ekzistencë të domosdoshme, që është Allahu, Zoti i gjithësisë.

Nga ana tjetër, po qe se supozojmë se lënda është, në të njëjtën kohë, fuqi që e krijon vetveten, ku është tani ajo fuqi? Është krejt e qartë se fuqia që s'ka fund s'mund të ketë as fillim, s'mund të jetë as e pafillim. Atëherë themi se përtej qenies është një Individualitet i pafillim e i pafund që sundon mbi gjithë qenien, që është Allahu, Zoti i gjithësisë.

3. As natyra dhe ligjet e natyrës nuk mund të jenë krijues

Ligji me atë që e vendos atë ligj nuk janë një. Nuk mund të ndodhë që ligjet e natyrës t'i kenë vënë vetë ligjet e natyrës. Nga ana tjetër, është e pamundur që natyra t'i japë diçkaje tjetër atë që s'e ka vetë. Kështu, asnjëra prej mijëra ndjenjave që ndodhen te njeriu nuk ndodhet në natyrë. Atëherë, si mund t'i japë natyra njeriut atë që s'e ka vetë. Cila mendje mund ta pranojë këtë absurditet?

Si mund ta krijojë njeriun natyra e përbërë prej guri, dheu, ajri, dielli dhe nxehtësie që s'mund të krijojë diçka më të përsosur se veten?

4. Në unitet ka përputhshmëri

T'ia japësh të gjitha gjërat një gjëje (t'i bësh të gjitha gjërat një) është më e lehtë sesa ta përpjesëtosh një gjë tek të gjitha gjërat. Për krijimin e një grimce (molekule) ka nevojë për tërë gjithësinë. Ai që s'e krijon dot tërë gjithësinë, nuk e krijon dot një molekulë të vetme. Sepse brenda materies ekziston *nevoja e gjërave për njëra-tjetrën, marrëdhënia e ngushtë e gjërave me njëra-tjetrën*.

Ta vësh një njësi ushtarake nën komandën e një komandanti është mënyra më e thjeshtë dhe e lehtë e administrimit, kurse komandantin ta bësh ushtar e ushtarët komandantë e ta vësh atë ushtar nën komandën e tërë atyre komandantëve, është mënyra më e vështirë dhe absurde e administrimit.

T'ia atribuosh tërë gjithësinë Zotit është e njëjta gjë sikur t'ia atribuosh Atij krijimin e një qelize. Në të njëjtin rezultat të çon edhe e kundërta. Domethënë, kush ta ketë krijuar një molekulë, ka krijuar edhe

gjithësinë. Si krijim, nuk ka ndryshim mes krijimit të molekulës dhe planetit, mikrobit dhe rinocerontit, pikës dhe detit, pjesës dhe të tërës. Ai që s'mundet ta krijojë planetin, rinocerontin, detin, të tërën, nuk mund ta zotërojë molekulën, mikrobin, pikën e ujit, pjesën!

III. PSE JANË KRIJUAR NATYRA, LIGJET E NATYRËS DHE SHKAQET?

1. Ligjet dhe shkaqet janë mjete dhe pengesa ndarëse; urdhrat dhe porositë e ardhura nga lart arrijnë në pikat e takimit (të marrëdhënieve të ndërsjella) që ndodhen pas këtyre mjeteve

Duke e krijuar gjithësinë materiale, Zoti ka krijuar edhe ligjet e natyrës dhe shkaqet bashkë me të dhe si tipar individual dhe veçori të natyrës. Ato që hyjnë në fushë të ekzistencës me urdhrin "bëhu" të dhënë në krijimin e parë, hyjnë në këtë fushë, në të njëjtën kohë të pajisur edhe me këtë veçori. Këtë të vërtetë e shpreh edhe ajeti Kuranor, *"... dhe i dhamë asaj një shkak për çdo gjë"* (Kehf, 18/84).

Ndërkaq, të gjitha shkaqet dhe ligjet janë pengesë ndarëse të dinjitetit dhe madhështisë së Zotit; pas tyre është Allahu, Zoti i gjithësisë, vepruesi i vërtetë dhe krijuesi i qenies ku përfshihen edhe shkaqet. Ligjet dhe shkaqet kanë për detyrë t'i shpërndajnë dhe shpallin veprimet dhe ndikimet e vërteta me burim atë Fuqi dhe janë si nga një perde prej dantelle që e mbrojnë dinjitetin e Tij ndaj vlerësimeve sipërfaqësore e formale të mendjes.

Edhe mes njerëzve, personat me pozitë kanë një dinjitet, madhështi dhe vlerë të caktuar, në raport të drejtë me postin dhe pozitën, për pasojë, veprojnë jo drejtpërdrejt, por me anë të një sërë mjetesh dhe pas një pengese ndarëse (kushtesh e mjetesh). Ata nuk ndërhyjnë personalisht në punët që kryejnë zyrat e dikasterit të tyre, nuk janë ata që i kryejnë ato punë. Ata e zhvillojnë të gjithë veprimtarinë në krye të të cilës ndodhen dhe të cilën e drejtojnë, me anë të njerëzve të tjerë, kurse vetë nuk duken tjetërkund veçse në zyrën e vet. Për shembull, kryetari i shtetit nuk shkon të kontrollojë tregun si një nëpunës bashkie, sepse s'ia lejon detyra dhe pozita. Nuk është gjenerali ai që merret me pastrimin e kapanoneve, të armëve, etj. por ushtarët dhe i gjithë personeli tjetër sipas detyrave, përgjegjësive dhe rangjeve, kurse ai vetë nuk duket. Në mundemi të bëjmë një përngjasim, Zoti që është zotëruesi dhe sunduesi i vetëm i gjithësisë dhe tërë ekzistencës, i krijon dhe drejton të gjitha dukuritë që ndodhin në gjithësi duke përdorur ligjet dhe shkaqet "duke u fshehur" pas tyre. Sepse këtë kërkon dinjiteti dhe madhështia e Tij. Me një ndryshim që gjërat që Allahu i bën pengesë ndarëse për dinjitetin dhe madhështinë e Tij, nuk kanë një veprim dhe ndikim të vërtetë.

Shkurt, ligjet dhe shkaqet janë si një zyrë administrative e shtetit, prandaj zbatimi i urdhrave dhe porosive që vijnë nga kreu i shtetit, lidhet me atë zyrë ose nëpunësit që veprojnë në kuadrin e asaj zyre. Në të vërtetë, është Allahu që i kryen ose që i detyron të kryhen të gjitha punët.

2. Ligjet e natyrës dhe shkaqet janë krijuar për t'u bërë objekti i parë i ankesave të padrejta

Materia dhe dukuritë kanë dy anë: anën materiale dhe anën ideale, të jashtmen dhe të brendshmen. Krejt si pasqyra. Njëra faqe e pasqyrës, e pastër, e rrafshtë, e shkëlqyer, pasqyruese, kurse faqja tjetër, e fëlliqur, e shëmtuar, e errët. Edhe ana ideale e materies ku s'ka ligje dhe shkaqe, është e kthjellët dhe e pastër. Jeta, drita dhe mëshira janë vetëm tri cilësi të kësaj ane. Kurse në anën e jashtme të saj ndodhen disa gjendje të kundërta me dinjitetin, madhështinë, përsosmërinë dhe bukurinë e Zotit dhe të papëlqyeshme për syrin, veshin, hundën, madje për përfytyrimin dhe mendimin dhe për t'i fshehur ose, disa herë, për t'i bërë objekt këto janë krijuar ligjet dhe shkaqet. Zoti vepron pas këtyre shkaqeve dhe pengesave ndarëse e fshehëse. Veçanërisht, edhe urtësia për të siguruar që ankesat e padrejta e pa vend të mos i drejtohen drejtpërdrejt Zotit, e ka bërë të domosdoshme krijimin e ligjeve dhe shkaqeve. Sepse njerëzit e paditur, injorantë dhe indiferentë, shpesh herë, duke mos i parë dot urtësitë e holla e të thella në materien dhe dukuritë, si rezultat, shumë bukuri të fshehura, i drejtohen vetë Zotit dhe i ankohen Atij. Mirëpo një ankesë e tillë është një fatkeqësi më e madhe se e keqja ose fatkeqësia për të cilën bëhet ankesa. Po, shumë herë, fatkeqësia që bëhet shkak për ankesë, sjell një fatkeqësi të re më të madhe. Ja, pra, Individualiteti i Madh që është Rrahman dhe Rrahim, Mëshirues dhe Bamirës, duke e fshehur veprimin e Tij pas ligjeve dhe shkaqeve, ka dashur t'i shpëtojë njerëzit nga fatkeqësia e vërtetë dhe u ka dhuruar atyre justifikime.

Kështu, ankesa e fshehur në klithmën e nënës së djegur për humbjen e frytit të zemrës së saj, është mbështjellë me perden e sëmundjes dhe fatkeqësisë duke e mbrojtur atë nënë nga paturpësia ndaj Zotit që është fatkeqësi më e madhe se humbja e fëmijës. Sa të varfra janë fjalët tona mbi madhërinë e Zotit që sillet me kaq dhembshuri ndaj robve të vet, ndaj madhërisë së vërtetë të Tij!

3. Ligjet e natyrës dhe shkaqet janë krijuar për t'ia ekspozuar shikimit artin hyjnor

Madhështia e artistit vlerësohet me vlerën e veprave të tij. Zogj këngëtarë, lule ngjyra-ngjyra, hollësi të një arti mrekullor të vëzhguara edhe në qenien më të vogël e sa e sa të tjera... Në të gjitha këto, Allahu, me gjuhën e natyrës, i bën të shqiptohen e këndohen emrat dhe atributet e Tij dhe, duke i ekspozuar shfaqjet e këtyre emrave dhe atributeve nën emërtimin "shkaqe", ua paraqet qenieve të vetëdijshme për t'i vëzhguar e soditur. Kurse vetë sodit habinë dhe mahnitjen e tyre!

Çdo zotërues bukurie dhe përsosjeje dëshiron ta shohë dhe ta tregojë bukurinë dhe përsosmërinë e vet. Prirja për një kënaqësi të tillë e vënë re në botë edhe në artistët njerëzorë plot të meta, shfaqet me galeritë dhe ekspozitat e artit, nga të cilat, çdo ditë njëra mbyllet e tjetra hapet. Mirëpo bukuria dhe përsosmëria te njeriu, si një njësi mase për ta kuptuar Zotëruesin e Bukurisë dhe Përsosmërisë Absolute, ndodhet në nivelin më të ulët. Megjithëkëtë, qoftë edhe me një thjerrëz të tillë matjeje është gjithmonë e mundur të dallohet dhe kuptohet vullneti i lartë dhe dëshira e Allahut, Zotëruesit të Bukurisë dhe Përsosmërisë Absolute, për ta bërë natyrën një sallon ekspozimi me dëshirën për ta parë dhe treguar bukurinë dhe përsosmërinë e vet. Është ky dallim dhe kuptim që e shtyn njeriun ta madhërojë dhe shenjtërojë Allahun. Madhërimi dhe shenjtërimi i Allahut, Zotit të gjithësisë, buron nga vetëdija e robit (krijesës) ndaj Zotit dhe e adhurimit të Tij. Adhurimi i Zotit është qëllimi final i krijimit të njeriut, madje i tërë gjithësisë. Ja, pra, shkalla e shkaqeve është e rëndësishme për ne sepse na fut në udhën drejt një qëllimi të tillë për të arritur në horizont.

4. Gradualiteti në ligjet e natyrës dhe shkaqet

Gradualiteti në ligjet e natyrës dhe shkaqet është parim. Dhe kjo është nga argumentet më enigmatike që vërtetojnë madhështinë e artit hyjnor. Sepse tregimi veç e veç i shfaqjeve të emrave në çdo shkallë e në çdo etapë si dhe prania e mrekullisë artistike që është e pranishme në të tërën, edhe në të gjitha pjesët që formojnë etapat e ndryshme formësuese të një organizme, është veçori e posaçme vetëm për artin e Zotit dhe për atë Artist të madh. Një veçori të tillë është e pamundur ta shohësh dhe ta tregosh në ndonjë vepër tjetër artistike.

5. Ligjet e natyrës dhe shkaqet janë rrjedhojë e domosdoshme dhe përfundim i ndodhjes sonë në vendin e urtësisë

Ahireti, jeta e pasme, është *vendi i fuqisë* (mundësisë së pakufizuar), kurse kjo botë është *vendi i urtësisë*. E thënë ndryshe, ndërsa në jetën e pasme sundon më shumë fuqia, në këtë botë sundon urtësia. Për rrjedhojë, në jetën e pasme, ligjet dhe shkaqet do të lihen jashtë funksionimit, kurse në këtë botë, ligjet dhe shkaqet funksionojnë si domosdoshmëri e urtësisë.

Krahas emrave si Halik (krijues), Rezzak (furnizues e ushqyes), Shafi (shërues), Mukaddir (vlerësues), Musavvir (përshkrues), etj., Zoti mban edhe emrin Hakim (i urtë). Me këtë emër të bekuar, Ai bën punë me *urtësi*: me urtësi krijon, me urtësi i bën ligjet dhe shkaqet pretekste të veprimtarisë së Tij, me urtësi e thur dantellën e ekzistencës në kuadrin e marrëdhënieve që i ka ngritur mes pretekstit me efektin dhe shkakut me pasojën.

Kurse në jetën e pasme, meqë aty do të sundojë *fuqia*, Zoti do të veprojë me fuqinë e vet. Botën tonë të përkohshme e kalimtare do ta shembë së bashku me ligjet dhe shkaqet që veprojnë në të, dhe do të krijojë një banesë të re dhe krejt tjetër, ku janë për parim kuptime të tjera. Në atë botë, të gjitha masat e vlerave të posaçme për këtë botë do të fshihen dhe qenia, duke marrë një natyrë tjetër, do të bartet në platformën e fuqisë.

Në këtë botë të pafundme ku sundon fuqia, për të ngrënë fruta nuk do të ketë nevojë të plugohet e të mbillet toka. Edhe rrobat e xhenetit, parajsës, të përgatitura pa gërshërën dhe gjilpërën e rrobaqepësit, do

ta veshin të zotin. Meqë atje s'do të ketë vjetrim, plakje e vdekje, nuk do të jenë as shkaqet që çojnë në këto përfundime. Kjo botë është shtëpia e shërbimit, kurse bota tjetër, shtëpia e shpërblimit. Prandaj, për të merituar të mirat e atjeshme, duhet punuar këtu duke u mbajtur pas shkaqeve. Kurse në jetën e pasme, ahiret, nuk do të ketë as shkaqe si këto, as dhe punë.

6. Ligjet e natyrës dhe shkaqet janë krijuar për sekretin e propozimit dhe provimin

Ligjet dhe shkaqet janë nga një perde (pengesë ndarëse) më vete. Këto perde të vendosura mes syve tanë dhe të panjohurës me qëllim për t'i dalluar ata që i besojnë të panjohurës prej atyre që s'i besojnë, ndihmojnë për ta veçuar besimtarin prej mohuesit. Besimi te e panjohura është vetia më dalluese e besimtarit. Këtu duhet bërë kujdes në këtë specifikë:

Po të dëshironte, Zoti mund të mos i krijonte ligjet. Bie fjala, e ngarkonte tokën mbi shpinën e një engjëlli që mund ta shihnim, dhe atëherë ne s'do të bënim fjalë për ligjin e gravitacionit. Ose, për të pasur një fëmijë, vinte si kusht vetëm një lutje të një nate dhe të nesërmen, njeriu do ta gjente fëmijën në prag të derës. Po të dëshironte, Allahu i përdorte yjet si shkronja dhe, duke e shkruar emrin e vet në qiell, na lajmëronte për ekzistencën dhe individualitetin e vet. Ose Zoti e krijonte njeriun me aftësi për të biseduar me të dhe, pastaj, Zoti bisedonte me të gjithë njerëzit veç e veç. Kështu, mund të përmendnim shumë gjëra. Vetëm se atëherë do të shmangej qëllimi final i krijimit, sepse qëllimi final i krijimit të njeriut është vënia e tij në provë. Atëherë, as mendja s'do të kishte më kuptim, as dhe propozimi për adhurimin e Zotit. Në të njëjtën kohë, njeriut do t'i hiqej vullneti dhe njerëzit do të detyroheshin të besonin, gjë që do të ishte në kundërshtim me frymën e përgjegjësisë. Atëherë, njerëzit shpirtbardhë si Ebu Bekri nuk do të dalloheshin nga njerëzit shpirtzinj si Ebu Xhehli. Meqë nuk do të kishte më të fshehtë prove, pozita e njeriut që i lë engjëjt pas, do të mbetej e palëkundur dhe krijimi i njeriut s'do të kishte më kuptim.

7. Ligjet e natyrës dhe shkaqet janë krijuar për zhvillimin e ideve, për formimin e diturive, shkencave dhe qytetërimeve

Që nga dita kur është krijuar, njeriu e ka përqendruar kureshtjen dhe kërkimin mbi lëndën dhe materien të krijuara nga Zoti; si rezultat, ai i ka zbuluar gjërat dhe dukuritë të krijuara në një formë të fshehur dhe, me përpjekjet e tij, teknologjia dhe qytetërimi kanë arritur në nivelin e ditëve të sotme. Por po qe se çdo gjë do të ishte krijuar qysh në fillim në formë të hapur, pra, do të dihej, nuk do të kishte as kërkim, as zbulim dhe as zhvillim. Njerëzit do ta quanin të zakonshme gjithçka që do të shihnin dhe nuk do të kishin punë tjetër veçse të prisnin vdekjen për t'u larguar nga kjo botë siç kishin ardhur...

8. Ligjet e natyrës dhe shkaqet, duke prodhuar një ambientim, afërsi dhe shprehi të caktuar, e bëjnë jetën të dashur

Ambientimi dhe shprehitë të çliruara nga qëndrimet e skajshme, janë veti të pamohueshme të jetës së jetuar me kënaqësi. Jeta e mangët nga këto veti s'do të ishte aspak e pëlqyeshme dhe e dashur. Duke mos e ditur se me ç'gjëra do të përballej të nesërmen, njeriu jo vetëm s'do të mund të planifikonte dot gjë për të nesërmen, por s'do t'i mbetej të bënte gjë tjetër veçse të habitej dhe hutohej, gjë që s'do të ishte aspak e dëshirueshme. Përgjithësisht, po qe se në botë nuk do të veprohej në bazë të ligjeve dhe shkaqeve, të gjitha vlerat që e bëjnë këtë jetë të jetë kjo që është, si rregullsia dhe ekuilibri, nuk do të ekzistonin, pra, nuk do të kishte jetë.

Rruga e mesme e ambientimit dhe shprehive është jetesa duke arsyetuar dhe medituar. Njëri qëndrim i skajshëm do të ishte fshirja e arsyetimit dhe meditimit, kurse qëndrimi tjetër i skajshëm do të ishte një

përqendrim i jashtëzakonshëm në arsyetim dhe meditim që do ta helmonte jetën. Ndërkaq, si në çdo gjë tjetër, edhe këtu besimtari zgjedh rrugën e mesme.

IV. NATYRA, LIGJET E NATYRËS DHE SHKAQET NUK MUND TË JENË KRIJUESI DHE ADMINISTRUESI I VËRTETË

1. Ligjet dhe shkaqet ekzistojnë me materien

Ligjet dhe shkaqet ekzistojnë me materien, prandaj nuk mund të mendohen veç prej saj. T'i shohësh ligjet dhe shkaqet, ekzistenca e të cilave është e pamundur pa materien, si burimi, baza dhe krijuesi i

materies, është krejtësisht një vetëmashtrim dhe përçartje dialektike. Nuk janë ligjet dhe shkaqet që e lindin materien dhe lëvizjen, përkundrazi, janë ligjet dhe shkaqet që lindin nga materia ekzistuese dhe lëvizjet e saj.

Yjet dhe planetet rrotullohen në orbitat e tyre dhe në një ekuilibër të caktuar. Por kjo nuk ndodh kështu sepse e ka zbuluar Njutoni. Ndoshta rrotullohen sepse janë krijuar pas dhe janë vënë në atë rrugë. Kurse ajo që kanë bërë Njutoni dhe të tjerë, është se kanë zbuluar një ligj të vendosur në gjithësi së bashku me materien dhe i kanë vënë një emër.

2. Ligjet dhe shkaqet janë nga gjërat e mundshme

Ekzistenca dhe mosekzistenca e ligjeve dhe shkaqeve janë njëlloj të mundshme. Meqë ligjet dhe shkaqet janë të lidhura me materien, kushtet që rrethojnë materien vlejnë edhe për to. Ashtu siç materia nuk mund të bëhet ekzistente pa pasur një shkak që të zgjedhë ekzistencën ndaj mosekzistencës së saj, ashtu dhe ligjet dhe shkaqet nuk mund të bëhen ekzistente pa një shkak zgjedhës. Ky është përfundimi i detyruar i të qenit i mundshëm. Ndërkaq, gjëja që është nevojtare për një zgjedhës dhe zgjedhje, kurrsesi nuk mund të jetë krijuese, sepse vetë ka nevojë për t'u krijuar.

3. Ligjet dhe shkaqet janë të krijuara pas, pra, akcidenciale. Për rrjedhojë, gjëja që s'është e pafundme, s'mund të jetë as e pafillimtë

Ligjet dhe shkaqet janë të krijuara pas, pra, akcidenciale. Prandaj, thënia jonë se *gjëja që s'është e pafundme, s'mund të jetë as e pafillimtë*, vlen edhe për ligjet dhe shkaqet. Të mendosh se një akcidencë është krijuar nga një akcidencë tjetër do të thotë të pranosh vargun e pafillim të lidhjeve shkak-pasojë, gjë që është absurditet.

Si materia, edhe ligjet dhe shkaqet po shkojnë drejt asgjësimit. Shkencëtarët paraqesin shumë shkaqe që do të çojnë në copëtimin e materies, shpërndarjen e yjeve dhe shpërthimin e kiametit, katastrofës së përgjithshme. Gjërat që kanë një fund, që janë të dënuara të shkatërrohen, nuk mund të jenë krijues.

4. Ekzistenca e ligjeve dhe shkaqeve është nevojtare ndaj shkaqeve të tjera

Ligjet dhe shkaqet që nuk janë vetë shkak për ekzistencën e vetes, prandaj dhe që janë pasojë, rezultat, kanë, gjithmonë, nevojë për shkaqe të tjera, gjë që shkon në mënyrë zinxhir. Meqë është e pamundur që kjo lidhje zinxhirore shkak-pasojë-shkak të zgjatet drejt fillimit në mënyrë të pafund, qëndrimi i saj në një pikë fillestare është i domosdoshëm e i pashmangshëm. Çështjen po e konkretizojmë kështu: fara është shkak për pemën, po shkak për farën, ç'gjë është? Pula vjen nga veza, po veza? Po të nisemi të kthehemi pas në vargun e shkaqeve dhe pasojave që arrijnë, ta zëmë, gjer te molla, nuk do të mbarojmë kurrë, veçse po t'i japim përgjigje përfundimtare pyetjes "po këtë?", gjë që mund të bëhet nëse në vend të një shkaku tregojmë një krijues, për të cilin s'kemi për të pyetur më "po këtë?"

5. Ligjet dhe shkaqet janë gjëra konvencionale; ato s'kanë trup të vërtetë dhe individual

Disa ligje dhe shkaqe nuk kanë trup të vërtetë dhe individual, por janë konvencionalë dhe imagjinarë. Le ta marrim ligjin e gravitacionit. Ky emër është vetëm një emërtim i vënë për të shënuar një dukuri. Ligji në fjalë nuk është një send që shihet me sy, që preket me dorë ose që analizohet në laborator. Të prekshme janë vetëm rezultatet. E thënë ndryshe, ligjet janë fuqi konceptuale të përbëra prej hipotezave abstrakte. Të këtij lloji janë ligji i zhvillimit (fuqia mbirëse) te fara, ligji i zhvendosjes te uji, ligji i shifrës te DNA-ja, ligji i tërheqjes te magneti.

6. Ligjet dhe shkaqet japin rezultate duke u mbështetur në ligje dhe shkaqe të tjera për të cilat kanë nevojë

Ligjet dhe shkaqet japin rezultate duke u mbështetur në ligje dhe shkaqe të tjera për të cilat kanë nevojë, por nuk kanë funksion krijues nga e paqena. Kështu, është e mundur të mblidhen të gjitha ligjet dhe shkaqet (kushtet), si rezultat i të cilave formohet një qelizë, por është krejt e pamundur që nga ligjet dhe shkaqet e grumbulluara artificialisht ose, e thënë ndryshe, nga kushtet e krijuara artificialisht të krijohet një qelizë e gjallë! Fundja, po e themi me këmbëngulje se, për t'u formuar një gjallesë, duhet që të bashkohen në mënyrë të vetëdijshme dhe të llogaritur mijëra shkaqe, gjë që nuk mund ta bëjnë vetë shkaqet ose të bëhet vetvetiu.

7. Mes ligjeve dhe shkaqeve, nga njëra anë, dhe rezultateve, nga ana tjetër, nuk ka përputhje

Ndërsa ligjet dhe shkaqet janë mjaft të thjeshta, të dobëta e të pavullnetshme, rezultatet e tyre janë shumë të përsosura, artistike, të çmuara e të rëndësishme. Kjo do të thotë se, edhe pse mes shkaqeve dhe rezultateve duken marrëdhëniet pretekst-efekt dhe shkak-pasojë, përputhje nuk ka. Ashtu siç do të shkaktonte habi dhe mahnitje një njeri me peshë pesëdhjetë kilogram duke ngritur një peshë prej pesëqind kilogramësh ose një fëmijë duke tërhequr një autobus me një pe të lidhur në gisht, ashtu do të vihej re një ndryshim shumë i madh dhe një çekuilibër i çuditshëm kur të shiheshin materia dhe dukuritë që kemi përreth nga këndvështrimi i përputhjes shkak-pasojë që bartin ato. Për shembull, po të dëshirojmë të shponim gurët apo shkëmbinjtë duke e përdorur gishtin tonë si majë kompresori, nuk do të arrinim ndonjë rezultat tjetër veç copëtimit të gishtit, sepse fortësia e gishtit tonë është jashtëzakonisht tepër larg fortësisë që kërkohet të ketë maja e kompresorit që shpon shkëmbinj. Mirëpo, ja që bimë të vogla fare me rrënjët e tyre të imta e të buta si mëndafsh, i bëjnë copë-copë gurët e shkëmbinjtë! Gjethe më të holla se letra e cigares e durojnë nxehtësinë përvëluese dhe arrijnë të mbeten të gjelbra. Shihni se sa e vogël dhe e thjeshtë është një farë që përmban programin e një peme të madhe me degë, gjethe e fruta! Mendoni spermatozoidin që e përmban njeriun me të gjitha mundësitë dhe aftësitë e veta... Shqyrtoni duke nxjerrë mësim raportet e madhësisë së farës së fikut, aq të vogël sa mezi shihet me sy, me drurin e fikut! Kështu mund të radhisim edhe shumë shembuj të tjerë e të shohim se ç'përfundime japin ligjet dhe shkaqet e dobëta e të thjeshta, të cilat nuk mund të jenë burimi, baza dhe krijuesi i përfundimeve të tilla kaq të përsosura e të shkëlqyera!

8. Ligjet dhe shkaqet nuk mund të jenë krijues sepse janë nevojtarë për të kundërtat e tyre

Ligjet dhe shkaqet nuk mund të jenë krijues sepse kanë të kundërta. Fundja, në gjithësi, çdo gjë ka të kundërtën e vet. Materia njihet me të kundërtën e vet. Polet tërheqje-shtytje, minus-plus, cilësitë apo gjendjet nxehtë-ftohtë, i bukur-i shëmtuar, natë-ditë, send-kuptim, etj. njihen vetëm sepse kanë të kundërta. Por gjëja që, për t'u njohur, ka nevojë për të kundërtën e vet, nuk mund të jetë krijues ose zot.

Artisti nuk është art. Muratori nuk është mur. E kundërta do të ishte një përçartje.

9. Disa herë, edhe pse bashkohen të gjitha shkaqet, rezultat nuk ka; disa herë, rezultati del në shesh edhe pa u formuar shkaqet e duhura

Disa herë, megjithëse bëhen bashkë të gjitha shkaqet (kushtet) për formimin e diçkaje, formimi i asaj diçkaje nuk ndodh. E kundërta, gjëja ndodh edhe pa u formuar shkaqet (kushtet) e duhura. Këto tregojnë se është një Individualitet, që zotëron vullnetin dhe aftësinë e duhur zgjedhëse për të bërë apo për të mos bërë diçka. Ai Individualitet është Allahu, Zoti i gjithësisë.

10. Ndërsa nevojat e njeriut si shkaku më i lartë dhe i aftë, zgjaten gjer në pafundësi, mundësia e tij është e barabartë me zero

Ndër shkaqet, njeriu është shkaku më i lartë e i aftë. Materia dhe dukuritë i janë nënshtruar atij. Me arsyen, vetëdijen dhe vullnetin e tij, njeriu është një qenie e zgjedhur. Pavarësisht nga të gjitha këto, njeriu është edhe qenia më e dobët, delikate dhe nevojtare. Diku mundet nga një mikrob, diku ndalet para edhe shkakut më të vogël. Megjithëse nevojat i ka të pafundme, fuqinë e ka të barabartë me zero. Dhe tani, njeriu me këtë përmbajtje dhe cilësi, ndaj cilit shkak do të hapë duart për lutje dhe nga kush do t'i kërkojë nevojat e veta të pakufishme?

Po, është një Individualitet të cilit ai i drejtohet e i lutet, Allahu, Zoti i gjithësisë, që i vërtit shkaqet në dorë si kokrrat e tespiheve!

V. PSE ALLAHU NUK I KRIJOI NJERËZIT TË NJËJTË DHE TË BARABARTË? PSE NJË PJESË NJERËZISH JANË TË PASUR, KURSE NJË PJESË TJETER TË VARFËR? NDËRSA NJË PJESË NJERËZISH NUK KANË ASNJË PROBLEM FIZIOLOGJIK, PSE NJË PJESË TJETËR JANË TË VERBËR, TË ÇALË OSE ME GJYMTIME TË TJERA? NGA ANA TJETËR, SHIHET SE, NDËRSA DISA NJERËZ VUAJNË NGA FATKEQËSI OSE KOKËÇARJE TE NDRYSHME, DISA TË TJERË ÇOJNË NJË JETË TË QETË E NË MIRËQENIE. Ç'KUPTIM MUND TË KENË TË GJITHA KËTO, CILAT MUND TË JENË URTËSITË DHE SHKAQET E KËTYRE?

Le të përpiqemi t'i japim përgjigje të shkurtra me pika kësaj pyetjeje të gjatë që e preokupon mendjen e njeriut të sotëm më shumë se të çdo periudhe të mëparshme.

1. Njeriu e do atë që njeh me aq sa e njeh

Po, njeriu e do atë që e njeh me aq sa e njeh, kurse i sillet si armik atij që s'e njeh; kështu ka ndodhur gjithmonë. Në fakt, një mosnjohje e tillë shtrihet edhe nën të gjitha pyetjet që vijnë erë kundërshtim. Sikur të kishte dëshirë njeriu për ta njohur krijuesin e vet sa ç'ndjehet i dëshiruar për ta njohur një popullaritet, sikur ta shqyrtonte njeriu librin e gjithësisë me kriteret dhe etalonet e Librit të Allahut duke përfituar nga mësimet e mjeshtërve që ia bëjnë të njohur e ia përshkruajnë Zotin e vet, sikur, duke ua vënë veshin sadopak të vërtetave të dala nga i Dërguari i Allahut, që i janë jetës jetë, për të mundur të sodisë aspektin përkatës të botës hyjnore të materies dhe dukurive me anë të blusë së tufave dritësore të formuara, si rezultat, në ndërgjegjen e tij, do t'u gjente zgjidhje qysh në krye të punës shumë pyetjeve dhe çështjeve që ia preokupojnë mendjen. Mirëpo ec e shih se në një periudhë kur dituria dhe meditimi janë vrarë, e kemi të pamundur të themi se ekziston ndonjëra prej këtyre!

2. Gjithë qenia, përfshi edhe njeriun, gjithë krijimi është pasuri e Zotit

Sa shumë gjëra ka që njeriu e pandeh veten për pronar të tyre, pra dhe që u del për zot ndërsa, duke e vrarë mendjen fare pak, do ta kuptonte se pronari dhe i zoti i tyre është Allahu dhe, kështu, do të hiqte dorë nga kjo çështje!

Ne s'mund të jemi pronari as i kafshatës që e fusim në gojë, sepse duhet të futet në punë tërë gjithësia që të përgatitet ajo kafshatë e të na vijë në tryezë. Kjo do të thotë se ai që na e dhuron atë kafshatë, mund të jetë vetëm Individualiteti që është i aftë për ta krijuar tërë gjithësinë. Meqë Ai është i zoti i çdo gjëje, vetëm Ai ka të drejtë të veprojë në pronën ku është zot, sepse pronari vepron si të dojë në pronën e vet dhe vetëm pronari mund ta administrojë pronën e vet!

Por shihni guximin dhe padrejtësinë e njeriut që i jep të drejtë rrobaqepësit ta presë e ta qepë, ta shkurtojë e ta zgjasë rrobën që e bën sipas shtatit të njeriut që e përdor si model, kurse e quan të tepër t'ia njohë këtë të drejtë Zotit!..

3. Allahu ka emra të pafund

Çdo emër kërkon praninë e pasqyrave që do të pasqyrojnë shfaqjet e veta. Për shembull, që të pasqyrohet, emri Rezzak, Ushqyes, kërkon praninë e qenieve që kanë nevojë për t'u ushqyer, kurse emri Shafi, Shërues, kërkon praninë e sëmundjeve dhe të të sëmurëve prej tyre. Ndërsa e interpretojmë këtë cilësinë e shfaqjes me aspektin që sheh nga ne, i themi "vrapimi i emrave në ndihmë". Me emrin Muxhib (që i përgjigjet thirrjes, ftesës), Allahu shkon në ndihmë të atyre që kanë mbetur në vështirësi, me emrin Kabz (që të shtrëngon, të tund e të sjell në vete), shkon në ndihmë të atyre që kanë rënë në indiferentizëm dhe përgjumje, kurse me emrin Basit (lehtësues), shkon në ndihmë të atyre që janë mbytur në halle. Po të merren të gjithë emrat një e nga një e të shqyrtohen pasqyrat që kërkojnë cilësitë e shfaqjeve si dhe gjendjet, situatat dhe trualli lidhur me ato pasqyra, atëherë do të shihet fytyra e urtësisë e pamjeve në jetën shoqërore të pandehura si diferencime.

Kjo do të thotë se Zoti na e bën të njohur veten me këta emra të pafund dhe na tregon shfaqjet e Tij të ashpërsisë dhe bukurisë. Ai na shfaqet në gjembat e trëndafilit me emra që shprehin forcë e ashpërsi duke na bërë t'ia shijojmë ashpërsinë, kurse në petalet e trëndafilit, me emra që shprehin delikatesë e bukuri duke na bërë t'ia shijojmë bukurinë. Ashtu siç piktori që, krahas peizazheve pranverore, pikturon po aq edhe peizazhe dimërore duke na e paraqitur mbulesën e bardhë të borës si dimension bukurie, që në një peizazh pylli, krahas luleve ngjyra-ngjyra, vizaton edhe një gjarpër të varur në degët e një peme dhe, pranë blerimit, vizaton edhe shkëmbinj, ashtu dhe Zoti e vizaton tablonë shoqërore me lapsin e shfaqjeve të emrave të ndryshëm të Tij duke i përftuar asaj një dimension dhe një thellësi tjetër. Fundja, kush mund ta bëjë këtë më bukur se Ai?..

4. Në gjithësi sundojnë të kundërtat

Nga grimcat e gjer te galaktikat, në çdo gjë ne vëmë re antagonizmin e polarizuar plus-minus. Fundja, nga ky antagonizëm buron uniteti i përsosur dhe rregullsia e pagabuar në gjithësi. Edhe njeriu duhet t'i përshtatet këtij ligji të krijimit në mënyrë që të ruhet uniteti në shoqëri. Pra, njerëzit duhet t'i përpjesëtojnë mes tyre gjendjet antagoniste, gjë që do të thotë të pranohet fakti që disa të jenë të pasur, disa, të varfër, disa të jenë të ngopur, disa, të uritur, disa të jenë të sëmurë e të gjymtuar, disa, të shëndoshë e pa të meta. Ashtu siç nuk është e mundur që gjithësia të grumbullohet e tëra në njërin pol (negativ ose pozitiv), nuk është e mundur as që të gjithë njerëzit të mbahen në të njëjtën gjendje dhe nivel. Çdo ndërhyrje e bërë nga jashtë, do ta prishë këtë ekuilibër sundues dhe harmoninë që siguron uniteti. Edhe zhdukja e gjarpërinjve dhe

minjve, madje, që do të thoshte të hiqej një fjali nga libri i natyrës duke ia prishur kuptimin përmbajtjes së tij, ndikon negativisht mbi rregullsinë dhe ekuilibrin në natyrë. Të tentosh për t'i bërë të gjithë të pasur ose të gjithë të varfër, është njëlloj, për sa i përket ndikimit negativ mbi rezultatin, si të tentosh t'i bësh të gjithë meshkuj ose të gjithë femra! Mjerë për gjithë ato përpjekje që kanë shkuar e shkojnë kot!

5. Krahas shumëllojshmërisë së formës dhe përmbajtjes së pyetjeve testuese dhe provimeve të zhvilluara për çdo profesion në rrugën për të arritur në përfundimin e dëshiruar, do të jenë të shumëllojshme e të ndryshme edhe numri, vështirësitë dhe lehtësitë e tyre

A mos është një meritë e vogël, për sa i përket përfundimit, të shpëtosh nga xhehenemi, ferri, e të fitosh xhenetin, parajsën, që të mos bëhet fjalë për një provim të caktuar dhe llogaridhënie sipas shkallës me qëllim për të hyrë atje? Njeriu që punon natë e ditë, që lodhet e mundohet për një pagë që i jepet në këtë botë sa për të jetuar ose edhe sa për të mbajtur frymën, gjithsesi do të pranojë të privohet, në shkëmbim të fitimit të një jete parajse, privimi prej së cilës është më i rëndë edhe se vdekja, nga disa gjëra të paktën po aq sa ç'privohet për ta fituar atë pagë. Dhe nga kjo kuptohet se situatat antagoniste që shohim në jetën e shoqërisë, janë shfaqjet më normale të cilësisë së vënies në provë të secilit, ndërkaq që prova apo provimi është i detyruar për këdo pa përjashtim!

6. Bota është shpenzim, jeta e pasme, fitim

Përpjekja dhe vështirësitë janë këtu, kurse vjelja e të mirave, atje. Meqë në jetën e pasme nuk ka shërbim dhe veprim, të gjitha shqetësimet do të kalohen këtu, do të jepet provim me durim tridimensional, kurse siguria dhe lumturia do të arrihen atje, sepse bota funksionon në të kundërt të jetës së pasme, kurse jeta e pasme funksionon në të kundërt të kësaj bote. Shpirti zhvillohet në të kundërt të kurmit, kurse kurmi zhvillohet në të kundërt të shpirtit. Ata që përpiqen të jetojnë në këtë botë sipas pasioneve të tyre, në botën tjetër do të përballen me një jetë që s'ka për t'u pëlqyer aspak. Shqetësimet e hequra dhe privimet e pranuara këtu, do të përbëjnë shkaqe për dhënien e shumëfishuar të shpërblimeve që do të fitohen atje. Në një hadith kudsi, kjo specifikë trajtohet kështu: *"Nuk i jap bashkë dy siguri dhe dy frikëra!"* Allahu nuk e miraton që jeta e pasme e robve të Tij të dashur të konsumohet këtu dhe u favorizon atyre një mënyrë jetese që të mos përballen me një përfundim të tillë, madje ua bën të detyrueshme dhe ky detyrim është një detyrim favorizues.

7. Shqetësimet dhe fatkeqësitë janë përjashtime dhe zënë një kohë shumë të shkurtër në raport me jetëgjatësinë mesatare të një njeriu

Po ta analizojë jetën e tij njëzetekatërorëshe duke e ndarë në fragmente kohore sipas ngjarjeve të jetuara dhe ta shtrijë këtë në të gjithë jetën e tij, njeriu do të shohë se pjesën më të madhe të kohës e ka kaluar në qetësi, begati dhe të mira.

Tani, duke mbajtur parasysh se janë shumë të mira mbi të cilat nuk na shkon mendja sepse janë të përgjithshme e të zakonshme, le të përpiqemi t'u japim përgjigje këtyre pyetjeve: *"A mos është dielli malli ynë? A kemi paguar gjer më sot ndonjë faturë për dritën e tij që kemi konsumuar? Po për rrezet e tij që janë burim nxehtësie, ç'duhet të themi? Sa kemi paguar për shërbimet që na kanë bërë shiu, retë, era dhe toka? Sa sekonda në vit na është prerë ajri? A ndodhi që të mos lindte dielli ndonjë ditë? Dhe sa ditë të vitit i kaluam të sëmurë?"*

Me të vërtetë, po t'i krahasojmë ditët e vitit që kemi kaluar të shëndoshë, me të mira dhe gëzim, me ditët që kemi kaluar të sëmurë, të shqetësuar, të goditur nga ndonjë fatkeqësi ose me mungesa të ndryshme, do të shohim se, në përgjithësi, ditët që kalon njeriu me vuajtje të ndryshme i zënë një pjesë shumë të vogël të

kohës dhe janë gjithmonë kalimtare. Veçanërisht, ditët me vuajtje i heqin njeriut shumë pak gjëra të lidhura me këtë botë, ndërsa i përftojnë shumë e shumë gjëra të lidhura me jetën tjetër. Ndërkaq, për sa u përket shkaqeve të vuajtjeve, duhet të mos harrojmë se shumica kanë të bëjnë me shpërdorime, nënvleftësime dhe vese të këqija të vetë njerëzve si individë e si shoqëri. Përtej këtyre, sëmundjet dhe fatkeqësitë kanë edhe shumë aspekte mëshire dhe përfitimesh.

Në historinë e botës, vitet e kaluara me luftë përbëjnë një pjesë shumë të vogël të shekujve të kësaj historie. Në të njëjtën mënyrë, po të mblidhen minutat e tërmeteve, nuk bëjnë as një orë në disa shekuj. *Harku është i shtrembër (i përkulur), por shigjeta është e drejtë dhe gjuajtja godet në shenjë!*

Po të shihet nga afër një tablo, do të kuptohet qartë se hijet e dukura si të shëmtuara e pa kuptim dhe ngjyrat e errëta, kur vlerësohen së bashku me bukuritë dhe si një e tërë me to, s'janë aspak ndonjë e metë e piktorit apo e tablosë, përkundrazi, pjesë përbërëse dhe funksionale e një të tëre harmonike dhe pjesë e bukurive dhe e estetikës së tablosë. Por për ta bërë këtë vlerësim, duhet që syri dhe koka të jenë të shëndoshë dhe tabloja të shihet nga largësia e përshtatshme!

8. Drejtësia shpreh kuptimin e një ekuilibri

Kur hejbet e ngarkuara të kafshës të jenë të ekuilibruara ose pjatat e peshores të jenë në një nivel, themi se është zbatuar drejtësia.

Allahu është i drejtë; edhe ekuilibrin, mbi këtë drejtësi e ka vendosur. Nga atomet te galaktikat, nga bimët te kafshët e gjer te njerëzit, çdo qenieje të gjallë ose jo të gjallë i janë dhënë pajisje në nivel të domosdoshëm në përshtatje me natyrën e krijimit të tyre. Për sa i përket njeriut, ai s'paguan asgjë për to. Po qe se drejtësia është dhënia në të njëjtën masë e cilësi me marrjen, në përgjithësi, kundërshpërblim i njëvlefshëm e i ekuilibruar, urdhëroni e jepini Allahut barazvlerësen e atyre gjërave që ju ka dhënë!

Pasuria i përket tërësisht Allahut. A ka diçka që të na bjerë neve në pjesë? Po çfarë kemi ne tonën për ta dhënë si kundërvlerë të gjërave që na ka dhënë Allahu falas?! Po qe se Allahu na kërkon *që, nga gjërat që përdorim dhe përfitojmë, pjesën e Tij ta ndajmë veç e tonën, veç,* neve na mbetet vetëm një *zero* dhe ajo e tillë, për të cilën nuk mund të themi *imja*! Atëherë themi se nuk kemi të drejtë dhe kompetencë të përzihemi në punët e të zotit të pronës në pronën e vet! Në mënyrë të veçantë, pavarësisht nga masa e gjësë që i është dhënë falas, njeriut i bie për detyrë vetëm të falënderojë për pjesën e vet.

Është e dobishme ta sqarojmë çështjen me një shembull. Le të mendojmë tre shokë të varfër, të panjeri e nevojtarë për gjënë më të vogël. Vjen një njeri i pasur, i kap për dore me radhë dhe, nga rrugë të ndryshme, i hip në minare me tre ballkone, si minaret e Selimijes.

Për ta, në shkallët spirale të minares ka dhurata të ndryshme. Ndërkaq, dhuratat për të parin mbarojnë tek dalja e ballkonit të parë. Prandaj shoku i parë del në ballkonin e parë. Dhuratat për të dytin mbarojnë tek dalja e ballkonit të dytë dhe ai del në ballkonin e dytë. Kurse për shokun e tretë ka dhurata më shumë. Ato mbarojnë në daljen e ballkonit më të sipërm. Së bashku me dhuratat, ai del në ballkonin e tretë.

Të tre shokët e shohin tashmë njëri-tjetrin dhe e kuptojnë se u janë dhënë dhurata në mënyrë të pabarabartë. A kanë të drejtë, megjithëkëtë, të ankohen? Fundja, ato janë dhurata dhe i pasuri nuk u kishte asnjë detyrim. Shokëve u mbetet për detyrë vetëm ta falënderojnë mirëbërësin.

Sipas këtij kriteri dhe në këtë masë duhen vlerësuar favoret dhe të mirat e Zotit. Duke e nxjerrë njeriun nga mosqenia në shkallaren e qenies dhe, pastaj, duke e ngjitur në nivelin njerëzor, Zoti ka vepruar vetëm me favorin dhe mirësinë e Tij. Prandaj, ajo çka i bie njeriut, është ta falënderojë Zotin në çdo shkallare të të mirave dhe, përballë çdo të mire, vetëm të entuziazmohet me ndjenjën e falënderimit.

Po të mendohet edhe ca më shumë, njeriu do të kuptojë se nuk është fjala për t'u ankuar ndaj Zotit, por për t'u drojtur prej Tij kur niset t'i kërkojë diçka. Fundja, nuk e ka falënderuar për të mirat e të shkuarës që t'i kërkojë Atij diçka për të ardhmen! Nëse i kërkojmë, këtë e bëjmë sepse i besojmë favorit dhe mirësisë së Tij dhe se është vetë Ai që na e ka dhënë të drejtën për të kërkuar!

9. Jo vetëm që s'është e mundur t'i bëjmë njerëzit të zotërojnë mundësi në të njëjtin nivel, por një gjë e tillë s'është as e dobishme!

Sa e sa pasanikë ka që do ta jepnin gjithë pasurinë vetëm për të shijuar një ditë lumturie të një të varfëri! Ka shumë pasanikë që bëjnë vetëvrasje për shkak të mungesës së qetësisë dhe lumturisë. Vetëm se këto fakte nuk do të thonë se varfëria sjell lumturi! Ka të varfër të tillë që çdo ditë e kalojnë sikur të gëlltitnin gjemba! Dhe nga kjo kuptohet se as pasuria është shkaku i vetëm i lumturisë, as varfëria! Sepse njeriu nuk është një qenie e identifikuar me stomakun. Krahas stomakut, ai ka shpirtin, ndjenjat, vetëdijen, ndërgjegjen... Dhe janë pikërisht këto e jo stomaku gjërat që e bëjnë njeriun njeri duke e dalluar nga frymorët e tjerë. Po qe se s'kënaqen këto, sikur të gjitha pasuritë e botës t'i jepeshin një njeriu të vetëm, prapë ai nuk do të bëhej i lumtur. Ja, pra, e gjithë çështja është të përgatiten individët dhe shoqëritë sipas një baze që do t'u jepte qetësinë dhe lumturinë. Ndryshe, në këtë botë të përkohshme, jepini njeriut ç'të doni, por nuk do ta bëni dot të lumtur!..

10. Botëkuptimi i barazisë ose barazitizmi

T'ia marrësh diçka të pasurit e t'ia japësh të varfrit, në fakt, nuk sjell barazi, përkundrazi, i hap rrugë atrofizimit të aftësive, shfaqjes së dëshirës për punë dhe përpjekje, rënies së prodhimit dhe vdekjes së ndjenjave të bukura si dashuria, respekti, bindja dhe dhembshuria. Fundja, nëse dikujt nuk i bie në dorë diçka ose ajo që i bie, i merret përsëri nga dora, kush përpiqet e kush derdh djersë për të fituar, për të vënë pasuri? Prandaj ndodhi që sistemi komunist mbeti, më në fund, i detyruar ta njohë pronën private duke e thyer me duart e veta gurin e themeleve të veta. Prandaj, rrëmbimi me forcë i pasurisë nga pronari nuk është zgjidhje. Ndoshta zgjidhje është t'i fitohet zemra e të përgatitet për të dhënë, kështu, t'i përftohet atij një ndjenjë njerëzore.

A mos vallë është drejtësi t'ia rrëmbesh nga dora pasurinë një njeriu që, duke respektuar moralin e tregtisë, përpiqet dhe fiton në rrugë legjitime e të bekuara, e t'ia japësh një dembeli që vret kohën me llomotitje në qoshet e kafeneve? A nuk e bën një sjellje e tillë viktimë një pjesë të shoqërisë, kurse pjesën tjetër, një shtresë parazitësh që jeton vetëm në kurriz të të tjerëve? Ata që propozojnë një drejtësi të tillë, si do ta shpjegojnë, pastaj, urrejtjen dhe armiqësinë e pashmangshme mes të pasurve që u është rrëmbyer me forcë pasuria dhe të varfërve që janë kthyer në parazitë duke u dhënë padrejtësisht mall dhe mundësi për të cilat nuk kanë derdhur djersë? Pas të gjitha këtyre pyetjeve dhe çështjeve qëndron fakti i falimentimit të sistemeve njerëzore të marrëdhënieve ekonomike e juridike. Është e qartë se njerëzimi ka për të shpëtuar vetëm me anë të sistemit hyjnor.

Dhe ja Islami i cili, nën frikën e Allahut, u ka dhënë rëndësinë e duhur edhe kapitalit, edhe punës; në të njëjtën kohë, duke e nxjerrë kapitalin nga të qenit një pushtet që qarkullon nëpër duar të të pasurve dhe duke ngritur ulluqe ushqyese për shtresën e të varfërve me anë të urës së lëmoshës, taksës së quajtur zekat dhe huasë pa kamatë, ka siguruar rrjedhjen dhe qarkullimin e kapitalit. Veçanërisht, Islami, duke penguar, nga njëra anë, shtypjen e të varfërve me anë të rrugëve jolegjitime të pasurimit, si kamata, tregu i zi dhe spekulimet e ndryshme, nga ana tjetër ka dekretuar *"t'i jepet punëtorit pagesa pa iu tharë ende djersa"*! Kështu, ndërsa nga njëra anë ka marrë këto masa, nga ana tjetër, Islami, nëpërmjet figurës së Profetit që e kalonte jetën mbi rrogoz, ka treguar me anë të këtij qëndrimi shembullor se ç'është varfëria për jetën tjetër.

Kështu, Islami pati formuar një shoqëri të mbështetur mbi mëshirën dhe dhembshurinë nga lart dhe bindjen dhe respektin nga poshtë, për rrjedhojë një shoqëri të qetë e të lumtur. Historia e Islamit është pasqyra më e bukur e hedhjes në praktikë të këtyre lloj mendimeve e ndjenjave si dhe e rregullave hyjnore që nxjerrin në pah mendjet dhe zemrat. Unë besoj se leximi dhe vlerësimi i historisë së Islamit nga kjo perspektivë do t'i përftojë shumë gjëra njeriut të sotëm dhe se historia e Islamit do ta kapë për dore atë për të gjetur rrugën më të efektshme për shkatërrimin dhe zhdukjen e të gjitha bllokimeve shoqërore.

Parapëlqimi dhe zgjedhja e pasurisë apo varfërisë ka të bëjë plotësisht me botën ndjesore të individit. Sado që ta shtrëngoni individin që i ka mbërthyer sytë te horizontet sublime e te idealet sublime e që përpiqet për ta ngritur njerëzimin në qiellin e të qenit njeri, nuk keni për ta futur dot në burgun që, sipas tij, konsiderohet pasuria. Megjithëse në planin individual kjo gjë qëndron kështu, në planin shoqëror e kombëtar përfshihet edhe përgatitja e të gjitha kushteve që shteti të jetë i fuqishëm, gjë që ka një rëndësi të pashmangshme. Me këtë ekuilibër e pati rrethuar Islami njerëzimin dhe ky ekuilibër qe ruajtur për sa kohë që qenë respektuar parimet që pati sjellë ai!

Sipas kritereve të Mbretit të Zemrave, Profetit Muhamed, kjo botë është, në krahasim me jetën tjetër, një hije, një kalim vape nën një pemë, një lojë dhe dëfrim dhe, para Allahut, vlera e saj në krahasim me botën e përjetësisë, është një etapë e zakonshme me vlerë as sa krahu i një mize. Megjithëkëtë, me një vlerësim tjetër, po kjo botë është mjeti dhe mjedisi më i rëndësishëm për t'u ngjitur në horizontet sublime ku shpaloset emri i Zotit. Duke u përdorur mirë ky mjet e ky mjedis, myslimanët do të bëhen element ekuilibri mes shteteve të botës dhe, në çdo lloj marrëdhëniesh diplomatike, do të bëhen një shoqëri e treguar me gisht. Më në fund, ashtu si në çdo fushë tjetër, myslimanët do të zotërojnë edhe në fushën e tregut, ku, shembullin më të zgjedhur e gjejmë përsëri në praktikën e Profetit. Pak kohë pas emigrimit të tij në Medine, myslimanët u bënë zotër të tregut të atjeshëm dhe, megjithëse nuk i pengonte kush, çifutët patën mbetur të detyruar ta braktisnin tregun.

Hz. Omeri, përveç kuajve të luftës, ushqente, në vende të ndryshme, edhe mijëra kuaj të tjerë. Hz. Osmani qe aq i pasur e bujar sa të dhuronte mijëra deve së bashku me barrën. Ndodhte kështu, sepse ishte një pikë që i bashkonte të dy: të dy bënin një jetë të thjeshtë, hanin një copë bukë thatë, flinin mbi rërë dhe nuk ndaheshin kurrë nga populli i thjeshtë. Këto s'ishin përfundime të arritura me shtrëngim, përkundrazi, ishte shpirti i përftuar prej Islamit që i rriste e përgatiste ata e të tjerë si ta për t'i vënë në shërbim të popullit!

Po qe se elementi njeri është me të vërtetë çështja më kryesore dhe po qe se ata që kërkojnë ta bëjnë këtë çështje flamur duke e bërë pajandër për idetë e tyre të vjetruara, nuk janë gënjeshtarë në fjalët dhe thëniet e tyre, atëherë, ejani t'i gjejmë një zgjidhje kësaj çështjeje. Me fjalë të tjera, ejani ta risjellim në rend të ditës zgjidhjen e gjetur pesëmbëdhjetë shekuj më parë. Sepse e vetmja zgjidhje që do ta bëjë njeriun një monument vlerash e virtytesh, është zbatimi në praktikë i asaj Recete Hyjnore. Në të kundërt, kërkimi i ndonjë zgjidhjeje tjetër është vetëm kthimi i sëmundjes në gjendje kronike.

11. Le të përpiqemi ta plotësojmë çështjen në aspektin që ka të bëjë me kokëçarjet dhe fatkeqësitë duke u shtuar një përmbledhje gjërave që thamë më lart

Edhe pse në ngatërresat, kokëçarjet, sëmundjet dhe gjymtimet ka disa dëme të pjesshme, duke u nisur nga përfundimi, mund të thuhet se janë jashtëzakonisht të dobishme. Kështu ndodh që ia tërheqim veshin fëmijës për ta edukuar, që e presim gishtin e gangrenizuar për ta shpëtuar trupin, që, kur duhet, prej helmit të gjarprit bëjmë ilaç, etj. dhe askush nuk del kundër këtyre, sepse lejohet një dëm i vogël i sotëm për një përfitim të madh të së ardhmes.

Le të vazhdojmë. Skifteri zhvillon aftësinë vetëruajtëse të trumcakut, ndërsa, në dukje, e tremb dhe e mban të shqetësuar atë. Disa herë ndodh që dikush apo disa të pësojnë dëm nga shiu, rryma elektrike apo

zjarri, por s'del kush që t'u lëshojë mallkime shiut, rrymës elektrike dhe zjarrit! Në agjërim, në pamje të parë, pranohet se trupi mundohet. Vetëm se agjërimi i përfton trupit qëndresë dhe gjallëri. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për stërvitjen ushtarake. Mirë, po shpirti ynë? A të mos pastrohet edhe ai me anë të sëmundjeve dhe fatkeqësive për t'u bërë i aftë për parajsë? Dhe ky përfundim nuk është aspak për t'u nënvleftësuar!

Të marrësh pak e të japësh shumë është veti e shquar e Allahut, Zotit të gjithësisë. Po të duhet, Ai na e merr syrin, këmbën, por, si shpërblim, na jep pozitën e dëshmorit. Na e merr pasurinë, por në jetën tjetër na shpërblen me shumë më tepër të mira. Na bën të durojmë dhe, si shpërblim, na dhuron të mira të pakufishme.

Durimi dhe lejueshmëria ndaj sëmundjeve, kokëçarjeve dhe fatkeqësive konsiderohen si adhurime. Edhe me to fitohen të mira. Pastaj, te këto nuk ka rrezik dyfytyrësie, sepse askush nuk bëhet i sëmurë për t'u dukur.

Kokëçarjet dhe fatkeqësitë ngrenë edhe shkallën e personit. Me ngjitjen në lartësitë malore, njeriu ndjen shtrëngim në gjoks për shkak të rrallimit të ajrit dhe oksigjenit. Bora, furtunat, tufanet gjenden më shumë në majat e maleve të lartë. Prandaj ka ndodhur që profetët kanë vuajtur më shumë dhe në këtë rrugë janë lartësuar njerëzit e mëdhenj.

Kokëçarjet dhe fatkeqësitë ua mësojnë njerëzve vlerën e të mirave dhe hapin për ta rrugën e falënderimit. Uria ia dyfishon vlerën bukës. Sa i ëmbël është një gotë ujë në iftar! I sëmuri e kupton më mirë vlerën e shëndetit, kurse ai që ka të gjymtuar një organ, e kupton më mirë se të tjerët vlerën e organeve të shëndosha.

Njeriu ka nevojë vazhdimisht të paralajmërohet ndaj armiqve të tillë si egoja e vet dhe djalli. Ja, pra, kokëçarjet dhe fatkeqësitë këtë detyrë kryejnë për njeriun, ta paralajmërojnë dhe mbrojnë ndaj mëkateve. Ç'të jetë guri që i hedh deles që kërkon të hyjë në livadhin e huaj, bariu i mëshirshëm, janë kokëçarjet dhe fatkeqësitë për besimtarin. Njeriu me xhepat plot dhe i shëndoshë e ka më të lehtë të bjerë në mëkat. Kurse privacionet dhe sëmundjet e mbrojnë atë përballë një rënieje të tillë. Veçanërisht, edhe sëmundjet dhe fatkeqësitë që, duke e kuptuar dobësinë e një të sëmuri viktimë fatkeqësie, mund të bëhen shkak për shpëtimin e tij nga sëmundja e krenarisë dhe mendjemadhësisë, vlejnë për të si ilaç. Madje ka mëkate të tilla, për të cilat vetëm fatkeqësitë mund të vlejnë si kundërvlerë. Po, sa e sa kokëçarje dhe fatkeqësi ka që, ashtu siç i shkund era gjethet e pemës, ia shkundin njeriut mëkatet duke e bërë krejt të pastër. Fundja në xhenetin që është i pastër, vetëm njerëz të tillë krejt të pastër do të hyjnë!

Po qe se çështjen do ta trajtojmë në një aspekt pak më specifik, roli i kokëçarjeve dhe fatkeqësive që shoqërojnë përgatitjen e një bashkësie, është shumë i madh dhe, sa ç'është i madh, është i rëndësishëm. Mbështetur në urtësinë për t'i dalluar shpirtrat vetëmohues që kanë për t'i vënë supet kauzës nga interesaxhinjtë, Allahu i trondit pjesëtarët e kauzës me prova të ndryshme, i shoshit, gjersa të kulluarit dhe të pastrit të veçohen prej të tjerëve dhe karakteret e dobët që kanë për t'u ndarë në gjysmë të rrugës, të ndahen qysh në krye të punës në mënyrë që në të ardhmen, në pika shumë kritike, të mos përjetohet disfatë!

Disa herë, kokëçarjet dhe fatkeqësitë përgjithësohen. Kokëçarjet e ardhura në këtë mënyrë, i fusin edhe të pafajshmit në të njëjtin karvan. Sepse kështu e kërkon e fshehta e provës. Ndërkaq, në jetën tjetër, të pafajshmit do të grumbullohen veç, sipas qëllimit, edhe të tjerët, veç, sipas qëllimit. Pavarësisht nga të gjitha këto, kokëçarjet dhe fatkeqësitë nuk kërkohen, por, po erdhën, njeriu duron, tërhiqet në vetvete. Kurse aftësia për të thënë për Zotin, *"edhe të mirën e ke të këndshme, edhe të keqen"*, është një çështje niveli.

Mëkatet e kryera dhe kundërshtimet e bëra ndaj Zotit janë si ftesa për kokëçarjet dhe fatkeqësitë. Kjo është edhe një ndër shkaqet e shkatërrimit të popujve të kaluar. Kurse ata që janë si rrufepritës dhe mbrojtës ndaj këtyre lloj kokëçarjeve dhe fatkeqësive, janë burra të zemrës që mund të derdhin lot për mëkatet e të tjerëve sa dhe për të vetat, dhe që kanë një shpirt delikat.

PJESA E DYTË

SHPIRTI, ENGJËLLI, XHINDI DHE DJALLI

I. EKZISTENCA E SHPIRTRAVE, ENGJËJVE, DJAJVE DHE XHINDËVE

1. Ekzistenca e këtyre krijesave është e fiksuar me pohimet e Kuranit dhe të Profetit (s.a.s.)

Të gjitha argumentet që vërtetojnë se Kurani është fjala e Allahut dhe të gjitha provat që dëftojnë profetësinë e profetit Muhamed (s.a.s.), janë, në të njëjtën kohë, argumente dhe prova të ekzistencës së shpirtit, engjëllit, djallit dhe xhindit. Ai që nuk mundet t'i mohojë të parët, nuk mund t'i mohojë as këta

sepse tema e këtyre krijesave është marrë dhe trajtuar, me raste të ndryshme, edhe në Kuran, edhe në fjalët e bekuara të Profetit dhe ekzistenca e tyre është dëftuar dhe miratuar nga ata vetë. Ja, me të tilla argumente të shëndosha e të përgjithësuara mbështetet çështja e shpirtit, engjëllit dhe djallit.

Edhe sikur të mos ketë argument tjetër lidhur me ekzistencën e engjëjve, xhindeve dhe Shejtanit, si kreu i xhindeve, Profeti dhe Kurani mjaftojnë si argument, siç mjaftojnë edhe për shumë tema dhe çështje të tjera, sepse ka pesëmbëdhjetë shekuj që jo vetëm që s'është përgënjeshtruar qoftë edhe një fjalë e Kuranit dhe Profetit, por as nuk është parashtruar e kundërta e tyre. Sa ligje shkencore të pranuara si të vërteta të pakundërshtueshme të jenë gjetur dhe sa zbulime të jenë bërë, pothuaj të gjitha ndodhen në Kuran si përmbledhje ose esenca dhe janë lajmëruar prej tij pesëmbëdhjetë shekuj më parë. Në këto kushte, themi se ekzistenca e engjëjve dhe xhindeve është e formës së prerë si dhe ekzistenca jonë dhe kategorike si karakteri kategorik i vërtetësisë së Kuranit dhe Profetit. Ata që nuk besojnë dhe bien në mohim, bien në këtë gjendje të çuditshme dhe të pakuptueshme si pasojë e mendjemadhësisë, krenarisë, kryeneçësisë, paragjykimit si dhe armiqësisë ndaj Kuranit dhe Islamit.

2. Fakti që nuk i shohim këto qenie, nuk argumenton mosekzistencën e tyre

Shikimi i njeriut është shumë i kufizuar në raport me ekzistencën e përgjithshme. Prandaj njeriu nuk mund të mjaftohet duke thënë "s'është" për atë që s'e sheh. Sa shumë gjëra ka që, megjithëse e dimë që ekzistojnë, nuk mund t'i shohim. Mosshikimi nuk përbën shkak për mosekzistencë. Shumë çështje që gjer dje ishin të panjohura për ne, sot, më në fund, janë të njohura e të zakonshme. Meqë gjërat që dimë kanë hapur portën për të ditur shumë gjëra që s'i dimë, ne jemi të detyruar t'i kërkojmë ato. Nuk ka asnjë pengesë që të bëjmë të njëjtin arsyetim edhe për çështjen që po diskutojmë.

3. Këto qenie nuk janë të dimensioneve tona të shikimit, vëzhgimit, perceptimit dhe njohjes

Shpirti, engjëlli, xhindi dhe djalli nuk janë të dimensioneve tona që të mund t'i shohim. Me organet tona, ne mund t'i shohim dhe ndjejmë vetëm ata që hyjnë në dimensionet tona. Me të vërtetë, edhe njësitë e masës ndryshojnë sipas gjendjes së posaçme të ekzistencës. Njësitë e masës të largësisë, peshës dhe dendësisë janë gjithmonë të ndryshme. Situata e atij që përpiqet ta mësojë temperaturën e zjarrit pa futur dorën në të ose pa përdorur aparat të posaçëm për matjen e temperaturës së tij, mund të përngjasohet me gjendjen e atij që përpiqet t'i shohë, t'i prekë e t'i përcaktojë se ç'janë qeniet metafizike, pra, jolëndore, me anë të mjeteve lëndore. Që të dy ndjekin një rrugë të gabuar për të arritur te synimi që i kanë vënë vetes.

4. Shpirti te njeriu që është mikrokozmos, është si engjëlli në makrokozmos.

Në gjithësi janë sundues kuptimi dhe shpirti, jo lënda. Gjithashtu, e para është krijuar antilënda, jo lënda. Së pari janë bërë ekzistente entitete që do të mund të bëheshin kallëpe për dritën, shpirtin dhe lëndën. Kjo është kështu për të gjithë ekzistencën, nga më e vogla gjer te më e madhja. Pastaj, brenda një kohe të caktuar, ekzistenca është formësuar sipas atyre kallëpeve.

Në ekzistencë sundon një determinizëm, një paracaktim, një masë, plan dhe program matematik. Në sajë të ligjeve dhe parimeve të pandryshuara dhe nën sundimin e këtyre parimeve, çdo gjë lëviz dhe qarkullon duke u vëzhguar dhe ruajtur. Në këtë mes, pas gjësë së dukshme ndjehen një sërë forcash të padukshme.

Për shembull, po ta kuptonim gjuhën e një fare ose, po ta kuptonte ajo gjuhën tonë, dhe ndoshta e kupton, do ta pyesnim: *"Ç'dëshiron të bëhesh ti?"* Ajo do të na përgjigjej: *"Pemë!"* Dhe, në përfundim, do të bëhej pemë. As ndërrimi i stinëve, as kalimi i periudhave të ndryshme, as transportimi i saj nga një vend në një tjetër nuk ka për ta nxjerrë farën gënjeshtare, sepse shndërrimi i saj në pemë është ligj. Mirë, po a mund

ta shpjegojmë ne, tani, ligjin për t'u bërë pemë te kjo farë? Jo! Mirë, mos për këtë do ta mohojmë? Sigurisht që jo!

Era me një përbërje të tejdukshme sa nuk mund të shihet me sy, zotëron një fuqi që mund t'i shkulë nga rrënjët e t'i hedhë tej pemët, t'i fluturojë çatitë, etj. Dhe ne, pasi jemi bërë dëshmitarë për vite të tëra disa herë në vit të ngjarjeve të tilla, a mos do ta mohojmë fuqinë e erës vetëm pse nuk e shohim?

Pasi rryma elektrike të lidhet në një sistem, pavarësisht se kush e shtyp butonin, vë në lëvizje një fabrikë të madhe, makineri gjigande, etj. dhe ne e kuptojmë fuqinë e saj potenciale vetëm nga pasojat. Gjer më sot askush nuk e ka parë dot energjinë potenciale të rrymës elektrike, por askush veç ndonjë naivi nuk e ka mohuar.

I tillë është edhe ligji i tërheqjes dhe shtytjes, prania dhe veprimi i të cilit nga molekulat gjer te trupat qiellorë pranohet nga të gjithë. Rregullsia dhe harmonia në natyrë vazhdon të ekzistojë në sajë të këtij ligji. Po a mos do ta mohojmë këtë ligj që ia shohim pasojat, por jo vetë atë?

Shembuj të tillë mund të japim plot. Por, si përfundim, ekzistenca dhe dukuritë duan të na thonë kështu:

"O njeri! Ti ngece pas nesh, por ne jemi vetëm si një perde e tejdukshme. Ne s'bëjmë gjë tjetër veçse zbatojmë urdhrat që na janë dhënë. Mbi ne ka ca vëzhgues që quhen shpirt dhe engjëll. Ju na shihni ne sikur të shihnit degë të një peme të zgjatura mbi avllinë tuaj, kurse trupi dhe fuqia e vërtetë tonat janë të shpirtit dhe engjëllit, të Zotit që shihet tek ta. Po, mos harroni se njeriun që është një kozmos i vogël, e vëzhgon shpirti, kurse kozmosin që është një njeri i madh, e vëzhgojnë engjëjt!.."

5. Gjithësia është përgatitur për qenie me jetë dhe vetëdije

Nuk i shërben jeta materies, por materia jetës. Po t'i shqyrtojmë një nga një dhe së bashku të gjitha ç'ka në gjithësi, nga toka te ajri, nga dielli te era, nga ligjet që veprojnë në gjithësi te rregullsia dhe harmonia që sigurohen me anë të këtyre ligjeve, shohim se të gjitha këto janë për të përgatitur në tokë bazën dhe kushtet për jetesën e gjallesave, veçanërisht të qenieve me vetëdije. Në gjithësi nuk ka shpenzim të kotë, nuk ka shpërdorim. Po qe se të gjitha këto gjëra nuk do të përfundonin me jetën, do të duhej të pranoheshin si gjëra të kota e pa kuptim. Sepse pa jetën nuk do t'i mbetej kuptim asnjë qenieje dhe veçorive të saj. Ndërkaq, edhe jeta vetë pa vetëdije si dhe gjithçka tjetër që do ta rrethonte, do të ishte e errët, pa ngjyrë. Kështu, pra, gjithësia është përgatitur edhe për jetën, edhe për qeniet e vetëdijshme. Pastaj, meqë kjo botë, megjithëse shumë e vogël, është plot me qenie të gjalla e të vetëdijshme, edhe yjet që janë mijëra herë më të mëdhenj se bota jonë, gjithsesi, brenda kushteve të tyre, duhet të jenë plot me qenie të vetëdijshme, që janë engjëjt, xhindet dhe shpirtrat.

6. Jeta nuk varet nga lënda prej së cilës përbëhet

Po qe se cilësia e jetës do të varej prej lëndës nga e cila përbëhet, elefanti dhe rinoqeronti duhej të ishin më të shpejtë e të shkathët dhe më të ndjeshëm se pleshti. Madje, ndijimet më të mprehta do të duhej të ndodheshin jo te miza, por te mali. Ndërsa ishin Everestët, një zog nuk do ta bënte dot botën një kopsht për vete. Kjo do të thotë se lënda dhe materia janë pasive, kurse kuptimi, shpirti dhe jeta janë vepruese dhe aktive. Jeta është esenca dhe përmbajtja, kurse lënda është cipa, lëkura. Është lënda, materia ajo që i shërben jetës dhe jo ndryshe. Atëherë themi se thelbësore janë jo ato që duken, përkundrazi, ato që s'duken.

7. Dukuritë që ndodhin në gjithësi nuk mund t'ua dedikojmë ligjeve imagjinare

Ligji i gravitacionit që është hipotetik dhe konvencional, nuk mund *t'i bartë në shpinë* trupat qiellorë gjigandë. Detyrat që kryen mendja, nënshkrimi i të cilës ndodhet mbi zbatime të pafund dhe ato funksione të mrekullueshme të trurit nuk mund t'u dedikohen reaksioneve kimike trunore që s'janë veçse një shkak i dukshëm. Atëherë jemi të detyruar të pranojmë ekzistencën e engjëjve që mbajnë në duar ligjet dhe të shpirtit që drejton trurin. Nuk është një shpjegim i arsyeshëm t'ua dedikosh të gjitha këto ligjeve imagjinare dhe lëndës së zbërthyeshme ndërsa ekzistojnë engjëjt dhe shpirti.

8. Janë një turrë dukurish dhe ngjarjesh që u japin shpjegim çështjeve mbi engjëjt, xhindet dhe shpirtrat

Bota është plot gjallesa, kurse çdo gjallesë, e pajisur me mjete në përshtatje me kushtet e veta jetësore. Gjallesat që jetojnë në tokë, gjallesat që jetojnë në ujë, shkurt, të gjitha gjallesat kanë organe në përshtatje me botën e tyre. Është e pamundur që këto të dalin jashtë kushteve ku ndodhen për të kaluar në një botë tjetër. Sado që është i pajisur me mjete të përsosura, njeriu nuk mund të jetojë as jetën e peshkut më të vogël. Njeriu mund ta vizitojë, bie fjala, botën e peshqve vetëm kalimthi, duke u pajisur me mjete që imitojnë organet apo mjetet e tyre.

Përreth nesh jetojnë mijëra lloje krijesash; ato që jetojnë në akullnaja, që jetojnë në shkretëtirë, që e marrin oksigjenin nga ajri, që e marrin oksigjenin nga uji, që hanë prodhimet e dala nga toka, që përshkohen duke ngrënë dhé, që ecin duke u zvarritur, që fluturojnë në qiell ose që notojnë në ujë, etj., etj.

Në këtë planet të vogël që s'do të përbënte as dhe një pikë në krahasim me sistemet e tjera, ekzistojnë mijëra lloje jetësh dhe mënyra jetese. Ndërsa gjendja në tokë paraqitet e tillë, a nuk kanë yjet shumë më të mëdhenj se toka, sistemet qiellore, dielli dhe planetet banorë të gjallë e të vetëdijshëm në përshtatje me kushtet e atjeshme? Përgjigjja "jo" që do të jepej menjëherë, pa u menduar, gjithsesi do të ishte e gabuar. Sepse njerëzimi ende s'ka hyrë në kushtet e atjeshme për të bërë kërkime. Nuk ka ndryshim mes mohimit të jetës në thellësitë oqeanike pa hyrë në to për të parë, dhe mohimit të jetës së mundshme në botët e tjera pa shkuar atje. Ashtu siç ka qenie që jetojnë në ujë pa u mbytur, ashtu dhe mund të ketë qenie që s'i djeg zjarri. Dhe banesa më e mirë për një qenie të tillë, gjithsesi do të jetë jo toka jonë, por dielli ose yjet si dielli. Ndërkaq, edhe në botën tonë ka sa e sa njerëz që s'i djeg zjarri sepse janë të pajisur me fuqi shpirtërore dhe mundësi përkatëse. Prandaj nuk është aspak e drejtë që, duke e marrë për model botën tonë, të arrijmë në përfundimin se në planetet ose yjet e tjerë nuk ka qenie të gjalla të vetëdijshme.

Po të bisedoni me një kimist, fizikan, astrofizikan, po të shkëmbeni mendime me një biolog, zoolog, gjeolog dhe arkeolog ose po të thelloheni në fushën e mjekësisë apo të takoheni me ndonjë që është thelluar në këtë fushë, ç'botë të pabesueshme, ç'kushte të pabesueshme jete dhe ç'udhëtime aventurore kanë për t'ju dalë përballë!

Edhe sikur të mos i pranoni ato që ju tregohen për çështje që nuk i njihni ose, të paktën, që nuk dini fakte që t'i keni parë me sytë tuaj, qëndrimi më i arsyeshëm është të mos i mohoni menjëherë. Sepse bashkëbiseduesit tuaj janë specialistë të fushave të tyre. Po qe se diskutimin e lidhim me çështjen tonë, duhet të themi se janë mijëra dhe qindramijëra specialistë të botës së engjëjve, shpirtrave, xhindeve dhe djajve që transmetojnë përvojën e tyre apo të të tjerëve si dhe qindra dukuri dhe ngjarje të transmetuara. Ky informacion është aq i shumtë, sa çështja mund të shihet si e argumentuar në mënyrë kategorike. Prandaj, a nuk duhet që t'u besojmë gjërave që tregohen mbi këtë subjekt ose, të paktën, të mos i mohojmë?

9. Në botën tonë ka jetë; edhe ekzistenca e jetës së llojeve të ndryshme në planetet e tjerë është gjithmonë e mundshme

Le të përpiqemi ta trajtojmë çështjen me një krahasim të figurshëm. Mendoni një mbret që ka thesare të panumërta e të pangjashme dhe vepra arti të pashoqe. Ai ka ngritur një qytet me pallate dhe në një skaj të atij qyteti të shkëlqyer ka bërë një banesë krejt të vogël, sa një kolibe. Por në këtë ndërtesë të vogël shohim të zhvillohet një veprimtari e madhe, shohim të ketë kushte të ndryshme jetese dhe të hahet e pihet në sasi të madhe. Ndërkaq, kthejmë sytë edhe nga pallatet, por nuk shohim dot askënd. Dhe tani, si është më e drejtë ta shpjegojmë faktin që nuk shohim gjë, të mendojmë se i kemi sytë të dobët, apo se banorët e pallateve fshihen prej nesh? Apo se në pallate nuk ka askush.

Të mendosh se në këtë qytet të shkëlqyer mijëra pallate janë bosh kurse vetëm një ndërtesë e vogël është e mbushur plot gjallesa, gjithsesi nuk është një pikëpamje që mund ta pranojë dikush me mend në kokë. Atëherë, themi se ose dobësia e syve tanë na pengon t'i shohim banorët e pallateve, ose ata banorë, për shkaqe dhe urtësi që nuk mund t'i dimë, fshihen prej nesh.

Në krahasimin tonë të figurshëm, bota jonë është ndërtesa e vogël, kurse planetet e tjerë dhe yjet, pallatet e shkëlqyer në atë qytet madhështor. Njeriu që sheh gjallërinë e madhe të jetës në këtë botë, si mund të mendojë se gjithë ata trupa qiellorë të shkëlqyer e madhështorë janë bosh? Jo, edhe atje ka jetë, edhe atje ka qenie të vetëdijshme! Fakti që ne s'i shohim nuk do të thotë se ata nuk ekzistojnë! Shpjegimi është ky: ose ne i kemi sytë të dobët, ose ata fshihen prej nesh në një dimension tjetër.

Në fakt, ne, edhe vetë globin tokësor e shohim si qenie të gjallë. Ashtu siç e administron shpirti kurmin njerëzor, ashtu dhe engjëjt e administrojnë tokën. Ky rregull vlen edhe për të gjithë trupat qiellorë.

10. Si bilbilat e kopshtit botë, janë edhe bilbilat që këndojnë bukuritë e gjithësisë

Në gjithësi ka bilbila që u këndojnë bukurive të gjithësisë. Si bilbilat e kopshteve tona, këta bilbila cicërojnë me falënderime mbi yjet që janë lulet e kopshtit qiellor. Disa herë ata bëjnë për banesë ndonjë qenie lëndore dhe kalojnë në ekstazë duke soditur variacionet e Fuqisë Hyjnore te lënda dhe materia. Dhe disa herë ia kushtojnë Zotit refrenin e një galaktike të tërë. Ata janë adhurues të përjetshëm dhe ekzistojnë vetëm si të tillë. Ata janë qeniet shpirtërore, engjëllore... Ata kanë zgjedhur për trajtë adhurimin e Zotit!

11. Profetët dhe të urtët kanë njoftuar ekzistencën e engjëjve, xhindeve dhe shpirtrave, kurse filozofët dhe dijetarët i kanë vërtetuar

Vërtetimi i një individi nga qeniet e tilla si shpirti, engjëlli dhe xhindi do të thotë vërtetim i të gjithë llojit. Dihet se pjesa tregon të tërën. Pasi të shohim veshka te disa njerëz, arrijmë në përgjithësimin se të gjithë njerëzit kanë veshka. Po të na tregohet një kafshë, ne mendojmë me bindje se ai lloj ekziston.

Ndërkaq, nga mijëra njerëz është thënë ekzistenca e qenieve të tilla si shpirti, engjëjt dhe xhindet. Njëqind e njëzet e katër mijë profetë, miliona të urtë dhe shumë njerëz të tjerë me të njëjtën pjekuri, me mijëra herë kanë parë engjëj dhe shpirtra, janë takuar dhe kanë biseduar me ta, ua kanë përcjellë këto takime dhe biseda të tjerëve që i kanë hedhur në letër dhe kanë arritur gjer në ditët tona.

A mund të dyshohet për mendimin e njëzëshëm mbi një çështje të qindramijëra, madje, miliona njerëzve që është e pamundur të akuzohen si gënjeshtarë dhe që është e pamundur të jenë marrë vesh për të gënjyer?

Në mënyrë të veçantë, edhe fakti që qindra filozofë dhe dijetarë që e kanë bërë rregull të ecin gjithmonë me këmbët e mendjes, e kanë pranuar këtë çështje duke e njohur vetë ose duke e dëgjuar, e vlen të trajtohet për sa i përket mbështetjes së saj.

12. Janë dy pole që përfaqësojnë forcat e të mirës dhe të keqes në natyrën e njeriut: engjëlli dhe djalli

Thamë se në gjithësi, çdo gjë e tregon veten me të kundërtën e saj. Atëherë, mund të themi se si e kundërta e engjëjve që janë, në gjithësi, nxitësit dhe miratuesit e të mirës, ekzistojnë, madje ekzistojnë domosdoshmërisht, djajtë që janë, në gjithësi, fryrësit dhe zbukuruesit e të keqes.

Allahu, Zoti i gjithësisë, i cili i do të bukurën e të mirën, është bartësi dhe përfaqësuesi i përsosmërisë dhe bukurisë absolute. Ai kurrsesi nuk i do e nuk i miraton të keqen e të shëmtuarën megjithëse i ka krijuar vetë. Ekziston një qenie shpirtzezë që është burimi, thelbi, nxitësi, stolisësi i të keqes, që i fut përfytyrimit dyshimin dhe lëkundjen dhe që, me vullnetin e vet, ia turbullon mendjen njeriut duke u bërë shkak që Zoti ta krijojë të keqen. Kjo qenie është shejtani, djalli. Djalli nuk krijon asgjë, nuk mund të krijojë asgjë. Krijuesi edhe i të mirës, edhe i të keqes është Allahu. Ndërkaq, Allahu, jo vetëm që s'e miraton të keqen, por nuk bën as padrejtësi ndaj njerëzve, domethënë, nuk ua lidh këmbë e duar për t'i detyruar të bëjnë mëkat. Njeriu i krijuar nga Allahu me natyrë të pastër e paqësore, gënjehet nga dredhitë dhe stolisjet që u bën djalli gjërave, e prish natyrën e vet me vullnetin e vet dhe bën mëkat. Ja, kjo është e keqja që themi se e krijon Allahu, e keqja ku njeriu është autor dhe fajtor.

Ashtu siç cilësohet *"si engjëll"* njeriu i pajisur me të gjitha mirësitë, bukuritë morale dhe virtytet, ashtu dhe njeriu i cili i lë me turp edhe çakejtë në egërsi, i cili është i hapur gjithmonë ndaj moralit më të keq dhe i cili, me mendimet e tij të mbrapshta e tinëzare, ndjen kënaqësi nga padrejtësia dhe është kreu i të gjitha të këqijave, cilësohet *"si djall"*. Ç'shprehin ky paralelizëm, kjo ngjashmëri? A vetëm një cilësim imagjinar? Njerëzit kanë gjetur tek vetja shumë anë të përbashkëta me kafshët, të cilat, pastaj, kanë hyrë të terminologjinë popullore në formën e shprehjeve dhe koncepteve. Pa studiojeni se ç'është formula e "njeriut" europian të përgatitur nga Aleks Karreli! Dhe, siç thotë një mjeshtër i fjalës, po qe se shumica e njerëzve do të ktheheshin së prapthi siç kthejnë rrobaqepësit rrobat e përdorura, para nesh do të dilnin trajta shumë të tjera: dhelpra, lepuj, ..., etj. Po, në natyrën e tij, njeriu bart bërthama të karaktereve shtazore. Ose, po të nisemi nga e kundërta, çdo lloj kafshe, me natyrën dhe kuptimin e saj, përbën përfaqësuesin dhe paraqitësin e një ndjenje dhe kapaciteti të zhvilluar ose që është duke u zhvilluar te njeriu. Luani përfaqëson, për njeriun, guximin e posaçëm, prandaj njerëzve të guximshëm posaçërisht, u themi *"si luanë"* apo *"luanë"*. Ujku, hiena e të tjera kafshë grabitqare si to përfaqësojnë aspektin grabitqar të njeriut dhe njerëzve të egër e grabitqarë u themi *"ujq"*, *"hiena"*, etj. Njerëzit e urtë e të butë quhet "qengj, dele". Kur themi *"gjarpër"*, na vijnë menjëherë në mendje njerëzit me gjuhë të mprehtë e helmuese. Penat e poetëve mbeten të paafta për të bërë rima me bilbilin. Kurse bilbili i botës njerëzore është Profeti Muhamed (s.a.s.)!

Po të vazhdojmë, do të sillnim si model të urrejtjes, devenë, të kokëfortësisë, dhinë, të errësirës dhe prapambetjes, lakuriqin e natës, të kokëtrashësisë dhe imitimit majmunëror, majmunin!

Po, me mijëra ndjenja e mendime të larta e të ulëta që dallgëzohen në shpirtin e njeriut, që përfyten në botën e mendjes dhe zemrës së tij, sjelljet morale të personifikuara nga shpirtrat e mirë e të këqij na nxjerrin vazhdimisht përballë dy forca kryesore që përplasen vazhdimisht me njëra-tjetrën: të mirën dhe të keqen. Dhe dy pole që vazhdimisht i ushqejnë këto, i stolisin, i nxisin dhe që bëjnë të reflektohen te njeriu kuptimet që përfaqësojnë: engjëlli dhe djalli!

Njeriu është një indeks i vogël i gjithësisë. gjithësia është pema, njeriu, fara. Ç'ka te njëra, ka edhe te tjetra. Zemërimi dhe furia, dallgët dhe furtuna. Gëzimi dhe hareja, dielli dhe pranvera. Enët e gjakut, lumenjtë dhe përrenjtë. Po kështu, frymëzimet, ndjenjat e larta dhe mirësitë me engjëjt; dyshimet, lëkundjet, ndjenjat e shëmtuara dhe të këqijat me djallin. Engjëjt dhe djalli përfaqësojnë ndjenjat dhe mendimet te njeriu. Populli e ka bërë që në krye të herës përgjithësimin e tij: njeri si engjëll, njeri si djall!

II. SHPIRTI: EKZISTENCA, NATYRA DHE ARGUMENTET SPECIFIKE

1. Shpirti është një qenie e vetëdijshme që vjen nga bota e urdhrit

Shpirti nuk është qenie lëndore; ai është një qenie e vetëdijshme me prejardhje nga bota e urdhrit ose e ekzistencës së pakushtëzuar. Së pari, le të përpiqemi t'i shpjegojmë pak a shumë këto dy botë.

Bota lëndore ose konkrete është bota që e shohim, përgjithësisht, e perceptojmë dhe bëhemi dëshmitarë të ekzistencës së saj. Në këtë botë, Allahu, Zoti i gjithësisë, jep vdekje dhe jetë, krijon forma dhe trajta të ndryshme, shpik dhe strukturon. Trupat e krijuar marrin forma dhe trajta të ndryshme duke u zbukuruar e stolisur. Bimët, kafshët dhe njerëzit janë gjallesat që e përbëjnë këtë botë ose këtë gjithësi. Nga molekula te trupat qiellorë e gjer te të gjitha sistemet qiellore, çdo qenie lëndore që perceptohet e që zë një vend të caktuar në hapësirë, përfshihet në këtë gjithësi.

Bota e urdhrit ose e ekzistencës së pakushtëzuar është një botë që nuk futet në masat lëndore dhe, më shumë, një botë e përbërë nga ligjet. Esenciale në këtë botë nuk është lënda, por kuptimi. Meqë kuptimi është i paperceptueshëm, ne shohim vetëm zgjatimet funksionare të kësaj bote në botën lëndore dhe vetëm me këto përpiqemi ta kuptojmë atë. Për ta bërë çështjen të kapshme nga arsyeja, duhet ta konkretizojmë.

Për shembull, le të marrim një farë bime. Fara që është e kësaj bote, për shkak të fuqisë mbirëse që bart, ka lidhje edhe me botën e urdhrit. Fuqia mbirëse e farës ndodhet në embrionin e saj, por është e padukshme. Kur plotësohen kushtet e caktuara, embrioni plas, hapet, sythi çel, bëhet filiz, bimë e rritur dhe jep frut. Të gjitha këto kryhen për shkak të ligjit të mbirjes, i cili është i paperceptueshëm. Pra, ne nuk mundemi ta shohim vetë ligjin, i cili i përket botës së urdhrit, por vetëm pasojat e tij, të cilat i përkasin botës lëndore të dëshmueshme. Për këtë arsye, ne e pranojmë ekzistencën jolëndore të ligjit si dhe botën e urdhrit të cilit ai i përket. Por anën e padukshme të këtij ligji e pranojmë edhe sepse shkaqet lëndore nuk mund të japin kurrsesi një rezultat të tillë. Ndryshe, do të duhej që një grimcë dheu dhe një molekulë ajri të zotëronin mjete zhvillimi të posaçme për çdo lloj fare veç e veç, gjë që do të ishte e pamundur.

Edhe veza në mitrën amësore zhvillohet po me anë të të njëjtit ligj.

Çdo muaj, mitra zbrazet. Ky është një ligj. Pastaj, muret e saj përgatiten si depo vitaminash për spermatozoidin mik që ka mundësi të vijë. Edhe ky është një ligj. Nga miliona spermatozoide që përmban sperma, vetëm njëri e fiton garën, pra, arrin te veza dhe hyn brenda saj nëpërmjet membranës dhe menjëherë mbyllen portat. Ja dhe një ligj tjetër. Pastaj, siç pohohet edhe në Kuran, e izoluar brenda tri errësirave (cipave), veza kalon etapat e qelizës, indit dhe organeve duke u ushqyer në mënyrë mrekullore. Edhe ky është një ligj. Të gjitha këto i quajmë ligje embriologjike. Me anë të pajisjeve teknologjike, sot mund të vëzhgohen të gjitha këto etapa, por jo ligjet që i urdhërojnë zhvillimet përkatëse.

Në të njëjtën mënyrë, megjithëse graviteti universal është një çështje e njohur dhe e pranuar nga të gjithë, perceptimi i tij si ligj është i pamundur. Ajo çka perceptojmë ne, janë funksionet ose pasojat e tij në botën tonë lëndore.

Edhe shpirti është një ligj i llojit të ligjeve që u përpoqëm t'i shpjegojmë me anë të shembujve, por vetëm me një ndryshim: ndërsa ligjet e tjerë janë të pavetëdijshëm, shpirti i njeriut është një ligj i vetëdijshëm.

Allahu e ka dërguar shpirtin nga bota e urdhrit *"bëhu!"*. Në Kuran, duke iu shpjeguar profetit Muhamed shpirti, i është thënë: "Thuaj: "Shpirti është nën urdhrin e Zotit tim!" (Isra, 85) Fakti që është thënë *Zoti* dhe jo *Zoti i gjithësisë*, është argument i faktit që shpirti i përket botës së urdhrit e jo botës lëndore.

2. Shpirti jo vetëm nuk mund të përshkruhet, por as të kuptohet me anë të informacionit njerëzor

Shpirti është i thjeshtë, jo i përbërë. Meqë lënda është e përbërë prej atomeve dhe atomet prej grimcave më të vogla, zbërthimi dhe shpërbërja e saj është e paracaktuar dhe e pashmangshme. Por gjendja e shpirtit nuk është kështu. Ekzistenca e shpirtit është e fiksuar, konstante dhe permanente, ai nuk jonizohet, nuk zbërthehet e nuk shpërbëhet. Pse ka këtë natyrë, nuk mund ta shohim ne shpirtin siç shohim lëndën, dhe nuk mund ta shqyrtojmë në laborator. Ekzistencën e shpirtit e pranojmë vetëm duke vëzhguar shfaqjet e tij në botën tonë, megjithëkëtë, natyrën nuk mund t'ia njohim. Fundja, pranimi i ekzistencës së diçkaje me njohjen e natyrës së saj janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme nga njëra-tjetra.

Për ta parë një gjë, kemi nevojë për sy, por syri nuk është i mjaftueshëm, sepse ai s'e kryen dot funksionin e shikimit po s'funksionoi truri në mënyrë të pandërprerë e të patëmetë. Sepse syri është një shteg, kurse shikimi është një operacion trunor. Kështu qëndron puna edhe me vetë trurin. Edhe truri, për t'i vënë në punë të gjitha fakultetet e strukturës së vet, ka nevojë për një fuqi qendrore shtytëse dhe drejtuese.

Kurrë truri nuk mund ta kapërcejë vetveten për t'i thënë shpirtit që e komandon, *"unë nuk mund ta njoh natyrën tënde, prandaj ti nuk je"*! Sepse, për ta kuptuar fuqinë e përsosur që sundon mbi të, truri duhet të përdorë të gjitha pajisjet që ka duke kapërcyer ndijimet materiale me karakter të kufizuar, gjë që është e pamundur për këtë botë lëndore.

Meqë nuk mund t'i kuptohet natyra, shpirti as nuk mund të përkufizohet. Njëri qëndrim skajor ndaj kësaj çështjeje, është mohimi i shpirtit, kurse tjetri, tentativa për ta përkufizuar atë si një lëndë.

Shpirti nuk mund të përkufizohet sepse njeriu që do të donte ta përkufizonte atë, shpesh nuk është i aftë për t'i përkufizuar as gjërat dhe dukuritë e botës së vet. Bie fjala, një njeriu që s'ka ngrënë kurrë mjaltë në jetë, nuk mund t'ia përshkruani dhe përkufizoni shijen dhe kënaqësinë që jep mjalti me fjalë abstrakte, edhe sikur të jeni një mjeshtër i fjalës. Edhe një njeriu që kurrë s'u ka marrë erë trëndafilit dhe karafilit, është e pamundur t'ia bëni të njohur aromën e këtyre dy luleve me anë të përshkrimit dhe përkufizimit.

Edhe sikur t'ia lexoni një libër të tërë një njeriu që s'jua merr vesh gjuhën, s'ka për të kuptuar qoftë edhe një shkronjë!

Në këto kushte, e vërteta që na del para është kjo: çfarëdo që të thuhet për shpirtin, as është e mundur të bëhet një përshkrim dhe përkufizim i shëndoshë për të, as është e mundur të kuptohet ai me anë të informacionit njerëzor!

3. Tek ne, elementi që flet kur hesht lënda jonë, është shpirti ynë

E dimë të gjithë se llojet e të folurit në botën tonë janë të shumta. Këtu, me të folurit e kemi fjalën për çdo lloj tingullimi dhe komunikimi.

Kështu, tingulli që del nga përplasja e dy gurëve është i ndryshëm nga tingulli që del nga përplasja e dy shkopinjve apo drurëve. Tingulli i ujit që del nga një burim nëntokësor është i ndryshëm nga tingulli i ujit që rrjedh i qetë. Sa e butë i vjen njeriut fëshfërima e zefirit apo flladit ndaj zhurmës gjëmuese të furtunës apo ciklonit. Bubullima është një zë tronditës, kurse në zhurmën magjepsëse të shiut është e fshehur një qetësi, një efekt qetësues.

Edhe banorët e pyjeve nxjerrin zëra që janë të posaçme për ta. Zëri i dikujt ta gërvisht veshin, kurse i dikujt tjetër është kënaqësidhënës. Zogjtë, fëmijët e blusë qiellore, nxjerrin tinguj dhe zëra të ndryshëm. Bilbili këndon, kurse sorra krakëllin.

Ashtu siç ka kjo botë lëndore forma dhe mënyra të ndryshme tingëllimi dhe komunikimi me anë të zhurmave, tingujve, fjalëve e fjalive, gjë që duhet të jetë më e mirë se një tingëllim dhe komunikim monoton, edhe Zoti bisedon dhe komunikon me botë të ndryshme në forma dhe mënyra të ndryshme. Ndërsa bisedon ndryshe me engjëjt, ndryshe me profetët, ndryshe me të urtët e ngarkuar me frymëzim, Allahu bisedon me njerëzit e zakonshëm me anë të librit, kurse gurit, malit dhe qiellit u flet me një gjuhë tjetër. Kurse frymëzimi me të cilin i drejtohet bletës, është krejt tjetër!

Ashtu siç bota e varrit ka një gjuhë të veçantë komunikimi, kuptohet se edhe gjuha e komunikimit në grumbullimin pas ringjalljes, në parajsë dhe ferr do të jetë e ndryshme.

Dhe tani le të kthehemi pak te vetja jonë. Edhe mënyrat e të folurit, komunikimit dhe bisedës mes njerëzve janë të ndryshme e të shumëllojshme. Në tokë ka me mijëra gjuhë. Përtej kësaj, edhe brenda një gjuhe, duke e shoqëruar fjalën me mimikë dhe gjeste, i japim asaj nuanca të reja shprehjeje. Brenda një kombi, format dhe mënyrat e komunikimit të mendimeve dhe ndjenjave të fiseve, krahinave dhe popullatave janë të shumëllojshme. Fundja, edhe shumëllojshmëria e zakoneve dhe traditave na japin të kuptojmë shumë gjëra mbi këtë çështje.

Njeriu komunikon me kompjuterin me një gjuhë të veçantë që ndryshon krejt nga gjuha e zakonshme e të folurit të tij. Ndoshta në të ardhmen njeriu do të bisedojë dhe komunikojë me robotët me një formë dhe mënyrë tjetër. Sidomos biseda telepatike mes njerëzve na tregon ne se në botë të tjera ka forma dhe mënyra të tjera komunikimi. Krejt e ndryshme është edhe gjuha e spiritistëve, hipnotizuesve dhe thirrësve të shpirtrave.

Është edhe biseda e njeriut me vetveten ose biseda në vetvete. Në fakt, kur themi *të folur* dhe *bisedë*, e kemi fjalën për komunikimin me tinguj, fjalë dhe fjali, për formulimin dhe prodhimin e të cilave marrin pjesë disa organe nga truri gjer te buzët, si dhe për dëgjimin e të cilave ka mjete të ndryshme si veshi i njeriut dhe mjetet teknike dëgjuese e regjistruese. Por në bisedën në vetvete, gjuha dhe buzët nuk lëvizin. Bashkëbiseduesi ynë mund të jemi vetë ne ose një tjetër. Përfytyrimi dhe imagjinata mund të na çojnë në botë krejt të tjera dhe ne të bisedojmë edhe me qenie që nuk kanë ardhur kurrë në botën tonë!

Edhe ëndrrat kanë gjuhën e tyre të veçantë. Ç'ngjarje përjetojmë ne, me kë dhe ç'gjëra bisedojmë në gjumë kur organet e trupit janë gjysmë të vdekura! Disa herë gjëmojmë në të qeshur, disa herë qajmë me ngashërime. Ndërkaq, pranë nesh mund të ndodhen zgjuar njerëz që s'marrin vesh asgjë nga ç'po ndodh me ne, që s'preken as nga të qeshurat, as nga të qarat tona!

Po, kur lënda jonë pushon, është një element tek ne që flet e bisedon, që i themi shpirt. Po qe se dikush i vë një emër tjetër, natyra e tij nuk ndryshon. Veçanërisht, edhe ndjenjat kanë gjuhën e tyre të veçantë.

4. Shpirti ka një formë dhe trup shëmbëllyes të posaçëm

Shpirti ka një formë, një këllëf që është i posaçëm për të. Meqë çdo gjë është krijuar çift, trupi ynë fizik (material) ose, siç i themi ndryshe, kurmi ynë, duhet ta ketë të kundërtën e tij. Ja, pra, ky është trupi ynë i dytë, i kundërt me kurmin fizik, material, prandaj dhe ideal, i posaçëm në vetvete. Ky trup i tejdukshëm dhe i rrjedhshëm (si lëngjet apo gazet), shërben, në të njëjtën kohë, si formë, këllëf ose rrobë për shpirtin. Pas vdekjes sonë, ai nuk e lë shpirtin lakuriq. Pasi shpirti e lë trupin, forma vazhdon ta shoqërojë. Shpirti e hedh këllëfin material por e ruan atë ideal.

Siç bëhet fjalë në burimet islame dhe siç vërtetohet nga spiritistët, te njerëzit që iu është prerë ndonjë gjymtyrë, ndjehet ekzistenca e formës ose trupit shëmbëllyes të shpirtit të gjymtyrës së prerë.

Në librin "Kthimi te Zoti në Rusi" ka shpjegime të gjata lidhur me këto çështje. Për shembull, një grup mjekësh thonë tekstualisht kështu: *"Krahas trupit fizik te të gjithë gjallesat, të përbërë prej atomesh dhe molekulash, ekziston edhe kopja e tij, trupi prej energjie..."*

5. Thuhet se janë bërë fotografi të trupit shëmbëllyes me anë të metodës kirliane

Metoda fotografike kirliane nxjerr në pah trupat shëmbëllyes me anë të fotove të bëra në frekuenca të larta. Krahët e prerë të dikujt të dukura në një foto të tillë duhet të jenë pamje të formës shëmbëllyese që mbështjell shpirtin. Në Kazakistan, në universitetin Kirov të Alma Atës, nën harkun elektrik të frekuencës së lartë është dukur dublanti i gjallë i lëvizshëm i një organizme.

Në vitet 1968 u botua një libër me titullin "Bazat biologjike të metodës kirliane". Në fotot, në vendet e gjymtyrëve të prera, dukej trupi i dytë (trupi bioplazmik).

Edhe mjeku amerikan Watters dalloi trupin e dytë në dhomën e dilatacionit me anë të grumbullimit dhe përqendrimit të avullit të ujit mbi jonet. Ai mbështolli rreth pesëdhjetë karkaleca me pambuk me eter dhe i vendosi në dhomën e dilatacionit. Kur mendoi se kishin ngordhur, lëshoi në dhomë avull uji dhe bëri fotografitë e tyre. Si rezultat, në pllakat fotografike u mbresuan hijet e trembëdhjetë karkalecave të ngordhur.

6. A mundet trupi shëmbëllyes të ndahet nga trupi fizik për të udhëtuar dhe a mund të duket duke u shëmbëllyer në të njëjtën kohë në disa vende?

Në numrin e marsit 1963 të revistës franceze Le Monde La Vie - nëse nuk bart qëllime propagande krishtere - tregohet se ç'i ka ndodhur një herë një prifti. Ai kishte shkuar me një grup fëmijësh për ekskursion në malet e Zvicrës. Diku, në rrugë e sipër, e kishte zënë gjumi dhe, kur ishte zgjuar, kishte vënë re në mënyrë të vetëdijshme se ishte larguar nga trupi dhe nuk mundej t'i lëvizte krahët. Pasi ishte mësuar brenda një kohe të shkurtër me gjendjen, kishte nisur të fluturonte mbi male. Ndërkohë i kishin shkuar ndërmend fëmijët që kishte shoqëruar, kishte dëshiruar të shkonte pranë tyre dhe kishte shkuar. Pastaj i ishte kujtuar gruaja dhe e kishte parë veten në qytet pranë saj. Pas këtyre ndodhive, kishte ndjerë një shqetësim të menjëhershëm dhe e kishte parë veten në trupin e vet. Më në fund, ishte kthyer pas. Pastaj ua kishte treguar të tjerëve një e nga një ç'i kishte ndodhur dhe dëgjuesit kishin mbetur të habitur. Ngjarja ishte hetuar dhe ishte kuptuar se kishte ndodhur me të vërtetë ashtu.

Në kohën e Bashkimit Sovjetik janë bërë hetime dhe kërkime mbi jogit që munden të bëjnë udhëtime jashtë trupit. Në gjendjet e krizës, komës apo nën veprimin e anestezisë, njerëzit i hedhin jashtë trupat e dytë në formë energjie.

Në fakt, shëmbëllim do të thotë dukje (shfaqje) në një cilësi çfarëdo. Edhe engjëjt, edhe xhindet mund të shëmbëllehen. Në ëndrra na shëmbëllehen të vërtetat, kurse në varr, punët që kemi bërë. Edhe kur shpirti shëmbëllehet me anë të trupit precedencial që ka, ne vërejmë që ai i ngjan vetes, domethënë njeriut që i përket. Prandaj meqë në ëndrra, personat që njohim, shëmbëllehen me anë të shpirtrave të tyre dhe se ai që duket është shpirti, na bëhet sikur i shohim dhe njohim me format e tyre fizike.

Në vetvete, shpirti ka një këllëf si kurm dhe një tjetër, ideal ose precedencial. Kështu tregohet për njerëz të gjallë apo të vdekur që janë dukur në të njëjtën kohë në disa vende. Për shembull, tregohet për njerëz që, ndërsa kanë qenë në burg, janë dukur në xhami në namazin e mëngjesit. Tregohet për persona që, megjithëse dihet se s'kanë qenë në haxh, janë dukur duke kryer haxh. Madje kemi dëgjuar të thonë se kanë qëndruar apo fjetur në aksh vend, etj.

III. A MUND TA SHOHË SHPIRTI TË ARDHMEN? INFORMACIONI I TË URTIT MBI TË ARDHMEN. THIRRJA E SHPIRTRAVE, PARANDJENJA, TELEPATIA, SPIRITIZMI DHE JOGA

1. Parashikimet për ngjarjet e së ardhmes janë bërë sipas njoftimit të Allahut

Mësimin mbi të ardhmen mund ta japë, para çdo gjëje tjetër, po e ardhmja. Me ato që do të tregojë dhe do të sjellë në të ardhmen, koha është lajmëtari më i sigurt e më i besueshëm. Njeriu nuk mund ta jetojë atë që ka për ta jetuar, pa e jetuar dhe nuk mund ta njohë me të drejtë atë që s'e ka jetuar. Prandaj ka shumë dokumente dhe fakte për të kaluarën, por asnjë gjë për të ardhmen. Për të ardhmen ne mund të bëjmë vetëm parashikime ose pandehma me mundësi vërtetimi shumë të vogël. Por, shumë natyrisht, gjendja nuk është aspak kështu te dija hyjnore. Te dija hyjnore nuk ka të shkuar, të tashme e të ardhme; të gjitha këto përbëjnë atje një të tërë të vetme. Prandaj, po qe se thuhet për të ardhmen jo me parashikime ose pandehma, por në mënyrë të prerë, "do të ndodhë, keni për ta parë", dhe parashikimi del i vërtetë, këtë mund ta shpjegojmë vetëm me njoftimin e Zotit.

2. Kapërcimi i kohës dhe hapësirës mund të bëhet vetëm duke hyrë në nivelin jetësor të shpirtit

Kapërcimi i kohës dhe hapësirës mund të bëhet vetëm me anë të shpirtit të pakushtëzuar nga koha dhe hapësira. Sepse shpirti nuk është nga bota e kohës dhe hapësirës, por nga bota e urdhrave dhe ligjeve, prandaj, jo vetëm mund të shkojë në shumë vende, por edhe të shëmbëllehet në shumë vende duke dërguar atje këllëfin dhe rrobën e tij. Veçanërisht, meqë shpirti është një qenie e tejdukshme, jolëndore, pra dhe e lirë, e pakushtëzuar nga kufizimi i kohës dhe i hapësirës si dhe i papenguar nga masiviteti i lëndës, edhe reflektimi i ngjarjeve që kanë për të ndodhur në të ardhmen, në ekranin e tij, do të jetë i ndryshëm. Mjafton që personi të çlirohet nga presioni i kurmit, të futet në jetën e ndjenjave e të shpirtit për ta zhvilluar dhe hapur shpirtin, dhe të bëjë përpjekje për të hyrë në lidhje me botë të tjera.

3. Profetët dhe të urtët kanë dhënë njoftime për të ardhmen duke ia ngarkuar Allahut dijen e tyre

Të urtët kanë dhënë njoftime për të ardhmen duke e bazuar diturinë e tyre te Allahu, Zoti i gjithësisë. Së pari, është profeti Muhamed ai që ka bërë më shumë njoftime të këtij lloji. Ai ia ka përcjellë umetit, bashkësisë së tij, ngjarjet që do të ndodhin gjer në kiamet, sikur t'i shihte kalonin parasysh siç na kalojnë ne pamjet në ekranin e televizorit. Ngjarja Hz. Ali-Hz. Zubejr (Episodi i Xhemelit), vdekja e Hz. Osmanit dhe vdekja e së bijës Fatime janë vetëm disa nga ngjarjet e njoftuara prej tij që më parë.

Disa prej këtyre njoftimeve janë aq të hapura sa s'kanë nevojë për interpretim. Kurse te e vërteta e disa të tjerave mund të arrihet vetëm me komente dhe interpretime të llojit të figuracionit të Kuranit. Dhe disa të tjera janë të llojit që mund t'i kuptojnë vetëm analistët. Kurse konkluzionet dhe njoftimet e bëra nga të urtët duke u mbështetur sa më sipër, mbështeten ose drejtpërdrejt te Kurani dhe tradita profetike, ose te frymëzimet e ardhura botës së tyre shpirtërore nën trashëgimin profetik. Secili prej tyre merr nga diturija hyjnore e Profetit me aq sa ç'e ka kapacitetin shpirtëror dhe, në këtë mënyrë, bëhet pjesëtar i disa të vërtetave.

Duke i parë të vërtetat lidhur me të ardhmen, disa herë s'bëjnë dot një përcaktim të saktë ngaqë s'e përcaktojnë dot plotësisht distancën. Kurse disa i shohin ngjarjet në formë simbolesh. Meqë Allahu nuk i ka bërë kompetentë për interpretimin e ngjarjeve të tilla, bien në gabime komentimi dhe interpretimi. Ata

thonë diçka, mirëpo dëshira hyjnore është gjë tjetër. Krejt si në komentimin e ëndrrave. Për shembull, ju shihni në ëndërr një mollë dhe e interpretoni si favor hyjnor, si shenjë të një ëmbëlsie materiale-shpirtërore të premtuar. Mirëpo e vërteta që mund të simbolizojë molla në botën e urdhrit, mund të jetë fuqizim i dëshirave dhe pasioneve tuaja. Ose shihni në ëndërr se Xhebraili hyn në një shtëpi dhe e interpretoni këtë si shenjë të hyrjes në atë shtëpi të frymëzimeve dhe begative hyjnore. Mirëpo hyrja e tij në atë shtëpi mund të jetë shenjë e thirrjes së një personi të asaj shtëpie në botën tjetër. Mund të jepen shumë shembuj mbi këtë temë.

Të urtët marrin simbolet në lidhje me të ardhmen dhe i interpretojnë, por interpretimet e tyre mund të mos vërtetohen identikisht. Ata e shohin çështjen në gjendjen e farës, interpretimin e bëjnë si pemë dhe gabohen. Ky gabim ndodh me këdo veç profetëve. Edhe nëse nga profetët mund të bëhet ndonjë gabim, atë e korrigjon Allahu që më parë. Sepse profetët janë për popujt e tyre modele që duhen imituar pa asnjë rezervë. Po qe se gabimet e tyre nuk ndreqen menjëherë, u reflektohen të gjithë bashkësisë.

Allahu që ka krijuar sytë dhe botët ku munden të zgjaten ato për të shëtitur, qoftë edhe në mënyrë të kufizuar, gjithsesi do t'i japë mundësi edhe shpirtit, komanduesit të syrit, të bëjë udhëtime në botën e vet të posaçme, do t'i tregojë atij shembujt, simbolet, pamjet përkatëse të përtej lëndës si dhe do t'i tregojë faqet e së ardhmes.

Megjithëse pati jetuar një shekull para themelimit të shtetit osman, Muhjidin Arabiu, në veprën e vet "*Shexheratu Numanije*", (Pema Gjenealogjike) që ndodhet në bibliotekën e Edrenesë, ka njoftuar për shumë ngjarje që do të ndodhnin në të ardhmen në periudhën e osmanëve. Në këtë vepër ai parashikon në mënyrë simbolike shumë ngjarje, nga themelimi i shteti osman te triumfi i Sirisë dhe Egjiptit e gjer te zbulimi i varrit të vet me rastin e hyrjes së Selimit të Rreptë në Damask. Po në këtë vepër ai parashikon se Hafiz Pasha nuk do ta marrë dot Bagdadin edhe pas nëntë muajsh rrethimi dhe se suksesi do t'i takojë më vonë Muratit IV pas një rrethimi 40 ditësh. Muhjidin Arabiu lajmëron se sulltan Abdulazizi do të ekzekutohet, kur ky sulltan do të lindte disa shekuj më vonë! Në veprën e tij, Muhjidin Arabiu bën fjalë për luftën ruso-japoneze, për luftërat e myslimanëve me armiqtë dhe fitoren e myslimanëve. Edhe për turqit thotë se *"për turqit ka fitore dhe lumturi"*.

Shtatëqind vjet më parë, poeti Xhelaledin Rumi, i mbiquajtur Mevlana si mistik, pati aluduar për mikrobet duke thënë: *"Po shoh gjallesa shumë të vogla; ato kanë gojë dhe hanë..."*

Me ç'realitete fizike dhe me ç'ligje të atomit, ose me ç'lloj syri dhe truri mund t'i shpjegojmë këto parashikime? Jo, është e pamundur të shpjegohen këto lloj ngjarjesh me gjë tjetër përveç me aftësinë e shpirtit për t'u zgjatur në të ardhmen dhe, me lejen dhe favorin e Allahut, për të marrë njoftim mbi të ardhmen!

Çështja e dhënies së njoftimeve për të ardhmen si një degë e telestezisë (telepatisë), mund të shihet edhe te orakujt, spiritistët dhe njerëzit mohues që merren me fall. Në shtypin botëror tregohen ngjarje të panumërta me këtë temë. Për shembull, revistat amerikane kanë shkruar për një grua të quajtur madam Gibson që ka parashikuar për vite me radhë ngjarje të ndryshme të fatit të botës. Kjo grua paska parashikuar vrasjen e Kenedit, ndarjen e Pakistanit dhe Indisë më 1947, etj. Kjo grua nuk është një e urtë, por e njeh të fshehtën me aq sa e lejon Zoti. Disa shpirtra janë të aftë për këtë gjë. Ata hyjnë në lidhje përtej botës fizike dhe japin lajme prej atje. Ata që çdo të vërtetë e lidhin me lëndën dhe flasin vazhdimisht për "natyrën", vjen një ditë që të shemben së bashku me lëndën e tyre, kurse shpirti vazhdon ta ruajë ekzistencën e vet kudo!

4. Parandjenja dhe telepatia

Te çdo njeri ekziston në një farë mase parandjenja e ngjarjeve që do t'i ndodhin. Ju shkon ndërmend dikush dhe disa minuta më vonë ai ju troket në derë! Ose juve ju shkon ndërmend një gjë, kurse një tjetër e

bën aty për aty. Ç'lidhje u krijuan mes jush dhe personit tjetër që ndodhej larg jush? Diku më sipër u fol për bisedën e njeriut me vetveten ose në vetvete. Ja, pra, shpirti që e bën atë bisedë, e krijon edhe këtë lidhje. Shpjegimi material i kësaj është i pamundur.

5. Për njeriun që e bën të afërt, Zoti bëhet syri, veshi dhe dora e tij

Edhe Rusia po merret me telepatinë! Megjithëse është e para që ka shpallur se "e ka vrarë kuptimin me anë të lëndës", sot Rusia, ndoshta para botës kapitaliste,[6] po bën përpjekje për vlerësimin e rrugëve të ndërlidhjes me anë të telepatisë. Një ekip prej 20-50 biofizikanësh kanë bërë shumë prova në këtë fushë. Ata po provojnë të ndërlidhen me një njeri që ndodhet brenda një dhome 300 km. larg, i izoluar nga drita dhe rryma elektrike. Gjithashtu ata po bëjnë kërkime për ndërlidhje me nëndetëse që ndodhen nën ujë dhe jashtë fushës së veprimit të stacioneve të huaja të përgjimit. Synimi i tyre është të hyjnë në ndërlidhje në një distancë prej 3000 km. për të shkëmbyer mesazhe prej 30-40 faqesh, duke ngritur, kështu, një rrjet spiunazhi pa shpenzime dhe pa rrezikun e zbulimit nga armiku.

Siç shihet, kjo çështje po pranohet dhe vlerësohet edhe nga njerëzit më materialistë. Nuk ka rëndësi nëse një rus e vlerëson apo jo këtë çështje, por fakti që është e pamundur të mohohen mrekullia e profetit, parashikimi i të urtit dhe parandjenja e shpirtit. Kjo do të thotë se, nëse pranohet dhe vlerësohet sot qoftë edhe njëra prej gjërave me karakter mrekullor, më në fund është e pamundur t'i kthehet shpina mrekullisë. Tani e tutje nuk do të ndodhë më që dikush i cili i ka gjetur në një farë mënyre vetes vend në katedrat universitare dhe mjediset intelektuale, t'i mohojë parashikimin dhe parandjenjën duke i quajtur halucinacione. Në shekullin tonë janë duke kërcitur muret e fizikës mekanike dhe fizika klasike pothuajse është duke u shembur.

Kush e di, ndoshta në një të ardhme të afërt do të shohim se fizika dhe natyra janë, në fakt, nën sundimin e një sërë fuqish përtej tyre. E mundur para kuptimit dhe fuqive, natyra do të përdoret si një lodër dhe lënda, duke u shtrënguar brenda kallëpeve të veta, do të detyrohet të bëjë edhe disa gjëra që s'hyjnë në fushën e mundësive të veta. Sigurisht, mbi lëndën sundojnë shpirti, engjëjt dhe fuqitë metafizike. Shpirti është esenca, kurse lënda, mbështjellësja e saj, e varur prej saj, kështu që shpirti e vëzhgon gjithçka ndodhet dhe ndodh përtej kësaj mbështjellëseje, pra esencën e çdo gjëje.

Telepatia që po studiohet sot në të gjithë botën, ngjarjet e ndërlidhjes në largësi dhe parashikimet mbi të ardhmen janë, në fakt, gjëra që dihen në anën tonë qysh në krye të herës. Mirëpo më parë ne e ndjenim veten të shtypur nën dyshimin e mjedisit për vërtetësinë e tyre dhe ose druheshim të flisnim për këto gjëra se mos viheshim në lojë, ose, kur flisnim, nënvleftësoheshim. Mirëpo tani kanë ndryshuar shumë gjëra dhe njerëzit që nuk besojnë, madje, kanë filluar të bëjnë fjalë për to dhe për çështje të tjera të ngjashme, kanë filluar të botojnë libra dhe revista me këto tema.

Po qe se ngjarje të tilla janë të rralla ose shumë të rralla, ju mund t'i quani *rastësi*, por, po qe se përsëriten shumë e shumë herë në të njëjtin mjedis, duhet t'i quani *domosdoshmëri hyjnore*. Për njerëzit që meritojnë afërsinë hyjnore, Zoti bëhet *syri i tyre që sheh, veshi i tyre që dëgjon, dora e tyre që prek...* Kjo është një çështje meritimi dhe favori hyjnor!

6. Spiritizmi dhe joga janë përvoja shpirtërore metafizike.

Përvojat shpirtërore metafizike të vërejtura veçanërisht në botën mosbesimtare, paraqiten më shumë si spiritizëm, jogë dhe thirrje shpirtrash. Përvoja të tilla si hyrja në lidhje me shpirtra të tjerë me anë të separacionit shpirtëror dhe gjendjeve të ndërmjetme, parashikimi i të ardhmes, lojërat me gjërat materiale

[6] Ky libër është shkruar para shthurjes së Bashkimit Sovjetik, prandaj autori e ka fjalën për Rusinë e asaj kohe.

dhe dukuritë si dhe, me ç'pretendohet, thirrja e shpirtrave, ecja mbi prush, shpimi i trupit me shtiza, prerja e gjuhës dhe ringjitja në vend, jetesa pa ngrënë e pa pirë për rreth gjashtë muaj me radhë, janë ngjarjet më të dëgjuara të spiritizmit dhe jogës.

Shpirti fiton fuqi me aq sa t'i presë lidhjet me kurmin të cilit i përket dhe botën lëndore-materiale. Përvojat e realizuara e të shënuara në këtë fushë nuk janë të posaçme vetëm për spiritistët dhe jogistët. Ato janë vërejtur qysh në krye të herës te mistikët krishterë, shenjtorët çifutë, madje te budistët, brahmanët dhe konfucianët, te ndjekës të fraksioneve dhe sekte besimore të ndryshme që ende veprojnë në vende të ndryshme të botës. Të gjithë ne kemi lexuar për gjëra të tilla. Dihet se këto kanë ndodhur edhe në tasavuf, mistikën islame. Për shembull, në sektin Rufaí njihen veprime të kryera nga jogistët, si mundimet trupore të ndryshme, futja e shtizave në pjesë të ndryshme të trupit pa shkaktuar rrjedhje gjaku dhe pa lënë gjurmë plage pas, mbajtja e prushit në pëllëmbë ose futja në gojë pa pësuar dhe ndjerë djegie, etj. Natyrisht ka ndodhur edhe që zjarri të djegë, që shtiza të dhembë dhe gjaku të rrjedhë...

Të gjitha këto varen nga njësimi i njeriut me botë të caktuara dhe aftësimi i tij në atë fushë. Njeriu del mbi dimensionet që veprojnë mbi anën e tij lëndore me sa të krijojë lidhje me shpirtin e tij, e thënë ndryshe, të krijojë lidhje me fuqinë që e njeh për të lartë e të shenjtë. Në ato dimensione, shpirti e merr lëndën nën ndikimin, veprimin dhe zotërimin e vet dhe atëherë zjarri nuk djeg, shtiza nuk shkakton rrjedhje gjaku, njeriu nuk ndjen më dhimbje dhe nuk ndjen as uri e as etje edhe sikur të rrijë gjashtë muaj pa ngrënë e pa pirë, sepse mbi njeriun nuk ka më kufizim kohe dhe hapësire!

Me separatizimin nga kurmi dhe gjendjen e tij të ndërmjetme, shpirti jo vetëm është i pakufizuar nga tre dimensionet, por mund t'i kapërcejë edhe dimensionet e katërt e të pestë. Në këto kushte, koha dhe hapësira pothuaj nuk veprojnë mbi të. Duke e shpjeguar çështjen në fjalë, një fizikan i shquar i kohës thotë: *"Unë e ndjej veten edhe jashtë hapësirës tënde tridimensionale!"*

Në sajë të manovrave të posaçme për botën e tyre dhe në përshtatje me gradën e vet, shpirtra të tillë që e thyejnë lëvozhgën e dalin jashtë, zhvillohen me anët e tyre të jashtëzakonshme dhe mrekullore. Le të tregojmë disa shembuj.

Siç tregohet në revistën "Mesage de La", një spiritist, në prani të një ekipi shkencor prej gjashtë-shtatë vetash, vë duart mbi tavolinën para vetes dhe, ndërkaq, tavolina përballë nis të lëvizë dhe shëtisë nëpër dhomë.

Në lagjen Bornova të Izmirit, në një çadër, dikush fillon t'i tërheqë drejt vetes kokrrat e grurit mbi tavolinë. Ndërkaq, disa prej të pranishmëve lexojnë të shkruar në lëvizjen e kokrrave të grurit këto fjalë: *"... mulliri u prish... mes jush ka njerëz me qëllim të keq..."*

Dr. Watson që tërhiqte një kohë vëmendjen e mjekëve në Ankara, bënte hipnozë, i vinte të gjithë në gjumë dhe i detyronte të bënin ato që u thoshte: "Ngrini krahët!" Dhe ata i ngrinin krahët! "Ulini!" Dhe ata i ulnin.

Në librin e tij "Shpirti dhe gjithësia", Bedri Ruhselman shkruan: *"Një mjek tregon kështu: "E kisha gruan të sëmurë. Kur sëmundja iu rëndua, dy gjëra si re hynë në shtëpi dhe iu ngulën të sëmurës mbi krye. Në atë mes, prej trupit të saj u shkëput dhe u shfaq një trup tjetër, i cili ishte i lidhur me time shoqe me një kordon mu në rrëzë të zverkut dhe përpëlitej. Më në fund, kordoni u këput dhe trupi që u duk disa çaste si i pavendosur, filloi të ngjitej në lartësi. Në atë çast gruaja ime kishte vdekur!"*

Fenni Beu që luftonte në frontin e Medinës, tregon: "Ndodheshim në Medinë të rrethuar. Ishte e pamundur të ndërlidhesha me shtëpinë në Beshiktash. Një natë pashë në ëndërr tym e zjarr në shtëpi. Kur u zgjova dhe u ngrita, thirra një ushtarin tim spiritist që merrej herë pas here me vëzhgime në botën e fshehtë dhe i thashë: *"Më trego se ç'po ndodh në shtëpinë time në Beshiktash!"* Ushtari i mbylli sytë dhe ashtu, filloi të tregojë: *"Arrita në aksh vend, arrita te shtëpia, trokita në portë dhe më doli një grua plakë kokëmbuluar*

me një fëmijë në krahë...” Unë i thashë: “Pyete plakën se ç’ka e ç’nuk ka në shtëpi!” Ai m’u përgjigj: *“Dje të paska vdekur gruaja!..”*

Nëna që e paça xhenetin nën këmbët e saj, më tregonte: “Pata mbetur një vit të tërë në kokë të një gruaje gjatë sëmundjes së saj që do t’i sillte vdekjen; një gruaje që, kur thoshte “Allah”, i pritej oreksi i bukës, dhe, kur thoshte “Muhamed”, qante 24 orë! Disa minuta para se të vdiste, tha: *“Përgatisni ujë!”* Përgatitëm ujë dhe ajo mori abdes. I shoqi ndodhej në shtëpi dhe ishte shëndoshë e mirë. Gruaja lëshoi një të qeshur si në të ri të saj dhe tha: *“Akoma s’e kemi marrë pjesën që na takon nga kjo botë! Sot, të enjten në darkë, në shtëpi do të jenë kufomat e të dyve ne!”* Pastaj koka i ra mbi jastëk ngadalë si një pendë zogu dhe, ndërsa ne po e zgjatnim në shtrat, nga dhoma tjetër u dëgjua një klithje: edhe i shoqi kishte vdekur!

Lexuesi di po aq edhe sa ne mbi ceremonitë e jogistëve, domethënë të disa fakirëve indianë. Kjo temë është përhapur aq shumë në programet televizive, në gazetat dhe revistat dhe mes popullit, saqë është bërë pronë e të gjithëve dhe kalon nëpër gojë edhe të fëmijëve 8-10 vjeçarë. Këtu desha të përcjell vetëm një pamje nga një dokumentar me titullin *“Terra X”* të transmetuar në kanalin gjerman ZDF-2 dhe pastaj të botuar si libër. Shfaqja e lajmëruar nga spikeri si *“provë e dhimbjes më të lartë, mësim për ta duruar dhimbjen”*, u zhvillua kështu: Jogisti nxori gjuhën jashtë, pastaj mbi gjuhë ngulën një shtizë nga lart poshtë dhe e prenë gjuhën. Tashmë pjesa e prerë mbahej nga shtiza e ngulur në të. Por gjak nuk rrodhi as nga ngulja e shtizës, as nga prerja e gjuhës. Pastaj gjuhën e ngjitën prapë në vend, kurse shtizën e nxorën. Dhe spikeri shpalli me mahnitje: *“Shkenca akoma nuk i ka dhënë përgjigje kësaj!”*

Mirë po ne, myslimanët, kemi pesëmbëdhjetë shekuj që i dimë këto. Në luftën e Bedrit, Hz. Muavidhit iu këput krahu dhe dora shëruese e Profetit (s.a.s.) ia vuri në vend pa lënë asnjë shenjë. Po ajo dorë e pat vënë në vend edhe syrin e dalë jashtë të Ebu Katades në Uhud. Dhe, natyrisht, të gjitha këto ishin mrekulli të zhvilluara në kufirin e fundit të brezit të mrekullive!

7. Seancat e thirrjes së shpirtrave janë operacione të hyrjes në lidhje me fuqi metafizike të padukshme e të panjohura.

Në ditët tona, seancat e thirrjes së shpirtrave kanë filluar të shtohen me shpejtësi. Kjo ka shkuar gjer atje sa me këtë punë ka filluar të merret edhe njeriu i zakonshëm, i rrugës, dhe ka hyjë gjer në shtëpitë e të rinjve të mëhallës ku luhet me filxhanë. Si rezultat i kësaj, materializmi ka filluar të shembet dhe materialistët kanë filluar të besojnë se, përtej fizikës, ekzistojnë ligje të tjera që veprojnë mbi ligjet fizike.

Tani, vendin e lojërave të pokerit të organizuara në nivelet intelektuale, veçanërisht në mjediset mondane që përpiqen ta shuajnë urinë shpirtërore dhe etjen ideore të shkaktuar nga mungesa e adhurimit, po e zënë seancat e thirrjes së shpirtrave. Është një e vërtetë për të cilën flasin zhvillimet e arritura rreth kësaj teme sot në Europë, Amerikë, madje në Rusi. Ç’duan këta njerëz dhe me se merren? A me lëndën? Jo! Ata përpiqen të hyjnë në lidhje me fuqi metafizike të padukshme e të panjohura dhe me qenie shpirtërore. Me këtë rrugë ata shpresojnë të gjejnë shpjegimin e shumë ngjarjeve që nuk i kanë shpjeguar dot gjer më sot. Përtej dëfrimit, përtej kalimit të kohës me seanca emocionante, ata, duke e lënë mënjanë kryeneçësinë me mendimin se do të mund t’i gjejnë përtej natyrës zgjidhjet e shumë problemeve që nuk ka mundur t’i zgjidhë materia dhe fizika, po i bartin seancat e thirrjes së shpirtrave nga shtëpitë, në laboratorët dhe katedrat e universiteteve. Krahas studimeve mbi telepatinë në Rusi, fakti që në Angli mjekët po i lënë mënjanë ilaçet e kurimit të ulçerës për të përdorur sugjerimet shpirtërore me metodën e hipnoterapisë që do t’i vinin në lëvizje mekanizmat shpirtërore, mund të konsiderohet si një ngjarje dhe zhvillim i rëndësishëm në këtë fushë.

Një besimtar tregon: *“Së bashku me një shokun tim hetues në Ankara, vendosëm të thërresim shpirtin e poetit Xhelaledin Rumi, të njohur me emrin Mevlana si mistik. Dhe ja ku e pamë të dy të na dalë para syve*

Mevlana me pelerinën jeshile dhe qylafin mevlevi! Por vumë re se përpiqej ta fshihte fytyrën. Kishte shumë mundësi të ishte jo Mevlana, por një djall i ardhur në vend të tij që s'dëshironte t'ia shihnim fytyrën!"

Edhe një psikiatrist e ka treguar kështu një ngjarje të kësaj natyre, dëshmitar i së cilës ishte bërë vetë: "U ftova në një shtëpi në një seancë thirrjeje shpirti (xhindi ose djalli). Thirrjen do ta bënte vajza e vogël e shtëpisë. Ajo rreshtoi mbi tavolinë filxhanë dhe shkronja. Pasi thirri shumë herë me radhë, mësuam se erdhi dikush. Po e shkruante emrin me anë të lëvizjeve të filxhanëve: Belma! Dora e vajzës së vogël lëvizte bashkë me filxhanin. Ne e pyetëm: *"A je myslimane?" "Jo",* - na u përgjigj ajo. *"Nga je?" "Nga aksh qytet!" "A s'ka ndonjë mysliman që të vijë e të bisedojmë me të?"* Vajza shkoi dhe u kthye me një tjetër. Mbi tavolinë u shkruar emri *"Aishe".* Pasi e pyetëm sa vjeçe dhe nga ishte, na u përgjigj se ishte 7-8 vjeçe dhe nga aksh vend.

Pastaj, njëri nga shokët tanë që ndodheshin aty, thirri shpirtin e të gjyshit, por nuk i erdhi. Pas shumë këmbënguljeve, u dëgjuan një zë që tha *"erdha!"* E pyetëm për emrin, por nuk na e tha. Pasi këmbëngulëm, tha: *"Jam djalli!"* Ne u tronditëm nga prania e qenies që ishte armiku më i madh i njerëzimit qysh nga profeti i parë, Ademi!

Ka shumë ngjarje të kësaj natyre, për të cilat kanë dëgjuar ose janë bërë dëshmitarë shumë vetë. Në fakt, qoftë edhe një rast i vetëm na mjafton neve të shpallim se materia ka falimentuar dhe se shpirti është zotërues mbi materien. Sepse pjesa argumenton të përgjithshmen dhe copa, të tërën!

Çdo besimtar, me forcën e shpirtit të vet, mund të bëhet i aftë me sa i jep lejë Allahu të kryejë veprime të tilla që u përpoqëm t'i trajtojmë gjer tani, si hyrja në takim me shpirtin, zbulimi dhe parashikimi, parandjenja, leximi i mendimeve, spiritizmi dhe joga. Disa prej këtyre mund të arrihen me përpjekje dhe stërvitje tremujore. Ndërkaq, puna nuk është për t'i bërë këto gjëra, për të fluturuar në ajër ose për të luajtur me xhindet. E rëndësishme për ne është t'i njohim dhe duam Allahun dhe Profetin. Kurani dhe bukuritë e tij na mjaftojnë neve. Qëllimi ynë më i parë duhet të jetë shërbimi ndaj besimit dhe fesë, përgatitja e brezave në këtë rrugë dhe përgatitja e shpirtrave tanë për jetën e pasosur. Të tjerat janë çështje për të cilat nuk e vlen të përqendrohemi e me të cilat nuk e vlen të merremi.

IV. ËNDRRAT

Vjen nata dhe ju bini në gjumë. Kapakët e syve ju mbyllen dhe ju nuk shihni, veshët nuk ju dëgjojnë, gjuha nuk ju flet, dora nuk ju kap dhe këmba nuk ecën dot më. Po qe se ju afrohet dikush pranë dhe ju flet, ju as e shihni, as e dëgjoni. As ai nuk di gjë se ç'shihni e ç'dëgjoni ju. Pastaj, pasi ngriheni në mëngjes dhe, pas faljes, në vend që të kërkoni të hani, silleni rrotull plot emocion nën ndikimin e ëndrrës që keni parë dhe kërkoni t'ia tregoni dikujt që e keni më të afërtin e më të dashurin dhe që i besoni më shumë. Pse veproni kështu ndërsa e keni barkun bosh? Ja, pra, në jetën e përditshme të njeriut ka ngjarje të tilla që e bëjnë ta harrojë urinë dhe që ushtrojnë mbi të ndikim të madh. Të gjitha këto janë kundërveprime të shpirtit.

1. E vërteta dhe llojet e ëndrrës. Shpirti në ëndërr sheh të ardhmen

Njeriu që kridhet në gjumë është si njeriu që kridhet në det ose në hapësirën e kozmosit. Ose kridhet me sy mbyllur dhe kthehet prapë pa parë asgjë, ose jepet pas lodrave që ka marrë me vete dhe, nën ndikimin e tyre, nuk sheh dot asgjë, ose sodit fosforeshencën e dallgëzimeve të detit dhe veprimtarinë enigmatike që zhvillohet në hapësirën qiellore dhe i bart ato në botën e vet. Ja, në këtë kategori mund t'i trajtojmë ëndrrat.

Janë disa që s'dinë gjë tjetër veçse të bien në gjumë e të zgjohen. Janë sikur të jenë zhytur me sytë lidhur në errësira dhe kthehen në botën e vet pa parë asgjë!

Disa herë ndodh që ngjarje të hedhura në nënvetëdije, ngjarje emocionante të jetuara dhe çështje të ngarkuara vetëdijes duke u përqendruar shumë mbi to, duke i menduar gjatë e duke u rikthyer disa herë tek to, gjatë ëndrrës dalin në vetëdije. Të këtij lloji janë ngjarje të tilla si ngritja nga gjumi në gjendje të trembur e të emocionuar për muaj me radhë i dikujt që posa është kthyer nga lufta.

Janë edhe ëndrrat e para për shkak të sëmundjeve, shqetësimeve, gjendjet shpirtërore të sëmura dhe dëmtimet psikike. Kështu, dikush që bie të flejë pasi ka ngrënë gjëra të kripura, sheh në ëndërr sikur ndodhet në buzë të një liqeni, dikush që fle i zemëruar, sheh ëndrra me grindje dhe zënie, një tjetër që bie të flejë duke menduar skena me epshe, sheh ëndrra të këtij lloji, etj. Personi që shtihet vazhdimisht pas ëndrrave, që bie të flejë për të parë ëndrra, që jepet pas imagjinatës dhe iluzioneve, që bie në gjumë sikur bie klloçkë dhe që vepron sipas shenjave të ëndrrave, do të thotë se ka rënë i sëmurë pas ëndrrave.

2. Ëndrrat e vërteta ose besnike

Janë ëndrrat që shihen papritmas, me ndjenja krejt të pastra, jo si rezultat i ndonjë sëmundjeje dhe pa rënë në iluzione, si, p.sh., ëndrrat e profetëve, të njerëzve të urtë e të mirë. Disa herë, ëndrra të tilla shohin edhe njerëz të radhës, besimtarë, madje edhe mosbesimtarë.

Ëndrrat e vërteta ose besnike mund të jenë një sihariq, një nxitje, një frymëzim dhe udhëzim i favorizuar nga Zoti, por mund të jenë edhe si paralajmërime, qortime dhe mësime prej Tij me qëllim orientimi. E veçanta mbi të cilën do të përqendrohemi këtu, janë ëndrrat mbi të ardhmen që shprehin një lidhje të avancuar e të lartë të shpirtit.

Këto ëndrra janë informacione të ardhura në formë valësh në këtë botë dëshmie ku jetojmë nga botët e varrit dhe të përjetësisë ku s'ka dyshim se do të shkojmë. Dritaret e mbyllura për botën e dëshmisë si rezultat i prerjes së lidhjeve të shpirtit me botën e dëshmisë dhe hyrjes në lidhje me botën e fshehtësisë me anë të mbylljes së pesë shqisave ndaj botës së dëshmisë që ka cilësinë e një membrane të hollë dhe të daljes vetvetiu të mekanizmit të ngacmimit nga veprimi, hapen, tani, për botën e shëmbëllimit. Dhe, nga këto dritare të hapura, hyjnë, së bashku me shëmbëllimet e botës së shëmbëllimeve, simbolet e kuptimit e të së vërtetës,

pamjet e reflektuara nga bota e varrit, tablotë që i ofrohen shikimit dhe parashikimit, faqet e ngjarjeve të së ardhmes. Nisur nga kjo, ëndrrat mund të quhen kabina enigmatike ose tunele kohe që e bartin njeriun nga kjo botë për në botë të tjera.

Le ta trajtojmë çështjen nga një këndvështrimi tjetër. Çdo ndodhi e ka identiken e vet të fiksuar para se të ndodhë. Me fjalë të tjera, çdo gjë dhe çdo ngjarje ekziston në mënyrë të paraqenë në diturinë hyjnore. Pastaj të gjitha këto, me vullnetin dhe fuqinë hyjnore, përcillen në botën lëndore. Ndërkaq, mes dy botëve ekziston bota e ndërmjetme e shëmbëllimeve. Ja, pra, shpirti i çliruar nga lëndorja, i shpëtuar përkohësisht nga lidhja me kurmin, fillon të ngjitet drejt botës së shëmbëllimeve edhe pa e braktisur kurmin plotësisht. Dhe, kur ngjitet në atë botë, del nga dimensionet materiale dhe hyn në dimensione krejt të tjera. Brenda këtyre dimensioneve, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja ndërthuren me njëra-tjetrën dhe shpirti atje mundet t'i shohë të gjitha kohët e shkuara e të ardhme. Në të njëjtin çast mund ta vëzhgojë natën e parë të Kadrit dhe t'i jetojë dy bajrame të Kurbanit menjëherë. Ndërsa ndodhet në shekullin e njëzetë, mund ta shohë veten si sahabe në shekullin e Profetit. Mos thoni "si ka mundësi"! Për shembull, personi që ndodhet në rrëzë të një mali konik ose në një shtëpi fshati, mund të vështrojë në atë çast vetëm mjedisin e tij të ngushtë. Por, po të ngjitet lart me një teleferik ose avion, mund t'i shohë edhe majën e malit, edhe tërë anët e tij, dhe jo vetëm një shtëpi, por të gjithë shtëpitë e atij fshati ose disa fshatra bashkë. Kështu ndodh edhe në ëndrra. Dublanti i shpirtit në gjendje kalimtare, duke u ndarë prej vetes dhe duke u futur në dimensionet e botës shembullore, mundet të ndjejë të njëjtat gjëra.

Kështu, njeriu që vëzhgon gjërat e përcjella në shpirt nga bota e shëmbëllimeve me anë të ëndrrave, i vëzhgon ato si në një perde kinemaje. Ai mundet t'i shohë në të njëjtin çast atë që ka ndodhur, që ndodh e që do të ndodhë. Dhe, disa herë, këto pamje janë aq të qarta, sa mund të kuptohen shumë lehtë. Disa herë shëmbëllimi mund të jetë në formë simbolesh dhe të kërkojë interpretim. Për shembull, një pikë ujë që e patë në botën e shëmbëllimeve, në realitet mund të jetë mollë. Jashtëqitja që e patë në botën e shëmbëllimeve, në realitet do të thotë pasuri, para. Po qe se kjo jashtëqitje është e dikujt tjetër, është për ju para haram, kurse po qe se është e juaja, është hallall. Po qe se në botën e shëmbëllimeve ju hipin mbi kalë, kjo do të thotë se keni për t'ia arritur qëllimit. Prandaj, mos u përpiqni t'i interpretoni ëndrrat tuaja vetë, por kërkoni t'jua interpretojnë njerëz që e njohin botën tuaj shpirtërore, që nxjerrin kuptim nga shikimi juaj dhe që jua lexojnë fatin nga linjat e fytyrës.

3. Disa shembuj lidhur me ëndrra besnike

Në tefsirin e tij, Prof. Sejid Kutub tregon: *"Ndërsa ndodhesha në Amerikë, pashë në ëndërr në sytë e time motre që ndodhej në Kajro, aq gjak sa ia pengonte shikimin. I shkrova letër dhe mora përgjigje ku më tregonte se me të vërtetë kishte kaluar një hemorragji në sy dhe ishte mjekuar."*

Në *Sejahatname*-n e tij, Evlija Çelebi tregon: "Vajza e Mehmetit IV, Kaja Sulltan, e sheh gjyshin e vet, sulltan Ahmetin, në xhenet. I gjyshi i thotë të mbesës: *"Mbesa ime, kur po ndërtohej Xhamia e Re, pata mbajtur gurë, prandaj Zoti më vendosi në xhenet. Eja dhe ti!"* Kurse i ungji Mustafa që ndodhej aty, i thotë sulltan Ahmetit: *"Mos u nxito kaq shumë për Kajanë! T'i bëhet një vajzë, pastaj të vijë!"* Me të vërtetë, Kaja vdiq më vonë gjatë lindjes!"

Edhe në librin me titull "Kthimi te Zoti në Rusi" tregohen këto lloj ngjarjesh dhe ëndrrash. Nëna e një shkrimtareje me emrin Ana Ostrovkij, pesë vjet para hyrjes së gjermanëve në Rusi pati parë në ëndërr luftën e ardhshme me shumë skena dhe kjo ishte botuar në gazetat e ditës.

Sër Hamilton që komandonte fuqitë e Antantës në Dardanele në vitin 1911, pa në ëndërr sikur po fundosej drejt thellësive të detit dhe se dy duar po i shtrëngonin fytin. Dhe, kur u ngrit, vuri re se një qenie

si fantazmë po dilte ngadalë nga çadra. Me të vërtetë, Dardanelet nuk i pati sjellë fat atij. Ajo i pati rënë sipër si një rrezik i pamënjanueshëm.

Gruaja e një shokut tonë vdes pas mesit të natës dhe këtë gjë s'e merr vesh askush. Kur bëhet mëngjes, fëmijët mblidhen në xhami si zakonisht për t'u praktikuar në këndimin e Kuranit. Pasi fillon mësimi, njëri nga fëmijët thotë: *"Unë pashë në ëndërr se nëna e këtij shokut tim ka vdekur. A është e vërtetë?"*

Dy gra shoqe prisnin të bëheshin nëna. Një ditë, njëra i thotë tjetrës: *"Ti do të lindësh para meje!" "Ku e di ti*? – E pyeti shoqja. *"Pashë në ëndërr sikur për tokë ra një pelerinë dhe ti e more!"*

E njëjta grua sheh në ëndërr sikur i gjyshi rrëzohet nga një shkallë e mbështetur në mur dhe thyen këmbën. Pas një muaji, ajo mori këtë lajm: *"Duke meremetuar murin e xhamisë, shkalla rrëshqiti dhe ra. Gjyshi theu këmbën dhe u shtrua në spital!"*

Përsëri e njëjta grua sheh në ëndërr sikur dajën ia qëllojnë me armë tek po rrinte në tavolinë dhe vdes. Kalojnë katër vjet dhe gruaja merr lajmin se dajën ia kanë vrarë duke ndenjur në tavolinë.

Në krye të shekullit të kaluar, Niels Bohr pati parë në ëndërr diellin dhe disa planete që rrotulloheshin rreth tij të lidhur me pé. Dhe, kur zgjohet, i shkon mendja se kështu duhet të jetë ndërtimi i atomit!

Kimisti Kekule pati parë në ëndërr atomet dhe diçka si gjarpër që e fut bishtin në gojë. Dhe, kur zgjohet, zbulon formulën në formë gjashtëkëndëshi të benzenit.

Me gjithë provat e shumta, Elias Howe nuk po e gjente dot si duhej bërë gjilpëra e makinës qepëse. Një natë, pa në ëndërr sikur kishte rënë rob te disa fise te gra dhe, ndërsa po derdhte djersë në duart e tyre si rob, vuri re se shtizat që mbanin në duar njerëzit e fisit, e kishin majën me një vrimë si sy. Elias u zgjua dhe bëri një "shigjetë të vogël" me majën të shtypur dhe të vrimosur që dukej krejt si një sy! Ajo ishte gjilpëra e makinës qepëse që kishte kaq kohë që s'po e shpikte dot!

Janë këto dhe qindra shembuj si këto si mesazhe drite të ardhura nga bota enigmatike e shpirtit!

V. KOMANDUESI I TRURIT DHE I TRUPIT ËSHTË SHPIRTI

Është një komandant që i urdhëron dhe i drejton të 60 trilion qelizat që funksionojnë secila si një shtet më vete. Ai është shpirti!

1. Shpirti është ose sunduesi i trupit, ose i burgosuri në trup

Në trupin ku hyn shpirti, duken shenja gjallërie, kurse kur ikën shpirti shkaktohet decentralizim dhe në mekanizëm fillon prishja dhe qelbja, qelizat shpërbëhen, çdo gjë zbërthehet e mbaron. Kjo do të thotë se shpirti është një esencë, një element esencial, kurse truri, gjymtyrët, ndjenjat dhe të gjitha veprimtaritë e trupit s'janë gjë tjetër veçse funksione të atij elementi esencial. Shpirti zotëron mbi të gjitha fakultetet e trupit të njeriut, mbi të gjitha qendrat dhe zonat e trurit dhe mbi të gjitha organet duke u dhënë atyre aftësi jetësore. Shpirti vë në funksion mendjen, zemrën dhe ndjenjat. Ndërkaq, shpirti që është sunduesi dhe urdhëruesi i trupit, përballë shqetësimeve dhe fatkeqësive të ardhura nga Zoti, përballë sëmundjeve dhe çrregullimeve fiziologjike, bie në gjendjen e të dënuarit, e të burgosurit, paralizohet. Fundja, me të vërtetë, kur shpirti nuk mbështetet te Zoti, fuqia e pafundme, i cili e ka krijuar dhe e mban në këmbë, është një rob me krahë dhe këmbë të lidhura.

2. Funksionet e trurit kryhen me anë të reaksioneve në qelizat nervore

Funksionet e trurit janë reaksione biokimike që zhvillohen në qelizat nervore. Ne dimë se këto funksione kanë karakter elektrokimik. Vendimi që marrim, iu përcillet muskujve me anë të rrymave biokimike; në tru hyjnë në reaksion dopa, nxitësi dopamin ATCH dhe lëndë të tjera dhe, si rezultat, ndodhin analiza ose sinteza. Disa molekula oksidohen, disa të tjera, reduktohen, elektronet merren dhe jepen dhe, në përfundim, në organe dhe gjymtyrë shkon rrymë elektrike dhe kryhen veprimet dhe lëvizjet e duhura.

Në trupin e gjallë, brenda gjashtë muajsh, të gjitha qelizat kanë ndryshuar. Në gjak, në çdo sekondë, vdesin një numër qelizash të kuqe, të quajtura eritrocite, dhe, në vendin e tyre, lindin të reja. Jetëgjatësia e një eritrociti është 28 ditë. Në një qelizë, në çdo sekondë krijohet një sintezë, gjë që do të thotë dyzet e pesë mijë sinteza në orë. Kjo do të thotë, se, me këtë aspekt tonin, ne ndryshojmë çdo çast, pra, e thënë në mënyrë të thjeshtuar, një çast më pas nuk jemi më ai që kemi një çast më parë! Siç ndërrojmë këmishën ose xhaketën e vjetruar, ndërrojmë vazhdimisht edhe mishin dhe kockat.

Para reaksionit, në tru ka disa lëndë që, kur hyjnë në reaksion, shkaktojnë rrymë bioelektrike, me anë të së cilës vendimet u përcillen muskujve dhe, kështu, kryhen veprime të ndryshme. Po qe se çështjen e vlerësojmë me këtë aspekt të saj që reflektohet jashtë dhe pranojmë se ata që i bëjnë veprimet, janë me të vërtetë gjymtyrët e trupit (kurmit) tonë, atëherë, sistemin e sotëm juridik e bëjmë rrëmujë. Sepse, sipas vlerësimit të mësipërm, do të duhej që sistemin e sotëm ta hiqnim nga fuqia dhe, në vend të tij, të vendosnim një sistem krejt tjetër. Po deshët, le ta përfytyrojmë sikur po hyjmë bashkërisht në një sallon gjyqi. Atje do të dëgjojmë bisedën si më poshtë dhe vendimin e dhënë:

Gjykatësi e pyet të pandehurin:

"Kur e bëre këtë krim?"

I pandehuri i përgjigjet:

"Një vit më parë, zoti gjykatës!"

Vendimi është i qartë: i pandehuri do të falet! Gjykatësi lexon vendimin:

"Meqë ka kaluar një vit nga dita e kryerjes së krimit dhe të gjitha qelizat e gishtit që ka hequr këmbëzën e armës, madje, të gjitha qelizat e trupit të të pandehurit janë ndërruar, për pasojë, meqë është e pamundur të dënohet vrasësi i vërtetë, juria vendosi njëzëri t'i japë lirinë të pandehurit!"

Natyrisht, në botë nuk ekziston një e drejtë penale e tillë!

Ose le të shohim se ç'mbrojtje i bën vetes një i pandehur në një gjykatë tjetër.

"Të nderuar anëtarë të jurisë,

Me të vërtetë, këtu jemi para një krimi, por autori i tij s'jam as unë, as ndonjë tjetër. E para, këtë krim më detyruan ta kryej një sërë molekulash dhe reaksionesh të trurit. E dyta, nga dita e ngjarjes kanë kaluar plot tetë muaj dhe ju, të nderuar anëtarë të jurisë, e dini mirë se të gjitha qelizat e mia kanë ndryshuar. Kështu, nga nga ai njeriu i para tetë muajve s'ka mbetur gjë. Prandaj, qelizat e mia të sotme nuk mund të mbajnë përgjegjësi për një krim që s'e kanë kryer. Duke u mbështetur në parimin se *askush s'mban përgjegjësi për fajin e tjetrit*, ju lutem të më nxirrni të pafajshëm e të më ktheni lirinë!"

Dhe, tani, po qe se nuk pranojmë se është shpirti që e meriton të dënohet, a nuk do të ishte i drejtë një gjykim i tillë? Sigurisht, po qe se e mendoni njeriun vetëm si materie, në këtë përfundim do të arrini. Por, në fund të fundit, njeriu nuk është identitet i materies, por i shpirtit, dhe autori i vërtetë i ngjarjeve është shpirti që drejton të gjitha sistemet e organeve, të ndijimeve e të ndjenjave, që i urdhëron ato. Trupi është vetëm një mjet i shpirtit, një zbatues, një ekzekutues, prandaj dënimi i duhet dhënë shpirtit e jo trupit.

3. Po qe se njeriu do të ishte identitet vetëm i materies, do t'i humbte prindërit

Po qe se njeriu pranohet vetëm si identitet i lëndës dhe qelizave që ndërrohen vazhdimisht, a nuk i humb prindërit shumë shpejt? Gjashtë muaj pas lindjes sonë, nëna jonë nuk është më nëna e trupit tonë "të ri". Mirëpo në këtë mes është një element themelor i ekzistencës sonë që nuk ka ndryshuar dhe që nuk ndryshon kurrë, shpirti ynë. Po kështu, edhe tek nëna jonë, është shpirti i saj, personaliteti i saj që nuk ka ndryshuar, ai shpirt dhe personalitet për të cilin thuhet se *"xheneti është nën këmbët e nënave!"* Përkatësia dhe lidhjet prindërore, birësore dhe vëllazërore mbështeten jo mbi trupin, por mbi shpirtin dhe dihet se ato vazhdojnë të ekzistojnë, pranohen dhe njihen edhe shumë shekuj pasi trupat të jenë tretur në tokë ose, më saktë, për sa i përket kësaj bote, sa të ekzistojë kujtesa e njerëzimit.

4. Po qe se njeriu do të ishte vetëm një qenie materiale, atëherë morali, karakteri dhe aftësitë e tij do të ndryshonin bashkë me ndërrimin e qelizave

Ndërsa qelizat na ndërrohen, morali, karakteri, mundësitë dhe aftësitë, veset dhe shprehitë, parimet, idetë dhe mendimet, ndijimet dhe ndjenjat, dijet dhe cilësitë dhe vetitë që kemi fituar, profesioni, pozita dhe posti, popullariteti dhe vendi ynë në shoqëri, në ndryshofshin, nuk ndryshojnë paralelisht me qelizat dhe në vartësi të tyre, pra, nuk varen nga ndërrimet dhe ndryshimet qelizore-lëndore të trupit tonë.

Takohemi shumë vjet më pas me një shokun tonë dhe i themi: "S'paske ndryshuar fare!" Me këto fjalë ne duam të vëmë në dukje se ai ka mbetur po ai si karakter, si shpirt. Por po të duam të vëmë në dukje se ai s'ka ndryshuar si trup, i themi, për shembull,: "S'qenke plakur fare!" Pra, ne, në takimin me shokun tonë pas shumë vjetësh ndarjeje, mund të kemi vënë re se ai nuk ka ndryshuar si moral. Edhe po të kishte ndryshuar, kjo do të kishte ndodhur jo paralel dhe për shkak të ndryshimeve materiale (fiziologjike) në trup; shoku ynë, pas shumë vjetësh, mund të na dilte para me një moral më të përsosur, por edhe i rënë poshtë moralisht! Përgjithësisht, morali i mirë ose i keq i fituar mund të ndryshojë, po kështu dhe cilësi të tjera të fituara me kohë, kurse karakteri ose, më drejt, disa tipare të karakterit, të trashëgueshme, nuk ndryshojnë kurrë ose ndryshojnë me shumë vështirësi. Pak a shumë e njëjta gjë mund të thuhet edhe për veset dhe shprehitë. Por po qe se tek njeriu do të bëhej fjalë vetëm për lëndën dhe për psikologjinë të varur vetëm nga lënda ose, e thënë ndryshe, nga proceset dhe ndryshimet fiziologjike, morali dhe karakteri i njeriut do të ndryshonin për çdo vit!

Pse s'ndryshon së bashku me qelizat një shprehi e duarve dhe një aftësi e arritur për vite me radhë? Pse duhen përpjekje shumëvjeçare për të zhvilluar një aftësi? Dhe pse një art, një mjeshtëri, një profesion i fituar nuk harrohet më?

Dhe tani le ta shohim çështjen nga një aspekt tjetër.

Në idetë dhe mendimet personale, me kohë, siç është e natyrshme, mund të ndodhin ndryshime dhe zhvillime pavarësisht nga ndryshimet qelizore apo fiziologjike, por idetë dhe mendimet e buruara nga revelacioni hyjnor dhe tradita profetike nuk ndryshojnë kurrë. Po kështu, edhe parimet që çdo njeri, sipas tij, i ka pranuar si të dhëna një herë e përgjithmonë e të pandryshueshme, nuk ndryshojnë aq lehtë. Qelizat ndryshojnë, fiziologjia pëson ndryshime, por ato mbeten ato që janë. Mirë, po cila është ajo forcë që i përcakton parimet dhe i akordon mendimet?

Edhe nëse disa prej njohurive që merren gjatë studimit shumëvjeçar, me kohë harrohen, në dijet e njeriut dhe në aftësimin e tij arsimor e kulturor nuk ndodhin ndryshime të përvitshme ose, e thënë ndryshe, në vartësi të ndryshimeve fiziologjike të rregullta të trupit.

5. Në kundërshtim me ngjashmëritë e rregullta mes njerëzve në qelizat dhe funksionet trunore, dallimet e mëdha mes tyre në mendje, arsye, vullnet, vetëdije, mendime dhe ide tregojnë se nuk janë funksionet apo ndryshimet qelizore dhe fiziologjike ato që përcaktojnë identitetin e njeriut

Fakti që, megjithëse tek të gjithë njerëzit janë po ato qeliza dhe funksioneve cerebrale, tek secili njeri ka mendje, vullnet dhe vetëdije tjetër, që mes njerëzve ka dallime të thella idesh e mendimesh, që mes tyre duken ndryshime të mëdha arsimore e kulturore, megjithëse mund të kenë marrë të njëjtin arsim e të njëjtën kulturë, si dhe, krahas kësaj, ndryshime në mundësi, aftësi e talente, a mund t'u dedikohet ky fakt, pra, qelizave të trurit, ndërrimit të tyre dhe molekulave të lëndëve që marrin pjesë në përbërjen e trurit? Nga makinat e endjes që përdorin të njëjtën lëndë të parë dhe punojnë në të njëjtat kushte, del i njëjti mall. Fabrika e tekstilit nuk prodhon çimento, në laboratorët e kimisë nuk piqet bukë! Në është kështu, edhe nga funksioni i qelizave të trurit duhej të dilte i njëjti prodhim! Mirëpo, ja ku janë njerëzit dhe gjithë këto dallime mes tyre! Kjo do të thotë se është e veçanta e shpirtit që e bën çdo njeri një qenie të posaçme në vetvete. Truri dhe funksionet e tij janë të njëjtë, por "urdhrat" që i jepen trurit, të ndryshme. Dhe, megjithëse tek të gjithë njerëzit qelizat ndërrohen e përtëriten si një ligj i përgjithshëm, idetë dhe mundësitë, të ndryshme nga një njeri tek tjetri, e shfaqin këtë ndryshueshmëri jo në vartësi të qelizave te çdo njeri, por vetëm për shkak të faktorëve që burojnë nga shpirti!

6. Përparimi i njeriut me anë të ndjenjave, ndijimeve dhe njohjes drejt të vërtetave të gjera, përsosja e tij me anë të meditimit objektiv dhe subjektiv si dhe përpjekja e tij për t'i thurur hojet e besimit me anë të përpjekjeve për t'i njohur emrat (atributet) hyjnore e me anë të mundësive të tij kulturore e shpjeguese, nuk mund të arsyetohen me anë të strukturës së tij lëndore

Fakti që njeriu i ndjen në çast bukuritë e shkëlqyera kulmore të materies dhe dukurive, që, duke i kaluar ato nëpër distilatorët e kuptimit, i rivlerëson brenda sintezave të reja, që disa herë, me një fjalë ose me një fjali, hap krahët e ngjitet drejt horizonteve të gjera të të vërtetave që s'i nxënë as librat, që, me anë të meditimit objektiv, arrin në sinteza të reja, që, me një dukje dhe frymë që mund t'i realizojë jo vetëm ai që shkruan e lexon, por edhe ai që jeton dhe dëgjon, flet për Zotin, emrat dhe atributet e Tij, që i nisur nga një botë për të udhëtuar dhe vëzhguar në mijëra botë dhe që i thur hojet e besimit me tufat e kulturës dhe zgjuarsisë të fituara në atë udhëtim, të gjitha këto, me ç'molekula mund të shpjegohen?

Si mund t'ua dedikojmë atyre molekulave të vdekshme mijëra lloje zërash që dëgjojmë, shumë shije që shijojmë, bukuritë që sodisim, cilësi që i quajmë e ëmbël, e hidhur, e bukur, e shëmtuar, estetike, ndjenjat dhe veprimet tona moralo-shpirtërore, si dashurinë, pëlqimin, dëshirimin, neverinë, frikën, ndrojtjen, harenë, pendimin dhe entuziazmin?

Njeriu disa herë bie në një gjendje të tillë shpirtërore që gjithë kjo botë e gjerë i duket e ngushtë dhe shtypëse, që tërë gjithësia në sytë e tij duket e veshur në të zeza. Kurse disa herë ngjitet në një gjendje të tillë shpirtërore që edhe mes katër mureve të shtëpisë e ndjen veten në parajsë duke i harruar fëmijët, familjen, fqinjët, çdo gjë! Vijnë kohë që njeriu i jep një një të shtyrë kësaj bote dhe, duke përdorur si shkallë yjet dhe galaktikat, fluturon hapësirave kozmike. Dhe vijnë kohë që njeriu, nën ndikimin e një gote pijeje ose të një shikimi në rrugë, të rrëzohet poshtë e më poshtë dhe rrëzimi i tij të mos mbarojë. Njeriu dëshpërohet, hidhërohet, qan, mërzitet, përpëlitet në ankthe e vuajtje ose gëzohet, qesh, ndjen kënaqësi e prehje dhe s'e nxënë botët. Ose mbetet vetëm dhe mbytet në vetmi ose hyn në një kuvend shokësh si trëndafilishte dhe, me largimin e reve dhe kthjellimin e qiellit sipër tij, çel si një trëndafil. Dhe me ç'gjë do t'i shpjegojmë të gjitha këto, a mos vallë përsëri me molekulat?

7. Kush lodhet, shpirti apo kurmi (kufoma)?

Me kalimin nga gjendja në gjendje para Zotit duke i vënë në veprim aktivitetet e posaçme të botës së tij, udhëtimet, fluturimet në botët e larta, delikatesat e veta e të zemrës, shpirti bie i lodhur. Pastaj, duke u rikthyer në botën e dëshmisë, mund t'i lehtësojë peshën dhe shqetësimet me anë të marrëdhënieve delikate në një kuadër legjitim. Ky është njëri aspekt i çështjes. Por çështja ka edhe një aspekt tjetër.

Ta zëmë se punuat gjatë gjithë ditës për 8-10 orë rresht dhe u lodhët. Prandaj edhe doni të uleni e të çlodheni, edhe e keni të nevojshme këtë. Mirëpo ja tek ju vjen një njeri me një lajm shumë të gëzuar, ose, mos e thëntë Zoti, shumë të hidhëruar. Ç'do të bëni ju? A mos do t'i thoni lajmësit ose vetes, "prit pak të pushoj"? Apo, nën veprimin e atij lajmi të papritur e të jashtëzakonshëm do ta hidhni tej lodhjen trupore dhe do të vraponi në vendin e ngjarjes? Natyrisht që do të bëni të dytën! Tani, ç'është këtu ajo gjë e cila, pavarësisht nga lodhja trupore, vazhdon të mbetet në këmbë dhe e freskët? Po, ka ndodhur që, para një ngjarjeje serioze, njeriu të mos flejë 2-3 net radhazi. Edhe nëse trupi është i lodhur e i rënduar, trupi është i palodhur, në këmbë e plot gjallëri!

8. Ndërsa qelizat na ndërrohen pandërprerë, fytyra dhe pamja na mbeten të pandryshuara, gjë që tregon se secili ka një shpirt të posaçëm për vete

Megjithëse qelizat na ndërrohen dhe përtërihen pandërprerë siç mund të ndërrohet tullat e një muri, pse fytyra s'na ndryshon dhe në bazë të ç'programi na mbeten të pandryshuara vetullat, sytë, hunda, goja, lëkura? A e dini se edhe sikur të plagoset gishti, e ripërtërin konfiguracionin e vijave duke e ruajtur origjinalitetin e tij të papërsëritshëm? A e dini se, tashmë, shkencëtarët thonë se, veç vijave të gishtave, njeriu ka të veçantë edhe ndërtimin e syrit dhe se, për përcaktimin e identitetit të personit ka filluar të përdoret edhe kjo veçori? A nuk tregojnë këto se çdo njeri ka një shpirt të posaçëm për vete dhe se, me anë të fuqisë së Zotit, shpirti ruan fytyrën, pamjen dhe strukturën e vijave të gishtave e të syve të personit të cilit i përket?

9. Fytyra është pasqyra e pandryshueshme e shpirtit

Fytyra nuk ndryshon sepse është pasqyra e pandryshueshme e shpirtit. Po, fytyra është një dritare e hapur për në botën shpirtërore të njeriut. Vijat dhe linjat e fytyrës tregojnë se të ç'vlere e ka shpirtin dhe ç'njeri është ai njeri. Struktura fizike, fytyra dhe pamja e njeriut janë si tregues të vlerave dhe përmasa të shpirtit të tij.

Për ta qortuar dikë se ju ka shqetësuar duke bërë zhurmë, ju mund t'i thoni thjesht: "na shqetësuat me këtë zhurmë", por edhe në një mënyrë tjetër për ta theksuar ndjenjën e pakënaqësisë dhe qortimit: "na shurdhuat veshët me këto rropama"! Pra, ju përpiqeni të zgjidhni fjalët më të përshtatshme që mund ta shprehin me efektin më të drejtë ose më të lartë mendimin ose ndjenjën tuaj. Në të njëjtën mënyrë, vijat dhe linjat e vendosura në fytyrën tuaj janë përmasat dhe veshja e shpirtit dhe karakterit tuaj që ndodhen brenda trupit tuaj. Ka njerëz të aftë që mund t'ju kuptojnë vlerën vetëm duke ju parë në fytyrë. Po, fytyra është si një libër i shkruar me argumentet e krijimit!

Psikologët thonë se shkrimi i njeriut, madje mënyra se si kollitet dhe fshin hundët zbulojnë karakterin e tij. Dhe aq ligje të sakta janë parashtruar rreth kësaj çështjeje, sa me një vështrim mund të thuhet me shumë afërsi se sa vlen.

Ata që bëjnë operacione estetike, edhe kryejnë mëkatin e ndërhyrjes së natyrën e krijimit, edhe i prishin lidhjet me shpirtin e vet, veçanërisht, edhe i mashtrojnë njerëzit që i njohin ose u dalin përballë. Nga ky aspekt, kjo është një çështje që e vlen për t'u përqendruar mbi të.

10. Krijimi i lidhjeve të shpirtit të ardhur nga bota e urdhrit, me botën materiale, është i mundur me anë të mjeteve të tilla si dora, krahu, gjuha dhe syri që zgjaten në botën e dëshmisë

Çdo pozitë kërkon një shfaqje të caktuar. Që shpirti i ardhur nga bota e dëshmisë të krijojë lidhje me botën materiale, ka nevojë për ndërmjetës materialë sepse për ta realizuar këtë lidhje, shpirti nuk mjafton. Ashtu siç trupi e ka të pamundur të krijojë lidhje me botën e shëmbëllimit, edhe shpirti ka nevojë për ndërmjetës materialë si dora, krahu, veshi, gjuha, syri, këmba, me anë të të cilëve percepton dhe hyn në lidhje me gjërat, dukuritë dhe ngjarjet.

Meqë shpirti bën punën e një drejtuesi qendror, po qe se në njërin nga organet dhe gjymtyrët ndodh ndonjë prishje, nuk krijon dot lidhje me të.

Si rezultat i kërkimeve mbi trurin, është arritur që, me ngacmimin e disa qendrave, në gishta dhe duar të kryhen disa lëvizje të thjeshta e të pavetëdijshme, të paafta për të mbërthyer edhe një kopsë. Kjo është si të prekësh pa i njohur tastat e pianos e të nxjerrësh tinguj të parregullt e të pakuptimtë. Prandaj truri që është si pianoja, ka nevojë për një qenie të vullnetshme e të vetëdijshme, të aftë për të nxjerrë nga tastat e tij melodi, pra, për shpirtin!

Në fakt, është shpirti që i bën sytë të shohin, jo truri. Treguam se si shohim në ëndërr kur i kemi sytë të mbyllur. Kështu, ndodh që jo në ëndërr, por zgjuar, të shihet me sytë të mbyllura.

Po marrim një rast përsëri nga Rusia, nga një botë vulgare që mohon çdo gjë jashtë materies. Siç tregohet në librin "Kthimi te Zoti në Rusi", në vitin 1962, në qytetin Nizhni Tagil, mjekët kanë bërë prova me një të vajzë të quajtur Roza që ia kanë mbyllur sytë dhe kanë vërejtur se si ajo ka dalluar ngjyrat dhe ka lexuar me anë të prekjes me majat e gishtave.

Drejtori i spitalit Pesavo në Itali, prof. Lambrozo tregon në librin e tij: "Kisha një vajzë të sëmurë në moshën 14 vjeçe. Kur e kapnin krizat nervore, as sytë nuk i shihnin, as hunda nuk i nuhaste. Në vend të tyre, ajo shihte dhe lexonte letrat me anë të majës së hundës dhe bulës së veshit, kurse me thembrat e këmbëve nuhaste me lehtësi.

Përveç rasteve të veçanta, është vërejtur gjerësisht dhe është e njohur edhe në popull se, kur një organ ose gjymtyrë dëmtohet pjesërisht ose plotësisht duke e humbur aftësinë për të kryer detyrën e vet, ndonjë prej organeve të tjera, disa prej tyre ose të gjitha bashkë fitojnë aftësi të jashtëzakonshme për ta zëvendësuar organin ose gjymtyrën e dëmtuar dhe dihet se njerëzit e gjymtuar arrijnë të kryejnë me organet apo gjymtyrët e shëndosha veprime që s'u përkasin, që njerëzit e zakonshëm s'kishin për t'i kryer dot kurrë.

Po ç'gjë sheh kur sytë janë të mbyllur? Shpirti është drejtuesi kryesor i përbashkët i trurit, i sistemit nervor dhe i të gjitha organeve dhe gjymtyrëve. Gjithashtu, me anë të tyre, shpirti hyn në lidhje me botën materiale të dëshmisë. Kështu, syri është një dritare përmes së cilës shpirti vëzhgon botën e jashtme. Por edhe sikur të mbyllet ajo, shpirti mund të gjejë dritare të tjera për të parë. Kjo bëhet ose me anë të seancave spiritualiste, ose me stërvitjen e gjymtyrëve të tjera, gjë që është, në fakt, aftësim i shpirtit, ose me dëshirën e Allahut i cili ia favorizon shpirtit aftësinë përkatëse...

VI. ÇËSHTJE TË NDRYSHME

1. Ndërgjegjja dhe krijimi kurrë nuk gënjejnë. Ndërgjegjja e një njeriu që nuk i është prishur natyra e krijimit, e gjen dhe e njeh Zotin e vet

Ndërgjegjja dhe natyra kurrë nuk gënjejnë. Sigurisht, ligjet e krijimit nuk gënjejnë! Cilësitë dhe veçoritë që ndodhen në natyrën e gjërave, nuk e gënjejnë njeriun. Për shembull, po qe se bota thotë "rrotullohem", rrotullohet. Fara ju thotë: "Hidhmëni në tokë. Kur të plotësohen kushtet e përshtatshme, unë do të mbij, do të nxjerr filiz, do të rritem e bëhem pemë dhe do të jap fruta!" Dhe ashtu bën. Po qe se uji ju thotë se ngrin nga të ftohtit dhe bëhet akull, me të vërtetë ngrin dhe bëhet akull. Po qe se zjarri ju thotë se ju djeg, tërheqja e tokës ju thotë të mos e lëshoni veten në hapësirë se rrëzoheni e vriteni, bilbili ju thotë se këndon, gjarpri ju paralajmëron se ju kafshon, ashtu bëjnë. Asnjë natyrë krijimi nuk bën ndonjë deklaratë kontradiktore.

Ndërsa lëndët pa jetë, bimët dhe kafshët, megjithëse s'kanë shpirt dhe ndërgjegje që hyn nën përgjegjësi, në natyrën e tyre krijimore nuk gënjejnë, a mund të gënjejë krijimi i njeriut i cili ka ndërgjegje, për rrjedhojë, edhe vetëdije dhe aftësi njohëse? Po qe se vetëdija si një rregullues, është në veprim, atëherë edhe ndërgjegjja e kryen funksionin e vet në përshtatje me natyrën e vet. Zemra është një element i rëndësishëm i ndërgjegjes, e cila është një thesar potencial që u përfton kahje dhe kuptim mendjes, vetëdijes, ndjenjave dhe delikatesave, kurse shpirti është urdhëruesi i saj, nga i cili ajo merr fuqi. Sigurisht, edhe nëse njeriu të cilit nuk i është prishur krijimi dhe vetëdija e kryen detyrën e vet, nuk i lexon librat si dhe argumentet e shkruara në faqet e gjithësisë, *siç thonë edhe shumë mendimtarë*, prapëseprapë, ndërgjegjja që nuk di ç'është gënjeshtra, e gjen Zotin e vet dhe e njeh. Ndërkaq, ta pranosh ndërgjegjen brenda një organizmi të panjohur pa llogaritur shpirtin, është mungesë ndërgjegjeje dhe shpirti.

2. Një nga pikat ku njeriu veçohet nga kafshët është edhe konceptimi i kohës nga shpirti

Njëra nga pikat e shumta që e ndajnë njeriun nga bota e kafshëve, është lidhja e tij me të shkuarën dhe të ardhmen. Kafsha jeton vetëm me shijimin e çastit. Siç nuk preket nga ngjarjet e së kaluarës, kafsha nuk është e pajisur as me veçoritë për t'u mërzitur, për t'u shqetësuar, për t'u gëzuar, për të ushqyer qëllime e synime për të ardhmen dhe për të bërë plane rreth saj. Një njeri s'mund ta hiqni mënjanë qoftë edhe për t'i dhënë një shpullë, pa ia mbushur mendjen që të dalë mënjanë. Kurse kafshët nuk e dallojnë dot as vdekjen

që mund ta kenë nën hundë. A do të gjenit dot kafshë në thertore sikur ta kuptonin ato se ku po i çojnë? Në jetën tjetër, kafshët do të bëhen dhé sepse s'kanë asnjë përgjegjësi. Kjo do të thotë se, edhe nëse njerëzit u ngjajnë kafshëve nga qelizat, mes këtyre dy qenieve ka dallime të rëndësishme si ndërgjegjja, mendja, vetëdija dhe njohja. Si këto, edhe mendimi mbi pafundësinë, dëshira për t'u bërë i përjetshëm, frika nga asgjësimi dhe konceptimi i kohës si dhe ndikimi nga e kaluara dhe përjetimi i frikës dhe gëzimit për të ardhmen janë veçori njerëzore që nuk ndodhen te kafshët.

3. Ndjenja e përjetësisë dhe dëshira për të qenë i përjetshëm i përkasin shpirtit i cili është kandidat i përjetshmërisë

Ndjenja e përjetësisë dhe dëshira për të qenë i përjetshëm mund t'i përkasin vetëm shpirtit i cili është kandidat për të kaluar në përjetësi. Lënda e konsumueshme dhe e vdekshme kurrë nuk mund të bëhet burimi dhe mbështetja e mendimit mbi pafundësinë. A mund ta mbajnë këtë mendim telat e hollë elektrikë, rryma e tensionit të lartë? Në botën materiale nuk ka ndonjë model që të reflektojë në pasqyrën dhe mendimin e brendshëm të njeriut dëshirën për të jetuar pafundësisht dhe për të tharmuar tek ai një ndjenjë të tillë, që të thuhet se njeriu e mori prej atij modeli dëshirën për të jetuar pafundësisht. Atëherë. themi se, përtej qelizave të trupit të vdekshëm dhe atomeve të gjithësisë, është shpirti, i pasionuari i përjetësisë, ai që thotë kështu për të: *"I vdekshëm jam, vdekatarin s'e dua, i dobët jam, të dobëtin s'e dua; dua, një Mik të Pavdekshëm dua, një botë të përjetshme dua!"*

4. Ndërprerja e funksioneve jetësore dhe vdekja shkaktohen nga largimi i shpirtit prej trupit

Sytë e të vdekurit mund të jenë edhe të hapura, por pse nuk sheh? Pse s'kupton se ç'po bëni dhe pse s'ju jep përgjigje? Pse u shthurën ushtarët qeliza të garnizonit trup dhe pse nuk i kryejnë më detyrat e tyre? Përgjigjja është mjaft e thjeshtë: Sepse komandanti i braktisi dhe shkoi, dielli shpirt perëndoi, zogu iku nga kafazi-trup dhe fluturoi në pafundësi, miku kalimtar i shtëpisë prej mishi e kockash mblodhi plaçkat e doli për ta vazhduar rrugën e vet drejt pafundësisë... Shpirti mbetet shpirt, kurse trupi që qëndroi në këmbë për 60 vjet me radhë, as 60 ditë s'u bën dot ballë mikrobeve dhe kalbet! Më thoni o sytë e mi, më thuaj, o drita e syve të mi, pse s'm'i tregon qoftë edhe për disa minuta miqtë, librat dhe lulet e mia?

5. Shpëtim nga vdekja s'ka!

Njeriu që e quani të vdekur në bazë të rrahjeve të zemrës, mund të kthehet në jetë me anë të masazheve, të elektroshokut, të ilaçeve dhe aparateve të përsosura, por kjo s'do të thotë aspak rikthim në jetë i një njeriu të vdekur. Në kushte të tilla, edhe nëse disa funksione trupore duket sikur janë ndërprerë, njeriu nuk ka vdekur, sepse shpirti nuk është larguar ende prej trupit. Me gjuhën mjekësore, kësaj i thonë "vdekje klinike", prej së cilës njeriu mund të kthehet në jetë. Kjo mund të quhet gjendje kalimtare mes jetës dhe vdekjes. Por kur shpirti të jetë larguar prej trupit, ndodh vdekja e vërtetë dhe atëherë rikthimi në jetë është krejtësisht i pamundur!

6. Kujdesi që tregohet për të vdekurin, nuk është për kufomën që do të kalbet e tretet

Po qe se e marrim dhe e trajtojmë çështjen nga aspekti i të drejtës islame, veprimet e larjes, qefinosjes, faljes funerale dhe varrimit pasi shpirti ta ketë lënë trupin dhe njeriu të ketë vdekur me të vërtetë, ndenjja pa gjumë, vrapimet andej-këtej, qarjet dhe vajtimet, lajmërimet dhe ftesat, mbledhja e jashtëzakonshme e fqinjëve dhe farefisit, bartja e tabutit pa e tronditur, ngritja në këmbë në shenjë respekti kur kalon kufoma, të gjitha këto a mos janë për kufomën që do të kalbet e do të bëhet dhé? Vizitat në varre, këndimet nga Kurani, lutjet, fshehja si kujtim e disa gjërave të mbetura nga i vdekuri, fotografitë e varura në mure dhe

psherëtimat duke i vështruar ato, a mos janë për qelizat e shkrira në tokë qëkuri? Edhe në botën e mosbesuesve, madje, bëhen shumë veprime përkujtuese, si balsamosja, ngritja e busteve dhe përmendoreve dhe lënia e luleve para tyre me raste të ndryshme përkujtimore, përkulja ose përgjunjja para varreve, monumenteve dhe përmendoreve, a mos janë për ato mbeturina të dekompozuara? Prej nga vjen urdhri për veprim i shifrave gjenetike që e përfaqësojnë çdo gjallesë me tërë imtësinë e saj? Ç'është ajo që siguron dhe rregullon jetën dhe veprimtarinë e DNA-së, RNA-së dhe qelizave si dhe veprimtarinë e atomeve? Ndërsa të gjitha shkaqet dhe pretekstet lëndore-materiale janë gati, pse pas shumë e shumë kërkimesh pohohet se "qelizës nuk mund t'i jepet jetë"? A nuk janë ekzistenca e Allahut, jeta pas vdekjes dhe shpirti që do ta mbajë atë jetë, të vërteta të lidhura me njëra-tjetrën? A nuk janë e vërteta e shpirtit, ideja e ringjalljes dhe llogaridhënies, besimi se fajtori dhe viktima përkatësisht do të ndëshkohen dhe shpërblehen, një frenim, një disiplinë dhe shkak ekuilibri dhe lumturie në jetën shoqërore për fëmijët, të rinjtë, pleqtë, të sëmurët, të shëndoshët, shkurt, për çdo njeri që beson?

A nuk kemi ne të drejtë t'i themi kështu mohuesit: "Ta zëmë se s'ka ditë ringjalljeje dhe llogaridhënieje, ç'humbim ne duke besuar dhe ç'fiton ti duke mohuar? Ndërsa jemi ende në këtë botë, besimtari ka fituar vlera dhe virtyte morale e njerëzore, ka fituar lumturi, po ti, ç'ke fituar? Ç'mund të thuash për hallin tënd? Mirë, po të ketë ditë të llogaridhënies, pa mendo se ç'do të fitojmë ne e si do të jetë fundi yt!"

7. Pse shpirti është bërë i panjohur e i padukshëm?

a) Shpirti i cili mbështetet në emrin "i gjallë" të Allahut dhe, për rrjedhojë, është jetë dhe esencë e jetës, është krejtësisht i pavarur nga lidhjet shkak-pasojë dhe marrëdhëniet e kushtëzuara. Me urdhrin "bëhu!" dhe me frymën hyjnore, shpirti kalon nga bota e urdhrit, në botën e dëshmisë ku sundojnë shkaqet. Me aspektin engjëllor që ka shpirti, në paraekzistencën dhe themelin e ekzistencës së tij nuk ka ndonjë shkak material që ai të mund të shihet e të njihet nga njerëzit!

b) Shkaqet dhe kjo botë lëndore-materiale janë një pikë uji e dënuar me avullim mes brigjeve të para dhe pas amshueshmërisë. Natyra e kësaj bote përsa i përket kohës, është vetëm një hije, një vezullim mbi lumin që rrjedh pandërprerë dhe një iluzion optik në shkretëtirë. Në këto kushte, gjëja që mund të duket e njihet, është vetëm gjëja e të njëjtës natyrë, kurmi, kufoma, kurse të padukshmen dhe të panjohurën e përfaqëson vetëm e padukshmja dhe e panjohura...

c) Në këtë botë të ardhur nga botë të padukshme e të panjohura, sundon vazhdimisht një pirje për hollim, rrjedhje, avullim, transparencë dhe një orientim drejt së panjohurës... Drejt së panjohurës së njohur! Kur hekuri nxehet në temperatura të larta, shkrihet, fiton rrjedhshmëri dhe plasticitet. Duke u djegur, copërat e drurit bëhen flakë dhe karbon (qymyr). Uji është i rrjedhshëm e i tejdukshëm dhe ka për pirje të natyrshme të avullohet, pra, të lartësohet drejt së padukshmes. Në temperatura të ulëta të caktuara, uji ngrin, pra ngurtësohet dhe bëhet i patejdukshëm, por kjo nuk është pirja e tij. Po të zbrisni te atomet, përballë do t'ju dalë përsëri para, përtej grimcave lëndore, një energji që nuk do që të duket. Edhe ju, po të doni të lartësoheni, lartësoheni dhe, në zona të quajtura "vrimë e zezë" ngaqë në sytë përmes të cilave shihet fytyra njerëzore, ka errësirë, vëzhgoni një plasticitet. Për të përfituar nga rryma elektrike që nuk duket, por thotë "jam", ngrihen diga, ndërtohen hidrocentrale, ngulen shtylla dhe zgjaten tela. Është një goxha histori e jetës suaj e mbyllur, tashmë, në dimensionet shumë të vogla të qendrës së kujtesës në trurin tuaj! Dhe shpirti i padukshëm, me hedhjen e tij të fundit e më tërheqëse nga trampolina "vdekje", shkon në botën e padukshme ku ka për t'u dukur dhe ka për t'u bërë i përjetshëm.

Përfytyroni sikur një tel enigmash pa skaje është kaluar nëpër një skenë me qëllim për ta parë njerëzit dhe në të janë varur disa llamba. Një qenie elektrike ose të ngjashme me të e cila nuk duket dhe së cilës nuk

i dihet natyra, do ta shihni dhe njihni vetëm me anë të shfaqjes së saj në llambën elektrike. Mirëpo as nuk do të thoni dot "s'ekziston", as nuk do të thoni dot "ja, kjo është"!

8. Me argumentet që e vërtetojnë, shpirti argumenton Krijuesin e vet dhe lajmëron me zë të lartë se Ai ekziston!

Janë edhe shumë e shumë gjëra që ende nuk i kemi parashtruar, të cilat argumentojnë për shpirtin dhe e tregojnë të padukshmen. Po, me të gjitha argumentet mbi të, shpirti argumenton Krijuesin e vet, e pohon dhe e lajmëron Atë!

a) Ashtu siç ka nevojë trupi për një shpirt që t'i vërë në lëvizje dhe t'i drejtojë mekanizmat e tij, ashtu dhe çdo gjë në gjithësi ka nevojë për Allahun që t'i krijojë dhe drejtojë botën e ekzistencës dhe shpirtin. Çdo gjë që ekziston te njeriu, ekziston edhe në gjithësi.

b) Ashtu siç ka vetëm një shpirt në trup e jo dy, edhe Zoti ynë është një i vetëm, pa partner.

c) Në trup nuk ndonjë pjesë për të cilën të mund të thuhet "ky është vendi i shpirtit", por ai e bën të ndjehet kudo prania dhe veprimi i tij. Meqë nuk është i përbërë prej mishi e kockash, pra dhe nuk është i kufizuar nga dimensione materiale e kohore, shpirti mund ta lërë trupin e të ndodhet kudo që të dojë. Në mos qoftë i gabuar përngjasimi, edhe Zoti ndodhet kudo i gatshëm për të vepruar, por është i lirë prej kufizimeve të kohës dhe hapësirës.

ç) Përsa i përket vullnetit dhe fuqisë, njëshi me njëmijën, e largëta me të afërtën janë të barabarta. Dielli e tregon veten në të njëjtën kohë edhe në një copë qelqi, edhe në një mijë copa, dhe është po aq afër ndaj njërës sa ç'është afër ndaj të gjithave një për një dhe së bashku. Në të njëjtën mënyrë, edhe raporti i shpirtit ndaj një qelize është i njëjtë me raportin e tij ndaj triliona qelizave, raporti ndaj një gjymtyre është i njëjtë me raportin ndaj ço gjymtyre dhe të gjithave së bashku. Edhe Zoti ynë e administron çdo gjë dhe të gjitha gjërat si një gjë të vetme. Megjithëse ne jemi larg tij në distancë të pafundme, Ai është për ne më afër se damari i qafës që na rreh. Veçanërisht, na njeh më mirë se ç'e njohim ne veten!

d) Ashtu siç trupi di për çdo gjë që është dhe ndodh në trup dhe asgjë nuk mbetet e fshehtë prej tij, ashtu dhe Zoti – megjithëse përngjasimi nuk është i mirë – di çdo gjë dhe çdo gjë është e fiksuar në dijen e Tij!

dh) Ashtu siç është shpirti te trupi urdhëruesi dhe drejtuesi i organeve dhe gjymtyrëve që janë mjete për të bërë mirë dhe për të bërë keq, për të vrarë dhe për t'i përtëritur zemrat me anë të besimit, edhe krijuesi i të mirës dhe të keqes është Allahu.

e) Shpirti tregon se botët para dhe pas ekzistencës trupore të njeriut janë eternale (të pafillim dhe të pambarim), argumenton për Zotin si i Vërteti Eternal, ekzistenca e të cilit nuk ka fillim dhe fund.

ë) Shpirti nuk shihet me sy dhe nuk i njihet natyra. Po kështu, Allahu është përtej dhe i ndryshëm prej çdo gjëje që mund të shkojë në mend.

f) Përsosmëria e aftësive (kapaciteteve) të shpirtit dhe shfaqjet e tij në botën e dëshmisë të sjellin ndërmend emrat, atributet dhe shfaqjet e Zotit.

g) Meqë shpirti është e pamundur të shihet e të njihet se ç'natyrë ka, ne ia njohim qenien dhe ia pranojmë ekzistencën me anë të veprave.

9. Etapat që do të kalojë shpirti pas vdekjes

Meqë krijimi i njeriut ndryshon nga krijimi i kafshëve në entitet dhe veçori, edhe vdekja e njeriut është e ndryshme nga e kafshëve. Shpirtin e njerëzve e merr ose vetë engjëlli Azrail, ose ndihmësit e tij, shpirtrat e kafshëve i merr vetë Zoti. Profetëve u ka shkuar Azraili dhe shpesh i ka njoftuar që më parë. Kështu ka ndodhur me profetin Adem, me profetin Musa dhe me profetin Muhamed. Madje, siç pohohet në një

hadith autentik, engjëlli Azrail i ka kërkuar leje profetit Muhamed për të hyrë në dhomën e tij e për t'ia marrë shpirtin. Në rastet kur shpirtin nuk e merr Azraili, ose shkon një ndihmës i tij, ose në prani të tij, shpirtin e merr ndihmësi.

Fakti që çdo njeriu i dërgohet një engjëll i veçantë, tregon për respektin që i bëhet njeriut. Është një engjëll i ngarkuar me punë për çdo njeri për t'ia marrë shpirtin, sepse njeriu është krijesa më e nderuar, më fisnike dhe më e përkryer. Një individ njerëzor shihet si i njëvlershëm me të gjithë individët e një lloji tjetër gjallesash. Ndërsa është një lloj, njeriu ka vlerë sa të gjitha llojet dhe çdo njeri jeton me kaderin, fatin e vet të paracaktuar. Njeriu ka një libër të veçantë dhe 360 engjëj të ngarkuar me punë. Meqë njeriu, krahas të gjitha gjërave për të cilat është parë i merituar, bart edhe një shpirt të lartë kandidat për në përjetësi, vdes në emër të jete të pasosur që i shtrohet para gjer në pafundësi... Si një përfundim i përputhshëm me këtë entitet dhe pozitë të tij të posaçme, shpirti i merret personalisht nga Azraili ose nga një engjëll i ngarkuar me punë.

Kurse për kafshët, siç u tha më lart, jepet një konkluzion i thjeshtë e i përgjithshëm dhe shpirtrat e tyre i merr Zoti drejtpërdrejt. Sepse kafshët, jo vetëm që s'janë përgjegjës si njerëzit, por nuk kanë as mendje, vetëdije, njohje dhe një shpirt që të ketë lidhje me përjetësinë. Ata nuk do të jetojnë jetë të amshuar në botën tjetër (ahiret) dhe, edhe nëse ringjallen përkohësisht se ashtu e do drejtësia hyjnore, për ta si individë nuk do të ketë xhehenem dhe xhenet. Vetëm qeni Kitmir i As'habi Kehfit, shokëve të shpellës, deveja e profetit Salih, zogu korrier i profetit Sulejman dhe trungu i hurmës ku qe mbështetur profeti Muhamed do të hyjnë në xhenet ku do të përfaqësojnë llojet e veta.

10. Si merren shpirtrat?

Njeriu që e krahason engjëllin me veten, nuk mundet ta kuptojë veprimin e engjëllit me anë të fuqisë së vullnetit të vet të kufizuar. Me cilësinë si qenie shpirtërore, engjëjt nuk janë të kufizuar nga koha dhe hapësira, kështu që mund të shëmbëllehen në të njëjtin çast në shumë vende. Kjo është si shëmbëllimi i njeriut që hyn në një dhomë ku ka me qindra pasqyra, në të gjitha pasqyrat. Kështu është edhe marrja nga Azraili e më shumë se një shpirti në të njëjtën kohë.

Është vetë Allahu që e vdes njeriun. Por që shëmtia e fytyrës së vdekjes të mos i dedikohet Allahut, për rrjedhojë, të mos u jepet shkak mendimeve të pakëndshme mbi Individualitetin e Shenjtë, Allahu e ka maskuar veprimin e Tij me anë të Azrailit.

Në çastin e vdekjes, secili hyn në kontakt me Azrailin. Sapo të shfaqet ndonjë sëmundje, fatkeqësi, aksident, shkurt, ndonjë shkak, menjëherë hyhet në lidhje me Azrailin. Prandaj s'është nevoja të kërkohet. Ta zëmë se përgatitet një aparat (stacion) që emeton valë me frekuenca të ndryshme dhe, me një buton, të emetojë valë në frekuencën 1000 herc. Kështu, në të njëjtin çast, me të do të hynin në rezonancë të gjithë aparatet marrës që punojnë në frekuencën 1000 herc. Një lehtësi e tillë ekziston në veprimtarinë e Allahut. Kjo është njëlloj me vënien në lëvizje të një mijë ushtarëve me një urdhër ose të reflektimit të diellit në një mijë pasqyra. Kështu, të gjithë njerëzit që ndodhen në një çast në të njëjtën frekuencë të vdekjes, e japin shpirtin sapo që Azraili të "transmetojë frekuencën përkatëse". Krejt si shuarja në një çast e qindra llambave elektrike me shtypjen e butonit të çelësit të vetëm që i komandon.

11. Si duket engjëlli në çastin e vdekjes?

Çdo njeri ka një nivel dhe pozitë të caktuar, të posaçme vetëm për të. Pozita në fjalë fitohet me të mirat dhe të këqijat. Pikërisht në atë pozitë takohet njeriu me Azrailin. Në çastin e vdekjes së një njeriu të mirë, atë e rrethojnë një sërë engjëjsh me pamje të qeshura dhe qëndrime shpresëdhënëse. Pastaj duket zotëria i atyre engjëjve, i përcjell njeriut përshëndetjen e Allahut dhe i thotë se ka për t'ia marrë shpirtin. Shpirti i mirë merret me të mirë.

Kurse në çastet e agonisë së një njeriu të keq, mëkatar e të ndyrë, engjëjt vijnë me pamje dhe qëndrim të pakëndshëm, tronditës, frikësues dhe tmerrues. Me t'i parë ata, njeriu në agoni tmerrohet. Pastaj vjen Azraili me një pamje që përhap tmerr, i ulet te kryet dhe e trajton sipas botës së tij të brendshme.

12. Si hiqet shpirti prej trupit dhe si merret?

Në agoni, çdo njeri ndjen diçka të veçantë dhe, meqë askush nuk ka gjetur dot mundësinë për ta shprehur atë që ka ndjerë, gjer tani nuk ka qenë e mundur të mësohet se ç'ndjehet. Megjithëkëtë, disa gjëra të përgjithshme mund të thuhen.

Ata që kanë jetuar si njerëz të mirë, ndjejnë gjëra të mira, kurse ata që kanë jetuar si njerëz të këqij, ndjejnë gjëra të këqija. Ai që ka jetuar si njeri i mirë, shkon duke vëzhguar gjëra të mira e të bukura dhe duke buzëqeshur. Ndërsa shpirti ndahet e shkon, kurmi që lë pas, buzëqesh. Si fëmija i cili po bëhet synet që nuk kupton gjë se i kanë futur në gojë një llokum, kur u merren shpirtrat profetëve dhe dëshmorëve, hapen dritaret e xhenetit, parajsës, dhe, sipas shprehjes së Profetit, shpirtrat e tyre dalin me lehtësi siç rrjedh uji nga shtamba dhe, ndërsa shpirti u del, trupi u gëzohet dhe u buzëqesh duke soditur vendin ku do të shkojnë. Për njeriun e mirë, vdekja nuk është aspak e tillë siç kihet frikë, përkundrazi, është shumë e ëmbël dhe e shijshme, po ashtu dhe ç'vjen pas saj...

Profeti i tha kështu Xhabirit për të atin, Abdullah ibni Amr që ra dëshmor në Uhud: A e di se si e priti Allahu tët atë? Në një mënyrë që nuk përshkruhet. Në një mënyrë që as sytë s'e kanë parë, as veshët s'e kanë dëgjuar, as ndonjë njeri s'e ka kujtuar! Yt atë tha: Zoti ynë, më kthe në botë që t'ua tregoj edhe atyre që kanë mbetur pas harenë e kësaj vdekjeje të ëmbël!" Por Allahu i tha: "Tani s'ka të kthyer më pas! Atje një herë shkohet dhe mbaron. Por Unë u tregoj atyre për gjendjen tuaj!" Pastaj zbriti ky ajet:

"Mos i pandeh të vdekur ata që kanë rënë në rrugën e Allahut! Ata janë të gjallë dhe po shpërblehen pranë Zotit të tyre!" (Al Imran, 169)

Ky është, pa dyshim, një sihariq për të gjithë ata që bien dëshmorë në rrugën e Allahut.

Në prag të vdekjes, secilit që i shkonte pranë, Profeti i thoshte: *"Namaz, namaz!.."*. Edhe Hz. Omeri vdiq duke thënë, si ai, *"Namaz, namaz!.."* Në çastet e vdekjes, Halid b. Velidi rënkonte: *"Kali im, shpata ime... sillmini t'i shoh edhe një herë!.."* Hz. Osmani vritej duke kënduar Kuran, kurse Hz. Aliu, duke shkuar në xhami... Në kundërshtim me këtë, shumë vetë jepnin frymën e fundit në tavolinën e pijes, duke luajtur bixhoz, në folenë e prostitutave... Po, siç kishin jetuar, ashtu vdisnin!

Shpirtrat e faraonizuar tërhiqen si fijet e zëna nëpër ferra. Ndërsa dublantët i lënë dhe ikin, pas lënë dëshpërim dhe fytyra të thartuara. Engjëjt i marrin me shumë mundim shpirtrat e tyre. Shpirtrat e tyre shkëputen me shumë vështirësi nga trupi, siç shkëputet pambuku i zënë në ferra!

13. Ç'ndjejnë kafshët duke ngordhur?

Meqë nuk janë të përgjegjshëm dhe përgjegjës si njerëzit, kafshët ndoshta nuk ndjejnë dhimbje fare kur u merret shpirti. Kundërveprimi që tregojnë është muskulor, nervor dhe, mbase, shprehje e një gjendjeje që ne s'e kemi shijuar. Kush e di, mbase në atë përpëlitje ndjejnë një kënaqësi që është e posaçme vetëm për botën e tyre. Meqë është vendi, le të përmendim një mendësi dhe praktikë të vendeve evropiane.

Siç dihet, perëndimorët nuk i therin kafshët si myslimanët; ose i vrasin me goditje elektrike, ose duke i shpuar me hell në fyt. Nuk e dimë nëse edhe kjo mënyrë therjeje është shprehje e kundërvënies së tyre kryeneçe ndaj myslimanëve! Në lidhje me këtë, ata përligjen dhe mbrohen kështu: "Kafsha që theret sipas mënyrës suaj, ndjen dhimbje dhe kundërvepron. Ne veprojmë kështu që kafsha të mos ndjejë dhimbje." Mirëpo ata nuk e kuptojnë një të vërtetë. Para së gjithash, gjaku, i cili pranohet edhe nga shkencëtarët se

është i dëmshëm, derdhet plotësisht nga trupi nën ndikimin dhe shtytjen e kundërveprimit muskulor dhe fizik që bën kafsha e therur duke iu prerë enët e gjakut. Kurse gjaku i mbetur në trup të kafshës së therur me goditje, kalon edhe në trupin e ngrënësit, kurse ne e kemi të ndaluar (haram) edhe ngrënien e një pike gjaku si dhe të falemi me rrobë të spërkatur me gjak. Ashtu siç u ndalua më 1989 në Angli shitja e veshkave, do të vijë një ditë që edhe ata do ta kuptojnë çështjen dhe do të kthehen në mendësinë dhe praktikën tonë.

E dyta, na thonë se, me therje, vdekja e kafshës zgjat, kafsha kundërvepron dhe vuan për rreth 15-20 minuta. Po ku e dinë ata se kafsha ndjen dhimbje dhe vuan?

Nuk është kusht që çdo kundërveprim të bëhet për shkak dhimbjeje. Siç u përmend edhe më lart, situata e vëzhguar te kafsha e therur përbëhet krejtësisht prej kundërveprimesh nervore dhe muskulare. Gjithashtu, ku e di ai që s'është kafshë se kafsha ndjen dhimbje dhe vuan? A mos vallë çdo gjë është ajo që sheh ti me sy dhe siç e sheh ti me sy?

E treta, te çdo qenie e gjallë në gjithësi ka një prirje dhe dëshirë të vazhdueshme për t'u ngjitur në një gradë më të lartë. Bimët *pothuajse bëjnë garë që t'i hanë kafshët dhe njerëzit dhe, kështu, t'u lartësohet grada e jetës*. Edhe kafshët *bëjnë garë sikur të donin që, duke kaluar në trupin e njeriut, ta vazhdonin jetën në një trup të vetëdijshëm dhe kandidat për t'u bërë i përjetshëm*. Sigurisht, te kafshët nuk ka mendje, vetëdije dhe njohje, por edhe kafshët bëjnë sipas ligjeve të Ligjvënësit të Lartë. Në është kështu, lini kafshët po shihni njerëzit se si përpëliten nga gëzimi se po u shkojnë miq!..

E katërta, ndoshta kafsha përpëlitet si shprehje e një kënaqësie që është e posaçme për botën e vet. Le ta nënvizojmë këtu këtë ide: Si njeri i dorëzuar te Zoti, myslimani sakrifikon çdo gjë në rrugën e Allahut dhe bie dëshmor. Ndërkaq, të rënët dëshmor është një lloj flijimi. Ashtu siç e shprehëm edhe më lart, dëshmorët ndjejnë një kënaqësi krejt të veçantë që po bëhen fli, por, në dukje, edhe ata përpëliten, kurse e vërteta qëndron ndryshe. Po qe se për kafshën e dërguar me dorën e engjëllit për t'u flijuar në vend të robit të shquar të Zotit, Ismailit (a.s), themi se është dëshmore e botës së kafshëve dhe se *nuk ndjen dhimbje e nuk vuan, por, ndoshta, ndjen një kënaqësi të veçantë*, gjithsesi gjykojmë dhe mbajmë një qëndrim më afër të vërtetës. Fundja, ne kurbanin (flijimin) e bëjmë për adhurim!

14. Ç'ndodh me shpirtin pas vdekjes së njeriut?

Pas vdekjes së njeriut, shpirti ngjitet gjer te Zoti. Sipas deklaratës së Profetit, pas daljes së shpirtit, engjëjt e mbështjellin me një copë atllas dhe e çojnë gjer në kuvendin e engjëjve të lartë. Në çdo shtresë dhe nivel, pyesin se kush është shpirti që po e çojnë dhe engjëjt e bëjnë të njohur atë me cilësitë më të mira me të cilat është njohur në botë. Më në fund, shpirtin e ngjisin mbi qiejt, në Audiencën e Zotit të Botëve. Zoti e pranon në audiencë dhe pastaj i porosit engjëjt: "Çojeni prapë në varr dhe vendoseni në kokë të kufomës që të jetë gati për t'iu përgjigjur pyetjeve!" Dhe engjëjt ashtu veprojnë. Pastaj ai fillon t'u përgjigjet pyetjeve: Kush është Zoti yt? Kush është profeti yt? Cila është feja jote?..

Kurse shpirti i njeriut të keq pritet kudo keq. Ai kujtohet në qiell me neveri. Ai hidhet nga Audienca e Lartë me kokë poshtë. Ai nuk është në gjendje t'u përgjigjet engjëjve Munker dhe Nekir, sepse në këtë botë e ka kaluar kohën me gjëra të panevojshme. Dhe kështu ai heq vuajtje të ndryshme gjer në kiamet.

Në varr ka marrje në pyetje, ka shtrëngim, por llogaridhënia e vërtetë bëhet në Gjykatën e Madhe. Sipas shprehjes së hadithit, varri të zë ngushtë, të shtrëngon, por llogaridhënia e vërtetë do të bëhet pas ringjalljes dhe grumbullimit. Do të ngrihet Peshorja, do të shpërndahen librat e llogarive, do të kalohet Sirati dhe pastaj do të bëhet një bartje e gëzueshme dhe e frikshme për në xhenet dhe xhehenem.

Varri është, në të njëjtën kohë, vendi ku bëhet llogaria dhe pastrimi i disa mëkateve të papastruara në botë. Krahas krimeve dhe fajeve të mëdha që i lihen Ditës së Llogarisë, një pjesë e mëkateve dhe njollave të konsideruara si të parëndësishme, lahen në kohën e varrit.

Analistët, duke u mbështetur në Kuran dhe Sunet, thonë kështu: Një pjesë e të metave dhe gabimeve të njerëzve që kanë edhe mëkate të vogla krahas mëkateve të mëdha, pastrohen qysh në këtë botë me anë të shqetësimeve, sëmundjeve dhe fatkeqësive të vuajtura. Një pjesë tjetër mëkatesh shlyhen në çastin e vdekjes dhe pjesa tjetër, për të mos iu lënë Gjykatës së Madhe, kur është e mundur një gjë e tillë, kalojnë nëpër një proces të tretë pastrimi në varr. Mëkatet e mëdha e të fryra që nuk mund të pastrohen në varr, do të pastrohen në të ardhmen në sheshin e grumbullimit pas ringjalljes, pranë Peshores, në Sirat e, më në fund, në xhehenem.

Siç mësojmë nga disa hadithe, me gjithë dëshirën e madhe, Hz. Abasi mundi ta shihte Hz. Omerin në ëndërr vetëm gjashtë muaj pas vdekjes dhe e pyeti: *"Ku ishe, o Omer?" "Mos pyet!"* – Iu përgjigj Omeri. *"Sapo munda ta mbaroj dhënien e llogarisë!"* Ndoshta Zoti e ka trajtuar kështu atë që të mos i mbetej sipër as dhe shenja më e vogël. Shtrëngesa dhe vuajtja e varrit luajnë një rol të madh për pastrimin e gabimeve dhe mëkateve të vogla. Një ilaç i hidhur, por që pasohet nga shërimi i xhenetit.

Shtrëngimin e varrit e shohim edhe te Sad b. Muadh, një sahabi, shok i Profetit, dhe njeri me nivel të lartë shpirtëror. Sipas burimeve të haditheve autentike, pasi e varrosën Sad b. Muadhin, Profeti tha: *"I madhëruar qoftë Allahu, në e shtrëngoftë varri edhe Sad b. Muadhin!.."* Domethënë se nuk ka njeri që të mos e shtrëngojë varri!

15. Ç'bën shpirti në botën e pritjes?

Duke lënë një lidhje me varret ku u ndodhen kufomat, shpirtrat shkojnë në Berzah që është pjesë e botës së varrit dhe një botë e ndërmjetme para ringjalljes dhe gjykimit të fundit, një sallon pritjeje. Pas varrimit të kufomës, shpirtrat përballen me një sërë shëmbëllimesh dhe pasazhesh. Punët që kanë bërë në këtë botë u dalin para në formë shëmbëllimesh a pasazhesh. Namazet, këndimet e Kuranit, shërbimet në rrugën e Allahut, tesbihet, etj., i gjejnë atje si shokë të afërt, si miq të gëzuar. Atje u hapen dritare që shohin në xhenet dhe, nëpërmjet tyre, u shpalosen parasysh peizazhet më të bukura e më të hijshme. Kurse shpirtrave që kanë jetuar në këtë botë si njerëz të këqij, që kanë bërë punë të këqija e të shëmtuara, u paraqiten shëmbëllime dhe pasazhe të këqija e të shëmtuara dhe u tregohet xhehenemi. Ndërsa disa dëshirojnë të shpërthejë kiameti një çast e më parë, disa të tjerë dëshirojnë të mos shpërthejë kurrë. Vetëm Allahu e di se sa do të qëndrojnë shpirtrat në botën e pritjes pas shpërthimit të kiametit.

Shpirtrat e vendosur në pritje në Berzah, mund të na dëgjojnë ne, kurse ne s'mund t'i dëgjojmë. Po të mos dojë Allahu, as ata s'mund të na dëgjojnë dhe, po të dojë, edhe ne mund t'i dëgjojmë. Ka njerëz me nivel të lartë shpirtëror që kanë dalluar se ç'ndodh në varre. Pas mbarimit të luftës së Bedrit, Profeti qe afruar në buzë të gropës ku qenë hedhur kufomat e politeistëve dhe pati thënë: *"A i patë gjërat që ju pati premtuar Allahu?"*

Ka nga ata njerëz të lartë që kanë hyrë në lidhje me shpirtrat e botës së ndërmjetme. Muhjidin Arabiu bën fjalë për faktin se ka hyrë shpesh në lidhje me shpirtrat e lartë. Imam Sujutiu tregon se është takuar 70 herë zgjuar me Profetin, kurse Ahmed Rufai tregon se ka pasur nderin të hyjë në lidhje me shpirtin e Profetit. Tregohet se Imam Buhariu, pasi merrte abdes dhe falte namaz, ia parashtronte Profetit me rrugën e meditimit dhe përqendrimit të lartë vërtetësinë apo jo të rivajeteve të haditheve. Takimi nëpërmjet ëndrrave e thamë që është i mundur. Sa për shpirtrat e këqij, njerëzit e mirë të këtushëm s'kanë përse të takohen me ta!

Meqë nga një aspekt, shpirtrat i kanë të lidhura këmbët me një farë lloj zinxhiri shpirtëror, nuk mund të kthehen më në botë. Prandaj, në seancat e thirrjes së shpirtrave, nuk vijnë shpirtrat, por xhindet ose djajtë. Ndërkaq, ndërsa shpirtrat e këqij absolutisht nuk mund të vijnë, shpirtrat e mirë mund të shëtisin në çdo kohë nëpër botë, mund të ndjekin zhvillimet fetare dhe mund t'i vazhdojnë lidhjet me varret.

Hadithet profetike i ftojnë myslimanët të tregohen të ndjeshëm e të kujdesshëm ndaj varreve dhe atyre që ndodhen në varre. Veçanërisht sot është edhe opinioni i parapsikologjisë se shpirtrat mbajnë lidhje me atomet e kufomave të tyre, për çka i vizitojnë varret herë pas here. Prandaj, ndërhyrjet në varrin e një shpirti të shquar e të shenjtë që i vazhdon lidhjet me kufomën e vet, sidomos ndërtimi mbi varre i ndërtesave të ndryshme dhe kryerjes së mëkateve në to, e shqetësojnë rëndë dhe, në një kuptim, e përdhunojnë atë. Shpesh dhe në vende të ndryshme njerëzit janë bërë dëshmitarë të ngjarjeve që e mbështesin këtë opinion. Për shembull, diku, në mes të një qyteti, gjatë hapjes së një trualli për ndërtim ose diçka tjetër, buldozeri nuk ka mundur ta shkulë një varr. Njerëzit kanë parë me sytë e tyre se si ka ngecur në vend buldozeri pa mundur t'ia arrijë qëllimit.

16. A mund të mbeten gjallë disa organe ose gjymtyrë pas vdekjes së njeriut dhe ndarjes të shpirtit nga trupi?

Pasi shpirti i cili ka lidhje të drejtpërdrejta me secilin prej qelizave që përbëjnë trupin që i ngjet një kolonie gjigande ose një shteti, i cili i drejton dhe urdhëron ato, pasi shpirti, pra, ndahet dhe largohet nga trupi, një sërë qelizash munden ta vazhdojnë jetën përkohësisht. Nëse disa qeliza trunore mund të qëndrojnë pa vdekur e pa ndryshuar edhe 50-150 orë të tjera, është mjaft e mundur që gjatë kësaj kohe të merren nga truri disa sinjale, lajme dhe mesazhe në "gjuhën" e tij. Ka vite që bëhen studime në këtë fushë veçanërisht për të zbuluar autorët e disa krimeve. Po qe se do të arrihet të ndërtohen aparate elektronike që do të mund të kapnin sinjalet e qelizave ende të gjalla, të zbërthenin kuptimin e tyre dhe, me këtë rrugë të përcaktohej autori i krimit, atëherë do të arrihej afër enigmës së ajetit të kapitullit Bekare të Kuranit (Bekare, 73) që tregon se si, në kohën e profetit Musa, i vrari ngjallet dhe tregon se kush është vrasësi i tij.

17. A do të ringjallet edhe kufoma së bashku me shpirtin?

Më parë le ta sqarojmë këtë specifikë se lidhjet dhe marrëdhëniet e shpirtit me trupin ose kufomën janë cilësisht të ndryshme në botë të ndryshme; të tjera në këtë botë, të tjera në varr, të tjera në botën e pritjes dhe të tjera në jetën e pasosur pas ringjalljes. Në këtë botë ne bëhemi dëshmitarë të një lidhjeje dhe marrëdhënieje shpirt-trup nën ndikimin e realitetit tonë lëndësor dhe material.

Shumë shkencëtarë bëjnë fjalë për grimcat (molekulat) esenciale dhe themelore te njeriu. Është e pamundur që të përcaktohet se ku ndodhen grimcat (molekulat) e para të njeriut që, në hadithin profetik, emërtohen si kërbisht. Allahu e ka ngritur njeriun mbi këto molekula themelore dhe me to do ta ringjallë dhe do ta grumbullojë në sheshin e grumbullimit pas kiametit dhe ringjalljes. Këto molekula që përmbajnë veçoritë e njeriut, ndoshta mund të jenë gjenet. Po qe kështu, gjenet e një njeriu mund të mbushin a mund të mos mbushin një gishtëz rrobaqepësi. Ndërkaq, po qe se një gjë kaq e pakët ndjen dhimbje kur hyn në lidhje me shpirtin, gjithsesi do të ndjejë edhe kënaqësi. Ka mundësi që gjatë ringjalljes dhe grumbullimit dhe në botët e mëpastajme, jo të gjitha molekulat e njeriut, por vetëm këto molekula esenciale e themelore që përfaqësojnë veten dhe identitetin e tij, do të krijojnë lidhje me shpirtin dhe, siç kanë theksuar shumica, me favorin e Allahut, së bashku me molekula të tjera të marra andej-këtej si molekulat e frutave e të tokës si dhe me molekula të tjera që kanë bërë shërbime në këtë botë, do ta përfaqësojnë anën lëndore e materiale të njeriut. Jo vetëm nuk ka asnjë pengesë që të ndodhë kështu, por mendoj se kjo është edhe më e arsyeshmja. Kurse molekulat e tjera, duke u mbledhur përreth molekulave esenciale sipas kushteve të asaj bote, mund ta përbëjnë trupin e njeriut.

18. Kush e vuan ndëshkimin e xhehenemit, shpirti apo trupi?

Ndërsa disa filozofë, mistikë dhe krishterë thonë se vetëm shpirti do të vuajë, ne, sunitë, siç besojmë se bashkë me shpirtin do të ringjallet edhe trupi, ashtu edhe besojmë se bashkë me shpirtin do të vuajë edhe trupi. Sepse puna e shpirtit me trupin është si puna e qorrit me topallin. Qorri e merr në shpinë topallin, kurse topalli i tregon rrugën qorrit dhe, kështu, së bashku, arrijnë të shkojnë atje ku duan! Si në këtë botë, ashtu dhe pas ringjalljes, shpirti me trupin i ndajnë së bashku vuajtjet dhe kënaqësitë. Fundja, ajetet dhe hadithet bëjnë fjalë qartë edhe për ndëshkimin dhe vuajtjet që do të heqin, edhe për kënaqësitë që do të shijojnë kurmi dhe gjymtyrët. Si mund të bëhet fjalë për përfitimet nga të mirat pa menduar një trup gjithsesi të përshtatshëm për jetën e botës së pasringjalljes? Pastaj, Allahu që ka krijuar, së bashku me shpirtin, edhe atomet e kurmit tonë, do të na e ringjallë kurmin së bashku me shpirtin dhe ose do të na ndëshkojë, ose do të na shpërblejë. Fuqia dhe dituria janë të Tij, Ai bën si të dëshirojë! Njeriu do ta mësojë të vërtetën e çdo çështjeje kur të shkojë në atë botë dhe të përballet me surprizat e atjeshme, sepse as syri ka parë, as veshi ka dëgjuar dhe as imagjinata s'ka përfytyruar dot se ç'ka atje!

19. Cilat janë dhuratat më të mëdha që mund t'u dërgojmë shpirtrave pas vdekjes?

Para së gjithash, shpirti i cili emigron nga bota, do t'i çojë vetë pothuaj të gjitha dhuratat e gjërat që do t'i duhen në atë botë. Si një rregull hyjnor, çdo frymë do ta gjejë gati atje atë që ka fituar këtu. Ashtu siç kërkohen në këtë botë pasaporta dhe viza për të kaluar nga një vend në tjetrin, ashtu dhe në atë botë, nga varri e gjer te dyert e xhenetit, parajsës, do të kërkohen "pasaportat dhe vizat" përkatëse që janë jo forma dhe trajta materiale, por besimi në zemër dhe puna e mirë. Veçanërisht, për të hyrë në kuadrin e shefatit, ndërhyrjes profetike për falje, do të duhen shenja të posaçme të fytyrës që shprehin botën e brendshme. Shkurt, i shkuari atje do të trajtohet sipas gjërave që ka çuar atje. Ndërkaq, janë tri dritare ose kalime nga të cilat mund të përfitohet.

a) Lënia pas e mirësive me veprim të vazhdueshëm si rrugë, ura, xhami, çezma, vakëfe, konvikte, kopshte, shkolla, etj., të cilat të kryejnë vetëm shërbime të mira. Në lidhje me to, Profeti ka theksuar se, për sa kohë të veprojnë ato, një pjesë e të mirave të fituara nga njerëzit që kanë përfituar prej tyre, do të shënohen në librin e punëve të atyre që i kanë ndërtuar.

b) Edhe veprat e lëna nga njerëzit e dijes janë mirësi me veprim të vazhdueshëm. Sipas kapacitetit shkencor përkatës, autori do të marrë për to shpërblimin përkatës. Veçanërisht mbështetja e njerëzve të dijes dhe shkencës, mbrojtja e tyre, kujdesi për brezin që ecën në rrugën e dijes së vërtetë, nën këmbët e të cilëve hapin krahët engjëjt dhe përpjekjet për t'u siguruar atyre libra, fletore, ushqime e veshmbathje, mund të konsiderohen kalime që s'mbyllen dhe mirësi me veprim të vazhdueshëm.

c) Shpirti që ikën kërkon bij të dobishëm e të bekuar që, pas tij, do të bënin të mira dhe do të përgatisnin breza të dobishëm e të bekuar. Allahu jua ka përgatitur botën e fëmijëve tuaj. Po qe se edhe ju do t'u dilni për zot atyre, do t'u shërbeni dhe do t'i rrisni e përgatisni me kujdes, do të thotë se keni lënë pas bij dhe breza të dobishëm e të bekuar. Vetëm bij dhe breza të tillë do të jenë të dobishëm për ju në atë botë. Këtë pret prej jush shpirti që shkon, jo hallvë e gostira, jo të shtata, të dyzeta, gjashtë muaj e motmote, jo mevlude dhe hatme me para, jo varre për t'u dukur e fotografi të vjetra të varura aty-këtu! Po të jesh i sinqertë, vizitoji në varret, lutu për ta për mëshirë, falje e paqe dhe qaj, por mos harro t'u çosh dhurata nga ato për të cilat ata kanë nevojë!..

VII. VEÇORITË E ENGJËJVE, XHINDËVE DHE DJAJVE

1. Veçoritë e engjëjve

Të krijuar prej drite, në natyrën e tyre duket se drita është bazë. Engjëlloritet do të thotë mision profetik (këshillues, paralajmërues), përfaqësim, kujdestari, vëzhgim, dorëzanësí, roje mbi një punë dhe miratim i saj, zbritje prej një lartësie, etj. Në kuptimin absolut të fjalës, engjëjt janë grupi i përfaqësuesve shumë të shenjtë hyjnorë që krijon lidhje midis botës së madhe (hyjnore) dhe botës së vogël (materiale), që kryen detyra përfaqësimi, që sjell lajme, që na e përkëdhel dhe na e formëson zemrën (ndjesitë), etj. Me fytyrën të orientuar kah bota tjetër dhe të ngarkuar më shumë me detyra të botës tjetër, engjëjt vëzhgojnë dhe duartrokasin veprimtarinë e Zotit në të dy botët.

Engjëjt nuk i përkasin vetëm botës tjetër; ata kanë edhe trupa prej drite të posaçëm për vete, por që janë prej drite dhe të tejdukshëm. Prandaj, cilësia e tyre përshkuese e vepruese është tejet e shpejtë dhe e përsosur. Ata zënë vend brenda ninëzës së syrit, i japin mundësi të shohë dhe i tregojnë gjëra të bukura. Ata hyjnë në zemrën e profetëve dhe njerëzve të urtë me kuptime të veçanta dhe, në botën e bimëve dhe kafshëve, me kuptime të veçanta. Frymëzimet që lindin në zemër, janë, në përgjithësi, drejtpërdrejt nga Zoti, disa herë, edhe nëpërmjet engjëjve.

Engjëjt *"nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut; ata bëjnë ashtu siç urdhërohen"* (Tahrim, 6). Kjo është një cilësi dhe një status i posaçëm për engjëjt. Njeriu kurrë nuk mund të bëhet si engjëjt. Në qëndrimin e tij duken ngjitje-zbritje dhe zigzage të vazhdueshme. Ndërkaq, njeriu, siç mund të fitojë një cilësi engjëllore, mbiengjëllore, edhe mund të bjerë nën nivelin e krijesave të paarsyeshme e të pavetëdijshme. Kurse pozita e engjëjve është e fiksuar. Meqë janë të krijuar prej drite, tek ta kurrë dhe në asnjë mënyrë nuk shfaqet kundërshtim dhe revoltë siç ndodh me njerëzit dhe xhindet. Engjëjt nuk kanë seks. Engjëjt nuk i kanë ndjenjat e këqija të zemërimit, furisë, urrejtjes, zilisë, smirës, etj. Gjithashtu, te ata nuk vihen re të metat që vihen re te njerëzit dhe xhindet. Ata janë të pafajshëm dhe të mbrojtur nga gabimet, të metat, fajet dhe mëkatet.

Engjëjt nuk hanë, nuk pinë, nuk uriten, nuk eten, nuk lodhen. Ata nuk i njohin këto ndijime. Ata nuk marrin shpërblim për punë, por në çdo urdhër të kryer në emër të Zotit ndjejnë një ëndje të hollë dhe një shije të këndshme. Megjithëse s'kanë kualifikim dhe grada, begatohen sipas gradës së adhurimeve që i bëjnë Zotit. Ashtu siç ushqehen njerëzit me ujë, ajër, dritë dhe ushqime të ndryshme, ashtu dhe engjëjt mbahen, ushqehen me adhurimet, afërsinë dhe dashurinë ndaj Zotit. Erërat e mira, aromat e këndshme e parfumore janë një lloj ushqimi për ta. Atyre u pëlqejnë aromat e këndshme dhe ndjejnë kënaqësi prej tyre. Me këtë rast le të kujtojmë se edhe i dërguari i Allahut, profeti Muhamed (s.a.s.) që e përfaqësonte natyrën e pastër në nivelin më të lartë, kënaqej nga erërat e mira, parfumore, dhe lyhej me to.

Engjëjt e kuptojnë më mirë se njerëzit individualitetin e lartë të Zotit dhe i njohin më mirë se ata emrat dhe atributet e Zotit. Por Zoti e ka krijuar njeriun më të përsosur se engjëjt si pasqyrë përgjithësuese të emrave dhe atributeve hyjnore, si botë ndjesore dhe jetë meditative.

Ne i njohim disa engjëj nga emrat dhe punët që bëjnë. Informacionin për ta e marrim edhe nga Kurani, edhe nga hadithet, porositë profetike. Kurse disa engjëj i njohim vetëm nga lloji i detyrës që kryejnë dhe nga titulli që u është dhënë të gjithëve bashkë. Por meqë rreth kësaj çështjeje për ta nuk ka ndonjë rrëfim, ne nuk njohim hollësi për emrat dhe zakonet e tyre.

Ne i njohim katër engjëjt e mëdhenj, Xhebrailin (a.s.), Mikailin (a.s.), Israfilin (a.s.) dhe Azrailin (a.s.), por nuk i njohim tetë engjëjt bartës të Arshit.

Veç katër engjëjve të mëdhenj njohim edhe engjëjt kerubinë, engjëjt muhejminë, vëzhguesin e xhenetit, Ridvanin, dhe rojen e xhehenemit, Malikun.

Njohim edhe engjëjt "kiramen katibin" që interesohen për gjendjen e fetusit njerëzor, që shënojnë fjalët dhe sjelljet e çdo njeriu. Nga ana tjetër, siç thuhet në hadithet, porositë profetike, çdo besimtar ka 360 engjëj që e mbrojnë. Këta mbrojnë veçanërisht fëmijët dhe pleqtë. Ka engjëj që i tregojnë njeriut të mirën dhe dobinë, që luten dhe bëjnë pendesë për besimtarin, që i frikësojnë mohuesit dhe u fusin lëkundje në shpirt, ka engjëj që ndjekin kuvendet ku bëhet adhurim, dhikër dhe ku diskutohen çështje diturore të fesë, engjëj që ndërrojnë detyrë në namazet e mëngjesit dhe pasdites, që sodisin lutjet e të premteve, që dëgjojnë Kuran dhe që krijojnë atmosferë qetësie dhe paqeje në këto mjedise.

Ka engjëj që falin namaz dhe marrin pjesë në lutje dhe adhurime të tjera.

Engjëjt Munkir dhe Nekir i shkojnë të vdekurit në varr dhe e marrin në pyetje.

Gjatë miraxhit, Profeti ka parë engjëj të mbetur qysh nga dita e krijimit, para madhështisë së Zotit, dikush në ruku, dikush në sexhde e dikush në këmbë.

Veç këtyre, ka, ndoshta, sa numri i molekulave në gjithësi, engjëj që vëzhgojnë lëvizjet e grimcave, rënien e shiut, rënien e meteorëve, lëvizjen e tokës, yjeve, sistemeve dhe galaktikave, çeljen e luleve dhe rritjen e frutave, përgjithësisht, të gjitha veprimtaritë krijuese e jetësore.

Çdo frymë do ta shijojë vdekjen! (A. Imran, 185) Çdo gjë është e përkohshme, vetëm Ai është i përjetshëm! (Rrahman, 26-27) Ky është një urdhër për çdo krijesë dhe engjëjt nuk bëjnë përjashtim nga ky urdhër. Në fund fare, edhe Azrailit do t'i thuhet: "Dorëzoje shpirtin tënd!" Megjithëkëtë, nëse ka krijesa të afërta të Zotit që do ta vazhdojnë jetën edhe pas kësaj, ne nuk mund t'i dimë.

Engjëjt, në mënyrë të veçantë engjëjt e mëshirës, nuk hyjnë në shtëpitë ku ka statuja, fotografi, qen dhe çanga, nuk u afrohen njerëzve të papastruar pas marrëdhënieve seksuale, njerëzve që kanë ngrënë gjëra me erë të rëndë e shqetësuese, si qepë, hudhra, presh, njerëzve që pijnë duhan dhe mund të thuhet se engjëjt ikin nga kundërmimet e rënda e të këqija. Ka rrëfime, sipas të cilave, engjëjt nuk shkojnë te njerëzit që presin marrëdhëniet me prindërit dhe të afërmit. Po qe se duam që engjëjt të jenë bashkë me ne, duhet të krijojmë për vete dhe për mjedisin tonë ato kushte që duan ata.

2. Kur mbron engjëlli dhe kur shfaqet?

Allahu e mbron njeriun drejtpërdrejt, por mund ta mbrojë edhe me anë të engjëjve, por për këtë është kusht që njeriu të dëshirojë dhe të ketë vullnet, që të jetë i pastër nga dredhitë dhe dinakëritë, që të hyjë në lidhje me engjëllin, që lidhja e tij me Allahun të vazhdojë dhe, më në fund, që të krijohet, në këtë mes, një lloj lidhjeje e caktuar. Me njeriun që krijon lidhje me botën engjëllore, edhe engjëjt hyjnë në marrëdhënie. Mbrojtjen e engjëjve e shohim te fëmijët, te të vegjlit e pafajshëm, te pleqtë e rënduar, sepse Allahu ka një mëshirë të posaçme për ta. Që engjëjt të shfaqen e ta mbrojnë njeriun, duhet që edhe njeriu të krijojë kushte për këtë, që të mos largohet nga Zoti, që të arrijë të krijojë lidhje me botën engjëllore. Por me botën engjëllore nuk mund të krijohet lidhje duke gogësitur apo duke mos ditur ç'thua!

3. Dobitë e besimit te engjëjt

Ashtu siç ka ndikime të mëdha pozitive besimi te Allahu, te ringjallja dhe llogaridhënia, ka ndikime të mëdha pozitive edhe besimi te engjëjt. Së pari, ky besim i jep qetësi e prehje individit dhe ia kthen egërsinë në butësi dhe afërsi. Engjëlli afrohet te ai dhe i bën shoqëri. Me anë të engjëllit marrin formë frymëzimet në zemrën e njeriut. Në sajë të marrëdhënieve dhe afërsisë me engjëjt mbushet me qetësi njeriu dhe me këto qenie i merr dritë qenia. Veçanërisht, duke menduar se është çdo çast nën vëzhgimin e engjëjve, njeriu rri larg nga mëkatet. Duke qenë engjëlli një frenues i dëshirave dhe pasioneve njerëzore, rregullimi dhe disiplinimi i jetës së njeriut bëhet më i lehtë.

Profeti Muhamed (s.a.s.) është më i virtytshmi në ndjenjat engjëllore. Edhe engjëjt që u kanë sjellë profetëve revelacionin, janë më të çmueshëm e më të virtytshëm se engjëjt e tjerë. Ashtu siç kanë, ndër njerëzit, më epërsi ata që patën marrë pjesë në luftërat e Bedrit, Uhudit, etj., edhe ndër engjëjt, kanë më epërsi ata që patën marrë pjesë në ato luftëra.

Profeti thoshte: *"Unë kam në qiell dy vezirë, Xhebrailin me Mikailin, kurse në tokë, Ebu Bekrin dhe Omerin!"*

4. Xhindet janë krijuar nga zjarri pa tym e pa prush

Xhindet janë krijuar nga zjarri (flaka) pa tym e pa prush. (Rrahman, 15) Kaq është informacioni që jep Kurani mbi strukturën dhe entitetin e xhindeve. Por, në një vend tjetër përdoret edhe shprehja *"zjarri përvëlues që hyn (në poret e trupit)"*. (Hixhr, 27) Megjithëkëtë, entiteti dhe cilësia e xhindëve është, për ne, prapëseprapë e panjohur. As teleskopët dhe mikroskopët nuk na kanë treguar gjë gjer më sot mbi një botë të tillë dhe entitetin e saj. *Xhind* do të thotë *i mbuluar, i fshehur, i maskuar*. Për t'i përshkruar xhindet përdoren shprehje të tilla si: *"një rreze zjarri; një zjarr që digjet duke flakëruar, duke shpërndarë shkëndija përreth; si prush ose si qymyr i ndezur";* etj. Por nuk e di nëse shprehje të tilla janë apo jo të mjaftueshme për t'i përshkruar xhindet. Ashtu siç është mbledhur entiteti morfologjik i njeriut nga toka në gjendje koncentrati proteinash, edhe xhindet bartin veçoritë e zjarrit meqë janë marrë nga esenca e zjarrit. A është lënda e xhindeve ajër inkandeshent apo një përzierje si flakë e ajrit me zjarrin, apo radiacion, grimcë, apo dritë diellore, nuk e dimë. Ndoshta një lëndë që përmban cilësitë e të gjitha këtyre. Apo ndoshta është si grimcat përbërëse të atomit, si rrezatimet e tyre, apo një përzierje jonike me prejardhje nga bota nënatomike, apo një trup eterik, apo një antilëndë.

Po, xhindet mund të jenë trupa eterikë. Në lidhje me këtë, megjithëse në ajetet Kuranore nuk ka ndonjë gjë të qartë, në hadithet profetike diku thuhet se *"arshi i Allahut ndodhet mbi errësirë"* e, diku tjetër, *"mbi ujë"*. Në thënien e parë përdoret fjala *"amá"* që do të thotë *"errësirë, verbëri"*, por, që, në rastin konkret, nënkupton diçka fluide si eteri. Meqë kjo nuk është një çështje besimore, përqendrimi i gjatë mbi të është i panevojshëm. As mosqenia e eterit është shpjeguar gjer tani, as qenia. Mund të ekzistojë si grimca më e vogël, si një lëndë aq e tejdukshme e fluide sa të mos dallohet dot. Kush e di, ndoshta atje ku materia konsumohet plotësisht, fillon eteri!

Xhindet ndoshta janë, në përmasat e kohës dhe hapësirës, qenie që s'i shohim dot brenda valëve të dritës që na e tregojnë materien. Edhe sikur të bëhen përpjekje për të thënë ca gjëra me anë të fjalëve dhe shprehjeve shkencore, arritja në konkluzione të prera për lëndën dhe përbërjen e xhindeve do të thotë të bësh komente dhe interpretime të gabuara, gjë që, për ne do të thotë të vësh në pikëpyetje revelacionin hyjnor. Sepse ne nuk e dimë ç'do të thonë fjalët *"marixh"*[7], *"nar"*[8] dhe *"nari semum"*[9] që përdoren në

[7] Márixh: 1. flakë pa tym.

[8] Nar: 1. zjarr. 2. xhehennem, ferr..

[9] Nar-i semum: zjarr i nxehtë, ajër i nxehtë e përvëlues.

Kuran. Pa shihni se ç'formë merr njeriu që e ka esencën nga toka! Atëherë, kushedi se si është zjarri nga i cili janë krijuar xhindet!

5. Si njerëzit, edhe xhindet janë të ngarkuar me besim dhe adhurim

Si qenie të padukshme të botës materiale, xhindet kanë shpirt me vetëdije. Xhindet dallohen nga njerëzit dhe engjëjt sepse kanë strukturë tjetër lëndore, kurse nga bimët dhe kafshët, sepse kanë vetëdije. Meqë janë të ngarkuar, si njerëzit, me detyrën për të besuar dhe adhuruar, mund të jenë edhe besimtarë, edhe mohues. Fitorja ose humbja e myslimanëve njerëz është edhe fitorja ose humbja e myslimanëve xhinde. Xhindet kanë seks, martohen dhe shtohen. Për jetëgjatësinë e tyre janë dhënë shifra gjer në një mijë (shih imam Shibli).

6. Lëvizjet dhe veprimet e engjëjve dhe xhindeve nuk janë të kushtëzuara dhe të kufizuara nga koha dhe hapësira

Në këtë botë me shumë aspekte relative, ku jetojmë, edhe gjëra të tilla si fuqia, forca, mundësia, format dhe mënyrat e të folurit, rëndesat, koha dhe shpejtësia janë relative. Për shembull, mes një veze dhe një cope druri, hekuri, guri e një mase zhive sa një vezë, ka ndryshime të theksuara rëndese (peshe). Si kjo, trupat kanë shpejtësi lëvizjeje dhe rënieje të ndryshme, të posaçme për veten. Zëri ka një shpejtësi përhapjeje të caktuar. Kurse drita thotë se *është kufiri i shpejtësisë i materies*. Gjatë rënies së lirë, shpejtësia e trupave rritet për çdo sekondë me produktin e rrugës së përshkuar në sekondën e parë me katrorin e kohës. Për shembull, po qe se një trup, gjatë rënies së lirë, në sekondën e parë përshkon një rrugë prej 5 metrash, në sekondën e dytë do të përshkojë një rrugë të barabartë me 4x5 =20m., në sekondën e tretë, 9x5=45m., në sekondën e katërt, 16x5=80m., në sekondën e pestë, 25x5=125m., etj. Me rritjen e shpejtësisë, koha ngadalësohet, si përfundim, trupi që arrin shpejtësinë e dritës, e humb cilësinë lëndore dhe fiton cilësi tejlëndore, jolëndore.

Nëse ndodh kështu me trupat lëndorë, është mjaft normale që të mos i shohim shpirtin, engjëjt dhe xhindet që lëvizin me shpejtësinë e dritës, madje përtej saj. Ajnshtajni dhe Lorenci e kanë përcaktuar shpejtësinë e dritës, si një ligj fizik serioz, 300 mijë km. në sekondë. Duke u nisur nga kjo, materialistët kanë dashur të arrijnë në përfundimin se gjithësia është e kufizuar, përtej saj ka përsëri lëndë, mirëpo studimet kanë treguar se ky kufi specifik për materien mund të kalohet. Shkencëtarët kanë vërtetuar matematikisht mundësinë e ekzistencës së rrezeve të dritës jashtë konceptit masë dhe rreze të tilla i kanë quajtur "Rrezet Tachyon dhe Syrnkoff". Pas kapërcimit të kufirit të shpejtësisë 300 mijë km. në sekondë, asnjë cilësi lëndore s'mbetet, kurse me pakësimin e shpejtësisë, fillojnë sërish të dalin në pah cilësitë lëndore, masa dhe dukshmëria.

Pas këtyre përcaktimeve të bëra për lëndën, çështja e shpejtësisë dhe largësive që mund të përshkojnë shpirtrat, engjëjt dhe xhindet, kuptohet më mirë. Kjo do të thotë se në botën e relativiteteve nuk ka më kufizim kohe dhe hapësire.

7. Në krahasim me njerëzit, engjëjt dhe xhindet mund të bëjnë punë më të mëdha e më të rënda

Para së gjithash, dihet se asnjë gjë nuk është e vështirë për fuqinë e Allahut. Allahu që i krijon me të njëjtën lehtësi si një mollë, ashtu dhe një mijë mollë, si kopshtin me mollë, ashtu dhe botën, si atomin, ashtu dhe galaktikën, si peshkun, ashtu dhe detin, mund t'u japë njerëzve, engjëjve dhe xhindeve fuqi dhe forcë në masën që dëshiron. Në fakt, ajo që bën njeriu s'mbetet aspak poshtë gjërave që bëjnë engjëjt dhe xhindet. Nëse janë engjëjt që vëzhgojnë lëvizjen e globit tokësor dhe trupave qiellorë, është njeriu që i vjen rrotull botës, që i jep formë lëndës, që ngre qytetërime dhe prodhon teknologji. Nëse njeriu do të kishte në dorë një gisht në vend të pesëve, flatra në vend të krahëve të vet dhe këmbë elefanti në vend të këmbëve që ka, a do të mund t'i bënte këto, vallë? Nga ana tjetër, punët e njeriut mos do t'ua dedikojmë gishtave, duarve dhe

këmbëve? Ja, pra, bëmat mrekullore të engjëjve dhe xhindeve të padukshëm, ja dhe bëmat e reaksioneve kimike dhe rrymave biokimike të padukshme të trurit! Me se i ngrenë dora, krahu, muskujt tanë peshat? Duke e kërkuar bërësin e vërtetë, a nuk arrijmë te palca e kockave aq e dobët fizikisht sa s'ka ku të vejë më dhe te rrymat biokimike të padukshme?

Megjithëse nuk shihen me sy, rrymat ajrore dhe erërat shkulin pemët dhe shembin shtëpitë. Ç'shkëmbinj të paepur e ç'punë gjigande bëjnë rrënjët e holla si mëndafsh të bimëve, ç'rrjetë të mrekullueshme formojnë në tokë duke e kërkuar lagështirën dhe ushqimin! Janë shumë burime energjie mbi të cilat bëjnë studime shkencëtarët. Me energjinë që prodhojnë duke i kapërcyer edhe kapacitetet e digave, centralet atomike e vënë lëndën (materien) në lëvizje. Sidomos rrezet lazer dhe shumë gjëra të tjera që presin të zbulohen, e trajtojnë dhe e përpunojnë lëndën në të gjitha fushat e jetës. Kështu, në çfarëdo fushe të jetës që të përqendrohesh, do të shohësh se lënda dhe materia janë vetëm "materiali" që përpunohet, që vihet në lëvizje, që urdhërohet, kurse përpunuesi, lëvizësi dhe urdhëruesi janë forcat e padukshme. E padukshmja sundon në mënyrë absolute e të paevitueshme mbi lëndën dhe materien!

Ndërsa energjia dhe rrezatimet veprojnë kështu mbi lëndën dhe materien, engjëjt dhe xhindet si qenie të padukshme përtej tyre, me mjetet komanduese që u ka dhënë Allahu, e vënë lëndën dhe materien në lëvizje dhe mund të bëjnë punë të karakterit mrekullor krejt të pamundura për ne. Prapëseprapë, edhe njeriu, ashtu siç u trajtua kjo çështje në diskutimin mbi shpirtin, mund të bëjë shumë punë të karakterit mrekullor, si lëvizja pa mjete e sendeve dhe loja me zjarrin nga spiritistët, etj.

8. Sa është numri i engjëjve dhe xhindeve?

Vetëm Allahu e di numrin e engjëjve dhe xhindeve! Allahu që krijon miliona gjallesa në një pikë ujë, që u jep jetë 4-5 milion eritrociteve në një milimetër kub gjak, që vendos në disa pika spermë miliona spermatozoide – kandidatë për t'u bërë njeri, që u jep jetë peshqve në det dhe kafshëve nën tokë, po të dëshirojë, mund të krijojë engjëj sa ç'ka pika shiu, sepse për Dorën e Fuqisë së Tij, si e shumta, si e pakta, janë njëlloj.

9. Shëmbëllimi i engjëjve dhe xhindeve, dukja e tyre duke marrë formë dhe entitet të caktuar

Siç u prek edhe më parë, si avullimi i ujit, kthimi i lëndëve të ngurta në lëng dhe gaz, copëtimi i atomit dhe kthimi i tij në energji dhe kuante, shfaqja e yjeve në formë vrimash të zeza, në jetën tonë dhe në gjithësi ekziston një veprimtari, një lëvizje dhe një rrjedhe nga bota e dukshme për në botën e padukshme. Kurse kur e mendojmë këtë veprimtari hyjnore nga ana e kundërt, mund të vërejmë ekzistencën edhe të një rrjedhe nga e padukshmja për te e dukshmja, nga e paperceptueshmja dhe e panjohura, për te e perceptueshmja dhe e njohura. Gazrat lëngëzohen, pastaj, nga lëngje, masivizohen ose kristalizohen dhe bëhen trupa të ngurtë. Pikat e ujit të kthyera në avull, sikur të donin të na thoshin se vazhdojnë të ekzistojnë, se nuk duken, por nuk janë humbur, kondensohen, kthehen në pika shiu dhe na bien mbi kokë duke na lagur. Grumbujt e pambukut të arës qiellore reflektohen mbi pasqyrën tokësore si mbulesë bore. Uji që ngjitet lart si avull, pa fituar ende masivitet për t'u bërë i patejdukshëm e për të marrë formë që të shihet, bëhet akull dhe e bën copë-copë enën ku është futur, edhe sikur të jetë prej hekuri të trashë! Gjërat e padukshme që planifikojmë në mendjen tonë, kur përcillen në botën e jashtme, marrin formë dhe dimensionohen duke u bërë të dukshme e të prekshme dhe jo vetëm kaq, por edhe të përmasave ndoshta miliona herë më të mëdha se përmasat në gjendjen e tyre të padukshme në mendje.

Ja, pra, edhe shpirtrat, engjëjt dhe xhindet, sado që, për shkak të strukturës së tyre të veçantë, janë të padukshëm në kushtet e botës sonë, mund të bëhen të dukshëm duke përdorur mënyra dhe forma të kësaj bote. Kjo lloj shfaqjeje dhe dukjeje e engjëjve dhe xhindeve quhet *shëmbëllim*. Duke bërë fjalë mbi

shëmbëllimin, Kurani (Merjem, 17) thotë: "(Engjëlli) *iu shëmbëllye* (Merjemes) *në formë njeriu*". Engjëlli që i sillte revelacionin Profetit, disa herë i shëmbëllehej në një formë të posaçme, disa herë si një kalorës që kthehet nga lufta, etj. Kur do të nisej ekspedita kundër fisit Kurejdha, Xhebraili i pati shkuar Profetit si një kalorës lufte i mbytur në pluhur dhe i pati thënë: *"O i Dërguari i Allahut, ju i nxorët parzmoret, por ne, engjëjt, jo!"* Po kështu, Xhebraili i pati shkuar Profetit në pamjen e një personi ndër shokët e tij, të quajtur Dihje, ose si një i ardhur me veshje vizitori për ta pyetur mbi çështje të besimit.

Si engjëjt, edhe xhindet dhe djajtë mund të shëmbëllehen. Sipas Hysejin Xhisriut, në sajë të formës së krijimit që u ka dhënë Zoti, xhindet dhe djajtë mund të marrin forma të dendësuara, sipas dëshirës së vet, të ajrit, eterit ose ndonjë lënde tjetër dhe të shfaqen para njerëzve me to. Kurse imam Shibli, duke u mbështetur në pohimin e Ebu Jalasë, thotë se xhindet dhe djajtë nuk mund të ndërrojnë formë vetë (me dëshirën dhe mundësitë e veta), se nuk kanë fuqi për këtë gjë, por, po të thonë njërën prej fjalëve që ua ka mësuar Allahu, fjalë që shërbejnë si shifër, Allahu i kthen ata nga një formë në një tjetër, nga një gjendje, në tjetrën. Këto fjalë janë, pothuaj, si shifra që u shërbejnë atyre për t'i thënë në kufirin e kalimit nga një botë në tjetrën, si një vizë që është kusht për t'u treguar për kalim, si parullat që përdoren dhe kërkohen në shërbimet e ndryshme ushtarake. Xhindet dhe djajtë nuk mund ta bëjnë këtë transformim me mundësitë (kapacitetet) dhe vullnetin e vet; po të tentojnë ta bëjnë, u shpërbëhet struktura dhe e humbin vitalitetin.

Djalli që është nga lloji i xhindeve, mund të marrë formë dhe trajtë njeriu. Kështu, rrëfehet se, para luftës së Bedrit, djalli, në formën dhe trajtën e plakut Nexhid, shkoi te kurejshët, u dha ide nxitëse për kurthin që kishin ngritur dhe u propozoi zgjidhje. Gjithashtu rrëfehet se, një herë tjetër, roja që po ruante plaçkën e luftës, kapi një djall që po përpiqej t'u shkaktonte dëm mallrave dhe e liroi pas lutjeve të shumta. Radhën e tretë, kur personi që e kapi djallin, vendosi ta çonte te Profeti, djalli i tha: *"Lëshomë se do të ta tregoj se me se mund të mbroheni prej nesh!" "Me se?"* - e pyeti personi. *"Me ajetin Kursi"* - iu përgjigj djalli. Kur ia treguan ngjarjen Profetit, tha: *"Është gënjeshtar i keq, por të vërtetën ka thënë!"*

Në Kuran thuhet se xhindet kanë dëgjuar këndim Kurani nga Profeti dhe se ua kanë përcjellë popullatës së tyre mendimin mbi të: *"O fisi ynë! Me të vërtetë, ne kemi dëgjuar një libër që ka zbritur pas Musait, që e vërteton librin para tij dhe që të shtyn te Zoti dhe te rruga e drejtë!"* (Ahkaf, 29) Edhe në librat e hadithit, me anë të rrëfimeve të ndryshme, thuhet se Profeti u ka kënduar atyre Kuran dhe ua ka kumtuar fenë. Thuhet se, në këto takime, Profetin e patën shoqëruar gjer në një pikë, një radhë Ibni Mes'udi e, një radhë tjetër, Hz. Zubejri.

Siç mund të duken në formë dhe trajtë njeriu, xhindet mund të duken edhe në formë dhe trajtë kafshësh. Rrëfehet se xhindet janë shfaqur si gjarpër, akrep, ka, gomar dhe zog. Kështu, në oazin Nahle, ndërsa do të merrte besën e tyre, Profeti u kërkoi xhindeve të mos dukeshin si akrepër ose qenër ose kafshë të tjera, por në trajtën e vet ose në ndonjë formë dhe trajtë tjetër të pëlqyeshme. Kurse bashkësinë e vet, Profeti e pati porositur që, *kur të shohin në shtëpi ndonjë kafshë si gjarpri ose insekte, t'u thonë tri herë, "shko, për hir të Allahut!" sepse mund të jenë xhinde dhe, nëse nuk shkojnë dhe u shkaktojnë dëm, t'i vrasin*. Kjo ishte si një marrëveshje mes dy fiseve të veçanta, mes dy racave të veçanta ose mes dy klasave të veçanta. Edhe xhindet i patën dhënë fjalën Profetit kështu: *"Po qe se umeti, bashkësia jote, e fillon çdo gjë me "besmele", çdo gjë e mbyll dhe e mbron, ne nuk i prekim ushqimet e tyre!"* Natyrisht, ne nuk e dimë se si mund të përfitojnë xhindet nga të ngrënat dhe të pirat tona. Ndoshta nga aroma, ndoshta nga gjendja e dekompozuar e tyre. Kështu, në një hadith, porosi profetike, thuhet: *"Mos u pastroni me kocka ose bajga lope të thara se ato janë ushqimi i vëllezërve tuaj xhinde!"*

10. A mund të hyhet në lidhje me xhindet? Në ç'kushte xhindet mund t'u shkaktojnë dëme njerëzve?

Shpirtrat e disa njerëzve janë të përshtatshëm për të hyrë në lidhje me xhindet. Ata mund të kalojnë shpejt në gjendje tranzitore, të dalin shpejt jashtë dimensioneve tona dhe të përshtaten me botën, gjuhën dhe mënyrën e ndërlidhjes dhe komunikimit të xhindeve. Kjo është një çështje mundësie, vetëm se nga kjo nuk mund të arrihet në mendimin apo konkluzionin mbi ndonjë epërsi.

Këto forca të padukshme kanë parimet e tyre. Për rrjedhojë, njeriu nuk mund t'i detyrojë ato të bëjnë diçka për të sa herë dhe ku të dëshirojë. Xhindet nuk mund të veprojnë jashtë dimensioneve të përcaktuara nga Allahu për ta. Njeriu mund t'i përdorë disa fjalë dhe shprehje si të hapte dryna enigmatikë, dhe të hyjë në lidhje me xhindet, por xhindet nuk mund të përdorin një mundësi që s'u është dhënë. Nisur nga kjo, çdo njeri nuk i përdor dot xhindet, nuk përfiton dot prej tyre dhe nuk i përdor dot ata për çdo dëshirë të vetën. Krahas kësaj, nuk janë të pakët as ata njerëz që hyjnë në lidhje me xhindet duke i përdorur disa fjalë e shprehje si kode, si numra telefoni, duke i përsëritur ato në forma dhe herë të caktuara.

Krahas faktit që ka një sërë rrugësh dhe mënyrash për të hyrë në lidhje me xhindet, për këtë kërkohet një drejtim dhe kualifikim i caktuar. Pa pasur një drejtues, pa njohur mënyrat dhe metodat përkatëse dhe pa një kualifikim në një nivel të caktuar, mund të bëhen gabime dhe të bihet viktimë. Njerëzit që merren me gjëra të tilla, si çdo njeri, nuk i kanë sytë të aftë për të parë në botën e kuptimit, prandaj, po s'i njohën vendet ku u shkel këmba, mund të sulmohen nga ato shpirtra, të hyjnë nën urdhrin e tyre dhe të bëhen lodër në duart e tyre. Si përfundim, xhindet i shtyjnë njerëz të tillë në krenari dhe mendjemadhësi, i përkëdhelin, i bëjnë t'i humbin kriteret e vlerësimit dhe, kur vjen koha dhe vendi i duhur, i kërcënojnë, i fusin nën ndikimin e vet dhe i bëjnë të flasin e veprojnë për interesa të veta. Kështu, në shek. XX, në Indi, Gulam Ahmed Kadijani qe bërë viktimë e shpirtrave të tillë të këqij. Ai pati dashur të luftonte në emër të Islamit në rrugën e fakirizmit kundër jogizmit indian, por qe sulmuar nga shpirtra të tillë dhe qe bërë lodër e tyre. Në fillim ia patën mbushur mendjen se ishte një novator, pastaj, se ishte Mehdi dhe, më pas, se ishte mesihu Isa. Ai shkoi gjer atje sa të thoshte se Zoti ishte mishëruar dhe shfaqur tek ai! Shpirtrat e këqij krijojnë shpejt lidhje me njerëzit e këqij dhe mund t'i çojnë ata gjer në çmenduri.

Xhindet u afrohen besimtarëve kur janë të papastër, kur s'falin namaz dhe në situata të tjera të ngjashme me këto si dhe me mënyra dhe forma të ndryshme për t'ua prishur dhe kthyer mendjen. Çdo mëkat i kryer është si një derë dhe një dritare e hapur për djallin dhe xhindet e këqij. Veçanërisht tipat e ndjeshëm, shpirtrat e dëmtuar, ata që bëjnë jetë të ulët, larg lutjeve dhe atmosferës së lutjeve, hyjnë shpejt nën ndikimin e xhindeve. Natyrisht, shkelja e kufijve jetësorë dhe e të drejtave të xhindeve si dhe hyrja në banesat dhe mjediset e tyre pa besmele janë faktorë të rëndësishëm që sjellin dëmtimin e njeriut nga xhindet. Prandaj Profeti na mëson që, para se të hyjmë në vende të pista, të bëjmë lutje, dhe na urdhëron të mos falim namaz në grumbujt e plehrave, pranë nevojtoreve, në banja, në livadhe, ku zakonisht ndodhen ata, dhe, madje, në varrezat. Këto janë vendet ku zakonisht shkojnë djajtë dhe shpirtrat e këqij. Profeti na porosit që, duke hyrë në nevojtore, të bëjmë lutjen: *"Allahumme inni eudhu bike minel hubthi vel habaith!"* Gjithashtu, ai na porosit që, çdo aspekt të jetës ta shoqërojmë me lutje, të ndodhemi në vende dhe mjedise të pastra për t'u ruajtur nga dëmet e tyre, të rrimë me njerëz të pastër dhe të mbrohemi me anë të adhurimeve. Kështu, kush dëshiron që të jetë i sigurt nga të gjitha të këqijat e xhindeve, para së gjithash, duke u shmangur nga mëkatet, të zërë vrimat nga mund të futen ata.

11. A është e vërtetë magjia dhe a mund të bëhet magji?

Ata që thonë se s'ka magji, se nuk besojnë në magjinë, ose janë mohuesit që, duke e parë çështjen me bazë fetare, mohojnë se ashtu ua kërkon karakteri i tyre mohues, ose janë tipa indiferentë që s'kanë lexuar

e dëgjuar fare, që s'është e qartë nëse jetojnë apo s'jetojnë në këtë botë. Dikush mbi të pesëdhjetat që e pata takuar personalisht në xhami dikur, më pati thënë kështu:

"Gjer një vit më parë, unë nuk i besoja magjisë. Ndërkaq, njëri prej të afërmve të mi u çmend. Kur e kapte kriza, shtangej dhe i ngulte sytë në një pikë. S'mbeti mjek e s'mbeti magjistar xhindesh që s'shkuam. Atje ku shkuam për herë të fundit, personi që merrej me këtë punë, e këndoi dhe i bëri edhe gjëra të tjera. Në kthim, hipëm në makinë dhe i sëmuri ynë, me një zë, me të cilin ishim çmësuar tashmë, na pyeti: "Ku jam unë? Ç'ndodhi me mua?" Mbeta i habitur! Dhe atëherë besova se kishte magji!"

Së pari, Kurani bën fjalë për magjinë që ndan burrin me gruan (Bekare, 102) dhe trajton hollësisht ngjarjet e magjive në kohët e profetëve Sulejman dhe Musa. E dyta, një çifut i pati bërë magji Profetit dhe, pasi Profeti pati filluar të ndjente shqetësim, materiali i magjisë, me ndihmën e shenjës së Engjëllit, qe nxjerrë nga pusi ku qe hedhur dhe, pas këndimit të dy sureve të fundit të Kuranit, Allahu ia pati larguar shqetësimin Profetit. E treta, në jetë kanë ndodhur dhe ndodhin ngjarje të tilla si dhe ka shembuj të tillë, që, edhe sikur të ngrihem e të tregoj vetëm të miat, mbushen 20-30 faqe. Por unë desha të mjaftohem vetëm me ato që i përmenda më sipër, sepse shërbejnë si argument për rastet analoge.

Ndikimi dhe veprimi i magjisë janë të vërtetë e të vërtetuar në praktikë. Por, ndërkaq, t'i bësh magji dhe të keqe tjetrit, t'i ndash burrin me gruan nga njëri-tjetri, t'i vësh dhe t'i armiqësosh njerëzit ndaj njëri-tjetrit, të bësh përpjekje për magji pavarësisht nëse zë apo jo, të bësh magji vetë apo të porosisësh magji, t'i ndihmosh ata që bëjnë vetë dhe që porosisin magji, të gjitha këto janë kategorikisht haram, domethënë, të pamiratuara, të pabekuara, të ndaluara, si dhe mëkat, domethënë, faj! Kurse të bësh ose të porosisësh magji me bindjen e një akti të lejuar, të miratuar e të bekuar (hallall), është mohim (kufr). Por ta shpëtosh dikë që me të vërtetë është sulmuar nga xhindet ose ka rënë viktimë e magjisë dhe vuan, duke e kënduar për ta shpëtuar nga vuajtja, gjithsesi është mirësi! Vetëm se kjo çështje s'duhet kthyer në profesion dhe fushë preokupimi. Sepse nga Kurani dhe Suneti (tradita profetike), në lidhje me këtë çështje, s'dimë gjë. Profeti është takuar me xhindet, por kjo ka ndodhur në kuadrin e detyrës së tij profetike dhe si profet edhe i tyre. Ai u ka kumtuar xhindeve fenë, ka marrë besën e tyre dhe ua ka bërë të ditura përgjegjësitë që kanë. Jashtë këtij kuadri, Profeti jo vetëm nuk është marrë me gjëra të tilla si mënyra e krijimit të lidhjeve me ta, mënyra e thirrjes së tyre, mënyrat e bërjes dhe prishjes së magjisë, mënyra se si vihen në punë ata, por as në thëniet dhe deklaratat e tij të bekuara nuk shohim ndonjë gjë lidhur me këtë çështje. Por Profeti ka treguar pikat e afrimit me xhindet, dëmet e tyre dhe rrugët e shpëtimit prej tyre. Ndërkaq, edhe pse, në kuptim të përgjithshëm, preokupimi i bashkësisë me këto çështje nuk miratohet, gjithsesi, përdorimi nga persona të veçantë me besim dhe përgatitje të caktuar i xhindeve me qëllim dhe synim të mirë duhet të jetë i justifikuar, pasi, në këtë drejtim, në Kuran ndodhet një pikë horizonti e treguar me dorën e disa profetëve.

12. A mund të vihen në punë xhindet në të ardhmen?

Në Kuran tregohet se profeti Sulejman kishte ushtri prej zogjsh dhe xhindesh, se xhindet ndërtonin kala, basene dhe bënin kazanë, se mes tyre kishte muratorë dhe zhytës dhe, në mënyrë të veçantë, se ata ia patën sjellë atij në çast fronin e Belkisës nga disa mijëra kilometra larg. (Enbija, 82; Neml, 39; Sebe, 12; Sad, 37)

Ajetet kuranore na çojnë ne në botët metafizike dhe, duke na njohur me ngjarje metafizike, na shëtisin në një botë ku mund të bisedohet me shpirtrat, xhindet dhe djajtë me gjuhën e ndjenjave. Në këtë çast, njerëzimi ndodhet në abëcënë e kësaj pune, në periudhën e ecjes këmbadoras për t'u ngritur në këmbë. Tani sapo hapet pak perdja e telepatisë, e bisedës me shpirtrat, e ndërlidhjes në fusha të gjera me anë të xhindeve dhe djajve, e vënies së tyre nën urdhër dhe kryerjes së punëve të ndryshme me anë të tyre. Do të ketë çështje lidhur me lëndën dhe materien, që nuk do të mund të zgjidhen në laboratore, do të ndjehet nevoja për t'iu drejtuar botëve dhe gjallesave të padukshme, do të shfaqet nevoja e shpirtrave të mirë apo të këqij dhe e

xhindeve për të zgjidhur shifrat e ardhura nga botët e tjera. Me shtimin e lidhjes me ta, do të shtohet edhe prirja për fushat e përdorimit të tyre.

Siç u pohua në ajetet e mësipërme, xhindet i shërbenin profetit Sulejman. Çdo profet ka qenë i merituari i vlerave dhe të fshehtave të një emri të Zotit, po kështu, edhe të emrave të vetë. Ideja dhe kuptimi i emrit Sulejman do të thonë sundim mbi botët e dukshme e të padukshme. Si domosdoshmëri e një emri të tillë, një dorë e atij profeti mund të vepronte në botën e dukshme, kurse dora tjetër, në botën e padukshme dhe ai mund të hynte në ndërlidhje me botën e padukshme. Këto cilësi janë shfaqur pjesërisht dhe përkohësisht edhe te disa profetë të tjerë, por te profeti Sulejman ishin një aftësi e përhershme dhe në një nivel të përparuar. Veçanërisht, këtu aludohet për rrugët dhe metodat me të cilat duhet të pajisen grupimet që u shërbejnë besimit dhe Kuranit.

Profeti Sulejman i pati zbuluar dhe vënë nën urdhër xhindet pa mjete dhe pretekste materiale, i pati vënë në punë, pati kryer ndërlidhje me ta duke treguar, në këtë fushë, kufirin e fundit ku mund të arrihej. Sipas shprehjeve të ajetit kuranor, nën urdhrin e tij, xhindet bënin siç dëshironte Sulejmani. Duke realizuar vepra të mrekullueshme të artit kaligrafik, xhindet patën dhënë një kontribut të madh për njerëzit për zhvillimin e këtij arti. Në të ardhmen, xhindet do të përdoren më gjerësisht në të njëjtën fushë dhe ata që kanë për t'i vënë në punë, do të vendosin gurët e kufirit të fundit të kësaj çështjeje.

Gjithashtu, siç u tha edhe më sipër, në Kuran bëhet e ditur se profeti Sulejman i ka përdorur xhindet për zhytje në fund të detit. Ka apo nuk ka lidhje kjo punë me telepatinë, por, sidoqë të jetë, një ditë do të arrihet që, me anë të xhindeve, të qëndrohet katër-pesë muaj nën det duke marrë edhe ushqimet me vete. Sepse është një i dërguar i Allahut që na tregon neve në këtë çështje horizontin e fundit.

Ajeti kuranor aludon se xhindet mund të përdoren në masë të madhe edhe në fushën e luftës. Duke përdorur xhindët në përpjekjet dhe luftën në fushën e teknikës dhe teknologjisë, shtetet e mëdha, meqë është eliminuar mundësia e përgjimit në ndërlidhje dhe meqë xhindet lëvizin me shpejtësi shumë të madhe, do të përfitojnë nga xhindet për të interceptuar dhe shtënë në dorë kodet, shifrat dhe çelësat e ndërlidhjes. Është e çuditshme se ata që sot tregojnë më shumë zell në këtë fushë janë vendet më të mbyllura ndaj ideve, Rusia dhe Kina!

Sigurimi i ndërlidhjes dhe bisedës me anë të xhindeve mund t'u vlejë edhe organeve dhe strukturave të sigurimit. Kështu, me anë të xhindeve mund të merret informacion në çast për aktet ose veprimet e çastit dhe në zhvillim e sipër duke i mbajtur ato si dhe grupet e veprimit nën kontroll. Kush e di, ndoshta atëherë do të ketë edhe drejtorë dhe komisarë policie nga radhët e xhindeve.

... Dhe do të vijë një ditë që popujve dhe kombeve nuk do t'u mbetet asgjë e fshehtë, xhindet dhe djajtë do t'i nxjerrin në shesh të gjitha gjërat e mbyllura, sekretet dhe anët e fshehta të popujve dhe kombeve dhe do të sigurojnë mundësinë për të njohur anët më të fshehta të çdo njeriu. Atëherë, njeriu do t'ua dedikojë çdo gjë bëmave të shpirtrave dhe xhindeve dhe, përfundim i zhvillimeve në këtë fushë, përdorimi i xhindeve në këtë mënyrë do t'i hapë rrugë, në një vështrim, mohimit të Allahut dhe Kuranit dhe, më në fund, njerëzit do t'i përdorin shpirtrat dhe xhindet për të realizuar kënaqësitë shpirtërore të veta.

Në ajetin e 82-të të sures Enbija të Kuranit, duke u bërë e ditur se xhindet kryejnë edhe punë të tjera veç këtyre që përmendëm, aludohet se në të ardhmen xhindet do të mund të përdoren edhe në shumë punë të tjera që ne nuk mund t'i dimë ose t'i parashikojmë. Ju mund të mendoni, për shembull, që xhindet të përdoren për të bërë libër ngjarjet e një mijë vjetëve, për zbulimin dhe shfrytëzimin nëntokësor të mineraleve, për të gjetur anijet e mbytura prej shekujsh, për të zbuluar burimet e reja pasurore ose për t'i përdorur xhindet si zhytësa të kozmosit, si satelitë, etj. Por, si gjithmonë, edhe në fund të këtyre që thamë, nuk duhet të lëmë pa thënë se *"Allahu e di të vërtetën e çdo gjëje!"*

13. A mund të bëhen xhindet shkak për sëmundje?

Xhindet janë qenie që mund të ushtrojnë pushtet mbi lëndën dhe materien. Edhe nëse nuk themi dot "ky është xhindi", është e qartë se xhindet janë qenie të tejdukshme, të padukshme, me aftësi ndikimi dhe veprimi. Le të japim një shembull të thjeshtë. Po qe se rrezet Rontgen e përshkojnë trupin e njeriut, po qe se rreze të ndryshme të caktuara mund të shkrijnë metale e mund t'ia ndryshojnë përbërjen lëndës, pse të mos mund të ndikojnë mbi trupin e njeriut xhindet që janë më të imta se rrezet në fjalë? Po, xhindet mund të veprojnë mbi fiziologjinë e njeriut duke u hapur rrugë dëmeve të ndryshme, mund të ndërhyjnë në enët e gjakut dhe në pikat qendrore të trurit.

Gjer në vitet 1960, rrezet lazer qenë arma e idealizuar e romaneve fantastiko-shkencore. Por, të zhvilluara pas gjetjes rrezeve të para të lazerit të kuq nga T. Warman-i, rrezet lazer filluan të përdoren gjithnjë e më gjerësisht dhe sot janë kthyer në një mjet të zakonshëm teknologjik në shumë fusha, si në kompjutera, në ndërlidhje, në industrinë e armëve bërthamore, në kërkimet policore, në mjekësi, etj. Për shembull, vetëm me anë të rrezeve lazer mund të dallohen shenjat e gishtave në një krim të kryer dyzet vjet më parë. Por më e rëndësishmja është se rrezet lazer mund të "rrjedhin" nëpër damarët tanë bashkë me gjakun dhe të përdoren për hapjen e damarëve të bllokuar. Një nga përdorimet mjekësore me shumë vlerë të rrezeve lazer janë edhe operacionet në sy me anë të tyre.

Ng ana tjetër, e dimë se oksigjeni që përmban ajri që thithim me mushkëri, na hyn dhe qarkullon nëpër damarë dhe na e pastron gjakun. Pikërisht në këtë moment le të kujtojmë fjalët e profetit Muhamed, i cili thotë: "Shejtani (djalli) qarkullon atje ku qarkullon gjaku i njeriut!" Djalli, pra, qarkullon së bashku me gjakun sikur të jetë kthyer në rruazë të kuqe apo të bardhë të gjakut!

Në këto kushte, duke i trajtuar tërë xhindet si të dëmshëm për njerëzit, duket se mund t'u hapin rrugë dëmtimeve materialo-shpirtërore. Dashtë Zoti që afrimin e djallit, plagët që hap dhe rrugët për t'u mbrojtur nga kjo t'i trajtojmë në çështjen në vazhdim.

Xhindet dhe djajtë mund të bëhen drejtpërdrejt edhe shkak për sëmundje fiziologjike. Kjo është gjithmonë e mundur sepse ata mund t'u ngjiten leukociteve dhe të na qarkullojnë nëpër enët e gjakut. Ndërkaq, as ne të mos e teprojmë në këtë drejtim, as mjekët të mos e mohojnë këtë të vërtetë. Bie fjala, po të ngrihet njëri e të thotë se janë këta shpirtra të këqij që bëhen shkaktarë të kancerit duke krijuar anarki në qeliza, kurse ju t'i thoni se s'mund të ndodhë një gjë e tillë, keni dhënë një konkluzion të shpejtuar e të paramenduar. E drejtë do të ishte, të paktën të mbahej hapur mundësia e diskutimit. Më e drejta dhe e arsyeshmja e gjërave të thëna gjer më sot për kancerin, është se kanceri është një anarki qelizore, anarkia e pjesëve më të vogla të trupit, kundërshtimi i rregullit normal dhe harmonisë të trupit dhe prishje e veprimtarisë së normale të funksionit dhe zhvillimit të qelizave. Kjo mund të ndodhë si në organet e jashtme, ashtu dhe në ato të brendshme, si në mënyrë të ngadalshme, ashtu dhe të shpejtë ose të vrullshme. Është gjithmonë e mundur që xhindet të vendosen në zonën kanceroze dhe, duke vepruar në mënyrë të organizuar, të krijojnë anarki qelizore. Ashtu siç janë xhindet qenie të padukshme, ashtu dhe kanceri shpesh herë nuk duket qysh në fillim, por jep shenja shumë vonë, atëherë kur ilaçet nuk bëjnë më dobi.

Pranimi i ndikueshmërisë së shpirtrave të këqij, si te kanceri, edhe në sëmundjen e epilepsisë, duhet të jetë një rrugë e arsyeshme. Kush e di, ndoshta xhindet bëhen u pengesë disa gjendrave të trurit për të punuar normalisht dhe për të kryer funksionet e tyre.

Gjithashtu, shpirtrat e këqinj mundet që, duke ia prishur mendjen njeriut dhe duke vepruar mbi sistemin nervor, t'i hapin rrugë çmendurisë. Ç'është e vërteta, mjekët ua dedikojnë të gjitha llojet e skizofrenive shkaqeve materiale dhe disa i shohin si të trashëgueshme, mirëpo është e mundur edhe që xhindet të futen në enët e gjakut, ta prishin ekuilibrin mendor të njeriut, ta rrënojnë sistemin nervor, për pasojë, t'i hapin rrugë çmendurisë. Të mos keqkuptohemi, nuk dua të them se epilepsia apo skizofrenia

janë patjetër punë të xhindeve, por po them “mundet”. Sepse këto sëmundje shpesh herë kalojnë me një këndim serioz të një goje lutëse.

Një prej shokëve tanë na solli kërkesën e një gruaje për t’u lutur për të. Për gruan e shkretë, mjekët kishin thënë se kanceri i kish lëshuar metastaza dhe se kishte edhe rreth një javë jetë. Ata i kishin këshilluar të afërmit e saj ta merrnin nga spitali që t’i kalonte në shtëpi ditët e fundit që i kishin mbetur...

Gruaja paskësh shumë mendim të mirë për personin tim. Duke kërkuar ndërmjetësimin e shokëve tanë, ajo kish thënë me bindje: “Le të lutet për mua, se kam për t’u shëruar!” Unë nuk e kujtoj dot tani se si u luta atëherë për atë të shkretë..., por, kur, pas gjashtë muajsh i pyeta rastësisht shokët se ç’kishte ndodhur me atë grua, më thanë se rronte! Pastaj kaluan edhe dy vjet dhe shokët më njoftuan se gruaja kishte shkuar në haxh dhe tani rriste nipërit e mbesat...

Në një rast tjetër, sjellin diku një të sëmurë me epilepsi me kriza të vazhdueshme dhe shumë të sëmurë. Hoxha hap Kuranin, këndon dy-tri ajete dhe i sëmuri ngrihet e shkon. Këto ngjarje është e pamundur të shpjegohen me anë të funksioneve materiale. Ju mund të arrini që, duke dhënë një ilaç, të veproni mbi një pjesë të trurit dhe, këtu, mund të bëheni i suksesshëm. Por suksesi në shërim mund të arrihet edhe me të kënduar!..

Po ofroj edhe një shembull tjetër. Tezja ime u çmend dhe nisi të shkatërrojë çdo gjë. Ajo mund të zotërohej vetëm duke e vënë në këmishën e forcës. U hodh nga kati i katërt i spitalit por nuk pësoi gjë. I shoqi shkoi te një hoxhë, i shkroi ca gjëra, ia solli dhe ia la asaj. Tezja tha: “Pse më keni lidhur kështu?” Dhe filloi të qante. Çudi, tezja ishte shëruar!..

Ka ngjarje të tilla, ka raste të tilla, para të cilave mjekësia dhe mjekët mbeten të paaftë. Dhe janë aq të shumta, sa çdo ditë mund të dëgjoni apo përjetoni një të re. Më në fund, po tregoj për një rast të tillë. Para shumë vitesh, në fshatin B., roja i komandës së policisë kishte pësuar një tragjedi të përsëritur: të shtatë fëmijët e parë i kishin vdekur nga asfiksia në ditën e 17 të lindjes! Më në fund, babai i shkretë kishte shkruar te një hoxhë dhe, më në fund, duke filluar me të tetin, fëmijët po i rronin. Tragjedia kishte marrë fund!

Ashtu siç kanë filluar tani në Europë dhe Rusi t’i përdorin fuqitë e padukshme për shërbime si ndërlidhje, etj., ka shumë mundësi që, në të ardhmen, tek të sëmurët psikikë të përdoret mjekimi me lutje. Madje, ndoshta, mjekimi me anë të xhindeve të bëhet aq popullor, sa të hapen për këtë katedra në universitete! Qysh sot ka mjekë që përdorin metodën e sugjestionit në mjekimin e ulçerës së stomakut. Bëhen edhe eksperimente për mjekimin me anë të muzikës duke ia ngritur moralin të sëmurit nëpërmjet dëgjimit të pjesëve muzikore të caktuara. Të gjitha këto tregojnë për ekzistencën e shpirtit dhe se sa rëndësi kanë ideja dhe mendimi në mjekim! Atëherë, ç’kuptim ka mohimi i shpirtrave të këqij dhe i xhindeve që u hapin rrugë sëmundjeve?

14. Ç’duhet bërë e ç’duhet kënduar për t’u mbrojtur nga e keqja e xhindëve?

a) Së pari duhen krijuar marrëdhënie të mira me Allahun dhe Profetin dhe duhet vepruar sipas parimeve të Islamit.

Rruga e parë dhe më e sigurt e kësaj pune është krijimi i lidhjeve dhe marrëdhënieve të mira me Allahun dhe Profetin, vënia në jetë e parimeve të Islamit si feja që e ndan të mirën nga e keqja, thellimi ndjesor dhe jetimi i botës sonë në atmosferën tonë krejt të pastër. Duke i bërë të gjitha këto, në njërën anë, në anën tjetër dhe njëkohësisht duhet të mos lëmë asnjë boshllëk dhe dritare mëkati nga mund të kalojnë shpirtrat e këqij. Një e çarë që mund të hapet në shpirt, mund të përgatitet terren për përvjedhjen dhe kalimin e tyre.

b) I duhet përgjëruar Zotit me lutje me fjalë dhe vepra.

Elementi i dytë për t'u mbrojtur nga e keqja e shpirtrave të këqij është lutja e cila, me veçorinë e vet si pjesë e adhurimit ndaj Zotit dhe një armë e jona, s'duhet të na bjerë nga gjuha. Po, mbrojtjen duhet ta kemi në unitet fjale e veprimi, shfaqjeje dhe ndjenje.

Lutja është dy llojesh: me punë dhe me fjalë. Puna që bën bujku për lërimin e arës, përgatitjen për mbjellje, mbjelljen dhe ujitjen, është lutje me punë. Pastaj ai hap duart dhe lutet me fjalë: "Zoti ynë, jepna bereqet, mos na e kurse mëshirën dhe bujarinë!" Po s'qe lutja e llojit të parë, me punë, vetëm lutja me fjalë nuk i sjell asnjë fitim njeriut. Nga ana tjetër, mjaftimi vetëm me punë, pa i kryer detyrat e lutjes dhe adhurimit ndaj Zotit, do ta zhvlerësojë punën në zero.

Le ta supozojmë se një besimtar lutet kështu: "Zoti ynë, bëji myslimanët fitimtarë!" Kjo është e bukur, por e pamjaftueshme. Sepse zogu nuk fluturon dot vetëm me një krah. Fakti që Profeti bëri përgatitje të gjerë e të patëmetë para luftës së Bedrit dhe vetëm pastaj iu drejtua me të gjithë qenien e tij Zotit për t'iu lutur për fitore, tregon se në fillim duhet bërë lutje me punë, gjë që nënkupton se njeriu është i detyruar të kryejë gjithçka që i takon dhe ka mundësi pa lënë asgjë mangët e me të meta, pastaj duhen hapur duart për lutje, për të pritur nga Zoti atë që e ka në dorë Ai!

Po kështu, kur kemi ndonjë shqetësim në trup ose kur jemi të sëmurë, duhet të shkojmë te mjeku dhe të përdorim ilaçe; të gjitha këto veprime janë nga një lutje praktike më vete. Pas kësaj, duhet t'i lutemi Zotit që e ka në dorë shërimin, të na japë shërim; dhe kjo është lutje me fjalë. Disa herë ndodh që sëmundja ose dhimbja e kokës apo e dhëmbit të na kalojë vetëm me lutje me fjalë drejtuar Zotit, por ndodh edhe që dëshira dhe vullneti hyjnor ta kërkojnë që të shkojmë te mjeku. Profeti na ka nxitur të mjekohemi, domethënë, të lutemi praktikisht, duke thënë: *"Allahu ka krijuar shërim për çdo sëmundje, prandaj mjekohuni!"*

Ashtu siç e thamë edhe më sipër, duke e njohur dhe pritur shërimin nga Allahu, ne nuk e lëmë kurrë mangët lutjen si një nga detyrat tona të adhurimit ndaj Tij. Mirëpo, siç ndodh që, ndonjëherë, një lutje specifike me fjalë të mbetet e pamjaftueshme, ndodh që edhe lutja praktike të mbetet e pamjaftueshme. Pra, ndodh që Zoti e jep shërimin vetëm me njërën lutje dhe ndodh që e jep vetëm kur të plotësohen të dyja lutjet. Çdo gjë është në dorën e Tij. Sa shumë njerëz ka që, megjithëse nuk dinë ç'është lutja me fjalë, domethënë, nuk luten kurrë, bëjnë një jetë plot shëndet, të qetë e të lumtur dhe sa shumë njerëz të lidhur me zemër pas Allahut ka që, megjithëse mjekohen dhe nuk pushojnë së luturi, kalojnë një jetë me sëmundje e shqetësime. Në kushte të tilla ne pandehim se lutja nuk na është pranuar. Mirëpo pranimi është tjetër gjë dhe përgjigjja e pranimit, tjetër. Çdo lutje dëgjohet dhe merr përgjigje, por kjo përgjigje siç mund të jetë në formën dhe kohën që pritet, mund edhe që të jepet më vonë se ç'pritet ose të jepet jo në këtë botë, por pas ringjalljes. Kjo varet plotësisht nga urtësia e Zotit. Ju e thërrisni mjekun ose shkoni te ai, por, po t'i thoni se cilat ilaçe dëshironi t'ju japë, ai përgjithësisht nuk ju jep ç'dëshironi ju, por ç'e sheh të nevojshme e të domosdoshme ose më të mirë se ajo që mendoni ju. Edhe Zoti i dëgjon gjithmonë lutjet e njeriut, robit të vet, dhe, duke i dhënë qetësi, ia bën të ditur njeriut se e ka dëgjuar, sepse Ai është më pranë njeriut se damari i qafës që i rreh. Mirëpo mund të mos i japë njeriut çdo gjë që dëshiron ose i kërkon sepse ato që dëshiron dhe kërkon njeriu jo gjithmonë mund të jenë në të mirë të tij, ose mundet që dhënien e tyre ta shtyjë për më vonë përsëri në dobi të njeriut. Fundja, Ai është "i zoti i mallit" dhe "me mallin e vet mund të bëjë si të dojë"! Edhe favori i Tij është i këndshëm, edhe persekutimi! Ai nuk bën punë pa kuptim; në çdo gjë që bën, ka jo një, por një mijë urtësi!

Veçanërisht, duhet ditur kategorikisht se, si namazi, edhe lutja është pjesë e adhurimit dhe se duhet bërë me thjeshtësi, me pastërti shpirtërore, me qetësi dhe pa interes. Njeriu duhet t'i drejtohet Zotit me një zemër krejt të pastër e të sinqertë duke kërkuar pëlqimin e Tij. Disa herë, Zoti, me bujarinë dhe favorin e tij, mund ta kënaqë njeriun menjëherë. Prandaj, lutjet e bëra me këtë paramendim duke pritur se do të merret një

rezultat i shpejtë dhe do të arrihet qëllimi për të cilin bëhet lutja, mund të mos pranohen. Ato mund të mos ngjiten në pikën e miratimit dhe pranimit ngaqë nuk janë të pastra nga ngarkesat me karakter subjektiv.

Nuk duhet këmbëngulur për shpërblime të parakohshme, por duhet këmbëngulur me vendosmëri në lutjet dhe pritjen e realizimit të gjërave vetëm nga Zoti. Të mos lësh mangët përgjërimin ndaj Zotit, të kërkosh gjithmonë gjërat e dobishme e të bekuara, t'i mbetesh gjithmonë besnik portës së Zotit ku mëkatet bien si gjethet në vjeshtë dhe ku vlerat njerëzore dhe virtytet shumëfishohen, të durosh me vendosmëri dhe, duke mos harruar se jemi në provë, t'i presësh rezultatet në jetën tjetër, ahiret, të gjitha këto janë domosdoshmëri të sinqeritetit ndaj Zotit!

c) Vlera e lutjes së personave të pranuar në Lartësinë Hyjnore.

T'u drejtohesh për lutje në emrin tënd njerëzve, lutja e të cilëve te Zoti është e çmuar, është shumë e rëndësishme dhe e dobishme. Me të vërtetë, Profetit i janë drejtuar shpesh për këtë gjë. Në rivajetet e Ahmed b. Hanbelit, Ebu Davudit dhe Taberanit, Umu Hani përcjell: "Të Dërguarit të Allahut i sollën një fëmijë të turbulluar. Profeti e preku duke thënë: "Largohu, o armik i Allahut!" Pastaj ia lau fytyrën fëmijës duke u lutur për të dhe te fëmija s'mbeti asgjë!" Edhe ne u drejtohemi njerëzve për të cilët kemi opinion të mirë dhe kërkojmë të luten për ne duke menduar: "Inshaallah Zoti na fal shërim!"

Po qe se u drejtohemi menjëherë atyre që merren me xhindet, kjo shkakton çarje në mendimin tonë besimor dhe mund të na e thyejë fuqinë shpirtërore. Gjithashtu, të tjerët mund të përfitojnë nga rasti ynë e të na shpërdorojnë. Shkrimi i nuskave andej-këtej duke e kthyer të sëmurin e shkretë në hamall nuskash, dhe përdorimi i tyre, sidomos, pastaj, humbja eventuale e tyre shkaktojnë shqetësime edhe më të mëdha te i sëmuri dhe e rëndojnë gjendjen e tij. Ai fillon të dridhet, të ketë frikë dhe ta humbë shpresën. Prandaj lutja është më e mira. Për shembull, Abdullah Ibn Amri u mësonte fëmijëve lutje. Ndërkaq, nuk duhet dhënë shumë pas kësaj pune. Sipas burimeve të haditheve autentike, Profeti, duke dhënë sihariqin e hyrjes në xhenet të 70 mijë personave pa u marrë në pyetje e pa u kërkuar llogari, thekson se ata janë njerëz të lidhur e të dorëzuar pas Allahut që nuk u japin vlerë nuskave, të fryrave e gjërave të këtij lloji. Prandaj, edhe lutja nuk duhet lënë, edhe shërimi prej Allahut duhet pritur duke iu dorëzuar dhe nënshtruar gjer në fund Atij!

d) Duhet shkuar te psikiatristët dhe mjekët besimtarë.

Kështilla jonë tjetër është që të shkojmë jo te psikiatristët dhe mjekët materialistë dhe mohues, por te ata që janë besimtarë dhe që i japin rëndësi rolit dhe ndikimit të shpirtrave dhe xhindeve në gjendjet e ndryshme të sëmura. Mjekët jobesimtarë të cilët, për shkak të mosushqimit të shpirtit dhe ndjenjave të veta, nuk munden të krijojnë ekuilibër ndërgjegje-ndjenja, për rrjedhojë, bëjnë një jetë dualiste, u këshillojnë të sëmurëve po të njëjtën gjë duke ua rënduar edhe më shumë gjendjen. Është pikërisht boshllëku shpirtëror një nga sëmundjet më të rënda të kohëve të sotme që bëhet shkak për shfaqjen dhe përgjithësimin e krizave të rënda shpirtërore e psikike me pasoja të shumta.

e) Duhen përdorur si lutje ajeti Kursi, suret Felek, Nas, etj.

Gjëja më e rëndësishme në kuadrin e kësaj çështjeje është mbështetja te Allahu, bashkimi me Të dhe hyrja nën mbrojtjen e Tij. Kjo është edhe ajo çka u thotë Allahu robve të Tij në Kuran: *"Po qe se ke ndonjë shtytje djallëzore, menjëherë mbështetu dhe strehohu te Allahu!"* (Fussilet, 36) Domethënë, thuaj: *"Eudhu bil'lahi mine'sh shejtani rraxhim / Mbështetem te Allahu nga shejtani i përzënë (i mallkuar)!"* Këtu le të shtojmë edhe këshillën për të mësuar përmendësh dhe përdorur si lutje ajetet 97 dhe 98 të sures Mu'minun.

Ajetin Kursi e ka këshilluar dhe porositur vetë Profeti. Një shok i tij pati kapur një shpirt të keq në trajtë njeriu që donte të vinte dorë mbi mallin e caktuar për zekat. Me qëllim për të shpëtuar, shpirti i keq i pati thënë kështu atij: "Më lësho që të të mësoj një lutje që të ruheni prej nesh. Ajo lutje është ajeti Kursi!" Në lidhje me këtë ngjarje dhe me fjalët e shpirtit të keq, Profeti pati thënë: *"Ai është gënjeshtar, por këtë herë ka thënë të vërtetën!"*

Kur çifutët i patën bërë magji Profetit, magjia qe zgjidhur me këndimin e sureve Felek dhe Nas të quajtur muavidhetejn, dy ndihmësit. Siç tregon Hz. Aisheja, *"Profeti këndonte në mëngjes e në mbrëmje nga tri herë suret Felek dhe Nas, frynte në pëllëmbët e bashkuara si grusht dhe të tri herët fërkonte trupin gjer ku t'i arrinte dora"*. Gjithashtu, në mëngjes e mbrëmje Profeti këndonte nga tri herë lutjen *"Bismil'lahil ledhi la jedurru measmihi shej'un fi'l erdi ue la fi semai ve huve semiul Alim"*, e cila, me leje të Zotit, është sigurim nga paraliza. Gjithashtu, *"Eudhu bi kelimatil'lahi tammati min kul'li shejtanin ve hammetin ve min kul'li ajnin ve lammetin",* është ndër lutjet e kështilluara dhe të provuara.

Kështilla e imam Gazaliut është këndimi 1 herë "*Bismil'lahi Rrahmani Rrahim"*, 10 herë "*Allahu Ekber"*, 19 herë *"La juflihu sahiru hajthu eta"*; gjithashtu, këndimi i *"ue min sherrin neffathati fil ukad"*. (Ta-Ha, 69; Nas, 4)

Sipas këshillës së një personi tjetër, duhet vepruar kështu: në fillim pihet një të gëlltitur ujë, çaj ose supë, pastaj këndohen dy ajetet e mësipërme dhe kjo gjë përsëritet 19 herë.

Ka edhe shumë lutje për të cilat duhet parë në librat e hadithit ose duhen pyetur personat kompetentë. Veçanërisht këshillohen As'habi Bedr, Xheushen dhe Kaside Burde.

f) Shembuj nga shërimi prej xhindeve dhe shpirtrave të këqinj.

1) Kur njëri prej të afërmve të mi qe paralizuar, i qe kënduar Kaside Byrde për një javë me radhë dhe, me lejen e Allahut, qe përmirësuar.

2) Te gruaja e një shokut tim që e doja shumë, u shfaqën shenja të shqetësimeve psikike menjëherë pas martese. Shtangej, sytë i shtrembëroheshin dhe thoshte: "Erdhën!" Nuk lanë mjek pa shkuar. Edhe një profesor i shquar u mor me të, por pa rezultat. Më në fund, një hoxhë i njohur për suksese në raste të tilla, e këndoi për një muaj me radhë dhe, me lejen e Allahut, e sëmura pati një përmirësim të dukshëm. Një radhë, mora me vete një letër ku shkruheshin emrat e luftëtarëve të Bedrit dhe shkova te shoku për t'i bërë një vizitë. Unë isha duke ngjitur shkallët kur u dëgjuan thirrjet e gruas nga dhoma. Unë u ndala dhe ia lashë letrën të shoqit, shokut tim. Ai u ngjit lart dhe, sapo ia lëshoi letrën gruas sipër, ajo zuri të bërtasë: "Pse ikni, apo pse erdhi Hz. Hamzai?" Unë nuk e di se si mund ta shpjegoni ju këtë, por ajo motra jonë e bekuar tani është shëruar plotësisht.

3) Dhe tani le t'i përcjellim disa vëzhgime të një shokut tonë nga goja e vet:

"Kur ndodhesha me detyrë në një zonë të qytetit I., më erdhën dy të rinj rreth të tetëmbëdhjetave që dukej se i përkisnin shoqërisë mondane. Po më prisnin jashtë tek po dilja nga xhamia. Ndër sy u lexohej qartë një shqetësim. Më erdhën pranë me ndrojtje dhe më thanë: "Në aksh zonë, ne organizonim seanca të thirrjes së shpirtrave dhe xhindeve ku merrnin pjesë djem dhe vajza. Shpirtrat dhe xhindet vinin, luanin me filxhanët dhe bisedonin me ne me shkronja lëvizëse. Pas një farë kohe, e lamë këtë punë ose dëfrim, quajeni si të doni. Por s'deshën ata ta lënë. Dhe vazhdojnë ende të na shqetësojnë ditë e natë. Na i lëvizin shtretërit, luajnë me kapakët e dollapëve, etj. Meqë s'dinim si të shpëtonim prej tyre, erdhëm në xhami. Ja, edhe tani këtu pranë ndodhen, në rrëzë të asaj peme atje!" Unë i ftova brenda në xhami. Aty biseduam gjerë e gjatë. Shfrytëzova gjithçka dija për t'u thënë se këto gjëra janë të rrezikshme e të dëmshme dhe se mund të kapërcehen vetëm me dije, kulturë, besim dhe lutje. Pastaj u shkrova disa lutje dhe ua dhashë me vete.

Në mbrëmje isha tërhequr në dhomën time e po lexoja një libër kur papritmas më hynë fëmijët e mi që gjer aty po luanin në dhomën e tyre. "Baba, - më thanë të trembur, - në dhomën tjetër u ndezën dritat dhe dikush është brenda!" E kuptova. Tani kishin ardhur te unë për të më kërcënuar për të rinjtë që i kisha ndihmuar. Hapa librin e lutjeve që e kisha mbi tavolinë dhe nisa të lexoj emrat e luftëtarëve të Bedrit. Unë s'kisha mbaruar së lexuari kur dritat në dhomën tjetër u shuan dhe zhurmat heshtën!"

4) Një shok tjetër që shërbente në një xhami të një zone tjetër të qytetit I., më ka treguar:

"Sa herë që ngjitesha në minare për të kënduar ezan, dëgjoja zhurmë hapash nga pas. Kjo më ndodhte veçanërisht mbrëmjeve. Pas namazeve të mbrëmjes dhe jacisë, kur të gjithë besimtarët kishin dalë dhe unë përgatitesha të shuaja dritat e të largohesha, dritat shpesh shuheshin më parë se të prekja çelësat. Dhe kjo gjendje vazhdoi aq gjatë, sa nuk durova dot më dhe u transferova në një xhami tjetër."

5) Një fshatar më pati treguar këto gjëra:

"Një natë, si çdo herë tjetër, po rrija vetëm në koliben pranë arës në fushë. Kështu bënim të gjithë gjatë verës për t'i ruajtur bimët dhe prodhimet nga tufat e derrave. Në një zonë të gjerë përreth s'ndodhej e s'lëvizte gjë. Pranë kisha armën. Isha shtrirë dhe, ashtu, kisha dremitur pak. Dremitjen ma prishi hapja e papritur e derës. Kush mund të ishte në këtë orë pas mesit të natës? Në derë u duk gruaja ime me fener në dorë! Ishte e pamundur që ajo të mund të vinte gjer këtu e vetme në këtë orë të vonë! Dhe s'kishte pse! E kuptova menjëherë si qëndronte puna dhe nisa të këndoj lutjet që dija. E ardhura u kthye, tërhoqi derën pas dhe u largua!"

6) Dikujt i kishin dalë nëpër duar nishane që po e shqetësonin shumë. Ai tregon: "Kurrsesi s'po më zhdukeshin! U vërtita doktor më doktor, por pa rezultat! Më zhdukeshin përkohësisht, por më dilnin shpejt prapë! Me këshillën e dikujt, këndova një lutje që s'më kujtohet. Të nesërmen duart dhe krahët i kisha krejt të pastra! Veç kësaj, lutjen ia këshillova edhe një të riu tjetër që vuante si unë. Kur u takuam pas disa ditësh, më tha i gëzuar: "Edhe unë u shërova! Ja, të gjitha m'u zhdukën!"

Ka shumë e shumë ndodhi të ngjashme me këto që s'mund të shpjegohen kurrë me shkaqe fizike. Prandaj specialistëve tanë u bie për detyrë që, në vend të nënvleftësimit absolut të këtyre rasteve si dhe të dukurisë në përgjithësi, gjë që nuk sjell asnjë dobi, ta studiojnë çështjen, t'i studiojnë rastet dhe të nxjerrin konkluzionet përkatëse.

VIII. DJALLI DHE DYSHIMI

1. Djalli dhe funksioni i tij

Para se ta kundërshtonte Zotin, djalli merrte pjesë së bashku me engjëjt dhe bënte punën që bënin edhe ata. (Kehf, 50) Ndërkaq, meqë nuk ishte si engjëjt e krijuar prej drite, nuk ndodhej nën garanci. Siç është thënë edhe më parë, engjëjt nuk kundërshtojnë, nuk ngrenë krye, por bëjnë atë që u urdhërohet. (Tahrim, 6) Natyra vërtetë e djallit, entiteti i vërtetë i tij doli në shesh pasi iu propozua t'i përulej njeriut të parë, Ademit, për ç'shkak embrioni i mendjemadhësisë dhe fara e revoltës të pranishme në qenien e tij, por të pashfaqura gjer atëherë, plasën dhe u zhvilluan me vrull. Djalli tha duke iu drejtuar Zotit me

mendjemadhësi: *"Unë jam epror ndaj tij sepse atë e krijove nga balta, kurse mua prej zjarri!"* (Sa'd, 76) Sipas deklaratës së ajetit kuranor dhe, ashtu siç thotë edhe imam Shibliu, gjersa ngriti krye, djalli quhej Iblis, pastaj u quajt shejtan, djall, dhe iu dha mundësia të rronte gjer në kiamet. Pas kësaj, djalli iu betua Zotit kështu: *"Do t'u futem njerëzve nga e djathta e nga e majta, nga para e nga prapa dhe do t'i prapësoj!"* (A'raf, 17)

Këtu duam ta sqarojmë me përparësi këtë specifikë: Në luftë, para se të merret vendim për ta sulmuar armikun ose për t'u mbrojtur prej tij, nuk studiohen një e nga një të gjithë individët-ushtarë të armikut, por përbërja dhe fuqia ushtarake e reparteve dhe nënreparteve, armatimi dhe rezervat luftarake, aftësitë e manovrimit, epërsia në armatim, pozicioni ose pozicionet që ka zënë, etj. Studimi dhe njohja e ngjyrës së flokëve dhe syve të oficerëve dhe ushtarëve, tipi i veshjeve dhe veçori të tjera personale s'vlejnë për kurrgjë. Kështu qëndron puna edhe me xhindet.

Lidhur me këtë çështje, e rëndësishme dhe themelore për ne është të përcaktojmë rrugët nga mund të na afrohet djalli, mënyrat dhe dredhitë e tij për të na goditur në besimin tonë që është garancia e jetës sonë të amshuar, dhe të gjejmë rrugëzgjidhjet e duhura.

2. Cila është urtësia e krijimit të djallit dhe e lejimit të tij për t'i prapësuar njerëzit?

a) Po të mos krijohej djalli, krijimi i njeriut s'do të kishte asnjë kuptim. E para, Allahu ka shumë krijesa si engjëjt që kurrë nuk bëjnë mëkat dhe që nuk ndikohen për të keq nga djalli. Ashtu siç ka krijuar ndryshe nga njeriu, bimët dhe kafshët, Allahu ka dëshiruar të krijojë njerëzit si pasqyra që i pasqyrojnë artet hyjnore ndryshe nga engjëjt. Ndërkaq u ka kundërvënë njerëzve djallin dhe shpirtrat e këqij si elementë provokimi dhe nxitjeje dhe pretekst zhvillimi me qëllim për të zhvilluar dhe nxjerrë në shesh mundësitë dhe aftësitë që përmbahen në natyrën dhe entitetin e njerëzve, qenien esenciale të tyre. Djalli që e reflekton jashtë mendjemadhësinë dhe shtysën e rebelimit, vepron në mënyrë të vetëdijshme. Djalli është si një maratonist kundërshtar që e ndjek njeriun nga pas. Për të arritur në finish, për të dalë fitues, për t'u shkëputur nga ky kundërshtar i përjetshëm që s'i ndahet, njeriut i duhet ta lërë pas, të jetë gjithmonë në krye dhe shumë para tij. Po qe se njeriu nuk do të kishte një kundërshtar dhe armik që do të mund të bëhej për të element provokimi dhe nxitjeje, njeriu kurrë nuk do ta bënte këtë garë serioze dhe t'i zhvillonte mundësitë dhe aftësive e veta; më saktë, njeriu nuk do të gjente dot terrenin për t'i zhvilluar mundësisë dhe aftësitë të cilat, më në fund, do të atrofizoheshin së bashku me njeriun. Njeriu e ka arritur nivelin më të lartë njerëzor dhe pozitën e njeriut të përsosur me anë të luftës kundër këtij armiku të përjetshëm. Në të njëjtën kohë, kur i ka munguar forca, dëshira dhe vullneti i duhur, njeriu e ka humbur këtë garë duke rënë nën nivelin më të ulët të qenieve!

b) E keqja nuk qëndron te krijimi i djallit, por te ndjekja e tij dhe kryerja e të keqes. Ashtu siç ndodh që në një krim, si shkak i vërtetë i krimit tregohen jo thika apo arma e zjarrit të përdorura në atë krim, por duart që i përdorën, pra, njeriu, në të njëjtën mënyrë, edhe djalli është një vegël e përgjakur e përdorur në aktet e këqija apo kriminale të kryera nga njeriu dhe fajtori i vërtetë, dora e përgjakur që e përdori atë vegël. Sigurisht, nuk është djalli shkaku i vërtetë i përfundimeve të këqija të arritura nga kryerja e disa akteve të këqija prej egos te njeriu dhe vullnetit të hyrë nën urdhrin e egos. Djalli dhe të këqijat janë nga një shkak banal më vete; shkaktari i vërtetë është vullneti i njeriut. Njerëzit bëjnë të këqija jo se është djalli, por me anë të vullneteve të veta.

c) Njeriu është i prirur ta vlerësojë çdo gjë në kuadrin e vet të ngushtë dhe sipas rezultateve të vogla që ka në dorë, kurse akti krijues i Zotit sheh kah rezultatet dhe dobitë e përgjithshme. Për shembull, po ta fusim dorën në zjarr, do të na digjet; megjithëkëtë, a mund të themi që zjarri është krejt i dëmshëm? Zjarri ka një sërë vetish dhe cilësish. Jemi ne që e bëjmë atë të keq e të dëmshëm apo të mirë e të dobishëm. Dhe, po t'i shohim rezultatet e përgjithshme të përdorimit të zjarrit, do të arrijmë në përfundimin se ai është

shumë i dobishëm e i nevojshëm. E tillë është energjia elektrike. I tillë është shiu. I tillë është edhe djalli. Duke u bërë pjesë e dëshirave dhe vullnetit të njeriut të keq, djalli e shtyn atë për në xhehenem, skëterrë. Kurse duke e nxitur vullnetin e njeriut të mirë për t'u larguar prej tij, si vrapuesi që përpiqet t'i shkëputet në vrapim kundërshtarit që e ndjek nga pas, djalli bëhet shkaktar për lartësimin moralo-shpirtëror të njeriut të mirë, për fitoren parajsore të tij. Ky është funksioni i djallit.

d) A mund të themi për zjarrin, rrymën elektrike apo shiun, "më mirë të mos ishin" duke i konsideruar të këqij vetëm duke parë disa rezultate negative të pjesshme e jo rezultatet e tyre të përgjithshme? Jo! Në të njëjtën mënyrë, s'mund të themi se "pse u krijua djalli". Ashtu siç ndodh që, bie fjala, për një gisht të gangrenuar nuk e vrasim trupin e shëndoshë, por vetëm gishtin e vdekur e presim, po ashtu, nuk duhet të kundërshtojmë ekzistencën e djallit që na sjell dobi të mëdha, për shkak të një sërë gjërash të këqija. Meqë në shërbimin ushtarak apo në luftë ka vrasje dhe vdekje, a mund të themi që të mos shkojmë ushtar ose në luftë? Si kjo, dëmet që mund t'i shkaktojë besimit djalli duke ia zbukuruar të keqen njeriut, janë apo s'janë një me një mijë në raport me dobitë që i sjell besimit profeti. "Si mund të ndodhë" – do të thoni. Nuk mund të thuhet se "a nuk shkojnë në xhehenem mijëra njerëz nën mashtrimin e djallit?" Sepse cilësia te besimtari është edhe më e rëndësishme se sasia te mohuesi, edhe më me epërsi. Kush ka më shumë rëndësi, jeta e një njeriu, apo jeta e një mijë insekteve? Ndërsa nga një mijë fara hurme, vetëm 11 arrijnë të mbijnë dhe bëhen pemë, a është më mirë të kesh një mijë fara, apo 11 pemë hurme?

3. Ç'është dyshimi?

Dyshimi është ndjenja e lëkundjes dhe pasigurisë së plotë që shkakton djalli në zemrën e besimtarit duke ia çoroditur imagjinatën me një sërë kujtimesh, portretesh dhe pamjesh. Dyshimi është loja e fundit dhe arma e fundit që luan djalli kundër një njeriu, veçanërisht kundër besimtarit. Duke ia lëkundur bindjet, besimin, qëllimet dhe synimet e shëndosha, duke ia çoroditur imagjinatën me pamje iluzive që e largojnë nga realiteti, djalli ia lëkund njeriut besimin dhe sigurinë në vetvete.

4. Ç'është shenja e djallit?

Shenja e djallit është një pikë e rëndësishme në zemrën e njeriut, veçanërisht besimtarit, ku djalli drejton topin, pushkën, shigjetën, ajo pikë e zemrës të cilën e merr në shenjë djalli. Në zemrën e njeriut, veçanërisht, të besimtarit, është pika ku vijnë e mblidhen frymëzimet engjëllore, si dhe pika e djallit. Krejt si polet minus (-) dhe plus (+) të një baterie elektrike!

5. Cilët njerëz dyshojnë më shumë?

Te myslimanët fillestarë, te ata që e fillojnë punën së pari nuk ndodh dyshim. Dyshimi shfaqet më shumë te disa myslimanë që ia kanë dhënë zemrën fesë, që ia kanë shkëputur djallit nga dora të gjitha lidhjet dhe frerët me të cilat ai kërkon t'i pengojë ose t'i shmangë nga feja për t'i drejtuar atje ku do vetë, që i kryejnë pak a shumë detyrat dhe adhurimet ndaj Zotit dhe që bëjnë përparime në besim. Besimtarët që janë në rrugën e përparimit me aftësitë e zemrës në botën e tyre të brendshme, që janë në ngjitje të vazhdueshme drejt nivelit të njeriut të përkryer, përballen në pikat e vështira të rrugës së tyre me dyshimin si armë e djallit. Po, ndërsa njeriu është duke u lartësuar në qiejt e shpirtit, djalli i ngre nga një kurth në çdo etapë dhe pret. Kur e sheh të përshtatshme, e hedh shigjetën e dyshimit duke marrë shenjë atë pikën e ndjeshme të zemrës së besimtarit, dhe pret rezultatin. Kjo do të thotë se thellësia në besim shkakton smirë dhe reaksion te djalli.

Dyshimi shfaqet disa herë te shpirtrat e ndjeshëm dhe nervozë, kurse, disa herë, te ata që hanë shumë ose janë të dhënë pas trupit. Dyshimi te besimtari nuk ka format e turbullirave dhe depresioneve, por të shqetësimeve të zakonshme. Sado i përparuar të jetë besimtari në besim, mund t'i shfaqet dyshim. Madje,

ka ndodhur që edhe personaliteti më i madh pas sahabëve, shokëve të Profetit, Imam Rabaniu, ka pësuar dyshim. Ashtu siç nuk është kusht që njeriu i prekur nga dyshimi ose i vënë në shenjë për këtë gjë, të jetë një besimtar i shquar në besim, nuk është kusht që njeriu i paprekur nga dyshimi ose që nuk vihet në shenjë, të jetë i qetë.

Te qafiri, mohuesi nuk shfaqet dyshim. Mohimi i mohuesit është, mbase, një mohim i llogaritur, i planifikuar, kryeneç, kundërvënës, armiqësor. Te mohuesi mund të shfaqen turbullira dhe kriza shpirtërore, pakënaqësi e shqetësime të cilat e bëjnë atë agresiv dhe përdhunues. Djalli i fryn atij filozofi të reja e origjinale, i jep ide të reja mohuese dhe, më në fund, e bën mohuesin ta mohojë edhe atë vetë, djallin!

Sigurisht, djalli nuk u jep dyshim atyre që janë regjistruar te ai, që ia kanë lënë frerët e vetes atij dhe që i shkojnë pas si qengj atij. Djalli nuk merret me ata që rrinë urtë e butë brenda atmosferës, brenda fushën magnetike të tij, me symbyllurit që numërojnë në vend, me ata që i kanë trutë te sytë, kurse zemrën, te stomaku! Ata janë viktima gjahu të tij të lidhur këmbë e duar në kafazin e tij, të urtë aq sa kurrë s'u shkon ndërmend të zgjidhen, të ikin e të shpëtojnë. Kështu bashkëjetojnë të dy palët: ata të kënaqur nga djalli dhe djalli, prej tyre, gjer ku mund ta çojnë...

6. Cili është qëllimi i djallit për të shkaktuar dyshim?

Djalli nuk mund të hyjë në zemrën e besimtarit të përgatitur në besim e që i plotëson detyrat adhurimore, nuk mund ta shtyjë atë në mohim. Dhe kurrë nuk e zë dot në zemrën e tij vendin e afërsisë dhe dashurisë për Allahun, e mendimit për sunetin, traditën e Profetit, kurrë nuk arrin dot ta bëjë besimtarin t'i braktisë adhurimet. Sepse, pavarësisht nga çdo gjë, besimtari përparon vazhdimisht, fiton afërsi ndaj Allahut dhe, me shpirtin, ndjenjat dhe trupin, ngjitet lart në një spirale drite. Në këto kushte, djalli mendon kështu: "Të paktën, t'i hedh një gur të fundit, t'ia turbulloj zemrën me shigjetat e dyshimit dhe të përpiqem t'ia prish qetësinë dhe kënaqësinë që ndjen në adhurimet. Ndoshta arrij ta preokupoj, ta mërzis dhe ta bëj të mendojë se kjo apo ajo gjë s'është ashtu siç e ka ditur ai. Atëherë, ai fillon të dyshojë!.." Dhe besimtarit dyshues të qëlluar nga këto shigjeta, fillojnë t'i vijnë në namaz mendime që s'i kanë ardhur ndonjëherë më parë. Pasi merr abdes, mendon se këtë apo atë gjymtyrë s'e ka larë mirë ose e ka harruar pa larë, etj. Dhe merr abdes përsëdyti. Gjëra të tilla vazhdojnë gjersa adhurimet t'i duken të rënda dhe, *na ruajttë Allahu*, t'i braktisë! Më në fund, ai bëhet lodër e djallit që ia ka arritur qëllimit!

Dyshimet mund të jenë të lidhura si me adhurimet, ashtu dhe me vetë besimin. Përtej kësaj, djalli mund t'i stolisë mëkatet duke e turbulluar imagjinatën, mund t'i provokojë ndjenjat dhe mund ta sjellë njeriun në gjendjen e një fantazisti që nuk do t'ia dijë për arsye, logjikë, gjykim!

7. Ç'do të thotë që djalli i afrohet njeriut nga e djathta, nga e majta e nga drejtime të tjera për ta goditur?

Afrimi i djallit te njeriu nga anë të ndryshme ka kuptimin e paralajmërimit në dimensione të ndryshme të njeriut ndaj të këqijave sipas situatave të ndryshme ku ndodhet ai. Njeriu, i cili paraqet një kuptim dhe përmbajtje shumëdimensionale, duke i zhvilluar dimensionet e veta, pavarësisht dhe në kundërshtim me përmbajtjen lëndësore të tij, mund të bëhet i denjë për xhenetin. Në antagonizëm me këtë, djalli përqendrohet për t'i vënë në punë dhe zhvilluar te njeriu cilësitë lëndësore jo vetëm për ta penguar lartësimin e njeriut, por edhe për ta shmangur dhe kthyer pas. Pa dyshim, po qe se secila prej disa mundësive me të cilat është pajisur njeriu për të siguruar disa dobi dhe urtësi, siç janë epshi, ndjenja e dhunës, agresiviteti, zemërimi, furia, arsyeja, ambicia dhe kryeneçësia, nuk zbuten ose nuk bëhen të rregullueshme e të kontrollueshme me anë të besimit, mund të vihen në punë kundër mekanizmit të ndërgjegjes dhe këtë vënie në punë e bën djalli.

Për shembull, për sa kohë që njeriu të mbetet nën mekanizmin e egoizmit frymor (vetjak, sensual), do të thotë se ndërgjegjja, domethënë mekanizma engjëllore, është dhe vazhdon të jetë e shtypur së bashku me të gjitha vlerat dhe atributet e saj të shquara. Kurse, kur zhvillohet dhe del në pah mekanizma engjëllore dhe engjëlloriteti, egoizmi frymor me të gjithë mekanizmën e vet hyn nën urdhrin e ndërgjegjes. Megjithëse djalli e gjen esencën e njeriut, përdor kundër tij vetëm mekanizmën e egoizmit frymor. Djalli nuk afrohet ose nuk mundet të afrohet te mekanizma e ndërgjegjes ose, siç mund të shprehemi ndryshe, te pikat e shquara dhe jetike të ndërgjegjes sepse atje ka vullnet, vitalitet hyjnor dhe vetëdije. Po të dijë njeriu ta përdorë vullnetin, djalli s'i afrohet dot; me flatrat e vetëdijes e të vitalitetit hyjnor, ngjitet dhe qëndron në qiejt e kulturës shpirtërore pa ngecur në pengesat djallëzore. Prandaj, njeriu i këtij brezi që e ka zemrën të mbushur me Zotin, ia mbyll gjithmonë dyert djallit dhe duhet t'ia mbyllë. Atëherë, të gjitha zhurmat, bubullimat dhe furtunat që shkakton djalli, mbeten jashtë njeriut, kufizohen duke qarkulluar vetëm në fushën e vetë djallit!

Fushat djallëzore dhe engjëllore ndodhen, në entitetin e njeriut, aq afër njëra-tjetrës, saqë mund të ndikohen gjithmonë nga njëra-tjetra. Për shembull, efektet radioaktive të një shpërthimi në anën djallëzore e fusin nën ndikimin e tyre edhe anën engjëllore. Siç e prekëm edhe më lart, djalli përdor epshin dhe e shtyn me forcë njeriun në sensualitet; ia pushton mendjen dhe ia rrokullis në dhelpëri; po kështu, ia provokon ambicien, zemërimin, mendjemadhësinë dhe pangopësinë për këtë botë. Ai kërkon t'ua turbullojë botët ndjesore dhe shpirtërore njerëzve që i fut në rrjetë dhe t'i largojë nga vetvetja!

Por djalli nuk na sulmon vetëm duke na bërë që të ndjejmë të këqijat e tij dhe të bëjmë edhe vetë të këqija. Ashtu siç na erdhi nga e majta, na vjen edhe nga e djathta, nga para e nga pas. Vetë Kurani tregon për armiqësinë e egër të djallit kundër Allahut dhe për pohimet e tij të paturpshme për mënyrën se si ka për t'ua marrë mendjen njerëzve për t'i shmangur nga rruga e drejtë. (A'raf, 17) Djalli i del njeriut para dhe ia thyen shpresat për të ardhmen, e bën që ta mohojë ringjalljen. Ai e bën njeriun të mendojë se "feja islame e mbaroi detyrën e saj dhe s'ka për t'u ringjallur më kurrë"! Ai hedh zi mbi zemra duke e treguar të ardhmen të errët e kaotike. Djalli i del njeriut nga pas dhe ia pret lidhjet me të shkuarën, me dritën profetike duke e bërë të mendojë se "kohët ndryshuan, kurse ato gjëra mbetën pas". Ai i bën njeriun ta shajë të shkuarën e vet dhe t'i mohojë rrënjët e veta, ta mohojë prejardhjen e vet. Në këtë mënyrë, duke na i mbyllur të gjitha dritaret dhe kalimet për në të shkuarën e për në të ardhmen dhe pasi na i këput të gjitha lidhjet me të djeshmen e të nesërmen, na ofron neve një mënyrë të menduari me përmbajtje plot helm dhe një filozofi jete me stoli të rreme: "E kaluara dhe e ardhmja janë përrallë, s'ke për të ardhur më në këtë botë, prandaj mos u merr me atë që iku se s'kthehet më, por shih ta shijosh jetën e jo ta shkatërrosh kot..."

Djalli i vjen njeriut nga e majta dhe e tërheq në rrjedha të njohura e të hapura të mëkatit. Veprimtaritë e kolonës së pestë janë veprimtari që i bëjnë ndihmësit e djallit, të cilët i rekruton ai duke u ardhur nga e majta. Të gjitha rrugët e haramit (akteve dhe veprimtarive jolegjitime, të ndaluara, të pabekuara e të dënueshme), të përhapura gjerësisht në ditët e sotme, janë rezultat dhe përfundim i goditjes së njeriut nga djalli nga ana e majtë. Por nuk duam të bëjmë këtu një përshkrim të shëmtuar duke i përmendur këto një e nga një.

Një formë dhe mënyrë tjetër e afrimit dhe e goditjes së djallit është paraqitja e tij me figurën e të drejtës dhe të vërtetës duke ia treguar njeriut gjërat e këqija si të mira dhe kjo është gjëja më e rrezikshme për besimtarin. Duke i shkuar nga e djathta besimtarit që ua ka mbyllur derën mëkateve e që është dhënë me gjithë shpirt pas adhurimit, djalli e bën atë t'i pëlqejë vetja, t'ia dedikojë sukseset vetes, kurse të metat, të këqijat dhe humbjet, të tjerëve. Kështu, djalli arrin ta bëjë atë të shijojë humbjet më të hidhura sikur të ishin suksese. Sigurisht, po qe se me ato që bëjmë dhe tregojmë, synojmë të na lavdërojnë dhe ngrenë në qiell të tjerët, do të thotë se djalli na godet nga e djathta. Një njeri i tillë, pastaj, nuk ka vlerë as kur bën Qaben tavaf, as kur lufton në radhët e para!

Omer bin Abdulazizi i shkruan dikujt një letër monument shprehjeje. Pastaj, duke e dalluar se ka përdorur ca shprehje formale, të zbukuruara e tërheqëse, nga të cilat e kupton se i është përkëdhelur egoja, e gris. Po qe se në ego na vjen një entuziazëm e një gëzim si rrjedhojë e punëve, detyrave dhe shërbimeve që kemi bërë e bëjmë, duhet të mendojmë se në këtë mes mund të jetë përzier djalli dhe, me këtë mendim, t'i drejtohemi Zotit duke e përtërirë fjalën e dhënë. Ajo që na duhet neve, është të mos tregojmë konsideratë për gjërat që i pëlqejnë egos sonë. Gjërat që bëjmë, t'i bëjmë sepse i ka urdhëruar Zoti, kurse kënaqësitë që i ka të nevojshme akti, t'i lëmë për në jetën tjetër.

Çdo njeri është i detyruar t'i mendojë favoret e Zotit për të dhe, në çfarëdo posti që të ndodhet, të falënderojë për faktin që Zoti e ka bërë të merituar të favoreve të Tij. Ai do të çojë në vend përgjegjësinë ndaj Zotit dhe detyrën për ta falënderuar Atë, kurse Zoti, si rrjedhojë imediate të mëshirës së Tij të gjerë, do t'u japë një thellësi të veçantë favoreve sipas qëllimit dhe sinqeritetit të njeriut.

Veç këtyre, në kuptim të përgjithshëm, mund të mendoni edhe këtë: djalli vjen nga e djathta dhe i tregon çështjet e mëdha, si të vogla, kurse të voglat, si të mëdha. Në çdo komë mund të hasni një njeri të tillë: është mysliman, haxhi dhe një nga ndjekësit e rregullt të xhamisë. Allahu mos e ndaftë nga adhurimi! Mirëpo në shtëpi ka fëmijë që s'falin namaz. Ndërkaq, nuk i plas zemra për këtë, por për gjëra të vogla, për të cilat grindet vazhdimisht në xhami! Rrugët janë plot me të rinj të mjerë, mes të cilëve janë edhe djali, vajza apo nipi i tij, mirëpo ec e shih se, në vend që t'i mendojë këto e të dëshpërohet, në vend që të kërkojë zgjidhje për këto, ngrihet dhe grindet për të meta ose mangësi të vogla. Njerëz si ky nuk i lënë t'u shpëtojnë pa ia bërë të vdekurit të shtatat, të dyzetat, gjashtë muajt dhe motmotin dhe ju zënë me top po s'i bëtë edhe ju këto dhe ceremoni si këto. Në shtëpitë e tyre, në vendin më të zgjedhur është një Kuran që askush nga pjesëtarët e asaj familjeje s'e di se ç'thotë! Ja, pra, situata si këto janë "kroshé nga e djathta", më të rënda se goditjet e djallit nga e djathta!

8. A ka dyshimi anë të dobishme?

Në fakt, siç e prekëm edhe më lart, në esencën e shumë vetëve, veçanërisht të natyrave të ndjeshme, dyshimi është një zemberek që do t'u shërbente përjetësisht si shtytje në zhvillimin e tyre. Krejt si zembereku i orës, edhe zemra e tyre punon pa pushim nëse është e kurdisur me dyshim dhe i çon përpara, sepse në sajë të tij, prova dhe lufta vazhdojnë gjer në vdekje. Në një besimtar me besim të shëndoshë dhe punë me vend që e ka shtënë në dorë egon e vet, burimi që e detyron të zhvillojë të ashtuquajturën "luftë të madhe" dhe i përfton shpërblimin e fitimtarit, është dyshimi.

Me një tjetër aspekt të tij, dyshimi e mban njeriun vazhdimisht të zgjuar e syçelë. I qetë dhe i kënaqur si rrjedhojë e suksesit në detyrë dhe zotërimit të situatës, myslimani duhet të rrijë vazhdimisht i zgjuar si ushtari me gishtin në këmbëz për të mos rënë në ndonjërën prej gropave të armikut djall që s'di ç'është gjumi. Ashtu si i sëmuri që i lutet e i përgjërohet Zotit se është i sëmurë, edhe njeriu i lëkundur, para çdo shenje dyshimi thotë "aman, o Zot!", e tendos veten para rrezikut, mbyllet brenda një kalaje ku s'mund të hyjnë mëkatet, dhe shpëton. Mjafton që, siç do ta theksojmë, të mos e zmadhojë dyshimin duke e bërë të rrezikshme.

9. Masat parandaluese për të shpëtuar nga dyshimi.

a) Dyshimi rrjedh nga fuqia e besimit.

Në fillim le ta bëjmë të qartë se dyshimi nuk është ndonjë gjë shumë e frikshme, sepse është besimi pra shfaqet dyshimi. Kur një nga shokët i pati shkuar Profetit dhe i qe ankuar se e kishte zënë dyshimi, ai i qe përgjigjur: *"S'ka gjë për t'u shqetësuar, ai është vetë besimi, rrjedh nga fuqia e besimit!"* Djalli zhvillon piratëri ndaj jush dhe ju sulmon pikërisht pse jeni të pasur, pse keni margaritarin e besimit, thesarin e adhurimit,

pasuritë e namazit dhe shërbimit ndaj fesë. Piratëria ndoshta ka kaluar dhe është mbyllur në faqet e historisë me formën e saj të grabitjes në det, por, me aspektin e saj djallëzor, ka filluar me njeriun dhe profetin e parë, Ademin, dhe do të vazhdojë gjer në kiamet.

Ashtu si piratët e detit që i grabisnin me dhunë anijet tregtare të pasura ose me mallra të çmuara si dhe sulmonin ishujt ku ndodheshin thesare, ashtu dhe djalli e sulmon zemrën e besimtarit që bart me vete margaritarin e besimit. Fundja, djalli nuk merret me zemrat e thara, boshe e të pandjeshme, nuk u hedh shigjeta dyshimi. Edhe vjedhësit e zakonshëm, nuk hyjnë në shtëpitë e varfra, por në të pasurat. E ç'kanë për të vjedhur në shtëpitë e varfra, pa gjë? A s'është kështu si në Lindje, ashtu dhe në Perëndim?

Besimtari që bie në dyshim, duhet të mendojë kështu: "Djalli u mund në të gjitha frontet, prandaj tani kërkon të më preokupojë mua me dyshime mbi besimin dhe Islamin, të vërë dorë mbi thesarin tim, por nuk ka për të shkëputur dot gjë prej meje. Këto janë përpjekjet dhe përpëlitjet e tij të fundit. Do të vijë një ditë që, kur ta kuptojë se s'ka për të shkëputur dot gjë prej meje, do të largohet, ashtu siç largohet lypsari që vjen disa herë te dera, por, kur sheh se nuk i del gjë, ikën për të mos u kthyer më kurrë. Edhe në qoftë se këmbëngul për të mos ikur, duhet t'i mbyllen dyert. Kalanë unë e kam të shëndoshë, prandaj, me lejen e Allahut, s'më bën dot asgjë!"

b) Dyshimi nuk është pjesë përbërëse e zemrës.

Nuk i duhet ngarkuar dyshimi zemrës vetëm pse zemra është e shqetësuar. Dyshimi nuk është pjesë përbërëse e zemrës, ndryshe, zemra nuk do të ndjehej e shqetësuar dhe e acaruar prej tij; nga ana tjetër, edhe djalli nuk do të merrej me një zemër të tillë!

Shqetësimi dhe acarimi i zemrës ka këtë shkak: zemrës nuk i pëlqen dyshimi dhe dyshimi nuk është i zemrës. Meqë mes dyshimit dhe zemrës nuk ka ndonjë lidhje kuptimore, përmbajtësore e cilësore, zemra ndjehet e shqetësuar dhe e acaruar prej dyshimit. Reaksionin që tregon dikush ndaj dikujt, diçkaje ose ndonjë situate, e kuptojmë nga ndryshimet që ndodhin tek ai: i hipën temperatura dhe skuqet, vetullat i ngrihen përpjetë, koka i dhemb, i hiqet oreksi, nuk i shijojnë gjërat, etj., ashtu siç i ngrihet temperatura dikujt si rezultat i reaksionit fiziologjik të trupit ndaj mikrobeve. Edhe zemra kundërvepron ndaj iluzioneve, mendimeve të huaja dhe dyshimeve të dërguara nga djalli; struktura jonë moralo-shpirtërore, potenciali ynë besimor prodhojnë "antikorpe" kundër "mikrobeve" që na kanë hyrë në zemër dhe atëherë temperatura na ngrihet, zemra na shqetësohet dhe na rreh me forcë. Por po qe se trupi nuk tregon ndonjë qëndrueshmëri dhe dorëzohet menjëherë si demi që, kur sheh gjarprin, bëhet si kec i urtë, atëherë, ashtu si antikorpet që dorëzojnë armët para virusit të AIDS-it, edhe puna jonë ka marrë fund. Po qe se zemra dhe besimi ynë nuk tregojnë qëndresë ndaj dyshimit që na ka hyrë, atëherë s'ka shqetësim dhe acarim dhe me këtë i thuhet djallit "eja e bëj ç'të duash"! Dhe djalli këtë do!

c) Zemra e goditur nga dyshimi i përngjet pusit të pastër ku dikush ka hedhur papastërti.

Çështjen mund ta mendojmë edhe kështu: Kemi një pus me ujë të pastër e të kulluar. Ka edhe veti shëruese, aq i mirë që është! Nami i këtij pusi ka marrë dhenë. Mirëpo, një ditë, një njeri i keq hedh në pus papastërti, gjëra të huaja e të ndyra. Ju e shihni dhe thoni: "Bobo, m'u fëlliq pusi, uji i tij s'pihet më!..." Por s'është e vërtetë. Uji i pusit vjen nga një burim i rrjedhshëm. Ai nuk është ujë i ndenjur, prandaj dhe është aq i mirë. Rrjedha e ujit ka për t'i marrë me vete papastërtitë dhe lëndët e huaja dhe pusi do të bëhet përsëri i pijshëm e shërues. Turbullira që pësoi pusi nuk ishte e tij. Kështu është edhe me zemrën që e turbullon dyshimi...

ç) Po qe se dyshimi nuk është i vullnetshëm dhe nuk reflektohet në praktikë, njeriun s'e bën përgjegjës.

Siç e dini, që njeriu të quhet përgjegjës dhe i përgjegjshëm, duhet të ketë vetëdije dhe vullnet. Veç kafshëve, edhe njerëzve me të meta mendore dhe vetëdije të çrregulluar ose të sëmurë mendorë dhe të

pavetëdijshëm nuk u bëhet propozim; ata nuk ngarkohen me përgjegjësi dhe nuk janë të përgjegjshëm për veprimet që bëjnë. Nisur nga kjo, po qe se dyshimi ynë nuk është i vullnetshëm dhe po s'ia hapëm vetë dyert dyshimit, nuk quhemi përgjegjës. Mjafton që dyshimin të mos e reflektojmë, të mos e vëmë në praktikë. Vullneti e gjen veten përballë dyshimit që vjen kështu, vetvetiu, dhe nuk i bën dot qëndresë se ka ardhur i paftuar. Veçanërisht, njeriu, me anë të bashkëshoqërimit të ideve, duke u nisur nga gjërat që dëgjon e lexon, mund të bjerë në mënyrë të pavullnetshme nën ndikimin e një sërë kujtimesh, iluzionesh dhe mendimesh. Në të vërtetë, shpesh është e pamundur për të shpëtuar nga ky fenomen, sepse kjo është në natyrën e njeriut.

d) Dyshimi është si një rrjetë merimange që nuk e pengon dot njeriun të shkojë më tutje.

Me paqëndrueshmërinë e vet karakteristike, dyshimi nuk është i dëmshëm kur njihet. Kurani konkludon: *"Pa dyshim, dredhia e shejtanit është e dobët!"* (Nisa, 76) Pra, djalli ka dredhi, por të dobët, sikur të mos e kishte. Për shembull, ju duhet të kaloni përmes një korridori të ngushtë mes dy muresh, mirëpo, mu në mes të korridorit, një merimangë ka thurur një rrjetë nga muri në mur duke e zënë rrugën. Por a mund të jetë ajo pengesë që ju të shkoni më tej? Pa dyshim që jo. Ju s'e shihni si pengesë rrjetën e merimangës dhe kaloni duke e prishur atë.

Profeti na thotë se nuk është djalli që i detyron njerëzit për të mohuar, për të bërë të këqija dhe mëkate. Ai nuk e kap dot njeriun për dore për ta çuar ose detyruar në mëkat. Puna që bën djalli është vetëm stolisja dhe zbukurimi i të këqijave, kamuflimi i tyre si të mira e tërheqëse. Është Allahu që i krijon edhe të mirën, edhe të keqen, që edhe orienton, edhe çorienton. Dyshimet e djallit janë si pallate ngjyra-ngjyra prej flluske sapuni. Ato duken të bukura nga jashtë, por brenda janë bosh, janë një gropë e rrezikshme!

Dyshimi nuk shkakton dëm kur dihet se është kalimtar, i përkohshëm. Dyshimi është i dobët si një pupël që e merr me vete edhe flladi më i lehtë. Dyshimi u përngjet reve që mblidhen për një çast, por pastaj menjëherë shpërndahen pa lënë pas as shi, as fllad. Dyshimi është si gropa ajrore ku bie për një çast avioni; as duhet bërtitur, as duhet vajtuar!

dh) Dyshimi nuk shkakton asnjë dëm po qe se nuk qëndrohet shumë mbi të dhe nuk bëhet çështje serioze.

Dyshimi nuk bëhet i dëmshëm kur e dini se s'ka për t'iu ngjitur mendimit tuaj për ta fëlliqur atë. Dyshimi është, në pasqyrën e imagjinatës, një gjurmë e përkohshme dhe e dobët që shuhet shpejt, një pamje që s'ka për të lënë njollë dhe një reflektim shumë i lehtë. Po qe se gjërat që vijnë në mendje dhe imagjinatë janë me burim të dobishëm, u japin një farë drite mendjes dhe mendimit, kurse po qenë një dyshim me burim të keqeje dhe intrige, prapëseprapë nuk ndikojnë mbi mendjen, mendimin dhe zemrën, nuk lënë papastërti dhe nuk shkaktojnë dëm. Ju mbani në dorë një pasqyrë dhe ja tek reflektohet në të një gjarpër. A mund t'ju dëmtojë ju gjarpri i reflektuar mbi pasqyrë? Gjithashtu, a mund t'jua ndyjë duart një papastërti që reflektohet në pasqyrë? A mund t'jua djegë duart flaka që reflektohet në pasqyrë? Po si kjo, produktet e katabolizmit që bartim përkohësisht në trup, nuk na e prishin namazin, pluhuri përreth një cope diamanti, nuk ndikon mbi të ose mbi vlerën e tij. Po si kjo, edhe sikur djalli të ketë një prani esenciale dhe individuale të brendshme ose të jashtme tek ne, shigjetat që hedh, pamjet që dërgon nuk janë të qëna dhe nuk shkaktojnë asnjë dëm.

Dyshimi nuk shkakton asnjë dëm nëse nuk përqendrohemi mbi të, nëse nuk e mendojmë me kërshëri e shqetësim, nëse nuk e pranojmë e nuk i dalim për zot, nëse, duke e nënvleftësuar, nuk i japim mundësi të fryhet dhe nëse nuk e bëjmë çështje shqetësuese. Atë do ta shihni gjithmonë nga maja dhe do të thoni me vete: "Me lejen e Allahut, do të godas nga poshtë e do ta mund!"

e) Dyshimi bëhet i dëmshëm kur përfytyrohet si i dëmshëm.

Po të veprohet në kundërshtim me ato që treguam gjer këtu, dyshimi mund të shkaktojë dëm. Nëse nuk dihet se dyshimi është i padëmshëm, për pasojë, përfytyrohet si i dëmshëm, bëhet i dëmshëm. Dyshimi është i dëmshëm kur përqëndrohet mbi të dhe trazohet me kërshëri e shqetësim. Sa më shumë të vlerësohet, sa më shumë të zmadhohet, aq më shumë fryhet ai dhe, duke u kthyer në një ballon, na thith përbrenda. Në rrugën tuaj ndodhet një koshere bletësh. Brenda saj ka me qindra bletë që, po i ngacmove e të sulmuan, të shkaktojnë vdekjen. Prandaj ti kalon i qetë pranë kosheres dhe s'të ndodh asgjë. Kështu duhet vepruar edhe me dyshimin.

Djalli na hedh në imagjinatë kuadrin e një pamjeje të dobët dhe kalimtare. Po qe se na duket tërheqëse dhe e zhvillojmë më tej, ajo pamje e dobët e përbërë prej vetëm një kuadri, shndërrohet në një shirit filmik disaorësh, madje pa i rënë ne më të! Sidomos kur njeriu mbetet vetëm dhe kur ky njeriu është një i ri dhe pamjet kanë karakter sensual... Ai e merr kuadrin dhe e kthen në një film aventuresk. Ndërkaq, i djallit është vetëm ai kuadri i dobët. Prandaj, i duhet shmangur atij grepi, nuk duhet t'ia lejojmë vetes të biem në atë grep, në mënyrë që djalli, pastaj, të mos ketë mundësi të na vërë në punë për të na i kthyer përfytyrimet në realitet duke na bërë të biem viktimë e asaj pamjeje prej një kuadri...

ë) Shpirtrat e ndjeshëm e nervozë nuk duhet t'i japin rëndësi dyshimi të djallit për të mos u kapur pas iluzioneve.

Më shumë në shpirtrat e ndjeshëm dhe nervozë, dyshimi mund të kthehet në një sëmundje të dëmshme dhe në një shqisë të brendshme më vete. Kur i vjen dyshimi, një njeri i tillë, duke patur frikë se mos dyshimi do t'i shkaktojë dëm, shqetësohet, e zë paniku dhe e lëshon veten pas iluzioneve. Pastaj, në vijim, duke e zmadhuar këtë me mendje, me zemër dhe duke e parë nga këndvështrimi i besimit, ia ngarkon vetes dhe, me kohë, e kthen në shprehi dhe njësohet me të, gjë që do të thotë të biesh në pesimizëm para djallit dhe të dëmtohesh plotësisht. Dikush që ka rënë në këtë gjendje, thotë shpresëhumbur: "Unë mora fund!" Ai e pranon humbjen. Përfytyroni një komandant që sheh larg në të djathtë disa vezullime metalike, jepet pas iluzionit se armiku do të sulmojë nga e djathta dhe e zhvendos për në atë anë krahun e djathtë të ushtrisë së tij duke i lënë pozicionet mbrojtëse bosh. Pastaj sheh nga ana e majtë ku ka mal dhe pyll, dhe, ngaqë asnjë gjethe s'lëviz, i bëhet sikur armiku është fshehur aty dhe prej andej do ta sulmojë. Kështu, komandanti i jep mundësi armikut t'ia sulmojë qendrën e dobësuar dhe ta asgjësojë. Kjo do të thotë të mos dish se ç'është taktika dhe të mos e njohësh armikun. E shihni se, ndërsa dyshimi i futur nga djalli s'ka vlerë as sa një kuti shkrepseje, njeriu e stërmadhon, e bën të rrezikshëm dhe ia lëshon kokës së vet! Të kemi kujdes, të mos e zmadhojmë dyshimin në imagjinatën dhe mendimin tonë!

f) Të largohemi nga fusha magnetike e dyshimit me anë të adhurimeve dhe të dalim nga ndikimi i tij psikologjik.

Silluni ndaj dyshimit në mënyrë që të largoheni nga fusha e tij magnetike. Ashtu siç është thënë në hadithet, porositë profetike, kur të ndodhë një gjë e tillë, bie fjala, kur të zemëroheni, nëse jeni në këmbë, uluni, nëse jeni ulur, shtrihuni ose ngrihuni në këmbë, merrni abdes dhe falni dy rekate namaz dhe bëni një ndryshim në botën tuaj të brendshme, në veçanti, bëni një sërë sjelljesh e veprimesh të lejueshme që do t'jua shpërndante mjegullën. Duke futur në veprim vullnetin, kërkoni një pretekst qoftë edhe të vogël që do të ndikonte në psikikën tuaj, që do t'ju nxirrte nga boshllëku ajror ku mund të keni rënë pa e pasur në dorë ose t'ju shkëpuste dhe largonte nga rryma elektrike ku mund të jeni kapur. Kur një radhë, duke u kthyer nga një fushatë, diku, pas një pushimi, Profeti nuk qe ngritur dot për në namazin e mëngjesit – gjë që s'i pati ndodhur më kurrë – u pati thënë shokëve: *"Largohuni menjëherë prej këtu se djalli këtu ka ngritur sundimin dhe mbretërimin e tij!"* Po, gjithmonë duhet bërë kujdes ndaj fushës magnetike të djallit dhe, në se është hyrë aty pa dashje, duhet larguar shpejt e shpejt. Po qe se indiferentizmi, mosinteresimi dhe pakujdesia janë për djallin dhe gjërat djallëzore, nga një perspektivë e bukur më vete, virdet dhe dhikret, shpallja e Allahut dhe hyrja në lidhje me Të janë, kundër të gjitha forcave të së keqes një mbrojtje, një

apologji, madje, një sulm. Për shembull, diku, Profeti tregon se djalli ikën nga zëri i ezanit. Kjo do të thotë se djalli nuk i duron dot ezanin dhe kuptimet që përmban ezani. Prandaj, sapo që djalli të kalojë në sulm me anë të dyshimeve, edhe ne duhet ta forcojmë lidhjen me Allahun dhe Profetin dhe të kridhemi vetëm në kujtime të larta. Mund të thuhet se kujtimi i miraxhit të Profetit i pret si me thikë dyshimin, veçanërisht kujtimet gjatë namazit, madje edhe hapjen e gojës. Shtrëngimi i grushtit dhe kërcënimi ndaj dyshimeve me qëllim nxitjeje për gjëra haram, të ndaluara, ose edhe nënvleftësimi duke i anashkaluar dyshimet me një buzëqeshje, janë shprehje të vigjilencës ndaj fushës magnetike të djallit.

Më kujtohet se një shokut tonë të ri i pata thënë kështu: "Kur djalli të del para e të kërkon të shohësh drejt diçkaje haram, të ndaluar, mendo kështu: Ç'do të arrij me të parë? Do të shoh, do të shoh, rezultati, zero! Edhe sikur ta çoj më tej këtë punë, prapë asgjë!.. Jo vetëm kaq. Janë edhe pendimi dhe vuajtja që do të të shkaktojë besimi. E ç'kuptim do të kishte një shikim i tillë i kotë, i errët dhe shqetësues?!" Në fakt, ndërsa njeriu përpiqet ta bindë veten kështu, ajo pamje e ndaluar me kohë ka kaluar!..

Çdo dyshim që vjen në mendje, çdo pamje e stolisur mund të fshihet duke menduar më të mirën, më të përsosurën që do të arrihet në të ardhmen. Në shumë vende të Kuranit thuhet se jeta e kësaj bote është një lojë e dëfrim dhe se jeta e vërtetë është jeta e pasosur pas ringjalljes, vendbanimi i vërtetë është atje. (Al Imran, 185; Ankebut, 64) Nëse dyshimi të propozon spinaq dhe kungull, Allahu të thotë se *atje ka fruta të gatshme për t'u këputur njëra pas tjetrës...* (Hakka, 23) Dhe pa u shqetësuar nga mostretja, dhimbja e barkut apo jashtëqitja. Në këtë mënyrë mund t'u japim ne përgjigje dyshimeve në lidhje me gjërat e ndaluara e të pabekuara. Kurse për gjërat e mira e të bukura të kësaj bote, do të themi, siç shprehej poeti Junus Emre, *jepi atij që të kërkon ç'të duash Ti, mua më duhesh Ti, më duhesh Ti!* A mos kërkon djalli t'ju tërheqë në breg të detit apo në vende të freskëta duke bërë si pretekst vapën përvëluese të verës, për t'iu shmangur nga shërbimi? Ia kujtoni atij se zjarri i xhehenemit është më përvëlues dhe pandeh se dyshimi dhe lëkundja që ka kërkuar t'ju shtjerë në zemër, do t'i mbetet në fyt atij!

Gjithashtu, më duket se, duke menduar se nuk është aspak me vend që, ndërsa na presin Profeti dhe ndjekësit e tij besnikë, ne të përsillemi andej-këtej më kot dhe në një gjendje të pahijshme, mund ta eliminojmë dyshimin dhe lëkundjen që kërkon të na shtjerë djalli duke na sugjeruar indiferentizmin dhe rehatinë.

g) Nuk duhet t'u jepen rëndësi as dyshimeve dhe lëkundjeve të formës "a mos e lashë mangët" në abdes dhe namaz.

Nuk duhet t'ua vëmë mendjen as dyshimeve dhe lëkundjeve që na vijnë në abdes dhe namaz lidhur me përpikmërinë e veprimeve. Po t'ju ndodhë një gjë e tillë për herë të parë, mund ta përsërisni abdesin ose namazin. Por po u përsërit, për shembull, po qe se dyshoni vazhdimisht nëse e keni larë një organ ose gjymtyrë, duhet ta hidhni poshtë dyshimin, duhet ta quani se e keni larë dhe të shkoni në namaz. Edhe në namaz, nëse përsëritet dyshimi ose lëkundja mbi faljen apo jo të të gjitha rekateve, duhet vepruar me mendimin se namazi është falur në rregull.

Nuk duhet përqendruar në mënyrë të përsëritur mbi gjërat mbi të cilat bie dyshimi. Jo të qëndrohet mbi dyshimin, por të veprohet krejt në të kundërtën. Duhet shkuar me mendimin se edhe sikur të jetë bërë ndonjë gabim, qëllimi është i mirë. Synimi është të goditet djalli dhe të largohet dyshimi.

PJESA E TRETË

MENDIME MBI KADANË, KADERIN DHE FALJEN

INTRODUKTE

Kader do të thotë *matje, prerje, formësim, trajtësim*. Në arabisht, folja paskajore *kadera* do të thotë *caktim, ndarje në pjesë* dhe *caktimi i një pjese për secilin*. Kurse folja e kohës së shkuar *kadera* do të thotë *konkludoi, aksidentoi, ekzekutoi*. Atëherë themi se kaderi është *"má jukaddirullahu mine'l kadá ve jahkumu bih"*, "ajo që Allahu caktoi dhe urdhëroi nga kadaja".

Para se ta trajtojmë çështjen në thellësi, mendojmë se është e dobishme të citojmë disa ajete kuranore lidhur me kaderin.

"Çelësat e të fshehtës janë pranë Tij. Ai e di se ç'ka në tokë e në det. Nuk ka gjethe që bie, nuk farë të groposur në thellësitë e errëta të tokës, nuk ka gjë të njomë e të thatë që të mos jetë në Librin e qartë!" (En'am, 59)

"Nuk ka gjë të fshehtë në qiej e në tokë që të mos jetë në Librin e qartë!" (Neml, 75)

"Pa dyshim, Ne i ngjallim të vdekurit dhe i shënojmë ç'marrin me vete e ç'lënë pas. Ne e kemi shënuar çdo gjë në një Libër të qartë!" (Jasin, 12)

"(O i Dërguar!) Pa dyshim, ky libër i zbuluar për ty është një Kuran i famshëm që ndodhet në Leuhi Mahfudh!" (Buruxh, 21-22)

"Dhe thonë: "Nëse jeni fjalëdrejtë, na e tregoni, kur do të ndodhë ky ndëshkim?" Thuaju: "Atë e di vetëm Allahu. Kurse unë jam vetëm një paralajmërues!" (Mulk, 25-26)

Në një kuptim, kadaja dhe kaderi janë e njëjta gjë, kurse në një kuptim tjetër, kaderi është paracaktimi (vendimi i paracaktuar) i Allahut, kurse kadaja është ekzekutimi (akti ekzekutiv) i këtij paracaktimi ose vendimi të paracaktuar.

Kaderi është, nga ana e Zotit që zotëron dijen e pafund dhe që i sheh si një pikë të vetme të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen pasi për qenien e tij nuk ka të kaluar, të tashme dhe të ardhme, planizimi dhe

programimi i universit me tërë imtësitë e tij, nga mikrobota në mikrobotë, nga molekulat në sistemet e gjer te njeriu në planin e tyre informativ dhe me strukturën e tyre informative, caktimi, përcaktimi, klasifikimi dhe miratimi i tyre sipas planeve dhe projekteve përkatëse dhe, me qëllim për t'i marrë të gjithë këta nga gjendja informative dhe e projektuar për t'i kaluar në gjendjen e vullnetit, dëshirës dhe fuqisë dhe për t'i treguar në shfaqjet e tyre të jashtme trupore në botën e krijimit, përcaktimi dhe miratimi i të gjithë këtyre para se të ndodhin, në një Libër "të qartë".

Libri i qartë është shkrimi (hedhja në shkrim), nga ana e engjëjve të nderuar të Allahut, e materies që sapo ka filluar të zërë vend në vargun e shfaqjes (trupore), në Tabelën e Shkatërrimit dhe në Argumentim në formën e kopjeve të Tabelës së Kujtesës.

Gjithashtu, kaderi është përputhja dhe koherenca mes asaj çka arrin dhe fiton njeriu dhe asaj çka krijon Allahu. Me fjalë të tjera, kur njeriu inicion dhe i futet një pune, Allahu, po deshi, e krijon atë punë. Ja, pra, kaderi është njohja eternale (pafillimisht më parë) nga Allahu me dijen e tij të pafundme e këtyre dy specifikave kryesore si dhe, gjithashtu, përcaktimi dhe miratimi eternal i tyre (para se të ndodhin) nga ana e Tij.

Kaderi nuk mund të mendohet pa vënë në llogari vullnetin dhe arritjen e vetë njeriut.

Në gjithësi sundojnë në mënyrë evidente kaderi, plani, programi, masa dhe ekuilibri. *"Allahu e di se ç'bart çdo femër dhe se ç'ka në mitra. Çdo gjë është pranë tij në një masë të caktuar."* (Ra'd, 8) *"E shtruam tokën, ngulëm mbi të male të sigurt dhe nxorëm atje gjëra të përshtatshme e të matura."* (Hixhr, 19) *"E ngriti qiellin dhe vuri balancën."* (Rrahman, 7)

Në gjithësi sundon një kader aq i gjerë dhe gjithëpërfshirës, saqë asgjë nuk mund të përfytyrohet jashtë tij. Allahu që e ka krijuar gjithësinë, nga plasja e farës në pranverë, nga lindja e njeriut në lindjen e galaktikave, në çdo gjë, me diturinë e tij përfshirëse, ka përcaktuar një plan dhe program dhe ka vënë një kader të tillë që, dje e sot, dijetarë, shkencëtarë dhe studiues nga të katër anët e botës, me mijra veprat e tyre përpiqen të bëhen interpretues të këtij rregulli, të kësaj harmonie e të këtij vendimi. Fakti që edhe marksistët, madje, i pranojnë disiplinat e përgjithshme me emërtime të ndryshme, si determinizëm, ka shumë rëndësi përsa i përket pranimit nga kushdo, mik e armik, besimtar e mosbesimtar, se në gjithësi ekziston një plan dhe kader. Ajo çka mendojmë ne nuk mund të jetë kurrë një determinizëm siç e mendojnë marksistët. Ne vetëm donim ta preknim çështjen nga këndvështrimi i kaderit qoftë edhe në një kuptim tjetër. Ç'është e vërteta, edhe një pjesë autorësh islamë si Ibni Halduni duken si përkrahës të një lloj determinizmi dhe, si në mendimin perëndimor të kohëve të fundit, për shembull në historizëm, e përfshijnë këtë determinizëm edhe në jetën e shoqërisë, por ne, brenda mendimit suní, e lidhim këtë me kushte të caktuara dhe e shprehim me "ndoshta". Brenda këtyre përmasave, ne besojmë se në çdo gjë, ku përfshihet edhe vullneti i njeriut, sundon një kader i përgjithshëm. Sigurisht, ndërsa kur duam të ndërtojmë një orë apo ndërtesë, ne në fillim përgatisim projektin e saj të imtë duke vendosur që në letër për çdo detaj dhe raportet e tij me detajet e tjera. Atëherë, a mund të mendohet që mes këtyre sistemeve marramendëse, brenda botës së atomeve dhe në marrëdhëniet mes njerëzve të mos ketë një plan dhe program të caktuar? Ndërsa një apo shumë sisteme me një të mijtën e rregullsisë dhe ekuilibrit të kësaj bote materiale që drejtohet pa ndodhur në të as shmangia, çrregullimi apo përplasja më e vogël, nuk mund të drejtohen as me kompjuterë gjigandë, a ka mundësi të mendohen gjithë këto universe me madhësi dhe shkëlqim marramendës pa plan e pa program?

Farat janë arkëza të ngarkuara me kader. E gjithë jeta që ka për të kaluar në të ardhmen pema është regjistruar te fara me të gjitha etapat dhe imtësitë e saj. Shumë fara që, për nga struktura duken të njëjta dhe përbëhen nga të njëjtët elementë të thjeshtë, kur bien në tokë, prej tyre dalin lule të shumëllojshme, bimë dhe drurë të një mijë llojeve. Çdo farë merr formën dhe trajtën informative dhe të entitetit të caktuar nga

kaderi për të ose brenda përmasave të bëra kader (të paracaktuara) për të dhe del mbi tokë duke iu shfaqur syve vëzhgues me formën, trajtën dhe rrobën e vet të posaçme. Edhe sikur mijëra rrobaqepës të përpiqen për vite me radhë për t'i bërë një veshje të tillë vetëm një peme, jo mijërave, nuk do t'ia arrinin dot. Kurse qindra-mijëra pemë ndoshta prej qindra-mijëra vitesh janë kah veshin e zhveshin njëra pas tjetrës rroba të prera e të qepura pas asnjë gabim si të ishin të porositura për trupin e secilës më vete. Dhe, duke e bërë këtë, mos janë ato vetë apo është një vendosës i lartë që u jep atyre atë formë, atë trajtë, atë kader?

Si rrjedhojë e kushtëzimit ndaj një kaderi dhe programi të caktuar, spermatozoidi kurrë nuk gënjen; me gjuhën e kromozomeve, me detyrën që s'e humb toruan të RNA-së dhe DNA-së dhe me shprehjen e qelizave, thotë "do të bëhem njeri me gojë, gjuhë, buzë, sy, vetulla, veshë, fytyrë, ndjenja, aftësi, etj." dhe bëhet.

Sipas astrofizikanëve, është e qartë qoftë edhe pak se ç'dimensione ekzistojnë në çdo pikë të universit, ç'efekt magnetik ekziston aty dhe se i ç'lloji është ai. Sepse intensiteti i sipërfaqeve dhe forcave gjeometrike ekziston që më parë. Edhe me shpikjen e kompjuterave është kuptuar se çdo qenie e krijuar në univers nga atomet gjer te galaktikat, krijohet e programuar ose, e thënë ndryshe, është njëkohësisht e programuar. Sigurisht, çdo gjë është e caktuar dhe e vënë qysh më parë në Leuhi Mahfudh (në Tabelën e Kujtesës).

ËNDRRAT DHE KADERI

Edhe ëndrrat janë argumente të ekzistencës së kaderit. Ashtu siç e shpjeguam pjesërisht në temën mbi shpirtin, pamja në ëndrra që më parë e një ngjarjeje çfarëdo që do të ndodhë në të ardhmen dhe realizimi identik i saj kur i vjen koha vë në shesh se çdo ngjarje është e caktuar dhe vendosur qysh më parë. Po, ne e lexojmë në ëndërr qysh më parë një faqe të librit tonë të jetës dhe pastaj vërejmë se ajo që kemi lexuar vërtetohet në praktikë!

Edhe fakti që Kurani, Profeti dhe njerëzit e urtë të lartësuar shpirtërisht njoftojnë në këtë apo atë mënyrë për ngjarje që kanë për të ndodhur në të ardhmen, tregojnë se në çdo gjë sundon kaderi; ndryshe, si do ta dinin diçka që s'do të ishte e shkruar, e përcaktuar dhe e vendosur?

Pyetje: Pse kanë hyrë kaderi dhe vullneti mes gjashtë parimeve besimore?

Përgjigje: Shpesh herë, për shkak shprehie, njeriu ia dedikon vullnetit dhe mundësive të veta relative favoret që i ka bërë Allahu, duke thënë "unë e bëra, unë fitova, unë e gjeta, unë e mësova, unë e mendova", etj. Në këto raste, kaderi i del menjëherë para dhe i thotë: *"Është Allahu që ju krijon ju dhe bëmat tuaja!"* (Saffat, 96) Prandaj mos harro se kush je! A është e mundur t'i bësh të gjitha këto punë me atë buton të vogël që ke në dorë? Jo!" E kështu, duke e shpëtuar njeriun nga krenaria, i siguron baraspeshën dhe proporcionalitetin në jetë.

Në shpirtin e njeriut është ndjenja e përvetësimit të bukurisë, aftësive dhe produkteve, lavdërimi dhe krenimi me to, madje, më tej, rënia në ekstazë nga krenaria e lartë për to. Ja, kundër një ndjenje të tillë, për të treguar se i zoti i vërtetë i të gjitha bukurive, mirësive dhe dobive nuk është egoja, por vetëm Allahu, ndërkaq që të gjitha të këqijat dhe mëkatet burojnë nga egoja, kaderi bën këtë paralajmërim: *"Çdo e mirë që të vjen ty, është nga Allahu, kurse çdo e keqe që të vjen, e ke nga vetja. Ne të dërguam ty përfaqësues te njerëzit*

dhe Allahu mjafton si dëshmitar për këtë!" (Nisa, 79) Dhe ju kthejeni pas shiritin e kujtesës suaj për të parë në të kaluarën tuaj që, ndërsa ndodheshit mes mëkatesh, kaderi ju futi mes shokëve më të mirë, jua mjekoi mendjen dhe shpirtin, si përfundim, në zemrën dhe buzët tuaja çelën burbuqet e mëshirës, kurse në gjoksin tuaj u varën medaljet e moralit dhe adhurimit. Mendoni mbi të gjitha këto dhe, pastaj, nëse mund të thoni "unë i bëra", thoni!..

Çështja ka edhe një aspekt të dytë. Kohë pas kohe njeriu mund të mendojë edhe kështu: "Meqë është Allahu që na ka krijuar edhe mua, edhe bëmat e mia, meqë unë nuk mund të dëshiroj gjë pa dëshiruar Ai dhe meqë unë jam pothuaj si një robot i programuar nga kaderi, atëherë cila është pjesëmarrja apo ndërhyrja ime në bëmat e mia që të jem përgjegjës dhe fajtor (mëkatar)?" Kështu, ai mund të bjerë në gropën e fatalizmit. Dhe, përballë një rreziku të tillë, nxjerr para vullnetin e vet dhe, duke hipur në anën tjetër të peshores, thotë: "Jo! Je i përgjegjshëm dhe përgjegjës! Ashtu siç je përgjegjës për të besuar dhe adhuruar, je përgjegjës edhe për të gjitha të këqijat që ke bërë dhe të gjitha mëkatet ku ke rënë!" Në këtë mënyrë, siguron drejtpeshimin e duhur. Atëherë, themi se as kaderi s'është mbështetje për t'ia ngarkuar drejtpërdrejt besimin, mosbesimin, përgjegjësinë, pendimin dhe mëkatet dhe këllëf për t'i mbuluar shëmtitë e egos, as vullneti s'është mjet dhe shkak që njeriu t'ia dedikojë vetes aftësitë, mirësitë dhe bukuritë e krijuara tek ai nga Allahu duke thënë faraonisht "unë" dhe, duke harruar tërë dobësinë dhe varfërinë e vet, t'i quajë të tijat dhuntitë e favorizuara pa shpërblim nga Allahu. Ne mund të shpëtojmë nga rreziku që vullneti ynë të hedhë të dy duart menjëherë mbi tërë bukuritë, mirësitë dhe dobitë dhe të krenohet e të mbahet më të madh me virtytet dhe vlerat që i rrinë sipër si një këmishë e dhënë amanet, vetëm me anë të kaderit; në anën tjetër, mund të shpëtojmë nga rreziku që egoja jonë të tentojë të shmanget nga përgjegjësia dhe përgjegjësitë, vetëm me anë të vullnetit dhe është pikërisht kjo "sirati mustakim", "rruga e drejtë" e trajtimit të vullnetit dhe kaderit.

Njeriu ka dy duar mjaft të shkurtra për t'i arritur mirësitë dhe bukuritë, kurse dy duar mjaft të gjata për t'i arritur mëkatet dhe prishjet. Njërës prej këtyre dy duarve të gjata i duhet dhënë pendim dhe pendesë që t'i bëhen pengesë prirjes së egos ndaj të këqijave dhe mëkateve, t'ia thyejnë veprimet e përdhunshme dhe t'i mbyllen të gjitha rrugët që çojnë në xhehenem, kurse tjetrës, lutje, orientim dhe nënshtrim ndaj Zotit për ta aktivizuar drejt mirësisë, forcë dhe dëshirë ndaj bukurive për ta entuziazmuar në rrugën e xhenetit.

Një kujtesë e rëndësishme:

"E kaluara dhe fatkeqësitë shihen nga këndvështrimi i kaderit, kurse e ardhmja dhe mëkatet, nga këndvështrimi i vullnetit!"

Me një vështrim të tillë, njeriu edhe pajtohet me shqetësimet dhe fatkeqësitë e së kaluarës duke thënë "paska qenë kaderi im", dhe s'bie në pesimizëm, edhe tregon se është i vetëdijshëm për përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e tij në vlerësimin e të ardhmes së vet.

Për njeriun që nuk mundet t'i shohë të kaluarën dhe fatkeqësitë e hequra në të kaluarën, nga këndvështrimi i kaderit, bëhet e pashmangshme që të mbetet i paralizuar para çdo ngjarjeje shpresëthyese dhe persekutuese, që të ankohet vazhdimisht për gjendjen e vet, ta godasë kokën sa andej-këtej, për më tepër, si përfundim, të bjerë në batakun e mëkatit dhe dëfrimit. Kurse për njeriun që nuk mundet ta shohë të ardhmen nga këndvështrimi i vullnetit, bëhet gjithashtu e pashmangshme që t'ia ngarkojë të këqijat dhe mëkatet e veta kaderit dhe të fundoset më thellë në batakun e dëfrimit. Ashtu siç ia dyfishon njeriut fatkeqësitë dhe ia vyshk dhe than botën ndjesore dhe jetën shpirtërore ankesa ndaj fatit, ashtu dhe shmangia dhe çaktivizimi i vullnetit janë, në të njëjtën mënyrë, një gabim i madh dhe, për të keqe të vet, dorëzim i mendjes dhe zemrës egos, djallit dhe mëkateve. Në këto kushte, jemi të detyruar ta rregullojmë jetën duke vënë në një anë të peshores vullnetin dhe në anën tjetër, kaderin, për ta mbajtur peshoren e jetës në ekuilibër.

Pyetje: A mund të lexohet kaderi i njeriut nga vijat e duarve ose të fytyrës?

Përgjigje: Personat që merren seriozisht me çështjen e shpirtit, krahas thënies se shpirti i njeriut është dublanti i tij ose ka një trup precedencial, flasin edhe për fatin e paracaktuar e të parashkruar të tij. Pretendohet se, kur njihen entiteti dhe funksionet e caktuara të shpirtit, mund të njihen në një raport të caktuar edhe se ç'ka për t'i ndodhur njeriut në të ardhmen, të cilat, Allahu, po të dojë i bën të njohura dhe i tregon.

Gjithashtu, ata që merren me shkencën e fizionomisë, domethënë me kuptimet që shpreh struktura materiale, munden të tregojnë qoftë edhe pjesërisht, nga vijat e dorës si shprehje të reflektimit të kaderit në materie (trup) në formë vijash, ato që kanë për t'i ngjarë njeriut në të ardhmen. Të mos keqkuptohemi, kjo nuk do të thotë njohje e të fshehtës, por vetëm, duke përfituar nga shenjat dhe gjurmët e vëna nga Allahu në trupin tonë, funksioni i mundësisë së njeriut për t'i njohur disa aspekte të jetës së vet. Vetëm Allahu mundet ta njohë të fshehtën në kuptimin e plotë të fjalës, ndërkaq që e fshehta nuk përbëhet vetëm prej këtyre lloj informacionesh!

Përpjekja për ta lexuar kaderin duke parë shenjat dhe gjurmët e vendosura nga Allahu në trupin tonë është një ndër çështjet ekzistuese edhe në periudhën e Profetit. Në atë kohë, njerëzit që e bënin këtë punë quheshin "kaifë", lexues të fatit. Në një kohë kur ishin përhapur thashetheme mbi birësinë e Usames ndaj Zejd bin Harithit, libertit të Profetit, Profeti pati sjellë një kaif për t'u dhënë përgjigje thashethemeve. I ati dhe i biri qëndronin shtrirë të mbuluar krejtësisht me përjashtim të shputave të këmbëve. Kaifi pati parë vijat e shputave të këmbëve të të dy personave dhe pati thënë se ata kanë lidhje me njëri-tjetrin. Me këtë mënyrë, Profeti ua pati vërtetuar një të vërtetë që e dinte, atyre që merrnin vesh nga gjuha e kaifëve, dhe i pati thënë Hz. Aishes: "O Aishe, Usame është i Zejdit!" Nuk mund të mendohet që Profeti i cili dinte gjëra edhe më të rëndësishme në bazë të njoftimeve të Allahut, të mos e dinte gjendjen e Usames, por, duke sjellë një kaif, pati dashur të përdorte si argument një institucion të pranuar nga populli dhe të shtresuar në jetën shoqërore. Sigurisht, nuk mund të dyshohej mbi pretendimin e Profetit i cili, siç thotë Kurani, *"nuk fliste nga vetja"*! (Nexhm, 3)

Në këtë ngjarje mund të ketë edhe nxitje për t'iu drejtuar fjalës së specialistëve. Po kështu, edhe në ngjarjen e lidhjes të pemëve, Profeti u pati thënë njerëzve: *"Ju i njihni punët e kësaj bote!"* Këtu nuk nënkuptohet "unë s'i di". Po s'diti Profeti, kush do të dijë? Në këto fjalë mund të jenë ndjekur këto synime:

a) Kompliment për sahabët, shokët e Profetit.

b) Në atë kohë, një pjesë sahabësh ende bartnin një sërë bindjesh dhe botëkuptimesh në kundërshtim me besimin monoteist, siç ishte dedikimi i ndikimit të vërtetë shkaqeve. Kështu, natën para paqes së Hudejbijes pati ndodhur një ngjarje e ngjashme. Atë natë pati rënë shi dhe, të nesërmen, Profeti u pati thënë kështu sahabëve: *"Sot disa u gdhinë besimtarë, kurse disa, mohues!" "Si ka mundësi?"* – Patën thënë sahabët. Dhe Profeti u pati bërë këtë shpjegim: *"Kush ka thënë se shiun e lëshoi ylli Sirius, ka gdhirë mosbesimtar, kurse kush ka thënë se shiun e lëshoi Allahu, ka gdhirë besimtar!"* Po si kjo, në atë kohë pemët e hurmave lidheshin (shartoheshin) duke patur bindjen se nga ky veprim ritual merreshin patjetër prodhime të mbara. Qëndrimi i Profetit ndaj kësaj bindjeje pati pasur dy qëllime: edhe t'u jepte mësim njerëzve se çdo gjë ishte në dorë të Allahut, prandaj shkaqet nuk kishin ndonjë ndikim të madh mbi përfundimet, edhe t'u sugjeronte me fjalët "ju i dini punët e kësaj bote" se nuk është kusht që shkaqet e mundshme të nënvleftësohen në mënyrë absolute.

c) Nisur nga cilësia e Hz. Muhamedit si profet dhe imam i njerëzve gjer në kiamet, kjo fjalë mund të merrej si prirje për t'i dhënë asaj karakter juridik. Mirëpo në jetën e njeriut ka një sërë çështjesh që s'kërkojnë interpretime dhe zgjidhje juridike, siç janë çështjet e zakonshme të jetës që i përkasin përvojës së përditshme dhe rutinës dhe kalohen ose kapërcehen në heshtje. Ndërkaq, shkencat përparuan aq shumë, saqë për të

nxjerrë zogj, vezët nuk lihen 21 ditë nën klloçkat. Tani inkubatorët nxjerrin zogj me metoda teknologjike me produktivitet të lartë. Po kështu, për të marrë prodhim të pandërprerë dhe me rendiment e cilësi më të lartë, përdoren serat. Kush e di, ndoshta në të ardhmen, me anë të pasqyrave gjigande të vendosura në stacionet kozmike, do të mund të reflektohet drita dhe energjia diellore në vendet e ftohta për të marrë, siç thotë Kurani, fruta në çdo stinë. Në përfundim, do të arrihet një bollëk i tillë saqë nuk do të gjendet njeri për t'i dhënë zekat!

d) Duke thënë "ju i dini punët e kësaj bote", Profeti lë portë hapur për të ardhmen! Nga një aspekt tjetër, duke mos u thënë në mënyrë të përcaktuar "lidhini" ose "mos i lidhni", Profeti ua ka lënë të lirë njerëzve ndërgjegjet dhe vullnetet si dhe i ka nxitur të përpiqen e të bëjnë kërkime për ta gjetur vetë se si është më e mira!

Shkurt, besimi te kaderi është domosdoshmëri e të qenit besimtar i plotësuar. Ashtu siç u besojmë Allahut, të dërguarit të fundit, profetit Muhamed, profetëve të tjerë, engjëjve, librave të shenjtë dhe ringjalljes, ashtu jemi të detyruar t'i besojmë edhe kaderit. Këto parime besimi janë si rregulla dhe shtylla të jetës së këtushme në emër të fitimit të jetës së amshuar. Kur ta trondisim njërin prej rregullave ose njërën prej shtyllave, kemi tronditur ndërtesën që jemi përpjekur të ngremë ose, në rastin më të keq, e kemi shembur. Kurani dhe hadithet përqendrohen seriozisht mbi kaderin. Pas ringjalljes, çështjet mbi të cilat ndoshta përqendrohet më shumë, janë dëshira, dija dhe vendimi i Allahut. Në shumë hadithe, kaderi trajtohet jo brenda parimeve të tjera fetare, por, mbështetur mbi kuptimin dhe rëndësinë, atje ku flitet mbi Individualitetin Hyjnor dhe atributet e Tij dhe bashkë me to. Kjo do të thotë se besimtari që kërkon t'i besojë Allahut në atë kuptim që do Allahu, është i detyruar t'i besojë kaderit. E thënë ndryshe, besimi te kaderi është domosdoshmëri e përsosmërisë së besimit në Individualitetin e Zotit, domethënë, ai që nuk i beson kaderit, nuk konsiderohet se i beson ashtu siç duhet Allahut dhe madhështisë së Tij.

Çdo njeri i beson kaderit sipas nivelit të vet, sepse aftësia ndaj Allahut dhe marrëdhëniet me Të janë të ndryshme. Ai që është në fillimet e besimit ose ka mbetur aty ku e ka filluar, duhet t'i besojë kaderit si një formulë fetare para së cilës e ndjen veten, për inerci, të detyruar, dhe si një parakusht të besimit. Kurse një besimtar i përplotësuar, me një përvojë të gjatë besimi, që ka arritur ta ndjejë në thellësitë e ndërgjegjes veprimin dhe administrimin e Allahut mbi çdo gjë, për çka dhe ka merituar të shohë sesi *"Allahu është bërë syri i tij që i sheh, veshi që i dëgjon, dora që i kap, ..."*, thotë pa asnjë lëkundje dhe mundësi për të kundërtën, "më duket sikur Allahu ma lëviz gishtin". Dhe kjo është një çështje kuptimi, njohjeje dhe këndvështrimi.

Kaderi nuk është çështje dijeje dhe veprimi, por ndërgjegjeje dhe statusi. Një njeriu që s'ka shijuar mjaltë, sado që t'i flisni për shijen, përmbajtjen dhe dobitë e mjaltit ose çfarëdo që të shkruani lidhur me këtë, nuk do të bëni mbi të as efektin që mund të bëjë sikur ai të shijojë vetëm një gisht mjaltë! Ndërsa ekzistenca e Allahut, profetësia dhe çështjet kuranore mund të shpjegohen me analiza shkencore, për ta njohur kaderin me vetëdijen e mirësisë, sikur e shihni si akt të Allahut, ju duhet të trazoni fletët e ndërgjegjes.

Kaderi është një subjekt delikat që të bën të të rrëshqasin këmbët. Ashtu siç njeriu mund të rrëzohet për çdo çast kur ndodhet mbi një truall rrëshqitës, ashtu dhe kaderi është një truall rrëshqitës që mund të të çojë në humbje. Disa dijetarë i kanë ndaluar nxënësit e tyre të flasin mbi çështjen e kaderit, kurse atyre që u kanë thënë "por ju flisni, ama", u janë përgjigjur kështu: "Flas për të folur, por sikur mbi krye të më kishte qëndruar një zog dhe të dridhesha nga frika se mos më ikte!"

Për të dhënë një mendim ose për të arritur në një mendim mbi kaderin, duhet që këto katër specifika kryesore të kuptohen mirë. Ne jemi të opinionit se çdo çështje lidhur me kaderin mund të shpjegohet me këto katër baza:

1) Nivelet e kaderit janë: plani dituror, shkrimi, dëshira, krijimi.

2) Dija e Allahut i njeh të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen si një moment i vetëm.

3) Kuptimi, përmbajtja dhe argumentet qenësore të vullnetit të pjesshëm.

4) Përputhja mes kaderit dhe vullnetit të pjesshëm dhe marrëdhëniet mes tyre.

I. NIVELET E KADASË DHE TË KADERIT

A. Kadaja dhe kaderi nga këndvështrimi i dijes hyjnore

Nga këndvështrimi i dijes hyjnore, kadaja dhe kaderi janë caktimi nga ana e Allahut i planeve dhe programeve të të gjitha pjesëve të materies dhe të dukurive dhe ngjarjeve që do të shfaqen dhe ndodhin gjer në kiamet, si dhe trupëzimi (konkretizimi) i tyre cilësor-sasior. Para se të krijohej universi (gjithësia), sipas shprehjes së hadithit, *"Allahu ishte dhe asgjë tjetër nuk ekzistonte"*. Kur ky univers krijimi dhe shkatërrimi nuk ishte krijuar ende, Allahu e caktoi çdo gjë me dijen e Tij gjithëpërfshirëse dhe të pafundme. Ky akt ishte caktimi dhe konkludimi i çdo gjëje në dijen e Allahut. (Hixhr, 21)

Allahu është përtej çdo gjëje që mund të shkohet në mendje, Ai është krejt i ndryshëm nga ç'mund të mendohet, Ai nuk ka asnjë lloj ngjasimi me krijesat dhe robtë e Tij. Por, për ta shpjeguar kadanë dhe kaderin nga këndvështrimi i dijes hyjnore – mos bëfshim gabim – ndoshta mund të japim këtë shembull:

Kur njeriu dëshiron të bëjë diçka, në fillim e sajon, e përfytyron dhe e projekton në mendje, pastaj kalon në etapën e dytë, e projekton në letër, pastaj vjen etapa e tretë, fillon zbatimin e saj në praktikë e, kështu, gjersa ta përfundojë plotësisht, gjëja e menduar prej tij merr formë konkrete, fiton përmasa cilësore e sasiore etapë pas etape. Ja, ky është trupëzimi (konkretizimi) cilësor dhe sasior në botën materiale i gjësë së menduar si ide.

B. Kadaja dhe kaderi nga këndvështrimi i dokumentimit

Planet dhe projektet, përcaktimi i të cilave bëhet në planin informativ, shkruhen në Librin e qartë: *"Edhe ai Kurani i nderuar është në Leuhi Mahfudh."* (Buruxh, 22). Në Kuran, këtij i jepen emra me pak ndryshime mes tyre, si *Imami Mubin* (Jasin, 12) dhe *Kitabi Mubin* (En'am, 59) dhe thuhet se në këtë libër është e shkruar gjithçka që ka për të na ndodhur (Tevbe, 51) dhe se në këtë libër s'është lënë asgjë pa u shkruar (En'am, 38). Ky është libër bazë dhe në gjërat e shkruara në të nuk ndodh asnjë ndryshim. Leuhi

Mahfudh që karakterizohet nga përkatësia e dijes hyjnore për krijesat, është si një regjistër themeltar dhe libër kryesor origjinal (Ra'd, 39). Si të thuash, duke u marrë për bazë ky libër, bëhen kopjime prej tij, reflektime të tij në tabela, fletore dhe libra të tjerë dhe nxirren shembuj.

Është edhe libri i Allahut *Tabela e Prishjes dhe Dëftimit* (Leuhi Mahv ve Isbat) (Ra'd, 39) ku bëhen fshirjet dhe ndryshimet.

Shkrimi, kopjim-shumëfishimi dhe llojet e tyre

Allahu ka libra (shënime) të qarqeve të ndryshme. Tabelat, faqet, indekset e ekzemplarëve të marrë nga Libri Kryesor, kopjohen dhe shumëfishohen në fletore të vogla. Mos qoftë i gabuar përngjasimi, për shembull, në zyrën e Gjendjes Civile ndodhet Regjistri Themeltar. Nga ky regjistër nxirret për çdo njeri një ekzemplar i posaçëm që ta fusë në xhep ose ta varë në qafë. Kështu, çdo njeri mban të varur në qafë një libër të vogël ku janë të kopjuara nga Libri Kryesor të gjitha ngjarjet e jetës së tij. Në lidhje me këtë, në Kuran thuhet: *"Pa dyshim, Ne shënonim ato që bënit ju!"* (Xhathije, 29)

Mes librit të varur në qafë të njerëzve dhe librit të shkruar nga *engjëjt shkrues*, nuk ka ndryshim. Libri ose ekzemplari në qafë të njerëzve (Isra, 13) që është një ekzemplar i Librit Kryesor që ndodhet në Tabelën e Kujtesës, nuk ka ndonjë trup ose përbërje të veçantë, të jashtme, por vetëm një përbërje informative të padukshme. Në jetën e kësaj bote futet në veprim vullneti i njeriut dhe engjëjt i shkruajnë në formën e një libri sjelljet që janë pesha dhe përbërja e jashtme e vullnetit. Në këtë mënyrë, edhe ato që ka lënë pas njeriu, edhe ato që çon përpara, shkruhen një e nga një pa lënë asgjë. (Jasin, 12) Ja, pra, kur krahasohen këta dy libra me njëri-tjetrin, shihet se mes tyre nuk ka asnjë kontradiktë, por një ngjashmëri dhe ekuilibër të plotë. Po qe se engjëjt do të thonë, "këto janë të shkruarat tona, o Zot", edhe Zoti do t'u tregojë se çfarë ka pasë shkruar dhe, ashtu si në ramazan që dëgjuesit ndjekin në tekst këndimin përmendësh nga hafizët të të njëjtave pjesë nga Kurani, do të vërehet se libri me përbërje informative i shkruar nga Allahu prej Leuhi Mahfudhit (Tabelës së Kujtesës) përputhet plotësisht me librin "praktik" të shkruar nga engjëjt me shënimet për sjelljet dhe veprimet e njerëzve. Dhe kjo tregon se çdo gjë që ka të bëjë me jetën e njeriut në këtë botë është përcaktuar dhe shënuar qysh më parë në Tabelën e Kujtesës. Ndërkaq, duhet kuptuar shumë mirë kjo pikë e rëndësishme e çështjes së kaderit: njeriu nuk sillet ashtu sepse ashtu është shkruar qysh më parë për të, përkundrazi, dihen që më parë se ç'ka për të bërë ai në jetën e kësaj bote duke përdorur vullnetin e vet. Këtë mund ta shprehim me disa pohime të qarta:

- Allahu që me dijen e tij të pafundme, e di qysh më parë se ç'ka për të bërë njeriu, i ka shënuar bëmat e tij në Tabelën e Kujtesës dhe një kopje të tyre ia ka varur njeriut në qafë.

- Njeriu i kryen me vullnetin e vet ato që janë shkruar në librin që i është varur në qafë.

- Allahu i realizon ato që dëshiron dhe për të cilat tregon vullnet njeriu.

- Engjëjt shënojnë një nga një ato që bën njeriu.

- Engjëjt shënojnë sepse bëmat verbale, praktike dhe të vullnetshme të njeriut do t'i hapen parasysh si një libër në botën tjetër, atij do t'i thuhet *"këndoje librin tënd"* (Isra, 14:14) dhe njeriu do t'i thotë me gojën e vet ato që ka bërë, pa gjetur mundësi për të kundërshtuar!

Shënimi në ndërgjegje: Shkrimet e padukshme të këtij libri të shkruar nga Zoti ynë duke marrë fjalë prej nesh ndërsa ndodheshim në botën e shpirtrave apo në botën e molekulave, i shohim në ndërgjegje pothuajse me sytë e shpirtit dhe i ndjejmë. Ky shënim (Araf, 172) i regjistruar në ndërgjegjet, të cilave shpirti që na i komandonte të gjitha molekulat para se ne të kalonim në botën e spermës, iu përgjig në botën e tij duke dëgjuar me veshin e tij dhe duke folur me gjuhën e tij, është shënimi i ekzekutuar në botën *"Elestu birabbikum? - Kalu Bela!"*[10]

[10] A jam unë Zoti juaj? Po, Ti je Zoti ynë!

Shënimi për fetusin: Në çastin kur njeriu fillon të formohet në barkun e nënës, engjëjt bëjnë një shënim dhe kopjim të veçantë. Engjëjt shënojnë pjesën që i takon njeriut nga Tabela e Kujtesës, *nëse ai do të bëhet zotëri apo i shërbëtor*, etj. (Buhari, Muslim).

C) Kadaja dhe kaderi nga pikëpamja e dëshirës hyjnore

Kur dëshira hyjnore lidhet me diçka, ajo diçka menjëherë konkretizohet, pra, *bëhet*. Në dy çështje të trajtuara më sipër, ashtu siç caktimi i çdo gjëje nga Allahu në plan informativ dhe shënimi i saj në forma të ndryshme, ashtu dhe *bërja-krijimi*, pas kësaj, realizohen me anë të dëshirës së Tij.

Në Kuran dhe në gjithësi e shohim dhe e ndjejmë shumë hapur dëshirën hyjnore. Njëra prej fjalëve që përdoret më shumë në Kuran, është "shae" (56 herë) dhe forma tjetër e saj, "jeshau" (116 herë). Me anë të këtyre fjalëve pohohet "dëshirimi i drejtpërdrejtë" i Zotit si dhe fakti që të gjitha etapat e krijimit në gjithësi realizohen si rezultat i dëshirës së Tij! Edhe shprehja "inshaallah", "në dashtë Allahu (Zoti)" që e përdorim për një të pritshme të afërme ose të largët me besimin se, në fund të fundit, realizimi i saj është në dorë të Zotit dhe me lutjen që Ai të na e realizojë në dëshiroftë, pra, në qoftë e dobishme për ne, ka në bazë fjalën "shae" që emërton një një trajtë gramatikore të caktuar dëshirën hyjnore.

Siç e thamë edhe më lart, në Kuran ka shumë ajete lidhur me dëshirën hyjnore, për shembull:

"Ai bën ç'të dëshirojë" (Buruxh, 16); *"Pronësia e tokës dhe e qiejve dhe e çdo gjëje që ndodhet mes tyre është e Allahut, Ai krijon ç'të dëshirojë!"* (Maide, 17); *"Thuaj: Allahu im, i zoti i çdo prone dhe pasurie, Ti i jep pasuri kujt do dhe ia merr pasurinë kujt do, Ti e lartëson kë do dhe e poshtëron kë do!"* (Al Imran, 26); *"Kë dëshiron, e ndëshkon, kë dëshiron, e mëshiron!"* (Ankebut, 21); *"Ai e çorienton kë do dhe e orienton kë do"* (Nahl, 93); *"Po s'dëshiroi Allahu, ju s'mund të dëshironi!"* (Insan, 30, Tekvir, 29).

Siç shihet, dëshira hyjnore e rrethon jetën nga të gjitha anët dhe e bën veten të ndjehet në të gjitha frontet dhe faqet e saj. Veçanërisht, edhe ajo që vëzhgohet në pohimet e të gjithë profetëve dhe në shprehjet e Kuranit, është gjithë po ajo e vërtetë. Edhe shprehjet që këndojmë në librin e gjithësisë, edhe kuptimet që gjen çdo njeri në botën subjektive dhe objektive, domethënë, në veten e vet dhe në gjithësi, s'janë gjë tjetër veç kësaj. Siç do ta trajtojmë më poshtë, ashtu siç nuk mundemi të ndërhyjmë në lindjen dhe perëndimin e diellit, nuk ndërhyjmë dot as në rrahjet e zemrës sonë, as në lëvizjet e kapakëve të syve tanë! Argumentet e mundësisë, akcidencës, rregullsisë, urtësisë, qëllimit final dhe artit që i trajtuam në fillim, duke mbështetur njëri-tjetrin, na tregojnë neve po atë Dëshirë dhe Vullnet!

Dëshira dhe vullneti i Allahut ekzistojnë edhe te e qena, edhe te e paqena, me fjalë të tjera, ajo që dëshiron Allahu të bëhet e paqenë, bëhet e paqenë, kurse ajo që dëshiron Allahu të bëhet e qenë, bëhet e qenë. (Jasin, 82) Ashtu siç u shpjegua te argumenti i mundësisë, qenia dhe mosqenia e gjithësisë dhe materies janë ekuivalente, zgjedhja e qenies së tyre ndaj mosqenies si dhe, gjithashtu, zgjedhja e mosqenies së tyre ndaj qenies janë atribut i Dëshirës dhe Vullnetit të Allahut!

D) Kadaja dhe kaderi nga pikëpamja e krijimit

Gjërat që kemi për të bërë, që kemi për të bërë në një të ardhme të afërt ose të largët, në fillim i dimë dhe i përfytyrojmë në kokë. Në etapën e dytë, nga përfytyrimet bëjmë plane dhe projekte, domethënë, përfytyrimet që kemi në mendje, i hedhim në letër: bëjmë vizatime, plane, projekte, skica, grafikë, etj., të cilat, po na u desh, edhe i kopjojmë dhe i shumëfishojmë. Në etapën e tretë, planet dhe projektet i kthejmë në realitete konkrete në formë sjelljesh, veprimesh dhe objektesh. Po s'vepruam kështu, përfytyrimet i lëmë siç janë, në planin e tyre informativ të përbërë prej të dhënash dhe treguesish të ndryshëm, pa i kthyer në realitete konkrete, pa u veshur një formë dhe trajtë reale. Akti i krijimit i Allahut nuk është i tillë, përkundrazi krejt i ndryshëm nga ç'mund të mendojmë ne, ndërkaq, në dijen e Allahut ndodhet plani dhe

projekti i çdo gjëje dhe këto Ai i ka caktuar në Leuhi Mahfudh, Tabelën e Kujtesës. Dhe, kur vjen koha, i kalon këto, me anë të Dëshirës dhe Vullnetit, nga Dija, në Fuqi, nga mosqenia, në fushën e qenies, ndërsa nuk ekzistojnë, i bën të ekzistojnë dhe, sipas gjendjeve të tyre në Librin Kryesor, i kalon nga paracaktimi informativ në etapën e krijimit praktik.

Nisur nga kjo, për gjërat dhe ngjarjet e krijuara në periudha të ndryshme kohore që zgjaten në të shkuarën, themi se "kështu paskan qenë përcaktuar në Tabelën e Kujtesës dhe kështu janë krijuar sipas atij paracaktimi!" Kurse, nga ana tjetër, edhe për periudhat kohore të së ardhmes te e cila sytë, përfytyrimi, mendimi dhe shpirti nuk na arrijnë dot dhe të cilën njohuritë tona nuk e kapërcejnë dot, themi: "Si të jetë caktuar dhe shkruar në Tabelën e Kujtesës, ashtu do të bëhet (krijohet)" ose, "Si të bëhet (krijohet), ashtu është caktuar dhe shkruar në Tabelën e Kujtesës!"

Në këtë pikë, ajo që duhet të thotë çdo mysliman, madje çdo njeri, është kjo: "Ç'të kem thënë, ç'të kem bërë dhe si të jem sjellë gjer tani, që të gjitha kanë qenë identikisht në dijen e Allahut dhe në Librin e Madh. Çdo gjë që do të them dhe do të bëj në të ardhmen, edhe pse unë s'i di, janë të shënuara në Librin Kryesor. Meqë Allahu, me dijen e Tij të pafundme, i di të gjitha ç'kam bërë e ç'do të bëj me vullnetin tim, ka shkruar: "Me vullnetin e vet do të bëjë kështu e ashtu." Unë nuk mund të dal jashtë këtij shkrimi, por ky shkrim nuk më detyron mua sepse unë s'e di se ç'përmban ai, prandaj çdo gjë e bëj me dëshirën dhe vullnetin tim. Edhe Allahu kështu e ka shkruar këtë duke e ditur qysh në pafillim me dijen e Tij."

Sipas kësaj, na dalin dy lloj kaderesh: krijim dhe urdhërim.

1. Kaderi i përgjithshëm dhe krijimi në gjithësi, ku vullneti i njeriut nuk ka asnjë funksion dhe nuk ushtron asnjë ndikim (urdhri universal dhe krijimi i detyruar). Kaderi i përgjithshëm dhe krijimi i takojnë Allahut. Allahu është i zoti i pronës dhe pasurisë dhe në pronën e tij vepron si të dojë. Ai është Autori i Madh që bën ç'të dojë (Al Imran, 40) dhe askush s'i kërkon dot llogari (Hud, 107).

Mirëpo Allahu është, në kuptim absolut, i drejtë dhe i gjykueshëm. Njerëzit që janë krijesat ose robtë e Tij, mund t'i bëjnë padrejtësi vetes së vet, kurse Allahu në asnjë mënyrë nuk u bën padrejtësi atyre. (Nisa, 40; Junus, 44; Kehf, 49)

Në urdhrin dhe krijimin e Allahut në këtë mënyrë, jashtë vullnetit dhe ndërhyrjes sonë ka shumë urtësi, në këtë krijim shtrëngues, detyrues, ka shumë qëllime, synime dhe dobi. Rrotullimi i tokës nuk është në dorën tonë, megjithatë, është krejtësisht në dobinë tonë. Edhe sikur t'i themi diellit të mos na dërgojë dritë (rrezatim ndriçues, ngrohës dhe jetësor), ai do të vazhdojë të na dërgojë ndërkaq që ne s'i japim asgjë si shpërblim. Pra, dielli punon pa shpërblim vetëm për të mirën tonë. Ne pijmë ujë, kurse një dorë e detyruar i nxjerr jashtë me anë të veshkave mbeturinat dhe papastërtitë e formuara pas përdorimit të tij. A mos është kjo kundër interesit tonë? Nga 24 orëshi me vlerë ari që na është dhënë, ne i japim dhënësit vetëm ndonjë orë dhe marrim si shpërblim një karakter të pajisur me virtyte që do t'i bënin ziliqarë edhe engjëjt, kurse në jetën tjetër, pallate parajsore! Ç'favor i madh, ç'kader i bukur!

2. Urdhri dhe krijimi ku marrin pjesë edhe dëshira dhe vullneti i njeriut (urdhrat juridike-fetare), si namazi, agjërimi, lufta në rrugën e Allahut, shmangia nga prostitucioni, etj.

Dëshira dhe krijimi hyjnor lidhen me të dy llojet e kaderit dhe urdhrit. Edhe krijimin e ngjarjeve dhe dukurive që zhvillohen në gjithësi jashtë vullnetit tonë, edhe krijimin e ngjarjeve dhe dukurive të urdhëruara prej Tij duke marrë parasysh dëshirën dhe vullnetin e njeriut, si rezultat i veprimeve të vetë njerëzve, Allahu i dëshiron dhe i bën me anë të dëshirës së Tij. Ndërkaq, në lidhje me këtë llojin e dytë të krijimit (ku Allahu merr parasysh dëshirat dhe vullnetin e njerëzve dhe përdor veprimin e tyre), Allahu mbetet i kënaqur nga disa akte që i krijoi, kurse mbetet i pakënaqur nga disa akte të tjera. për shembull, Allahu e urdhëron namazin, e dëshiron kryerjen e tij dhe, duke vepruar me anë të vullnetit të njeriut, e krijon aktin e namazit duke mbetur i kënaqur prej tij. Por Allahu nuk i do mohimin dhe mëkatin, por, kur njeriu priret me

dëshirën dhe vullnetin e tij për të mohuar ose mëkatuar, edhe dëshira e Tij zhvillohet në atë drejtim dhe Allahu i krijon mohimin dhe mëkatin por pa mbetur i kënaqur prej tyre. Si kjo, bie fjala, Allahu nuk i do ngatërresën dhe dhunën (Bekare, 205; Al Imran, 22-57), por kur njeriu me dëshirën dhe vullnetin e vet priret dhe vihet t'i kryejë ato, Allahu i krijon (mund t'i krijojë, nuk i krijon detyrimisht gjithmonë) ngatërresën dhe dhunën por pa kënaqësi. Prandaj themi se, krahas të mirës, Allahu është ai që i krijon gjërat e dukura të këqija në pamje të jashtme ose në të vërtetë!

Po, ashtu siç e shohim vetë dhe siç e kuptojmë nga ajetet e Kuranit, Allahu është krijuesi i çdo gjëje. Ndërkaq, që të mos e ndjejmë veten sikur na ka rrethuar nga të katër anët me një detyrim dhe shtrëngim të plotë, që të mos mbytemi përballë shkaqeve dhe rrjedhës dhe sulmit të ligjeve dhe ngjarjeve që zhvillohen e veprojnë jashtë vullnetit tonë dhe që ta ndjejmë se mund të dëshirojmë dhe veprojmë me vullnetin tonë, na ka lënë një të çarë, një dritare të hapur, nuk na ka hedhur në hapësirë me duar e këmbë të lidhura, viktima e të pashpresë. Dhe kjo e çarë, kjo dritare e hapur që është si një buton me shtypjen e të cilit ne vëmë në veprime gjëra të mëdha, e ka emrin *vullnet i pjesshëm*!

II. DITURIA HYJNORE DHE MARRËDHËNIA E SAJ ME KADERIN

Me dijen e Tij të pafundme, Allahu i di të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen si një pikë të vetme.

Me qëllim për t'i rrokur dhe kuptuar më mirë marrëdhëniet vullnet-kader, le t'u hedhim një sy disa ajeteve kuranore në rrugën për të mund ta kuptuar sado pak dijen e pafundme të Allahut që e ka nën vëzhgim dhe kujdes gjithçka.

"Allahu e di gjithçka që bëjnë!" (Nur, 41) *"Ndodh që juve të mos ju pëlqejë diçka, mirëpo ajo është në të mirën tuaj; dhe ndodh që ta doni diçka, mirëpo ajo është për të keqen tuaj. Allahu di, ju s'mund të dini!"* (Bekare, 216) *"Ai e di çdo gjë që është në tokë e në qiej!"* (Al Imran, 29) *"Nuk ka gjallesë në tokë që të mos ta ketë Allahu në dorë ushqimin dhe furnizimin e saj. Allahu e di vendin ku ndodhet dhe ku është lënë amanet ajo! Të gjitha këto janë të shënuara në një libër të qartë!"* (Hud, 6) *"Allahu e di edhe të kaluarën, edhe të ardhmen e tyre, kurse ata nuk mund ta rrokin diturisht Atë!"* (Ta-Ha, 110) *"Allahu ia mësoi njeriut ato që nuk dinte!"* (Alak, 5) *"Çelësat e të fshehtës janë tek Ai; Ai e di gjithçka që ka në tokë e në det!"* (En'am, 59) *"Po qe se detet do të ishin bojë për t'i shkruar fjalët e Zotit tënd dhe t'i shtonim edhe me aq, do të mbaroheshin pa mbaruar fjalët e Zotit tënd!"* (Kehf, 110)

Këto nuk janë tjetër gjë veç po atyre të vërtetave për të cilat flet libri i gjithësisë. Ashtu siç fakti që në gjithësi, nga makrokozmosi në mikrokozmos, në çdo gjë, sundon një ekuilibër matematik i ndjeshëm dhe masë, është tregues i një dijeje të pafundme, ashtu dhe mijëra libra të shkruar në çdo degë të dijes i vënë gishtin të njëjtës të vërtetë. Ndërsa gjer dje, gjithë dijet mbi anatominë e trupit të njeriut mund të përmblidheshin në vetëm një libër, sot shkruhen libra të tërë veç e veç për sytë, mëlçinë, zemrën, organet e tjera, madje për qelizat dhe në universitete ngrihen katedra e degë studimi për to si specialitete më vete. Edhe sikur për mijëra vite të tjerë të vazhdojnë të shkruhen libra mbi dijet duke shpenzuar bojë më shumë se ç'kanë ujë detet dhe lapsa më shumë se ç'kanë drurë pyjet, ato që do të jenë mësuar dhe treguar, do të jenë a s'do të jenë ende sa një pikë ujë nga oqeani në sqepin e një zogu!

S'e di, a keni menduar ndonjëherë, duke u parë në pasqyrë, se fytyra nuk ju ngjan me asnjë prej fytyrave që keni njohur gjatë gjithë jetës? Po për shenjat e gishtave ose përbërjen e syve? Kush e di ç'dallime nga të tjerët do të vini re në të ardhmen në veten tuaj dhe do të mbeteni të çuditur! Sigurisht, po t'i shqyrtoni me kujdes pemët, do të dalloni ndryshime serioze mes tyre si në trungun, ashtu dhe në gjethet. Shkencëtarët që

i kanë vëzhguar me thjerrëza zmadhuese flokët e borës, kanë vënë re se asnjë flok bore nuk ka ngjashmëri me ndonjë flok bore tjetër në numrin e molekulave të ujit që përmban dhe në konfiguracionin kristalor.

Ç'kuptim kanë të gjitha këto? Për ekzistencën, në një çast të dhënë, të një fytyre ose të konfiguracionit të gishtave të një njeriu, të pangjashëm me asnjërën prej fytyrave ose konfiguracionit të gishtave të njerëzve që kanë ekzistuar gjer atë çast dhe do të ekzistojnë pas atij çasti, është e domosdoshme ekzistenca e një qenieje me dije gjithëpërfshirëse e të pafundme që i njeh të gjithë njerëzit me fytyrat dhe konfiguracionet e gishtave, të posaçme për secilin, pa i ngatërruar e pa e harruar asnjërin! Ashtu siç i ngulisim ne fytyrat e njerëzve tanë të njohur në kujtesën tonë që është një model shumë shumë i vogël i Tabelës së Kujtesës, dhe, kur i shohim, i njohim, domethënë, i dallojmë nga të tjerët në sajë të cilësive dalluese, ashtu dhe Allahu – krahasimi mos qoftë i pavend – i njeh në pafillimshmëri me dijen e tij të pafundme fytyrat dhe konfiguracionet e gishtave të të gjithë njerëzve që kanë shkuar e do të vijnë dhe i ka shënuar, gjithashtu, në pafillimshmëri, në Librin e Kaderit. Historiku i jetës sonë, i ngulitur në kujtesën tonë, është realiteti i jetuar i asaj që është shkruar për ne; po kështu, edhe fytyrat dhe konfiguracionet e gishtave që shfaqen në jetë me kalimin e kohës, janë realitet i krijimit të asaj që është shkruar.

Me dijen e Tij të pafundme e gjithëpërfshirëse, Allahu i sheh dhe i di të shkuarën e të ardhmen si një moment të vetëm. Ta zëmë se jeni ngjitur në majë të një mali, prej ku mund të hidhni poshtë një shikim konik duke përfshirë me një vështrim aq shumë gjëra që, për t'i parë së afërmi, do t'ju duhej kohë dhe përpjekje. Po kështu, vetëm se përtej çdo lloj mase dhe shpjegimi material, Zoti i di të gjitha ç'kemi bërë në të shkuarën e ç'kemi për të bërë në të ardhmen bashkë me përfundimet e atyre bëmave dhe vullnetin tonë, prandaj përcakton dhe vendos për ne qysh në pafillimshmëri, kurse ne, kur vjen koha, i realizojmë bëmat tona me anë të vullnetit tonë.

Të gjithë e dimë që çdo vit shtypen kalendarë ku shënohen kohët e namazeve të 365 ditëve të ardhshme duke i ditur ato që më parë me hollësi minutash e sekondash. Pastaj, kur vjen çasti, këndohet ezani dhe ne, me vullnetin tonë, lidhim duart para Zotit dhe e kryejmë faljen. Ja, pra, kalendari është njohja dhe përcaktimi që më parë i veprimeve tona, konkretisht i adhurimeve tona!

III. SUBJEKTI I VULLNETIT TË PJESSHËM

A. Argumentet mbi ekzistencën e vullnetit të pjesshëm

a) Ndërgjegjja e bën njeriun ta ndjejë peshën e të këqijave që ka bërë ose bën. Kështu, shpesh herë njeriu ndjen pendesë për ato që ka bërë, përpëlitet nga ankthi, madje ndodh që njerëz të çekuilibruar, për shkak të ankthit dhe vuajtjeve të pendimit, të shkojnë gjer në vetëvrasje! Po qe se njeriu, i privuar nga dëshira dhe vullneti, e bën një gjë i shtrënguar nga kaderi, atëherë pse të vuajë vrasjet e ndërgjegjes, pse të shtypet nën peshën e mëkateve dhe të derdhë lot, pse të pendohet? Dhe pse kur ia thyeni zemrën dikujt shkoni e i kërkoni falje? A s'tregojnë të gjitha këto se ato që bëni, i bëni me dëshirën dhe vullnetin tuaj?

b) A jemi apo s'jemi të lirë në fjalët dhe sjelljet tona, në lëvizjet dhe veprimtarinë tonë? A kemi mundësi t'i lëvizim si të duam krahët, këmbët, duart, gjuhën, apo i kemi gjymtyrët të lidhura në pranga dhe gojën të zënë dhe presim të na i zgjidhin që të bëjmë ato që duam të bëjmë? Kur duam të ulemi apo ngrihemi, të hamë e të pimë ose të bëjmë një punë në emër të Zotit, a ka ndonjë gjë që na detyron ose shtrëngon pozitivisht ose negativisht, pra, për të vepruar ose mosvepruar? Kur duam ta njoftojmë të drejtën dhe të vërtetën, a veprojmë me vullnetin tonë, apo me detyrim? Jo, asnjëri prej nesh s'jemi ndonjë buton komandimi në dorë të tjetërkujt, ndonjë robot që komandohet në drejtimin e dëshiruar ose një kukull që tërhiqet me pé!

c) Lëkundja, pavendosmëria, krahasimi, gjykimi, vlerësimi, parapëlqimi dhe vendimi gjithashtu tregojnë për vullnet.

Një shoku ynë i mirë na fton për në një vend të mirë, ndërkaq që edhe një shok i keq na fton për në një vend të keq. Në kushte të tilla, mendojmë se ku do të shkojmë, krahasojmë dhe gjykojmë, i mendojmë përfundimet, bëjmë parapëlqimin dhe zgjedhjen tonë dhe vendosim se ku të shkojmë. Në të njëjtën mënyrë, ndoshta njëqind herë në ditë, të vënë përballë me ftesat me kahje të kundërta të engjëllit dhe djallit, bëjmë po të njëjtat veprime gjykimi, krahasimi, zgjedhjeje dhe vendimi. Sepse ne nuk jemi një gjethe që e hedh era nga të dojë, një fije kashte që e zvarrit rryma nga të dojë!

ç) A mundeni që, si pasojë e një faji që keni bërë, të justifikoheni para viktimës suaj apo organit të drejtësisë duke thënë, "ç'të bëj, më mungon vullneti"? Edhe sikur të thoni, a do t'jua pranonin një justifikim të tillë? Po qe se e vërteta do të ishte e tillë, atëherë s'do të kishte as shtet, as organe drejtësie, as polici, kurse skena e jetës do të mbushej me miliarda viktima të kaderit, qofshin vrasës ose të vrarë! Kurse e vërteta është

ndryshe! Dhe, fakti që, në njërën anë ka njerëz të moralshëm e të virtytshëm, ndërsa në anën tjetër, të pamoralshëm e të pavirtytshëm, ndërsa përballë të pafajshmëve, në njërën anë, janë fajtorët, në anën tjetër, ndërsa, në njërën anë, disa punojnë e derdhin djersë, kurse, në anën tjetër, disa të tjerë rrinë si përtacë të paturpshëm, fakti që njerëzit ndahen në klasa, poste e pozita të ndryshme sipas karakterit, profesionit, mjeshtërisë, suksesit etj., a nuk tregon për përpjekjet dhe luftën e madhe të vullnetit të njeriut për t'i përgatitur vetes një vend të caktuar në këtë hierarki vlerash e pozitash?

d) Vetëm njerëzit me zhvillim mendor jonormal, me të meta mendore të lindura ose të pësuara si dhe të sëmurët mendorë e psikikë nuk janë të përgjegjshëm e përgjegjës, sepse vullneti i tyre nuk funksionon normalisht. Prandaj, fjalët, sjelljet dhe veprimet e njerëzve të tillë i shohim si jonormale dhe themi për to: "Këto s'janë fjalë, sjellje dhe veprime njerëzish të mençur!" Ç'është, atëherë, gjëja që na dallon ne prej tyre? Ç'është e drejta, haku i të qenit i mençur? Është vlerësimi dhe veprimi i përgjegjshëm dhe me përgjegjësi! Të mos i japësh të drejtën që i takon mendjes dhe vullnetit, a nuk është, në një dimension tjetër, shprehje çmendurie? A nuk është pasioni i sëmurë pas parasë, pasurisë, postit dhe pozitës, shprehje e një marrëzie apo çmendurie shumëdimensionale? Mes konfuzionit të koncepteve, u bënë të pakuptueshëm si mençuria, ashtu dhe çmenduria!... Në këtë rast është me vend të mendojmë edhe një herë tjetër për kuptimin e fjalëve që i dedikohen Hasan Basriut:

"Po qe se ju do t'i shihnit sahabët, do t'i quanit të marrë, kurse po t'ju shihni ata ju, do të thoshin "këta s'janë besimtarë"!"

e) Te kafshët nuk ka vetëdije, njohje dhe vullnet. Kafshët veprojnë me anë të *shtytjes hyjnore*. Për shembull, bleta, me anë të shtytjes apo frymëzimit hyjnor (që s'është instinkt), i bën hojet gjithmonë gjashtëkëndëshe dhe me një përpikmëri të jashtëzakonshme, sepse as ka vullnet që të veprojë ndryshe, as i është dhënë ndonjë aftësi për të bërë një model tjetër.

Disa herë ndodh që të bëni veprime të pavullnetshme pa e vënë re as vetë se ç'po bëni. Dilni nga shtëpia pa ndonjë plan, pa ndonjë synim, por i ngarkuar rëndë me mendime që s'i vini dot në rregull, prandaj dhe, siç themi shpesh, shkoni nga t'ju çojnë këmbët! Ka filluar shiu, por ju s'e ndjeni dhe s'e hapni as çadrën që e keni në dorë. Vetëm kur ju fundoset këmba në një gropë me ujë ose kur t'ju bëjë zë me të madhe ndonjë shok, vini në vete. Atëherë i bini në të shiut, hapni çadrën, ndërroni rrugën... Pra, përdorni vullnetin, atë që quhet *vullneti i pjesshëm*.

B. Kuptimi dhe përmbajtja e vullnetit të pjesshëm

Vullneti i pjesshëm që i themi edhe vullnet fakultativ i pjesshëm, është, në fakt, një ndjenjë njerëzore prirjeje me ekzistencë konvencionale, pa një trup të jashtëm material e konkret. Prandaj vullnetin nuk e shohim si diçka që ekziston. Për shembull, themi se kemi kokë, krahë dhe veshë, sepse këto gjymtyrë janë të krijuara dhe kanë një trup të jashtëm material e konkret. Kurse gjëja e pakrijuar kështu, në fakt s'ekziston. Për shembull, themi se kemi dy sy sepse janë të krijuar dhe janë trupa materialë, pra, ekzistojnë. Por nuk e pranojmë ekzistencën e një syri të tretë sepse s'ekziston një sy i tillë i krijuar dhe me trup material. Por ju mund të thoni kështu: "Kam një sy të brendshëm që më sheh më mirë se dy sytë bashkë!" Me këtë ju e keni fjalën për një aftësi tuajën për t'i kuptuar qartë dhe saktë gjërat, më mirë se ç'i shihni me sytë si organe të të parit. Kjo aftësi që ju e quani "sy" duke bërë një paralelizëm midis funksionit të saj dhe syve si organe, ekziston, por, meqë nuk ka një trup konkret, ne nuk themi dot "ekziston". Për rrjedhojë, meqë vullneti i pjesshëm nuk ka një ekzistencë konkrete, për të mund të themi "s'ekziston", por edhe nëse e pranojmë ekzistencën e tij duke u nisur nga funksioni dhe rezultatet dhe nëse ia atribuojmë njeriut, nuk bëjmë gabim si dhe nuk biem në politeizëm, sepse, fundja, Allahu i krijon aktet e njeriut pikërisht mbi bazën e këtij

vullneti të pjesshëm që është prirje për diçka, parapëlqim, dëshirë për ta arritur dhe veprim për t'i realizuar të gjitha këto.

Vullneti i pjesshëm, në të vërtetë, s'është asgjë, megjithëkëtë, është një kusht elementar, mbi të cilin, ndoshta, mund të thuhen shumë gjëra. Pavarësisht nga madhësia dhe pesha, nga kuptimi dhe përmbajtja, Allahu e ka pranuar vullnetin e pjesshëm si një kusht elementar dhe një shkak për vendosmërinë dhe madhështinë. Megjithëse mjaft i dobët dhe i paqenë në botën e jashtme, vullneti i pjesshëm është i madh, i mrekullueshëm dhe shkaku i përfundimeve të mëdha e shumë të rëndësishme.

Përsa kohë që projekti i një ndërtese që dëshironi të bëni, mbetet mbi letër në sirtarin e tavolinës tuaj të punës, nuk ka për të pasur asnjë kuptim dhe dobi. Por kur ta nxirrni projektin nga sirtari, të filloni punën sipas tij dhe ta ngrini ndërtesën, atëherë projekti do të marrë një kuptim të rëndësishëm dhe do të ngjitet pothuaj në nivelin e shkakut themelor të ndërtesës. Po kështu, vullneti i njeriut është si projekti i një ndërtese që ndoshta do të kryejë shërbime shumë të mëdha ose do të bëhet skenë e të këqijave të shumta. Ndërkaq, është Allahu që ka për ta ngritur ndërtesën duke u mbështetur në projektin tuaj, prandaj, edhe nëse vullneti juaj nuk përbën në vetvete ndonjë vlerë apo ekzistencë, meqë përbën një kusht elementar për aktin krijues të Allahut, do të fitojë rëndësi shumë herë më të madhe se ç'e ka hapin!

Megjithëse është Allahu që e krijon çdo gjë, në krijim nuk ka kurrë detyrim absolut, ndoshta ka "detyrim të kushtëzuar" për të cilin bëhet shkak vullneti i njeriut. Allahu i krijon aktet e njeriut sipas vullnetit të tij që është në nivelin e një plani apo projekti dhe, meqë e di që më parë se si do të sillet njeriu, gjërat që ka për të krijuar i ka shkruar në Librin e Kaderit.

Për ndriçimin e një pallati të madh, në fillim duhet shtruar një rrjet elektrik i përsosur. Megjithëkëtë, edhe pas shtrimit të rrjetit dhe përfundimit të punimeve instaluese, ndriçimi nuk realizohet po qe se nuk plotësohet një kusht elementar: shtypja e butonit të ndezjes. Përsa kohë që gishti nuk do të shkelë mbi butonin ndezës, pallati nuk do të ndriçohet pavarësisht nga rrjeti elektrik i përsosur, llambat dhe abazhurët e bukur që ka, duke mbetur të gjitha këto si një gjë e pavlerë. Ja, pra, njeriu që ka një prirje dhe dëshirë për të besuar, do ta shtypë butonin për t'i ndezur pishtarët e pallatit të zemrës, Allahu me dëshirën e Tij do t'i ndezë të gjithë abazhurët dhe llambadarët dhe do ta çojë atë njeri në vendin e dritave, në xhenet... Natyrisht, edhe njeriu që do të bëjë të kundërtën, që do të priret dhe dëshirojë mohimin, do të trajtohet sipas prirjes dhe dëshirës së tij!

Po qe se lypsari i drejtohet portës së mbretit me lutjen e tij të përulur e cila e pohon varfërinë, dobësinë dhe nevojtarinë e tij, dhe me një mënyrë që i ka hije lypsarisë, lutja e tij do të marrë një përgjigje që i ka hije mbretit dhe kjo lutje e thjeshtë dhe e cunguar jo vetëm ka për ta bërë lypsarin mbret në gjithësi, por edhe kurorëzues mbretërish tokësorë në jetën e pasosur. Nga i njëjti këndvështrim, mund të mendojmë edhe se ai do të mund t'i shpërndajë yjet me një të fryrë, se me një lugë ujë do të mund t'i zotërojë oqeanet, se me një pikë bojë do të mund ta ngjyrosë tërë sipërfaqen e tokës dhe se me një shtypje butoni ashensori do të mund të udhëtojë përtej galaktikave!

Kështu, pra, vullneti i përgjithshëm sheh kah vullneti i pjesshëm, kurse vullneti i pjesshëm ka vlerën e një kushti të thjeshtë dhe elementar për krijimin e rezultateve dhe përfundimeve shumë të mëdha. Shihet, pra, se njeriu nuk është si një robot me krahë e këmbë lidhur që vihet në lëvizje me detyrim, aq më pak një qenie, siç pretendojnë dhe shprehen disa të paedukatë, "viktimë e fatit". Ndërkaq, edhe pa ia mohuar të drejtën, vullneti i pjesshëm nuk duhet t'i dalë për zot asgjëje, sepse mes vullnetit mjaft të thjeshtë, të dobët dhe elementar të njeriut dhe përfundimeve tejet të mëdha të rrjedhura në dukje prej tij, nuk ka proporcionalitet apo përputhje. Sigurisht, sa mund të jetë roli i një butoni të vogël në ndriçimin e një pallati të madh ose përsëri i një butoni në udhëtimin e njeriut në hapësirat mes galaktikave? Atëherë themi se është një Individualitet, zotërues mbi çdo gjë, që e krijon lëvizjen dhe aktin, që ngre mbi shkaqe të dobëta e të

thjeshta përfundime të mëdha. Megjithëse kemi vullnet, aftësi parapëlqyese e zgjedhëse dhe një fuqi të pjesshme, të konsiderueshme sipas dimensioneve tona, pjesa që na bie neve në shfaqjet dhe dukuritë që ekspozohen në gjithësi, s'është as një për milion. Ne nuk mundemi t'i numërojmë favoret si kjo që na janë dhënë dhe na jepen neve pa shpërblim. (Nahl, 18) Po të donte Allahu prej nesh t'i ndanim nga njëra-tjetra pjesën që na takon neve me pjesën që i takon Individualitetit të Lartë, gjithsesi, në dorë s'do të na mbetej tjetër përveç një zeroje, sepse s'do të dilte se s'ishte e jona as dhe ajo që ne e quajmë tonën, vetja jonë!

Për shembull, sa është kontributi ynë apo, e thënë ndryshe, pjesa që na takon neve në një kafshatë bukë që e hamë çdo ditë pa menduar fare për burimin nga është nisur dhe fundin e saj si kafshatë buke? Para së gjithash, kush është ai që e ka krijuar tokën, burimin mëmë të asaj kafshate, dhe e ka sjellë atë në gjendje të përshtatshme për t'u mbjellë? Kush është krijuesi i kokrrës së grurit të hedhur në tokë si dhe i lagështirës, ajrit, resë, shiut, erës, dritës dhe ngrohtësisë që i duhen asaj në rrugën e mbirjes, rritjes, kallëzimit dhe, më në fund i bërjes bukë? Po aventurën e farës nën tokë, ambientimin dhe lidhjen e saj të ngushtë me tokën, takimin dhe njohjen me plehun, vëllazërimin me bakteret, kush i ka rregulluar? Pastaj, kush na mësoi dhe aftësoi ne për ta punuar tokën, për të mbjellë e për të korrë, për ta bërë miell kokrrën e grurit dhe, pastaj, me miellin, bukë? Kush na i ka dhuruar neve mendjen, arsyen, trurin, muskujt dhe kockat që janë të domosdoshme për t'i bërë këto punë? Vepra e kujt janë dhe me urdhër të kujt punojnë duart, krahët, dhëmbët dhe një sërë gjendrash të domosdoshme, të gjitha këto, për ta futur kafshatën në gojë, për ta përtypur dhe për ta sjellë në gjendje të gatshme për tretje, gryka, trakea, stomaku, zorrët, pankreasi, etj? Nga vjen shija e kafshatës dhe funksioni i gjuhës për të ndjerë shije? Sa merr pjesë vullneti ynë në ndjenjën e urisë dhe ngopjes që na favorizohen pa ditur gjë ne? Kush është ai që e rregullon marrëdhënien e ngushtë jetësore mes kafshatës dhe trupit? Vepër e kujt janë cilësitë komplekse dhe veprimtaria komplekse e qenies së kafshatës gur përbërës i gjakut dhe qelizave? Ja, kështu, për një kafshatë bukë bashkëpunojnë toka dhe qielli, të ftohtit dhe të nxehtit, dielli dhe sistemet e tjera yjore, shiu dhe bora, pothuaj tërë gjithësia dhe ky bashkëpunim, duke u bashkuar në mënyrë imediate me mekanizmin trupor, fiton unitet. Sa është, vallë, shpenzimi dhe çmimi i një kafshate buke brenda tërë kësaj aventure? A do të mjaftonte kapitali i tërë njerëzve që kanë ardhur e ikur nga kjo botë e që do të vijnë, për ta paguar shpenzimin e bërë për këtë kafshatë buke? Dhe a e menduat se ç'pjesë kemi ne në tërë këtë aventurë?

Cili adhurim mund t'i shpërblejë, vallë, gjithë këto të mira që na janë favorizuar e do të na favorizohen? A nuk bëjmë një punë të lodhshme tetorëshe për një shpërblim të vogël? Po qe se rrushi do të ekzistonte vetëm si koncept, si vlerë, a do mundnim dot ta bënim të qenë një vesh rrush sikur të bëheshim bashkë të gjithë njerëzit e botës? Kurse Allahu që na i ka dhënë dhe na i jep të gjitha gjërat pa shpërblim, ç'kërkon nga ne? Për shembull, po të na kërkonte të falnim një mijë rekate namaz për një thes grurë, njerëzit do të detyroheshin t'i falnin për të mos mbetur të uritur. Në kohë thatësire, dalim në fusha e kodra për t'u lutur për shi. Po sikur shpërblimi i një pike uji të ishte një rekat namaz, ç'kishim në dorë tjetër veçse të falnim miliona rekate namaz? A nuk do t'ia shitnit njeriut në mes të shkretëtirës, të kërcënuar nga vdekja prej etjes, një shishe ujë për shumë qese florinj?

Siç na thotë Profeti, me se mund ta paguajmë falënderimin për çdo nyje të trupit tonë? Në spitale mund të shihni njerëz që nuk munden të urinojnë, që kanë humbur krahun, këmbën ose syrin, që e kanë të lejuar të hanë vetëm patate, etj., dhe mendoni se si mund të falënderoni për shëndetin! Mendoni se si duhet falënderuar për faktin që jeni besimtar dhe mysliman dhe që ndodheni mes myslimanësh dhe pastaj llogaritni të mirën për ta parë xhenetin, parajsën, megjithëse s'i kryeni dot siç duhet adhurimet! Të gjitha këto të mira me se mund t'i meritojmë përveç se me mëshirën e pasosur të Allahut dhe me varfërinë, dobësinë dhe nevojtarinë tonë që e vënë në lëvizje këtë mëshirë? *Zoti ynë, mos na largo nga adhurimi për Ty, mos na ndaj nga rruga e drejtë dhe mos na privo prej gjurmës dhe mësimeve të Profetit tonë! Amin, ashtu qoftë!*

Gjithsesi, u kuptua se mes vullnetit që zotërojmë ne dhe të mirave për të cilat jemi favorizuar, nuk ka ndonjë proporcionalitet. Ndërsa e vërteta qëndron kështu, Allahu me mëshirën e tij të pafundme ka krijuar për ne pretekste të ndryshme dhe atë vullnetin tonë të pjesshëm, të vogël e të cunguar e ka bërë shkak elementar për të na e favorizuar xhenetin, parajsën e Tij! Kur rënkoni duke thënë "Allah!", fitoni faljen e Tij. Po qe se thoni një herë "La ilahe il'lallah", "Nuk ka Zot veç Allahut" me motivin e besimit, vendosmërisë dhe qëndresës së pafundme, Allahu thotë "Jua kam dhënë xhenetin!" Ja shprehjet e lehta në gojë, por të rënda në peshore, ja vullneti ynë i pjesshëm dhe rezultati i tij!

Si përfundim, sado që të mos e tregojmë me gisht duke thënë "ja ku është", vullneti është një prirje me ekzistencë të qartë por me përbërje dhe peshë të panjohur për ne. Ai nuk ka një ekzistencë që shihet me sy dhe preket me dorë, por është një e fshehtë që ekziston. Ndoshta, ç'të jetë truri për njeriun, është dhe vullneti për shpirtin!

IV. RRUGA E MESME NË MARRËDHËNIEN KADER-VULLNET

Në çështjen e kaderit, specifika që i preokupon më shumë mendjet është përputhja mes kaderit dhe vullnetit të njeriut. Nga njëra anë, botëkuptimi determinist i xhebrive (deterministëve) mbi kaderin, i cili shkon gjer në kritikën e kaderit, i cili e cilëson kaderin detyrues e shtrëngues dhe njeriun, të dënuar dhe viktimë të kaderit dhe, nga ana tjetër, botëkuptimi liberal determinist-mohues i mutezilive që ia atribuon njeriut plotësisht edhe kaderin (fatin e vet), edhe krijimin (e akteve të veta), duke qenë qëndrime dhe botëkuptime të skajshme, janë shumë larg vlerësimit të saktë mbi kaderin dhe vullnetin. Kurse e vërteta mbi kaderin është mu në mes të këtyre dy pikëpamjeve dhe botëkuptimeve. Siç e shpjeguam gjer tani, edhe kaderi është sundues në jetën e njeriut, edhe njeriu është i pajisur me prirje, qëllim, mendim, arsyetim, gjykim, krahasim, parapëlqim, zgjedhje si dhe një vullnet për të marrë vendim. Atëherë, çështja duhet trajtuar si të përbëhej prej dy pjatash të një peshoreje duke i mbajtur ato në nivel.

Në dy ajete të njëpasnjëshëm, Kurani e ezauron çështjen duke i bashkuar menjëherë të dy pozitat. Ndërsa në ajetet 27 dhe 28 të sures Tekvir thuhet se *"ai (Kurani) është vetëm këshillë për botët... për ata që dëshirojnë të qëndrojnë në rrugë të drejtë"*, në ajetin 29, duke thënë se *"po të mos dëshirojë Allahu, Zoti i botëve, ju s'mund të dëshironi"*, pohohet dhe theksohet se Allahu është dëshiruesi i gjithçkaje, ndërkaq që kjo dëshirë nuk bie në kundërshtim me të drejtën e njeriut për të pasur një prirje dhe dëshirë. Në një ajet tjetër (Saffat, 96), duke thënë se *"Allahu është krijuesi i juaj dhe i bëmave (akteve) tuaja"*, pohohet se krijimi (si akt universal) dhe bërja i përkasin plotësisht Allahut, kurse në ajete të tjerë, me anë të pohimeve dhe nxitjeve, si *"njeriut s'i përket gjë tjetër veç asaj për të cilën përpiqet vetë"*, *"luftoni në rrugën e Allahut"*, *"vraponi për në xhenet"*, *"kërkoni pretekst nga Allahu"*, *"lexoni, shkruani, mendoni"*, bëhet e ditur se njeriu nuk është para kaderit një i burgosur me duar e këmbë lidhur dhe se duhet ta përdorë vullnetin e vet si një kusht dhe shkak elementar. Në disa ajete kjo është më e qartë: *"mbajeni fjalën që më keni dhënë , që edhe unë ta mbaj fjalën që ju kam dhënë"* (Bekare, 40), *"nëse ju e ndihmoni fenë e Allahut, edhe Allahu ju ndihmon juve"* (Muhamed, 7), *"nëse një popull nuk e ndryshon vetë gjendjen e vet, as Allahu s'ia ndryshon gjendjen"* (Rad, 11). Atëherë themi se detyrim absolut (determinim) ka për jogjallesat, për bimët dhe kafshët, kurse për njerëzit dhe xhindet ka "detyrim të kushtëzuar". Ndërkaq, krijimi i vullnetit të pjesshëm dhe i rezultateve të tij janë projektuar nga Allahu qysh në pafillim dhe janë përcaktuar dhe shënuar imtësisht në Librin e Kaderit.

a. Allahu e ka shkruar kaderin duke e ditur që më parë se si do ta përdorim vullnetin tonë

Siç u sqarua edhe më parë, kaderi nuk e detyron njeriun të sillet dhe veprojë sipas një drejtimi të caktuar, përkundrazi, meqë Allahu e di qysh më parë se si ka për t'u sjellë dhe vepruar njeriu, kaderi i tij përcaktohet i tillë. E thënë ndryshe, kaderi ka karakter informativ (përbëhet prej një grumbulli informacioni të caktuar) dhe s'është vullnet apo fuqi, kurse informacioni është dije, përbëhet prej dijes.

Ndërkaq karakteri informativ i kaderit ka fuqi për t'u bërë realitet. Të dish është tjetër, ta bësh atë që di, domethënë ta shfaqësh, t'i japësh formë asaj që di (asaj që ke në kokë – për rastin tonë) në botën e jashtme, është tjetër gjë. Le të bëjmë sa të duam ne plane në kokë, shumë prej tyre kurrë s'kanë për t'u realizuar. Kurse kaderi i Allahut që është një plan, realizohet me anë të akteve që do të kryejë njeriu me anë të vullnetit të vet. Kjo është si puna e shkrimeve me bojë të padukshme mbi letër që bëhen të dukshme sapo letra të lyhet me lëndën kimike të caktuar që i bën të dukshme. Sapo njeriu merr iniciativë me vullnetin e vet, Allahu vepron mbi shkrimet e padukshme të kaderit mbi letër me anë të fuqisë dhe vullnetit të vet dhe shkrimet marrin formë dhe trajtë. Ndërkaq, meqë Allahu i di që më parë (në pafillimshmëri) ato që do të bëjë njeriu me vullnetin e vet, i ka shënuar që më parë (në pafillimshmëri) një nga një në librin e vet.

Le të mendojmë një tren që udhëton në linjën e gjatë nga qyteti A në qytetin B. Lëvizja e trenit nga qyteti A në qytetin B është përcaktuar qysh më parë me hollësi në një grafik ku janë shënuar stacionet si oraret e hollësishme (orë, minuta e sekonda) të nisjes dhe arritjes, shpejtësitë e trenit në vende dhe distanca të caktuara të kësaj linje, etj. Krahas kësaj, byroja e planifikimit dhe koordinimit të lëvizjes së trenave të asaj linje di edhe shumë të dhëna të tjera në lidhje me këtë tren dhe trena të tjerë të kësaj linje, të cilat ndikojnë mbi lëvizjen dhe planifikimin e saj, si stinët, temperaturat, numri i pasagjerëve, etj. Kështu, megjithëse pas hartimit të grafikut të lëvizjes, treni do të lëvizë duke respektuar me korrektesën më të lartë oraret dhe kushtet e tjera të lëvizjes, nuk është grafiku i lëvizjes (kaderi) që e detyron trenin të lëvizë ashtu, por janë kushtet më reale dhe të detyrueshme të lëvizjes (vullneti) që kanë detyruar (përcaktuar) hartimin e një grafiku të tillë. Për shembull, nëse shpejtësia mesatare e trenit e shënuar në grafik është 70 km/orë e jo 250 km/orë, do të thotë se në kushtet e dhëna, treni nuk mund të lëvizë me një shpejtësi mesatare më të madhe se 70 km/orë (50km/orë – 90 km/orë) si dhe në realitet treni do të lëvizë me një shpejtësi brenda këtyre caqeve jo se kështu është shënuar në grafik.

Dukuri astronomike të tilla si eklipset, njihen që më parë, prandaj dhe shënohen me hollësi sekondash në kalendarë dhe raporte shkencore. Kështu, një eklips i caktuar nuk ndodh sepse ashtu është përcaktuar dhe shënuar në raportet shkencore dhe kalendarët, por shënohet në raportet shkencore dhe kalendarët sepse ashtu ka për të ndodhur. Edhe njeriu nuk sillet apo vepron ashtu sepse ashtu ka shkruar Allahu në kaderin e tij, sepse s'e di se ç'ka shkruar; Allahu ashtu e ka shkruar sepse e di se ashtu ka për t'u sjellë dhe vepruar ai njeri. Nëse çdo gjë që ka për të bërë njeriu duke përdorur vullnetin e vet, e shkruar në formë kaderi dhe të fshehtë për njeriun, nuk e pengon njeriun ta përdorë vullnetin e vet, edhe gjërat që ka për të bërë njeriu duke përdorur vullnetin e vet nuk bëhen pengesë që ato të shkruhen qysh më parë në formë kaderi për të (por me kusht që të mbeten të fshehta për të).

b. Nuk mund të bëhet fjalë për një kader të njëanshëm ku s'llogaritet vullneti

Pika më e ndjeshme, "jetike", e çështjes së kaderit është kjo: ndërsa Allahu e shkruante Librin e Kaderit duke e ditur çdo gjë që më parë në sajë të dijes së tij të pafundme, akti i njeriut ose vullneti i tij që e krijon aktin e tij, nuk është lënë jashtë këtij shkrimi ose nuk është përjashtuar. Pjesa që i takon njeriut është "ta shtypë butonin" (të dëshirojë dhe të iniciojë), kurse pjesa që i takon Allahut, ta krijojë aktin që dëshiron dhe inicion njeriu, të krijojë rezultatin e dëshiruar. Ja, pra, kësaj i themi "kader": përcaktimit dhe shënimit të njëkohshëm të këtyre dy faktorëve.

Mendoni një orë në dhomën pranë, që s'e shihni dot, por që ia dëgjoni tiktakun. Po ju pyetën nëse punon apo jo, ju përgjigjeni pa ngurrim "punon", sepse ia dëgjoni tiktakun. Në këtë mes, ju s'keni aspak dyshim që të gjitha detajet e orës, ingranazhet me dhëmbëza, akrepët, lavjerrësi, nëse ka, funksionojnë dhe lëvizin. Pra, vetëm dëgjimi i tiktakut ju mjafton për të arritur në përfundimin se ora punon. Edhe e kundërta, po qe se keni para një orë që s'i dëgjohet ose s'ia dëgjoni dot tiktakun, por vetëm ia shihni akrepin e sekondave tek lëviz, vetëm lëvizja e tij ju bind se ora punon. Po si kjo, po pati kader, ka edhe vullnet ose, nëse duam ta trajtojmë vullnetin, mund ta trajtojmë vetëm bashkë me kaderin.

Në këto kushte, njeriu nuk është para kaderit një robot me duar e këmbë të lidhura. E shprehur ndryshe, njeriu nuk është një merimangë e mbështjellë në pezhishkën e kaderit të vet, nuk është një i dënuar me vdekje me vendimin të varur në qafë, me duart dhe këmbët të lidhura me pranga, ose një i dënuar i mjerë, i hedhur në det për t'u mbytur, me të cilin, për më tepër, ekzekutorët e tij tallen duke i thënë të ketë kujdes se mos laget! Sigurisht, jo vetëm kaderi s'është ky, por edhe njeriu s'është një gjethe e thatë që e vërvit era nga të dojë. Në çdo çështje të Islamit ka masë (oportunitet) dhe orientim. Për shembull, nëse zemërimi në çdo vend dhe për çdo gjë është një teprim në të djathtë, pra, një sjellje dhe qëndrim intolerant, edhe heshtja dhe urtësia para çdo sjelljeje dhe veprimi janë një teprim në të majtë, pra, një sjellje indiferente, një tolerancë e panevojshme dhe e gabuar. Siç është qëndrim i skajshëm mohimi i femrës dhe ndenjja pa u martuar fare, është qëndrim i skajshëm edhe mendimi për të përfituar prej çdo femre që të del para! Nëse totemizimi i kapitalit është një qëndrim ekstrem, edhe mohimi i kapitalit është një qëndrim ekstrem në anën tjetër. Edhe në çështjen e kaderit, t'ia atribuosh gjithçka njeriut dhe të thuash se "njeriu e krijon vetë aktin e tij" (racionalizmi i mutezilive, fraksionistëve racionalistë), është qëndrim i skajshëm; gjithashtu, ta bësh njeriun të paralizuar para kaderit duke thënë se "njeriu nuk ka pjesë fare, nuk ka asnjë funksion në aktin e tij" (determinizmi i xhebrive, deterministëve) është qëndrim i skajshëm në anë të kundërt. Kurse sunitë, për pikëpamjet e të cilëve u përpoqëm të bëhemi interpretë gjatë gjithë trajtimit të çështjes, duke mbajtur, edhe në këtë çështje, rrugën e mesme të së vërtetës, thonë: "Vullneti dhe iniciativa janë të njeriut, kurse krijimi i aktit të dëshiruar dhe iniciuar prej njeriut, është i Allahut".

Është Allahu që i krijon edhe orientimin (rrugën e drejtë), edhe çorientimin (rrugën e shtrembër), edhe të mirën, edhe mëkatin. Nëse njeriu dëshiron të shkojë në xhami ose të bëjë një punë të mirë dhe inicion, domethënë priret dhe vë në veprim vullnetin e vet në këtë drejtim, Allahu e çon atje ku dëshiron, priret dhe përpiqet. Po kështu, nëse njeriu dëshiron të shkojë në pijetore ose të bëjë një punë të keqe dhe inicion, pra, priret dhe vë në veprim vullnetin e vet në këtë drejtim, në këtë rast, Allahu, ose e çon në pijetore, në punë të keqe duke i dhënë mundësi të humbë, të pësojë disfatë, etj., ose nuk e çon, e pengon nga rruga e keqe dhe e mbron. Një fjalë e shëmtuar e thënë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij mund ta vërë në lëvizje atributin Mudil (çorientues) të Allahut për t'i dhënë përgjigjen e merituar thënësit sipas qëllimit të tij të keq, pra, dhe duke mos i bërë padrejtësi. Shkurt, njeriu që zgjedh rrugën e drejtë ose të shtrembër, çohet në atë rrugë dhe bëhet të arrijë në rezultatin që ka dëshiruar. Prirja, dëshira dhe inicimi janë të njeriut, kurse realizuesi i tyre është Allahu. Prandaj dhe njeriu, në botën tjetër, do të shpërblehet ose ndëshkohet sipas llojit të aktit të dëshiruar dhe inicuar prej tij.

c. Kaderi përfaqëson tërësinë unike të shkaqeve dhe shkaktarëve; edhe mjetet në dorë të vullnetit janë të shënuara në Librin e Kaderit

Pas një aksidenti, pas një vdekjeje, shkurt, pas një ngjarjeje të hidhur, themi, "sikur të mos kish shkuar atje", "sikur të mos e kishte marrë armën në dorë", "sikur të mos kishte ecur me aq shpejtësi", etj., kurse në kader janë shënuar, së bashku me ngjarjen, edhe të gjithë faktorët dhe shkaqet përbërëse duke filluar me vullnetin e njeriut (viktimës apo fajtorit), edhe të gjithë faktorët dhe shkaqet anësore, pra, ngjarja është shënuar me të gjitha hollësitë e jetës në të gjitha çastet dhe aspektet e saj.

Bie fjala, po qe se një njeri ka vrarë një njeri tjetër me armë zjarri duke vepruar me vullnet, kjo gjë është ditur nga dija e pafundme e Allahut qysh në pafillimshmëri dhe është shënuar: "Iks person, duke e përdorur me vullnetin e vet armën e zjarrit, do t'ia tërheqë këmbëzën me gishtin e vet dhe, si përfundim, ipsilon person do të vdesë!" Po të mos ishte shkaku, arma e zjarrit nga u hodh plumbi dhe gishti që tërhoqi këmbëzën, si do të realizohej vdekja e personit në fjalë? Ta zëmë se do të vdiste në një aksident automobilistik. Atëherë themi se për të paska qenë e shkruar se do të vdiste në një aksident automobilistik. Ose, nëse shkaku i vdekjes do të ishte një sëmundje, do të thoshim se për të paska qenë e shkruar se do të vdiste nga një sëmundje, etj.

ç) Si përfundim, kaderi e mbështet vullnetin dhe që të dy shkojnë paralelisht. As kaderi s'e mohon vullnetin, as vullneti s'e mohon kaderin

Çështjen mund ta shprehim me fjali konkluduese të formuluara qartë e prerë.

1. Në gjithësi sundon një kader dhe program hyjnor, kurse te njeriu ka prirje dhe vullnet.

2. Meqë Allahu zotëron dijen e pafundme, të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen i sheh dhe i di si një moment të vetëm.

3. Allahu i shënon dhe shkruan si libër të gjitha ngjarjet që do të ndodhin në të ardhmen.

4. Ne bëjmë diçka jo pse ashtu e ka shkruar Allahu (sepse s'e dimë se si ka shkruar për ne), kurse Allahu shkruan ashtu sepse e di qysh më parë se si dhe për çfarë do ta përdorim ne vullnetin tonë.

5. Duke e shkruar kaderin tonë, Allahu nuk e përjashton vullnetin tonë, por shkruan duke e futur në llogari se si do ta përdorim vullnetin tonë.

6. Përveç atyre që na favorizon, Allahu na premton xhenetin, parajsën, si shpërblim të përdorimit të vullnetit tonë në rrugën e Tij!

V. KADERI, KADAJA DHE LIGJET E FALJES

Kada-ja është vënia në veprim e konkluzioneve dhe vendimeve të marra nga Allahu në Leuhi Mahfudh (Tabela e Kujtesës), pra, në Librin Kryesor, kur u vjen koha dhe me anë të vullnetit të njeriut, domethënë, ekzekutimi i paracaktimit hyjnor.

Veç Tabelës së Kujtesës, Allahu ka edhe librat Leuhi Mahv ve Isbat (Tabela e Prishjes dhe Provës). Siç e kemi thënë edhe më parë, Leuhi Mahfudh është "Imami Mubin" ose "Umul Kitab", pra, në të nuk ndodh fshirje dhe ndryshim. Kurse "Tabela e Prishjes dhe Provës", siç thuhet në ajetin, "Allahu e fshin atë që do dhe e lë në vend atë që do; Libri Kryesor është tek Ai" (Rad, 39), është libri ku Allahu, me ligjin e faljes, bën ndryshime në vendimet dhe konkluzionet e paracaktuara prej Tij duke anuluar ekzekutimin e tyre.

Ligji i faljes e prish kadanë (ekzekutimin). Për shembull, një njeri për të cilin do të ekzekutohet një vendim i paracaktuar, duke përdorur një mundësi specifike të vetën, hyn në marrëdhënie me Allahun, fiton afërsi me Të ose, duke kryer akte të pëlqyeshme për Të, si lutjet dhe sadakatë, bën që, si rrjedhojë, Allahu të bëjë një falje të posaçme për të, ta anulojë ekzekutimin dhe ta ndërrojë në favor të tij.

Për shembull, njeriu del nga shtëpia me qëllimin dhe prirjen për të shkuar në vendin e mëkatit, pra, "shtyp butonin" e kryerjes së një mëkati. Atëherë, edhe Allahu, sipas dëshirës dhe vullnetit të njeriut, do ta realizojë aktin përkatës duke e çuar njeriun në vendin e mëkatit, si dhe rezultatet e atij akti, mëkatin përkatës. Mirëpo mund të ndodhë që, një sjellje ose qëndrim i mirë i atij njeriu ta vërë në veprim mëshirën hyjnore dhe Allahu t'i nxjerrë në rrugë një shok të mirë që ta çojë jo në vendin e mëkatit, por në një vend mirësie e bukurie dhe, kështu, ta ndryshojë në favor të tij vendimin dhe ekzekutimin (kadanë) e merituar nga ai me vullnetin e vet. Ja, pra, ndryshimi me shkak ose pa shkak nga Allahu në favor të njeriut i një vendimi ose ekzekutimi të caktuar për të, është falje dhe mirësi për atë njeri.

Ndërkaq, ne nuk kemi të drejtë ta pyesim Allahun: "Pse s'e lejove të shkojë në vendin e mëkatit kur ai e kishte vënë si qëllim atë?" "Pse e ndryshove kadanë për të me falje dhe mirësi?" Ai e favorizon atë që do me aq sa do, Ai e çon në rrugë të drejtë atë që do dhe në rrugë të shtrembër, atë që do. Prandaj, të gjitha të mirat tona janë favori i Allahut kurse të gjitha të këqijat tona janë përmbajtja jonë. (Nisa, 79) Ndërkaq, shumë herë, kur ne jemi duke u rrëzuar kokëposhtë me mëkatet dhe të këqijat tona, na kap për dore e na shpëton. Ky është favori i Tij! Me këtë favor, Allahu u bëhet pengesë ngatërresave dhe fatkeqësive, gjithashtu, nuk e lejon njeriun të zhytet në mohim dhe mëkat. Këto janë falja dhe mirësia e Tij madhore për disa njerëz që nuk e meritojnë e nuk janë të denjë për falje e mirësi!

Po qe se Allahu nuk do ta prishte kadanë me faljen dhe mirësinë e Tij, por do ta krijonte aktin që dëshiruam dhe iniciuam me vullnetin tonë, kjo do të ishte thjesht një zbatim drejtësie. Kurse po të mos e

krijonte, kjo do të ishte një favor dhe mirësi e posaçme. Siç pohohet shpesh në Kuran, Allahu e ka lidhur shkatërrimin e popujve nga ana e Tij me këmbënguljen e tyre në mohim, politeizëm, padrejtësi, dhunë, kundërshtim dhe revoltë. Mirëpo populli i Junusit, sapo pati nisur t'i vinte fatkeqësia ndëshkuese, pati nisur të lutej dhe, si përfundim, Allahu e pati larguar fatkeqësinë dhe ndëshkimin e tyre, domethënë, falja dhe mirësia e patën prishur kadanë për popullin e Junusit.

VI. ÇËSHTJE TË VEÇANTA LIDHUR ME KADERIN DHE VULLNETIN

Nën këtë titull, krahas përsëritjes nga një këndvështrim tjetër i shpjegimeve që bëmë gjer tani, do të përpiqemi t'u japim përgjigje pyetjeve më të shpeshta mbi kaderin.

Pyetje: Pse Allahu pa më pyetur për mua, pa marrë që më parë mendimin tim, më krijoi dhe më bëri të dënuarin e kaderit? Pastaj, pse kaderi im shfaqet jo në formën që unë të bëhem i pasur e të jetoj në mirëqenie, por në formën që të pësoj ngatërresa, kokëçarje e fatkeqësi?

Përgjigje: Kaderi s'është detyrues, i padrejtë, dhunues, sidomos kurrsesi i shëmtuar!

Siç kuptohet nga shpjegimi që kemi bërë gjer tani, nuk ka ndonjë vendim të paracaktuar pa llogaritur vullnetin e njeriut. Veç kësaj, Allahu edhe na ka tërhequr vëmendjen dhe paralajmëruar në mënyrë të vazhdueshme duke na dërguar profetë dhe duke na zbritur libra të shenjtë.

Nuk ndodh ndonjë gjë e shëmtuar ose mëkat nëse njeriu nuk i del për zot asaj. Nën ndikimin e egos, duke e përdorur vullnetin për keq, për rrjedhojë duke u bërë ftesë të këqijave, njeriu ka shtypur butonin e së keqes, pra, është bërë shkak që të hapet kapaku i gropës ku ka për të rënë. Pastaj ai shkon dhe rrokulliset brenda në të! Për shembull, ashtu siç është vetë i pastër e i shkëlqyer, dielli është edhe burimi i dritës dhe ngrohtësisë që janë të nevojshme domosdoshmërisht për jetën, si dhe burimi i ngjyrave dhe bukurive që reflektohen në fytyrën e luleve. Mirëpo, nëse njeriu rri nën diell me orë të tëra, mund të sëmuret, madje, të vdesë. Po për këtë mos ka faj dielli? A mund të thotë njeriu "pse u krijua dielli" nga pakënaqësia e sëmurjes, për të cilën është vetë shkaktar ngaqë e shpërdoroi diellin? A mund ta kritikojmë ne krijimin dhe ekzistencën e diellit për shkak të pasojave negative, si djegia e trupit, sëmurja apo prishja e ushqimeve, të buruara, këto, krejtësisht nga gabimet e vullnetit tonë?

Sigurisht, mëkatet, dëmet dhe shëmtitë që i ngarkohen kaderit, janë, në të vërtetë, rezultat i shpërdorimit nga njeriu të vullnetit të vet. Po qe se ia ngarkojmë kaderit një sërë padrejtësish dhe shëmtish pa futur në llogari vullnetin tonë, edhe fatkeqësinë tonë e dyfishojmë, edhe tregojmë paturpësi ndaj kaderit.

Për shembull, njeriut i është dhënë ndjenja e epshit edhe si një shije e kënaqësi, edhe si shkak që çon në një rezultat të dobishëm siç është shtimi i brezit. Dhe në qoftë se njeriu, duke e përdorur keq vullnetin e vet, përpiqet ta realizojë këtë ndjenjë dhe plotësojë kënaqësinë e rrjedhur prej saj me rrugë të gabuara e të ndaluara, si marrëdhëniet seksuale jolegjitime dhe prostitucioni, kush do të ketë faj, kaderi, apo njeriu vetë? Në këtë rast, njeriu, një pretekst të dhënë për dobi dhe, për realizimin e të cilit, janë përgatitur të gjitha mundësitë, e përdor për të keq, bën keq dhe hyn në mëkat dhe, si përfundim, i bën padrejtësi vetes, e dëmton veten. Të kësaj natyre janë edhe krimi dhe veprime të tjera të këqija, të ndaluara e të dënueshme. Ndërkaq, ka edhe vuajtje e fatkeqësi që heq njeriu jo për faj të tij, pra, jo se e shpërdoron vullnetin e vet, por

ne u përpoqëm të shpjegojmë kuptimin, urtësinë, dobitë dhe bukuritë e tyre dhe, kur të jetë vendi, do të flasim përsëri për to.

Krahas rezultateve dhe përfundimeve, kaderi merr parasysh edhe shkaqet, kurse njeriu, për shkak të krijimit të vet dhe ngaqë nuk e kupton dot plotësisht kaderin, vështron vetëm përfundimet dhe shkaqet e jashtme, formale e që mundet t'i shohë, arrin në konkluzion të gabuar dhe bën padrejtësi. Për shembull, po të shihni një të moshuar duke ia hequr veshin një fëmije, meqë veprimi është i papëlqyeshëm, ju menjëherë konkludoni se fëmijës po i bëhet padrejtësi. Kurse ai që po i tërheq veshin fëmijës është, ndoshta, i ati, i cili po bën diçka të domosdoshme që do ta bënit edhe ju. I ati vetëm sa i ka hequr veshin fëmijës për një gjest të keq të tij ndoshta jo dhe aq me rëndësi, me qëllim që në të ardhmen të mos vijë puna që t'u bjerë gjunjëve nga mjerimi dhe pendimi për një veprim të keq më të rëndë të fëmijës, ka marrë masa para se shtamba të thyhet... Mirëpo ju konkluduat sipas dukjes dhe e akuzuat atë baba për dhunë dhe padrejtësi, duke i bërë, në fakt, padrejtësi jo atij, por vetes suaj. Kurse kaderi i sheh tërë shkaqet menjëherë dhe i di edhe shkaqet e padukshme, prandaj konkludon plotësisht dhe me drejtësi!

Shihni një gjuetar që qëllon një luan dhe e vret. Juve ju vjen keq për luanin, por nuk e dini se atë e pati dënuar kaderi sepse pati lënë pa nënë të vegjlit e një drenusheje. Nga ana tjetër, vjen një ditë që gjuetari thyen këmbën dhe ndëshkohet që vrau luanin. Dikush plagos me thikë dikë tjetër, por, për shkaqe të ndryshme, nuk dënohet dhe, me kalimin e kohës, ngjarja harrohet. Mirëpo ja që vjen një ditë dhe për këtë njeri dikush shpif për çnderim, ai del para gjyqit dhe dënohet megjithëse është i pafajshëm. Ju që mund ta dini të vërtetën, e akuzoni gjykatësin për padrejtësi, por gjykatësi s'ka faj, se ai sheh faktet dhe provat që ka në dorë. Në të vërtetë, është kaderi që ka vendosur për të duke marrë parasysh të gjitha shkaqet dhe ai po dënohet tani për atë plagosjen me thikë që ishte harruar! Ja, pra, bukuria te kaderi dhe shëmtia në konkluzionet tona! Pa dyshim, çdo konkluzion i kaderit ose është i bukur në vetvete, ose është i bukur si rezultat dhe përfundim.

Meqë erdhi vendi, e quaj me vend të tregoj një ngjarje të rrëfyer për profetin Musa.

Profeti Musa i lutet Zotit: "O Zot, tregoma drejtësinë tënde!" Dhe Zoti i përgjigjet: "Prit pranë aksh çezme dhe shih ç'do të ngjasin!" Profeti Musa shkon atje dhe pret i fshehur. Pa shkuar shumë, te çezma vjen një kalorës, i jep ujë kalit dhe largohet, por, ndërsa po i jepte ujë kalit, i bie përtokë një qese me florinj. Pas tij vjen menjëherë një fëmijë, e merr qesen dhe largohet. Pastaj te çezma vjen një i verbër dhe, në atë mes, vjen edhe kalorësi i cili, pasi e vë re se i ka rënë qesja, kthehet te çezma për ta marrë. Kalorësi ia kërkon florinjtë të verbrit, i cili përpiqet ta bindë kalorësin se as ka gjetur, as ka marrë qese me florinj, por më kot. Kalorësi e vret të verbrin dhe largohet. Profeti Musa e pyet Zotin se ku është drejtësia te ato ngjarje krejt të padrejta dhe merr këtë përgjigje:

"Kohë më parë, kalorësi i pati vjedhur të atit të djalit një qese me florinj dhe Ne ia kthyem të birit. Kurse i verbëri, dikur, ia pati vrarë kalorësit të atin dhe Ne e çuam drejtësinë në vend me vrasje për vrasje!" Ja, kështu, zinxhiri i ngjarjeve të dukura tërësisht si padrejtësi për shkak të mosnjohjes së shkaqeve të vërteta dhe vështrimit nga jashtë, kur njihen shkaqet e vërteta, del si drejtësi e plotë. Kështu është edhe konkluzioni i kaderit; në të nuk përmbahet as padrejtësia dhe shëmtia më e vogël. Çdo konkluzion dhe vendim i tij është vetëm drejtësi dhe vetëm bukuri!

Në gjërat që njeriu i sheh si të këqija duke vështruar dukjen, Allahu ka dëshiruar për të shumë të mira, kurse në shumë gjëra që njeriu i mendon se të mira e të dobishme, për të ka të këqija. (Bekare, 216) Për shembull, veçanërisht në mot të ftohtë, njeriu e ka të vështirë të marrë abdes, kurse abdesi është vetë i bukur, i ka edhe përfundimet të bukura. Xhihadi, sipas shprehjes së ajetit, mund të vijë i rëndë e i neveritshëm, por, si rezultat, mund të sjellë shumë favore e shpërblime. Ndodh që Allahu e bën dikë të falimentojë, por njeriu nuk e di se pasuria do t'i bëhej pretekst për ta nxjerrë nga rruga e drejtë. Njeriu lutet, por, kur s'i

plotësohet, bie në pesimizëm, kurse ose ato që kërkon janë kundër interesit të tij, ose Allahu do t'i japë më vonë ose në jetën tjetër gjëra edhe më të mëdha e të bukura!

Kështu, në çdo konkluzion dhe vendim të Allahut për ne ka shumë urtësi dhe dobi që nuk mundemi t'i dimë. Allahu nuk është i detyruar që patjetër ta trajtojë njeriun me urtësi duke marrë për bazë të mirën e tij, por siç është Krijues dhe i Ditur, Allahu është edhe i Urtë dhe kurrë nuk bën punë të kotë, por ç'e do se në shumicën e rasteve ne mund të mos i dimë urtësitë në veprimet e Tij! Në këto kushte, ta pranojmë kaderin dhe t'i nënshtrohemi Zotit, të orientohemi kah Ai dhe, me botëkuptimin se *edhe favori i Tij është i këndshëm, edhe persekutimi i Tij*, t'i nënshtrohemi pa kundërshtim gjithçkaje që vendos Ai për ne!

Pyetje: Si mund të shpjegohet që, për një vullnet tejet të thjeshtë, të vogël dhe të dobët, jepet një xhenet ose xhehenem i pafund?

Përgjigje: Siç u prek kjo çështje edhe më parë, në të vërtetë, ne duhet të mendojmë më shumë jo të meritojmë favore të së ardhmes si xheneti, por të falënderojmë për të mirat që na bien si shi në kokë. Është krejt e pamundur që falenderimin e të mirave që na jepen në dorë dhe pa shpërblim, s'është e mundur kurrë ta bëjmë me anë të adhurimeve. Në jetën e kësaj bote, punojmë një ditë për të jetuar një ditë, punojmë gjashtë muaj për të jetuar gjashtë muaj dhe themi: "Eh, sikur të punoja gjashtë muaj e të jetoja një vit!" Ndërsa e vërteta qëndron kështu, si mund të fitohet xheneti, parajsa, vendi i mrekullive të pasosura, me një jetë kaq të shkurtër që kalon më shumë me gjumë, me fëmijëri dhe me punë që i përkasin kësaj bote? Për më tepër, si mund të fitohet xheneti me kontributin e vogël të njeriut që llogaritet me shtypjen e një butoni? Ose, nga ana tjetër, si mund të dënohet njeriu me xhehenemin e përjetshëm vetëm për shkak të një akti kaq të vogël?

Tani le të përpiqemi t'i bëjmë dritë çështjes nga disa aspekte.

a. Nga aspekti i qëllimit

Xhenet i përjetshëm, të mira të përjetshme dhe Bukuri e përjetshme e Allahut! Të gjitha këto s'mund të bëhen produkt i kësaj jetës sonë të vdekshme e të shkurtër dhe ne kurrsesi s'mund ta arrijmë përjetësinë me anë të vlerave tona materiale! Mirëpo është *"qëllimi i besimit të përjetshëm"* që mund të na bëjë ta arrijmë përjetësinë. Lavdi Allahut, i besojmë Zotit tonë dhe jemi të vendosur e besnikë në këtë besim. Në këtë drejtim e përdorëm butonin e vullnetit tonë dhe, gjithashtu, me vullnetin tonë, do ta mbajmë fort me anë të qëllimit tonë këtë besim të përjetshëm. Prapë, është Zoti ynë që na ka vënë në rrugën e drejtë që na e ka ndezur si pishtar në zemrën tonë. Po qe se kemi për të jetuar shtatëdhjetë vjet, jemi të vendosur në qëllimin tonë për të jetuar me besim. Edhe sikur Zoti ynë të na jepte jo shtatëdhjetë e njëqind e shtatëdhjetë, por edhe një mijë vjet jetë, prapë ne nuk do të kthehemi, por do të vazhdojmë me vendosmëri në besimin tonë! Sa të jemi gjallë, madje, sikur Zoti ynë të na lërë përjetësisht në këtë botë, ne nuk do të ktheheshim nga besimi dhe do ta besonim Zotin përjetësisht. Ja, pra, thelbësore në hyrjen në xhenet apo xhehenem është ky qëllim. A nuk thotë edhe Profeti se *aktet vlerësohen sipas qëllimit?* Çdokush do të marrë përgjegjësen e qëllimit të vet. Po qe se qëllimi ynë s'mbetet në vijën e besimit të përjetshëm, edhe shpërblimin do ta kemi sipas kësaj. Ndëshkimi dhe shpërblimi janë sipas llojit të aktit: për besimin e përjetshëm dhe qëllimin e besimit të përjetshëm, xhenet i përjetshëm; e kundërta, për mohimin e përjetshëm dhe qëllimin e mohimit të përjetshëm, xhehenem i përjetshëm. Allahu nuk sheh pamjen tonë dhe as sa kohë ndenjëm me trup në këtë botë të vdekshme, por qëllimin që bartëm, vendosmërinë që treguam, besimin që patëm në zemër dhe vazhdimësinë e qëllimit dhe mendimit në besim.

Sigurisht, pavarësisht se sa pak që të jetohet, me anë të mendimit të besnikërisë dhe vendosmërisë në besim, qëllimi mbetet një dritë që ndriçon kohët gjer në pafundësi. Në antagonizëm me këtë, edhe jeta e pafundme e mohuesit me qëllim të errët, i cili e sheh çdo gjë të errët, është e errët siç e ka kuptimin

xhehenemi. Sepse mohuesi është i vendosur me kryeneçësi të mos e ndezë dritën e përjetshme të besimit edhe sikur të jetojë me miliona vjet, për pasojë, do të bëhet viktimë e qëllimit të vet të errët që ia errëson zemrën, jetën e kësaj bote dhe të botës së përjetshme.

Qëllimi juaj i kthjelltë u zgjattë gjer në pafundësi dhe përjetësia e haptë prehrin për ju!

b. Vendimi në ndëshkim sheh peshën e fajit si dhe qëllimin, synimin dhe rezultatin në kryerjen e tij, jo kohëzgjatjes së kryerjes

Në botë, për fajin e vrasjes me paramendim, i cili, si akt, kryhet brenda disa minutave, disa herë jepet dënim me 25 vjet burg, domethënë, 13 milion minuta, disa herë me burgim të përjetshëm ose me vdekje dhe në asnjë rast nuk merret parasysh kohëzgjatja e aktit. Ndoshta shihen elementë të tjerë përbërës të fajit, si pesha e tij, qëllimi, synimi dhe përfundimet. Krimet që bartin në shpinë mohimi dhe mohuesi, janë shumë më të mëdha, shumë më të rënda sesa krimi i vrasjes së një njeriu. Numri i dëshmitarëve që dëshmojnë ekzistencën e Krijuesit është sa numri i molekulave, atomeve, qelizave, engjëjve, pikave të shiut, etj., kurse mohimi, duke konsideruar për një çast si të paqenë dëshminë e kaq shumë dëshmitarëve, merr kuptimin e akuzimit si gënjeshtarë të tyre si dhe të dënimit të tërë gjithësisë me errësirë. Gjithashtu, duke e nënvleftësuar Artistin e Madh, duke i quajtur të dobëta qëndisjet e Tij në gjithësi dhe duke i hedhur poshtë argumentet e Tij, mohimi konsiderohet një krim i madh. Për më tepër, është përgënjeshtrim i mijëra profetëve, në jetën e të cilëve është e pamundur të gjesh gënjeshtër, i miliarda besimtarëve besnikë. Gjithsesi, edhe ndëshkimi i një faji të tillë do të jetë nga lloji i tij që është xhehenemi i përjetshëm!

c. Vullneti i pjesshëm është vërtet e vogël, por përfundimi i tij është shumë i madh, pra dhe Allahu e jep ndëshkimin sipas përfundimit të tij

Me shtypjen e një butoni, mund të shuani në një çast miliona llamba elektrike duke lënë në errësirë një qytet apo vend të madh. Ose, si në Luftën e Parë Botërore, me një sjelljen apo veprimin tuaj mund të bëheni shkak për vdekjen e miliona njerëzve, për shembjen e miliona familjeve, për rrafshimin e qyteteve, për asgjësimin e veprave që kanë kërkuar punë dhe përpjekje shekullore të popujve ose të të gjithë njerëzimit dhe të ndryshimeve shumë të mëdha në dimensione botërore. Në të njëjtën mënyrë, me një shkrepëse mund të digjni një pyll të madh ose, duke hequr një tullë, mund të shembni një pallat. Mohim do të thotë shkatërrim dhe shkatërrimi është shumë i lehtë dhe, si rezultat, shumëpërfshirës dhe tronditës. Ja, pra, meqë me përdorimin e vullnetit të vet për të shkatërruar, mohuesi bëhet shkaktar shkatërrimesh shumë të mëdha, meriton xhehenemin, skëterrën e përjetshme. Në antagonizëm me të, duke e përdorur vullnetin në drejtim pozitiv, besimtari ia ndriçon vetes edhe këtë botë, edhe botën tjetër.

ç. Njeriu që ia kthen shpinën dhënësit të mirësive të pakufishme, e meriton të hajë shpulla

Njeriu që ia kthen shpinën zotëruesit dhe dhënësit të atyre të mirave të pakufishme që tregojnë madhështinë dhe fuqinë e pafundme të Allahut dhe që kanë peshë dhe vlerë të pafundme në ekzistencë, njeriu që, pastaj, duke e mbyllur një libër si ndërgjegjja që është dëshmitari i pazë i ekzistencës së Allahut, i vret mendjen, vetëdijen dhe ndjenjat e veta të pasionuara ndaj përjetësisë, veçanërisht, njeriu që i mbyll sytë për Profetin i cili, duke e treguar librin e gjithësisë me anë të Kuranit, tregon rrugën e lumturisë, dhe që e mbyll derën e zemrës, ky njeri, pra, duke e shpërdoruar vullnetin e vet me peshë shumë të vogël në përmasat gjigande të gjithësisë, duke parapëlqyer në zgjedhje ca gjëra iluzive e konvencionale pa asnjë peshë në krijim dhe ekzekutim dhe duke rënë në lojën e egos së vet dhe djallit, sigurisht që do ta meritojë të hajë shpulla të rënda sa gjithësia!

d) Dënimi i tradhtisë së amanetit jepet në raport të drejtë me vlerën e amanetit dhe të të zot të amanetit

Dënimi që i jepet fëmijës që thyen xhamin e dritares, nuk është i njëjtë me dënimin që i jepet adjutantit që prish duke e shpërdoruar kurorën prej kristali të mbretit. Po t'u dorëzohet në ruajtje një ushtari dhe një

komandanti armate një sasi kapitali sipas pozitës së secilit dhe ata ta bëjnë atë kapital rrush e kumbulla, sigurisht që, në ndryshim të pakrahasueshëm me dënimin që do t'i jepet ushtarit, komandanti i armatës do të nxirret para gjykatës së lartë ushtarake. Po kështu, përgjegjësia e një shkencëtari që e kalon jetën me studime e zbulime të mëdha, është krejt e ndryshme nga përgjegjësia e një çobani që e kalon gjithë jetën pas kopesë në mal.

Si në shembujt e mësipërm, kapitali jetë që u është dhënë kafshëve dhe kapitale e të mira të tjera të dhëna sipas mundësive të kafshëve dhe funksioneve që kanë për të kryer, përdoren prej tyre pa bërë ndonjë shpërdorim. Po, kapitalet dhe të mirat që u janë dhënë, disa kafshë i përdorin për të bartur dhe transportuar ngarkesa, disa për të dhënë mish dhe qumësht, etj. Mirëpo njeriu nuk është kafshë dhe kapitali i dhënë atij nuk është si kapitali i dhënë kafshëve. Një dorë njeriu është më e çmuar sesa duart e një mijë merimangave; një gisht njeriu është më i çmuar sesa krahët e një mijë trumcakëve. Sigurisht, kur njeriu ta shpërdorojë kapitalin e madh që i është dhënë, ndërgjegjen, mendjen, arsyen, vetëdijen, gjykimin, njohjen si dhe mijëra ndjenja, aftësi e mundësi, edhe dënimi i tij ka për të qenë i të njëjtave përmasa. Sidomos po qe se zemra, vendi i shfaqjeve të posaçme, e cila duhet të mbushet dhe ngopet me afërsinë, respektin dhe dashurinë ndaj Allahut e jo të hapë dyert ndaj tjetër gjëje e tjetërkujt, merret nëpër këmbë nga egoja, atëherë njeriu do të bjerë në nivelin e një guri si lëndë djegëse e xhehenemit, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atëherë, njeriu duhet ta përdorë vullnetin me vend, t'ia kushtojë zemrën të Zot të zemrës dhe të shkojë tek Ai me zemër të pastër.

Pyetje: Si ndodh që, gjatë krijimit të shpirtrave ose kur njeriu është ende fetus në barkun e nënës, për të të shkruhet se do të bëhet zotëri apo shërbëtor, se do të shkojë në xhenet ose xhehenem?

Përgjigje: Megjithëse kjo çështje u shpjegua në mënyrë të mjaftueshme në vendin e duhur, këtu le të përpiqemi ta parashtrojmë me pak rreshta.

Para së gjithash, Allahu shkruan se si ka për t'u sjellë njeriu me vullnetin e vet, se do të kryejë akte për xhenet apo akte për xhehenem, me anë të diturisë së Tij të pafundme, sepse i di qysh në pafillimshmëri me diturinë e tij të pafundme, kurse njeriu bëhet i denjë për xhenet ose xhehenem, bëhet zotëri ose shërbëtor jo se Allahu ka shkruar ashtu për të.

E dyta, Allahu, jo vetëm di se në ç'drejtim do ta përdorë njeriu vullnetin e tij, por di edhe të gjitha shkaqet që ndikojnë e do të ndikojnë mbi aktet e tij dhe sipas këtyre gjërave shkruan. Allahu e di se si do të jetë ndikimi dhe edukata e familjes së tij mbi të, se në ç'drejtim do ta ndikojë atë mjedisi, cilat do të jenë pretekstet që çojnë në besim ose mohim dhe se si ka për t'i kapërcyer ai të gjitha këto.

Ne nuk mund ta dimë nëse njeriu do të bëhet për xhenet apo xhehenem, sepse s'dimë gjë sepse s'e njohim kaderin. Ne gjykojmë faktet e jashtme dhe, nëse ka fjalë dhe veprime që çojnë në mohim, më e shumta i themi "mohues", por nuk mund t'i themi se është për në xhehenem. Meqë s'e njohim të vërtetën, zemrën e atij njeriu, dhe se si ka për ta dhënë frymën e fundit, këto ia lëmë Allahut. Dikush që sot e njihni për ateist, vjen një ditë dhe e shihni se është bërë një besimtar i kompletuar. Me që është vendi, do të tregoj një ngjarje nga Gjermania, të dëshmuar nga një shoku ynë funksionar feje. Xhamitë janë të hapura për këdo, bëhen biseda dhe përpjekje për t'i shpjeguar disa çështje me rëndësi. Një i ri që vjen të dëgjojë, thotë: "A e dini, unë jam komunist!" A mund t'i thuhet menjëherë këtij të riu se e ka vendin në xhehenem? Kalojnë ditë, i riu njihet me disa shokë, mëson prej tyre me një mënyrë të përshtatshme mbi besimin dhe çështjet fetare dhe ja tek duket një të shtunë në xhami së bashku me një shok tjetër për të falur namazin e jacisë... E ka sjellë edhe shokun me vete që të mësojë disa gjëra!

E, tani, ç'do të fitonit po ta kishit refuzuar qysh në çastin e parë duke i ngjitur vulën e të dënuarit me xhehenem? A s'do të turpëroheshit kur ta shihnit atë të shtunë mbrëma me ndryshimin që kishte bërë? Nuk është as detyra, as kompetenca jonë të konkludojmë dhe vendosim mbi njerëzit!

Le të shohim edhe fjalët e një të riu tjetër që u bëhen interpretë të ndjenjave të brezit tonë.

"Unë merrja pjesë në Këln në marshimet nën flamujt e kuq. Një ditë shkova te shokët e rinj. Atje bëheshin pyetje dhe jepeshin përgjigje. Meqë isha simpatizant i komunizmit, ndjeja shqetësim, dëgjoja me shumë kujdes dhe rrija në pritë duke pasur dyshim se mos sulmojnë totemet e mia, mos thonë fjalë të këqija për to, mos hedhin parulla. Nuk ndodhi asgjë nga këto, por u fol për çështje besimi që s'i kisha dëgjuar asnjëherë. Ndryshe, do të mbetesha i pakënaqur dhe do të vazhdoja me zakonet e mia të vjetra si pijet, etj."

Prapë po pyesim: Si do ta dënonit me xhehenem këtë të ri që sot është bërë një besimtar i mirë dhe vrapon majtas e djathtas me makinën e vet për të bërë ndonjë shërbim?

Siç kuptohet edhe nga shembujt që dhamë, meqë Allahu e di se si do ta përdorë njeriu vullnetin dhe si do ta japë frymën e fundit, shkruan qysh në botën e shpirtrave ose në barkun e nënës se ç'do të bëhet ai, zotëri, apo shërbëtor, për në xhenet apo xhehenem. Siç shprehet hadithi, porosia profetike, "njeriu, si të rrojë, ashtu vdes dhe, si të vdesë, ashtu ringjallet"! Ajo që na takon ne, është të përpiqemi dhe punojmë pa e prerë shpresën te Allahu dhe pa e parë të ardhmen e brezit tonë errësirë, të tregojmë zell në rrugën për t'u bërë pretekst për besimin dhe orientimin e njerëzve në rrugën e drejtë!

Pyetje: Ç'do të thotë natyrë islame? Ç'është orientimi dhe si bëhet preteksti për orientim?

Përgjigje: Në një hadith autentik thuhet: "Çdo njeri që lind, lind me natyrë islame. Pastaj prindërit e bëjnë atë krishter, çifut ose zoroastrian (ose një nga izmat e sotme)!"

a. Çdo njeri lind me krijim të pastër, të panjollë dhe me një natyrë të përshtatshme për besim dhe Islam

Njeriu lind si një letër e bardhë ku mund të shkruhet çdo gjë, si një shirit elektromagnetik ku s'është regjistruar asgjë, si një mineral i shkrirë që pret të futet në kallëpë, si një fidan i njomë që mund ta përkulësh nga të duash.

Për këtë arsye, ç't'u tregosh fëmijëve të moshës 5-15 vjeç, e regjistrojnë menjëherë në mendje dhe kujtesë, e ruajnë me dashuri në zemër, gjë që ka shumë rëndësi për edukimin e besimit. Për shembull, sapo t'u thuash se edhe fshati më i vogël e ka një kryeplak, se gjilpëra e ka mjeshtrin që e ka bërë, kështu që, edhe tërë kjo gjithësi e madhe e ka një Zot që është Allahu, ata e kuptojnë mesazhin sepse, në sajë të natyrës së pastër që kanë, s'i ngatërron e s'i pengon asgjë. Në lidhje me natyrën e pastër, ne kemi konceptet dhe kriteret tona me të cilat jemi mësuar dhe jemi në gjendje t'i dallojmë natyrat e pastra sapo t'i shohim, sapo ato të përputhen me konceptet dhe kriteret tona.

b. Natyra e pastër mund të fëlliqet dhe të atrofizohet me anë të mohimit dhe mëkateve

Me mohim dhe mëkate, njeriu konsiderohet se i ka mbyllur sytë ndaj argumenteve dhe provave në përmasa universale, se i ka zënë veshët, se e ka shuar ndërgjegjen, e ka atrofizuar natyrën dhe, për pasojë, e ka privuar veten nga të gjitha burimet e dritave, është groposur në errësira dhe mbi natyrën e tij të pastër në origjinë, ka lyer njolla të zeza që Allahu s'i do. Në antagonizëm me këtë, me besim dhe akte të mira, njeriu e ruan natyrën e tij në origjinë të pastër. Atëherë, mund të themi se, në natyrën e njeriut, besimi është esencial, kurse mohimi, aksidental. Natyra e pastër në krijim, mund të fëlliqet më pas. Po qe se gjendja e fillimit e krijimit nuk ruhet, nuk i shkohet në ndihmë dhe nuk merren masat e duhura në këtë drejtim, është krejt e mundur që ai të bëhet ose krishter, ose çifut, ose zoroastrian, ose çfarëdo gjëje tjetër që mund t'ju shkojë nëpërmend!

c. Pasi fëlliqet dhe prishet natyra e pastër, njeriu fiton një natyrë të dytë të prishur

Zogu që del nga veza është zog edhe pse s'fluturon dot. Ai është në krijim i përshtatshëm për të fluturuar dhe i pajisur me aftësinë dhe prirjen e fluturimit. Ne vëmë re, gjatë periudhës së daljes së pendëve, se zogu bie e ngrihet në përpjekjet për të fluturuar dhe themi se ai zog ka për të fluturuar. Por po qe se gjatë kësaj periudhe ndërhyjnë shkaqe dhe faktorë që i cenojnë veçoritë dhe mundësitë e bashkëlindura të zogut dhe ia heqin aftësinë për të fluturuar, ai s'do të fluturojë edhe pse është zog. Kështu është edhe mohimi. Duke e atrofizuar krijimin e pastër dhe të pajisur me aftësi të shumta të njeriut, mohimi formon tek ai një natyrë të dytë të prishur *duke e bërë të paaftë për të fluturuar*! Siç thoshim për zogun se do të fluturojë sepse është zog, edhe për njeriun e porsalindur themi se është mysliman ose se ka për t'u bërë mysliman. Por ç'e do se, me kohë, mbi të fryjnë erëra të dëmshme, edhe ai vetë e përdor vullnetin në drejtime të dëmshme, për pasojë e prish natyrën e pastër dhe bëhet diçka tjetër.

ç. Në të gjitha këto çështje që i grumbulluam këtu për t'i trajtuar, ekziston mundësia që gjithmonë të na dalin para dy specifika lidhur me çështjen e kaderit: shkaqet e jashtme dhe vullneti.

Sigurisht, çdo njeri që lind, lind me natyrë islame, por faktorët e jashtëm si prindërit, shokët, mjedisi, shoqëria dhe shkolla, si dhe vullneti i cili do t'i përdorë këta në favor apo në disfavor të vet, ndikon mbi natyrën në drejtim pozitiv ose negativ. Kurse kaderi, duke i futur në llogari të gjitha këto, shkruhet kështu: "Ky njeri do ta mbajë natyrën të pastër dhe do të bëhet i lartë"... ose, "Ky njeri do ta prishë natyrën, do të fundoset në mohim dhe do të bëhet i poshtër."

Orientimi në rrugën e drejtë. Orientimi në rrugën e drejtë ose, shkurt, orientimi, udhëzimi, është një dritë që Allahu ia ndez njeriut në botën e brendshme pasi ai ta përdorë vullnetin e tij të pjesshëm në drejtim pozitiv dhe në favor të vet. Siç e theksuam edhe më parë, edhe orientimi, edhe çorientimi realizohen me anë të aktit krijues të Allahut. Në një ajet thuhet: *"Po të donte Zoti yt, të gjithë ç'janë mbi tokë i bënte të besonin!"* (Junus, 99) Kurse në një ajet tjetër, thuhet: *"Po të donte, Allahu i mblidhte ata në rrugë të drejtë!"* (En'am, 35) Madje, Profetit i thuhet: *"Pa dyshim, ti s'mund t'i bësh të vdekurit të binden, t'i bësh shurdhët të ta dëgjojnë fjalën... dhe ti s'je orientuesi i të verbërve nga rruga e shtrembër e tyre për në rrugë të drejtë!"* (Rum, 52-53). Fundja, edhe ne, në çdo rekat të namazit i lutemi Zotit të na orientojë dhe dyzet herë në ditë themi: *"Ihdina siratal mustakim", "Shtyna ne në rrugë të drejtë"!*

Edhe ajeti si më poshtë është nga ajetet që duhen përmendur rreth kësaj çështjeje: *"Ti nuk mund ta orientosh dot njeriun që do, por Allahu e orienton atë që do!"* (Kasas, 56) Edhe Profeti porosit: *"Unë u dërgova si ftues i njerëzve në besim dhe në rrugën e drejtë. Është Allahu që do t'i çojë ata në rrugë të drejtë dhe që do t'ua shtresojë besimin në zemër!"* Edhe djalli i tregon të zbukuruara mohimin, çorientimin dhe mëkatet, u fut zemrave dyshim e lëkundje, por edhe çorientimin, edhe mëkatet, Allahu i krijon.

Të bëhesh pretekst për orientim

Në një ajet thuhet: *"Pa dyshim, ti je orientues në rrugë të drejtë!"* (Shura, 52) Kurse në një ajet tjetër, thuhet: *"Pa dyshim, ti i thërret dhe i fton ata në rrugë të drejtë!"* (Muminun, 73) Ndërsa në ajetin e parë bëhet fjalë për veprimtarinë orientuese, në të dytin, për ftesën. Siç kuptohet nga ajetet, Profeti ynë është pretekst për orientim, kurse djalli, për çorientim dhe mëkat, ndërkaq që, siç e theksuam më lart, edhe orientimin, edhe çorientimin i realizon Allahu.

Duke filluar me profetët, Allahu ka krijuar pretekste të ndryshme orientimi. Po qe se njerëzit nuk i përvetësojnë pretekstet në fjalë dhe nuk e përdorin vullnetin në drejtim të orientimit, Allahu nuk e krijon për ta orientimin, domethënë pretekstet i krijon, por përfundimet, jo. Për shembull, në lidhje me këtë çështje, Kurani thotë: *"Ne e patëm orientuar fisin e Themudit, por ata zgjodhën verbërinë në vend të*

orientimit!" (Fussilet, 17) Kjo do të thotë se njëri aspekt i çështjes, që i përket njeriut, ka të bëjë me prirjet dhe vullnetin e tij, kurse aspekti tjetër, që i përket Allahut, ka të bëjë me krijimin, realizimin e orientimit apo çorientimit.

Duhen kërkuar pretekstet që çojnë në orientim

Duke u përqendruar, në njërën anë, në kundërshtimin e shkaqeve dhe preteksteve që çojnë në mohim dhe që krijojnë pritë para orientimit, në anën tjetër Kurani nxit pretekstet që çojnë te e vërteta. E thënë ndryshe, ndërsa nga njëra anë na mëson se si t'u shmangemi cilësive që i bëhen pengesë besimit, si mendjemadhësia, krenaria, vetëpëlqimi, kryelartësia, nënvleftësimi i tjetrit, parapëlqimi i kësaj bote dhe injoranca, nga ana tjetër na nxit të lexojmë, të mendojmë, të bëjmë kërkime në gjithësi, të nxjerrim mësime nga pësimet, të gjykojmë, të dëgjojmë ata që bisedojnë në emër të Zotit dhe të ndjekim rrugën e tyre të ndriçuar.

Në Kuran, fjala "vesite", pretekst përdoret në dy vende. Njëri nga këta është ajeti 35 i sures Maide: *"O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun, tregohuni të respektuar ndaj Zotit tuaj, kërkoni pretekste për t'iu afruar Atij dhe luftoni që të shpëtoni!"* Kurse në ajete të tjera thuhet: *"Dhe ata që luftojnë në rrugën tonë, Ne pa dyshim që i fusim në rrugët tona të dobishme!"* (Ankebut, 69) *"Atij që frikësohet nga Allahu, Allahu i krijon një rrugëdalje (pretekst)!"* (Talak, 2)

Siç kuptohet edhe nga ajetet, Allahu kurrë nuk i çorienton ata që ecin në rrugën e Tij.

Në jetën e tij të nderuar, Profeti e ka kryer gjer në fund detyrën e pretekstit për orientim. Allahu e pati vënë në veprim të Dërguarin e Tij duke e urdhëruar: *"Paralajmëroji njerëzit e tu më të afërt!"* (Shuara, 214) *"Kujto dhe këshillo!"* (Gashije, 21) *"Dhe shpalle hapur atë që të është urdhëruar!"* (Hixhr, 94)

Fakti që në ditën e triumfit të Mekës, Profeti i fali me fjalët *"shkoni, jeni të lirë"*, ata që s'patën lënë të keqe pa i bërë kur pati shkuar në Taif si interpretues i të vërtetës, fakti që i porosiste shokët që kishin nxjerrë shpatat për t'ua hequr kokat atyre që i patën luftuar me aq egërsi, se armiku më parë duhet këshilluar dhe ftuar për të besuar, fakti që i thoshte Aliut se *"orientimi i një njeriu me dorën e tij ishte më i vlefshëm se çdo gjë tjetër mbi të cilën lindte dielli"*, si dhe shumë e shumë shembuj të tjerë tregojnë se ç'rëndësi të madhe ka preteksti në orientimin e njerëzve në rrugë të drejtë!

Ai që bëhet pretekst, fiton mirësi sa dhe ai që e kryen atë punë për të cilën tjetri iu bë pretekst. Profeti na porosit: *"Atij që hap një shteg të mirë dhe bëhet pretekst për dobi, i jepen po aq mirësi që u jepen pa të metë atyre që ecin në atë rrugë dhe atij që hap një shteg të keq dhe bëhet pretekst për mëkat, i ngarkohen po aq mëkate sa ç'u ngarkohen atyre që ecin në atë rrugë!"* Po qe se keni ndërtuar ose jeni bërë pretekst për të ndërtuar një xhami, në librin tuaj do të shkruhet një mirësi sa mirësitë e të gjithë atyre që falen në atë xhami; po kështu, nëse në rrugën për të rritur e përgatitur brezat që do ta mbushin atë xhami, keni treguar zell e përpjekje, keni ngritur, për këtë qëllim, institucione, keni dhënë bursa, keni blerë libra e fletore për t'i shpërndarë falas, edhe ju do të fitoni mirësi sa mirësitë e të gjithë atyre për të cilët jeni bërë pretekst në rrugën e drejtë dhe libri i punëve tuaja të mira kurrë s'ka për t'u mbyllur.

Ndërkaq, nuk duhet harruar se preteksti për aktin e mirë mbetet vetëm pretekst, sepse krijuesi i aktit të mirë është Allahu. Në këtë kuptim, sa ç'është qëndrim i skajshëm përvetësimi i meritave nga ai që është bërë pretekst, po aq është qëndrim i skajshëm edhe atribuimi i meritave atij që është bërë pretekst. Falënderimi dhe mirënjohja i përkasin vetëm Allahut!

Këtu ka rëndësi të theksohet kjo specifikë: T'ia kushtosh falënderimin dhe mirënjohjen vetëm Allahut dhe ta dish se orientimin e bën vetëm Ai, nuk është pengesë për ta respektuar dhe falënderuar personin që është bërë pretekst për orientimin. Në këtë gjë duhet të mbajmë ekuilibrin duke vepruar sipas porosive dhe kritereve të Profetit.

Po, në çdo vend ku njeriu futet me vullnetin e tij, Allahu krijon edhe të mirën, edhe të keqen. Por, disa herë, sipas ligjeve të faljes dhe dhurimit, nuk e krijon të keqen, sepse Ai nuk e pëlqen të keqen. Megjithëkëtë, po qe se njeriu ngul këmbë për ta përdorur vullnetin për të keq, Allahu e krijon të keqen edhe pse s'i pëlqen, sepse bota është një vend prove, ndeshjeje, dhe adhurimi. Mbetet të themi se nuk është krijimi i të keqes e keqja vetë, por rezultati i saj, se në shumë gjëra që ne na duken si të këqija, ka shumë dobi të rëndësishme, se çdo gjë zhvillohet në një kuadër urtësie dhe dobie.